

INSTITUTI ALBANOLOGJIK

Dr Nuhi Veselaj

**RRETH FORMËZIMIT TË EMËRTIMIT
TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT
NË GJUHËN SHQIPE**

Prishtinë, 2013

Recensues: Prof. Dr. Latif Mulaku
Dr. Mehmet Halimi

P Ë R M B A J T J A

Në vend të parathënies
Nga vlerësimi i ak. Rexhep Ismajlit
Pjesë nga vlerësimi i recensuesve.
HYRJE

Kreu I

RRETH PËRKUFIZIMIT TË TERMIT "PROFESION" DHE TOGFJALËSHIT "NJERIU SIPAS PROFESIONIT"

1. Profesioni si veprimtari specifike e njeriut
2. Termi togfjalësh "njeriu sipas profesionit" në përfaqje me sinonimet përkatëse
3. Njeriu sipas profesionit dhe "vendi i punës"
4. Parimet rreth klasifikimit të profesioneve
5. Rreth strukturës së klasifikimit të profesioneve ...
Paraqitja skematike piramidore e sasisë së profesioneve sipas niveleve të caktuara..
Skema e klasifikimit të profesioneve sipas shkallëve të ndërlikueshmërisë së punëve
6. Harmonizimi i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit çështje e hapur e qendrave shqipfolëse
- Shembuj ilustrues të titujve profesionalë
Pasqyra e disa emërtimeve në raportin Kosovë-Shqipëri Emërtimet e njerëzve sipas profesionit çështje e hapur shoqërore
8. Vendi i emërtimeve të njeriut sipas profesionit
Përmblyllje

KREU II

VËSHTRIM KRONOLOGJIK I FORMËZIMIT TË EMËRTIMEVE TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT NË GJUHËN SHQIPE SIPAS

A. PERIUDHA PARA LUFTËS II BOTËRORE

1. Etapa para Rilindjes Kombëtare
 - a) Nga shkrimet e vjetra geqe (të konfesionit katolik)
Pasqyra e numrit të emrave me prapashtesim te Buzuku e F. Bardhi...
 - b) Nga shkrimet e vjetra toske (të konfesionit ortodoks)
 - c) Nga shkrimet e arbëreshëve të Italisë..
 - ç) Nga shkrimet e bejtenxhinjve
Përmblyllje ...
2. Etapa e Rilindjes Kombëtare ...

- 1) Nga veprat e Naimit dhe të Samiut
- 3) Nga Fjalori i "Bashkimit" ...
Përmbyllje
- 3. Etapa ndërmjet dy luftrave botërore .
 - 1) Nga Fjalori i Leottit dhe Fjalori i Kordinianos
 - 2) Nga shkrimet e A. Xhuvanit të kësaj etape
 Përmbyllje
- B. PERIUDHA PAS LUFTËS II BOTËRORE .**
 - 1. Etapa e konsolidimit
 - a) Faza e parë e etapës së konsolidimit
 - 1) Nga Fjalori serbokroatisht-shqip (1947)
 - 2) Nga Fjalori i H. Bariqit (1950)..
 - 3) Nga Fjalori i S. Mannit..
 - 4) Nga Fjalori i Sokol Dobroshit .
 - 5) Nga Fjalori rusisht-shqip (1954) .
 - b) Faza e dytë e etapës së konsolidimit ..
 - 1) Nga Fjalori i gjuhës shqipe (1954)
 - 2) Nga Fjalori terminologjik serbokroatisht-shqip (1961
 - 3) Nga fjalorët e terminologjisë tekniko-shkencore ...
 - 2. Etapa e normëzimit
 - a) Faza e parë e etapës së normëzimit
 - 1) Nga Fjalori serbokroatisht-shqip (1974)
 - 2) Nga Fjalori shqip-serbokroatisht (1976).....
 - b) Faza e dytë e etapës së normëzimit
 - 1) Nga Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe.....
 - 2) Nga Fjalori shqip-frëngjisht i V. Kokonës.....
 - c) Faza e tretë e etapës së normëzimit
 - 1) Nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980)...
 - 2) Ng Fjalori shqip-serbokroatisht (1981)
 - ç) Faza e katërt e etapës së normëzimit
 - 1) Nga Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja të M. Ndrecës...
 - 2) Nga Fjalori i fjalëve të huaja
 - 3) Nga fjalorët terminologjikë të fushës ekonomike të H. Goranit
 - 4) Nga Fjalori komparativ i termave ushtarakë ...
 - 5) Nga Fjalori frëngjisht-shqip i M. Bejtës.....
 - 6) Nga Fjalori i shqipes së sotme (1984)
- C. NGA DORACAKËT MBI NOMENKLATURËN E PROFESIONEVE TE NE**
Përmbyllje.

KREU III
FORMËZIMI I EMËRTIMEVE TË NJERËZVE SIPAS
PROFESIONIT NË GJUHËN SHQIPE..

A. RRUGËT E FORMËZIMIT TË EMËRTIMEVE TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT...

1. Emërtimet autoktone .
 - a) Krijimet me autoktoni të qartë .
 - b) Krijimet a formëzimet me elemente plotësisht të përvetësuara
2. Emërtimet si terma të huazuar a si fjalë ndërkombëtare .
 - a) Emërtimet me cilësi ndërkombëtarizmi
 - b) Emërtimet pa cilësi ndërkombëtarizmi

B. EMËRTIMET E NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT MBI BAZË TË TIPAVE KUPTIMORË

1. Emërtimet sipas procesit të punës
2. Emërtimet sipas mjetit a veglës së punës
3. Emërtimet sipas produktit të punës
4. Emërtimet sipas lëndës a objektit të punës
5. Emërtimet sipas vendit të punës (lokalit).
6. Emërtimet sipas degës a veprimtarisë së caktuar shoqërore - ekonomike

Përmbyllje .

Skema e zbrërthimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit mbi bazë të tipave kuptimorë

C. RRETH STRUKTURËS SË FORMIMIT TË EMRAVE TË NJERËZVE SIPAS VEPRIMTARISË SË TYRE

(1) Emrat e prejardhur me prapashtesim...

Tabela e numrit të emrave të njerëzve sipas profesionit sipas fjalorëve përkatës

a. EMRAT E NJERËZVE SIPAS VEPRIMTARISË ME PRAPASHTESËN -S

1. Emrat më -S me temë emërore.....
2. Emrat më -S me temë foljore.....

Pasqyra e procesit të formimit të emrave foljorë të vepruesit

I. Nga foljet vokalike me zanore e togzanor....

- 1) Foljet më -OJ dhe emrat e vepruesit.....
Skema e procesit të zhvillimit të disa foljeve më -OJ..
- 2) Foljet më -UAJ dhe emrat e vepruesit
- Pasqyra e zhvillimit të foljeve më -UAJ.....
- 3) Foljet më -EJ dhe emrat e vepruesit
- 4) Foljet më -IJ dhe emrat e vepruesit
- 5) Foljet më -UJ dhe emrat e vepruesit
- 6) Foljet më -ËJ dhe emrat e vepruesit.....
- 7) Foljet më -YJ dhe emrat e vepruesit
- 8) Foljet më -AJ dhe emrat e vepruesit
- 9) Foljet më -IEJ dhe emrat e vepruesit
- 10) Foljet më -YEJ dhe emrat e vepruesit.....

II. Foljet vokalike me mbaresë zero dhe emrat e vepruesit

III. Foljet e parregullta (supletive dhe jo supletive) dhe emrat e vepruesit

IV. Foljet me temë në bashkëtingëllore

1. Foljet me temë në bashkëtingëllore pa cilësinë e prapashtesës dhe emrat e vepruesit
2. Foljet me bashkëtingëllore a formant me cilësinë e prapashtesës së mëvetësishme dhe emrat e vepruesit

Përmbyllje

b. EMRAT E NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT ME PRAPASHTESA TË TJERA

- 1) Emrat me prapashtesën -TAR
- 2) Emrat me prapashtesën -AR
- 3) Emrat me prapashtesën -OR
- 4) Emrat me prapashtesën -TOR
- 5) Emrat me prapashtesën -XHI
- 6) Emrat me prapashtesën -IST
- 7) Emrat me prapashtesën -ER
- 8) Emrat me prapashtesën -IER
- 9) Emrat me prapashtesën -AN
- 10) Emrat me formant -ANT
- 11) Emrat me fundorin -ENT
- 12) Emrat me fundorin -IK
13. Emrat me formantë a fundorë të tjerë.....

- (2) Emrat e parmë si emërtime të njerëzve sipasprofesioni
- (3) Emrat me përngjitje dhe prapashtesim njëherazi..
- (4) Emrat e përbërë (kompozitat).....

Ç. EMËRTIMET JONJËFJALËSHE TË PROFESIONEVE

TË FORMËZUARA NGA SHTYTËS TË JASHTËM

1. Emërtimet me dyfishim a gërshetim profesionesh
2. Emërtimet togfjalësha.....

Shembuj lajthitjesh përmbajtësore të disa emërtimeve togfjalësha te ne..

Përmbyllje....

Kreu IV

RRETH EMËRTIMEVE TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT
ME GJINI PËRFAQËSUESE FEMËRORE.....

1. Ndërtimi i emërtimeve të grave mbi bazë të emrit në gjininë mashkullore duke marrë prapashtesën femërorëzuese -E
2. Ndërtimi i emërtimeve të grave mbi bazë të emrit në gjininë mashkullore duke marrë prapashtesën -eshë...
3. Emërtime të pavarura të grave me prapashtesën -ATORE ..
4. Emërtime me prapashtesa të tjera speciale femërorëzuese jo prodhimitare ..
5. Disa emërtime të grave të ngulitura në shqipe si emra të parmë
6. Emërtime të pavarura të grave sipas veprimtarisë ..
7. Rreth kërkesave në rritje lidhur me emërtimin e grave sipas profesionit
8. Formanti fjalëformues prapashtesor i emërtimit

- të grave në shërbim të diferencimit stilistik .
9. Dukuria e homonimisë dhe emërtimet e grave
Sipas profesionit
Shembuj të "ikjes" së homonimisë me dallim gjinie
Përmbyllje

Kreu V
EMËRTIMET E NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT VËSHTRUAR
NGA ASPEKTI I LIDHJES.....

1. Sinonimia në emërtimet e njerëzve sipas profesionit
 - a) Disa shembuj të sinonimisë gramatikore..
 - b) Disa shembuj të sinonimisë leksikore .
2. Antonimia në emërtimet e njerëzve sipas profesionit ..
3. Homonimia në emërtimet e njerëzve sipas profesionit
Përmbyllje

Kreu VI
RRETH DALLIMIT NDËRTIMOR E KUPTIMOR TË EMËRTIMEVE TË
NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT PA E ME PROFILIZIM TË NGUSHTË
Skema e vargut fjalëformues të shkallëzimit pa e me profilizim të ngushtë profesioni

Kreu VII
VËZHGIMET QENËSORE MBI EMËRTIMET E NJERËZVE
SIPAS PROFESIONIT NË GJUHËN SHQIPE
DHE REZULTATET PËRMBYLLËSE ..
Përfundim ..
Literatura

Në vend të parathënies

Në vend të prathëmies, së pari, po japim vlerësimin e akad. Rexhep Ismajlit, së dyti pjesë nga vlerësimi i recensuesve dhe së treti, ca sqarime pse është zvarritur deri tash botimi i kësaj vepre.

1. Nga vlerësimi i ak. Rexhep Ismajlit, *

Tema “**Struktura fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe**” e zgjedhur për disertacion doktrate nga Mr. Nuhi Veselaj është vlerësuar si dyfish e rëndësishme për studimet e viteve ‘80 të shqipes: së pari, për njohjen e thelluar teorike të proceseve dhe të rrugëve të fjalëformimit në gjuhën shqipe dhe së dyti, për aspektet me peshë praktike që implikonte tema. Proceset e fjalëformimit në përgjithësi në gjuhën shqipe dhe emërtimet e njerëzve sipas profesionit në këtë kuadër, përkisnin një fushe të tretë me rëndësi - atë të terminologjisë. Tematikë kjo që hapej ndaj çështjes së organizimit të shoqërisë shqiptare policentrike, ku funksiononte kjo terminologji. Detyrat e studiuesit mr. Nuhi Veselaj në këtë kuadër dilnin kështu edhe më të mëdha dhe më komplekse.

Disertacionin e tij të doktoratës “*Struktura fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe*” ai e ka përqëndruar në hulumtimin dhe ndriçimin e mundësive leksiko-gramatikore që ka shqipja për formimin e emërtimeve të përmendura në përgjithësi. Materien e studiuar N. Veselaj e ka organizuar në disertacionin e tij në shtatë kapituj të gjerë:

I. Rreth përkufizimi të termit **profesion**, përkatësisht togfjalëshit **njëriu sipas profesionit**;

II. Vështrim kronologjik i formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe sipas burimeve përkatëse;

III. Rreth emërtimeve të njerëzve sipas profesionit me gjini përfaqësuese femërore;

IV. Emërtimet e njerëzve sipas profesionit nga aspekti i lidhjes së tyre nga kuptimi dhe forma;

V. Rreth dallimit ndërtimor e kuptimor të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit pa e me profilizim të ngushte dhe

VI. Vëzhgimet qenësore mbi emërtimet e njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe

dhe rezultatet përmbyllëse.

Derisa në pjesët hyrëse është dashur të merret me përkufizimin e kritereve mbi bazë të të cilave dallohen elementet që hyjnë në ndërtimin e termave të rinj, me shpjegimet e procesve fjalëformuese në fushat përkatëse, menjëherë pastaj atij i është dashur të ndërmarrë një kufizim kronologjik në dy periudha të mëdha në studimin e këtyre proceseve të formimit të emërtimeve në gjuhën shqipe: periudha para Luftës II Botërore dhe periudha pas Luftës II Botërore. Në këtë kuadër janë hulumtuar jo vetëm fjalorët dhe burimet e ngjashme, por edhe manualët e ndryshëm normativë për përcaktimin juridiko-profesional dhe të nomenklaturave të profesioneve, të cilat kanë mundur të ndikojnë në favorizimin e proceseve të caktuara. Shquhet në këtë pikë analiza që bën N. Veselaj për emërtimet e njerëzve sipas profesionit mbi bazë të tipave kuptimorë dhe pjesa tjetër “Rreth strukturës së formimit të emërtimeve të njerëve sipas profesionit sipas veprimtarisë së tyre”.

N.Veselaj është përqendruar në mënyrë të veçantë në studimin dhe analizën e tipave dhe të nëntipave të emërtimeve të parë nga aspekti i ndërtimit të tyre, që dalin zakonisht me gjininë përfaqësuese mashkullore, qoftë mbi bazë të temës foljore, qoftë mbi temë emërore sipas prapashtesave speciale a të specifikuar e të tjera, por nuk i ka harruar as emërtimet e njerëzve sipas profesionit me gjini përfaqësuese femërore. Pjesa e quajtur “emërtimet e njerëzve sipas profesionit nga aspekti i lidhjes së tyre nga kuptimi dhe forma” dhe nxjerrja e skemës së vargut fjalëformuese të shkallëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit pa dhe me profilizim të ngushtë, mund të konsiderohen rezultat i veçantë i këtij disertacioni.

Disertacioni i doktoratës i mr. Nuhi Veselajt “**Struktura fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe**” është rezultat i një pune të ngulmët dhe me cilësi shkencore mbi një temë me rëndësi, që është: studimi i proceseve fjalëformuese të shqipes me vështrim të veçantë në proceset e fjalëformimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit. Si i këtillë ky studim paraqet ndihmesë dhe për pasurimin e leksikut terminologjik në fushën përkatëse në gjuhën shqipe.

Prishtinë, më 25.04.1997

Ak. prof. dr. Rexhep Ismajli, d.v.

**Fjalë e mbajtur me rastin e promovimit të doktoratës, më 25.04.1997.*

2. Pjesë nga vlerësimi i recensuesve

Vepra shkencore nga fusha e gjuhësisë e dr. Nuhi Veselajt me titull “*Struktura fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipa sprofesionit në gjuhën shqipe*” radhitet ndër studimet e rralla dhe shumë të rëndësishme në fushën e fjalëformimit, veçanërisht në

fushën e formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe. Prandaj vepra në fjalë paraqet një ndihmesë të ndjeshme dhe ka herë tepër të nevojshme në fushën e terminologjis shqiptare.

Autori veprën e vet e organizon në shtatë krerë, duke e ndarë atë edhe në nënkrerë të shumtë, arrin me sukses të ndriçojë të gjitha mundësitë gramatikore-leksikore në fushën e fjalëformimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit të tyre, fushë kjo shumë pak e studiuar deri më tani te ne.

Veprës i paraprin një hyrje jo fort e gjatë por e thukët motivuese, ku autori shpjegon qëllimin dhe nevojën e ngutshme e të domosdoshme për problemet e përditshme të formëzimit dhe të fjalëformimit të terminologjisë tekniko-shkencore, e në kuadër të saj edhe të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në ndërmarrje të ndryshme industriale, ku ai ishte i shtrënguar të punonte si përkthyes në gjuhën shqipe.

Pason kreu I, bukur i gjatë, ku autori me kritere shkencore dallon finesat gjuhësore, që inkuadrohen në “prodhimin” apo “ndërtimin”, siç e quan ai, të termave të rinj fjalëformues, ku shihet se autori spikat dallime e përkufizime të hollësishme, duke shpjeguar qartë e drejtë definicionet fjalëformuese në fushën e profesioneve përkatëse.

Autori me zell e përkushtim të veçantë në krerët vijues iu ka rrekë çështjes së fjalëformimit, duke u heparur që nga periudha parashkrimore e gjuhës shqipe, ka shfrytëzuar shkrimet e shkrimtarëve të vjetër shqiptarë e deri te shkrimet e sotme. Ka marrë në shqyrtim të gjithë fjalorët njëgjuhësh e dygjuhësh, madje edhe shumëgjuhësh të botuar seri më tani të të gjitha llojeve e kategorive, ka bërë ndarjen e zhvillimit të fjalëformimit në periudha të ndryshme gjuhësore, ka shfrytëzuar një mal veprash studimore në fushën e shkencës së gjuhësisë në përgjithësi dhe të veprave leksikografike në veçanti. Ka ofruar zgjidhje të reja në këtë fushë të dijes gjuhësore, duke sjellë shembuj të shumtë konkretë, propozimet e veta i shpjegon dhe i sqaron bindshëm e në mënyrë shkencore. Ai shpeshherë nuk ngul këmbë në konstatimet e veta, por me modesti të një punonjësi shkencor, lë shteg të hapur, hap probleme të reja, që kërkojnë zgjidhje në një të ardhme të afërt. Sepse ai është i vetëdijshëm se në kuadër të një vepre shkencore as nuk mund të ndërthehen as të zgjidhen të gjitha problemet e terminologjisë gjuhësore në fushën e kulturës materiale dhe shpirtërore kombëtare shqiptare.

Është me rëndësi të veçantë që autori ka arritur ta shohë, ta ndjejë dhe ta kuptojë nevojën urgjente të fjalëformimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesioneve dhe të përpiqet që t’i zgjidhë ato në mënyrë të kënaqshme ose së paku t’i hapë problemet dhe t’i aktualizojë, duke nxitur kureshtjen dhe interesimin deri në atë shkallë e të kërkojë ndihmë nga gjuhëtarët a veçanërisht nga leksikografët shqiptarë.

Puna në studimin e fjalëformimit nuk është as e lehtë as e thjeshtë. Kjo punë kërkon vullnet, mund të pakursyer e kohë të vazhdueshme. I vetëdijshëm për këtë dr. Nuhi Veselaj me zell të madh, punë të pandërprerë, duke hulumtuar këllëfet e gjuhës dhe mundësitë e gjera e të pasura të fjalëformimit, ka shfjetuar me kujdes të veçantë studimor vepra të shumta letrare, fetare e shkencore, ka shfjetuar fjalorë të ndryshëm, I ka studiuar ata, e duke njohur mirë natyrën e shpirtin e gjuhës amtare, ka arritur të depërtojë në thellësitë e problemeve që kërkojnë zgjidhje të domosdoshme e të ngutshme.

Duke përfunduar vlerësimin tonë, të themi të përciptë, të veprës në fjalë, konstatojmë se dr. Nuhi Veselaj me këtë vepër shkencore paraqet një studim të rëndësishëm për gjuhësinë, veçanërisht për leksikologjinë dhe mundësitë e fjalëformimit në fushën e emërimit të profesioneve të ndryshme e të nduarduarta shoqërore.

Prandaj, duke pasur parasysh, në radhë të parë cilësinë e thellësinë shkencore të studimit në fjalë, nga njëra anë, dhe rëndësinë e studimit të mundësisë së pasurimit të gjuhës e të leksikut të shqipes në fushën e fjalëformimit, nga ana tjetër, vepra shkencore e dr. Nuhi Veselajt paraqet kontribut të rëndësishëm për zgjerimin edhe pasurimin e leksikut të gjuhës shqipe në fushën e fjalëformimit të emërimit të njerëzve të profesioneve të ndryshme shoqërore, botimi i kësaj vepre është me interes të veçantë për gjuhësinë tonë.

Prishtinë, 21 shkurt 1997

Recensues: 1. Prof. Dr. Latif Mulaku, d.v.
2. Dr. Mehmet Halimi, d.v.

3. Ca sqarime pse është zvarritur deri tash botimi i kësaj vepre

Ky punim, i filluar më herët, është kryer që në fillim të viteve '90, kur edhe u mbrojt si tezë doktorate. Po ato vite si botim i veçantë ishte përfshirë në planin botues të Instituti Albanologjik të Prishtinës, mirëpo për arsye të situatave të krijuara, sigurisht, jo vetëm për mungesë mjetesht materiale, mbeti pa e parë dritën e shtypit deri në ditët e sotme. Në të vërtetë, edhe vetë më tepër kam pasë insistuar të botoheshin punime të tjera ende jo të vlerësuara si kjo, ngase fundja, mendoja se kjo vepër tashmnë e kishte të siguruar vizën për botim dhe shpresoja që herdokur, pa e zvarritur shumë, Instituti do ta botonte. Madje një kopje (versioni i parë i këtij punimi) që i ishte dërguar prof. A. Kostallari ishte pronë e Institutit përkatës të Tiranës, madje edhe atje, me sa isha i informuar, punimi ishte vlerësuar shumë pozitivisht. Ndërkohë, sa për t'u rikujtuar faktorëve përkatës realitetin rreth ekzistencës së kësaj vepre, pjesë të kësaj teme kam shfrytëzuar në tri kumtesa, të lexuara dhe të botuara e para në revistën *Gjuha në shkollë* me titull: *Çështje rreth emërimit të profesioneve në shkollat tona* (1987) dhe dy të tjera në revistën **Seminari...** të Prishtinës: *Çështje të emërimit të njerëzve sipa profesionit* (1984) dhe *Rreth klasifikimit të prapashitesave në emërimitin e njerëzve sipas profesionit në shqipe, sipas tipave kuptimorë* (2003), ku është cekur sidomos në kuptesën e fundit, edhe titulli i kësaj vepre, i mbetur në dorëshkrim, paksa edhe me qëllim për të zgjuar kureshtjen e autoriteteve dhe të faktorëve përkatës për ta libërtuar këtë dorëshkrim për hir të vlerave të veçanta që kishte, megjithatë nuk ia dola, nuk qeshë i zoti me ia arritë qëllimit.

Kështu kaluan vite të tëra, ndërkohë futa në dorë edhe një pjesë të materialit të dëshiruar nga Shqipëria (dy guida zyrtare të emërtimeve të profesioneve) dhe, një emëror mjaft voluminoz me emërtimin e profesioneve nga Kosova, guida këto të cilat i konsultova dhe i vlerësova edhe në mënyrë kritike. Dhe materialin e tillë kritik me titull **Emërtesat e guidave të sotme zyrtare të profesioneve me shqipe të dëshiruar** (në prag të regjistrimit të popullsisë), e botova te *Zemra shqiptare.net* në tri vazhdime.(tetor 2010), lëndë kjo që mendoja se do ta bëjë efektin e vet tek faktorët përkatës të të dy qeverive përkatëse për t'i interesuar jo vetëm për vlerësimin e guidave por edhe për tërë tekstin integral kushtuar kësaj teme, sepse vërtet ky punim, bashkë me shtojcën për guidat do të ishte jo vetëm një kontribut për shqyrtim, por edhe si ndihmesë për zgjidhjen e shumë problemeve nga kjo fushë e terminologjisë. Përsëri isha i pazoti për të ngjallë interesimin e dëshiruar nga faktorët përkatës. .

Sidoqoftë, tashti, pasi e rilexova punimin, e pashë të arsyeshme që tekstin e disertacionit të doktoratës ta botojë veçan, pa vlerësimin nga kumtesat dhe guidat, ngase ato në njëfarë dore e kishin parë dritën e shtypit dhe për vlerat specifike që kanë, nëse krijohen kushte të favorshme do të mund të ribotohen, qoftë si broshurë në vete, qoftë edhe në ndonjë përmbledhje punimesh, ndërsa punimi i disertacionit, ndonëse i kryer para 20 e sa vitesh ende ruan veçori specifika të tjera, përkatësisht ende ruan freskinë, nuk e ka të humbur aktualitetin, ngase ka mjaft risime në përmbajtje.

Vërtet,, siç është edhe bindja e recensuesve, kjo vepër, do të jetë një ndihmesë e mirëpritur nga çdo lexues i interesuar e sidomos do t'u shërbejë ortologëve të gjuhës sonë standarde, të cilët janë të ballafaquar me një problematikë të tillë, të cilët për zgjidhjen e shumë çështjeve të hapura të kësaj natyre e më gjerë do t'u vijë si një përvojë e mërifilltë.

Falenderoj nga zemra investuesit, përndryshe edhe pse ky punim i vlerësuar lart në fushën e terminologjisë, sidomos në formëzimin e të fjalëformimit të emrave të njerëzve sipas profesionit etj., do të mriizonte keqas edhe më, pa marrë pjesë në rrezatimin shërues në rrugën e zgjidhjes së shumë problemeve të kësaj nënfushe terminologjike, për çka ka aq shumë nevojë gjuha jonë e dijes për të gjitha fushat e jetës e të veprimtarisë, duke filluar nga emërtimet e punëve dhe të detyrave, përkatësisht të formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit lidhur me punët më të thjeshta mendore e fizike me zejet e hershme, deri te ato më të ndërlikuarat nga jeta bashkëkohore, siç janë çështjet tekniko-teknologjike, ato organizative politike e ekonomike, elektronike, digjitale etj., të kushtëzuara dhe të diktuar këto edhe gjuhësisht nga globalizmi bashkëkohor botëror.

Prishtinë, janar 2013

H y r j e

Në ndërmarrjen industriale prodhuese “Uzina e amortizatorëve” - Prishtinë, ku isha i punësuar pa dëshirë si përkthyes, ngase me urdhër të organeve të pushtetit të atëhershëm, më ishte ndërprerë (ndaluar) puna në arsim e kudo në organizata shoqërore, duke bartur me vete sinqeritetin mësuesor me ndërgjegje të plotë për punë në dobi të arsimimit dhe kulturës së gjuhës sonë, tani i ballafaquar me probleme të përditshme të formëzimit dhe të fjalëformimit të terminologjisë teknike-shkencore, hetova se edhe këtu në ndërmarrje prodhuese, si në arsim do të mund ta jepja sadopak ndihmesën time, gjithashtu brenda *brerores së gjuhës shqipe*. Madje këtu në përputhje *me detyrat nga vendi i ri i punës në kuadër të “klasës punëtore”*, mund ta jepja kontributin tim, qoftë në të shtruarit a paraqitjen e çështjeve të gjuhës shqipe, qoftë edhe në zgjidhjen e problemeve të caktuara praktikisht në fushën e përkthimit (sendërtimit të dygjuhësisë), ku dilnin edhe çështje teorike të pastudiuara, sidomos nga fusha e terminologjisë tekniko-shkencore me të cilat, në të vërtetë, isha i ballafaquar që në çastet e para. Ç’është e vërteta, ishte fillimi i viteve ‘70, kur edhe në të ashtuquajturat organizata të punës së bashkuar të Kosovës, që dhënë njëfarë lirie rreth zbatimit të dygjuhësisë deri edhe në kuadër të "dokumentacionit teknik të punës". Me fjalë të tjera, krahas gjuhës serbokroate, do të mund të përdorej (shënohej) për punëtorët shqipfolës edhe gjuha shqipe. Mirëpo sa i përket "shqipes teknike", përveç pengesave objektive paraqiteshin, siç dihet, edhe pengesa subjektive, ngase mungonin kudrot profesionalë.

Kështu për të ndihmuar sadopak kuadrot shqipfolës, pra, edhe brenda *"klasës punëtore"* me qëllim të zbatimit më me sukses edhe të kësaj të drejte të premtuar kushtetutare rreth dygjuhësisë, pasi u njoha me probleme shumë komplekse e të mprehta të natyrës gjuhësore, përgatita dhe botova me sukses disa artikuj rreth çështjeve të tilla. Një ditë, nga vitet ‘80, pasi ofrova për botim ndonjë artikull të ri të natyrës së tillë (teknike-shkencore) në Institutin e Albanologjisë të Prishtinës iu rrëfeva, si me thënë, shtruar ak. prof. Idriz Ajetit. Ai jo vetëm se më trimëroi që të vazhdoja me paraqitjen e çështjeve të tilla, por njëherazi më sugjeroi ta zgjidhja njërën prej temave *“të mëdha”* dhe ta emnoja si temë doktorate dhe për këtë, si e lypte procedura, më udhëzoi që kërkesën duhesh t’ia drejtoheja Fakultetit Filozofik të Prishtinës (tash: Fakulteti i Filologjisë)- Dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe, në mënyrë që puna, qëllimi a munda i tillë, së paku të stimulohej intelektualisht, me "gradë shkencore". Ashtu edhe veprova. Pas konsultimit me përgjegjësën e atëhershëm të Degës (prof. Mehdi Bardhin), më 12.IV.1984, paraqita

kërkesën me shkrim, natyrisht duke e kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm. Pasi tema "*Struktura fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe*" si temë doktorate, konsiderohej paksa e papërshtatshme, ngase në praktikën e deriatëhershme, me sa dihej, nuk ishte dhënë për t'u punuar asnjë temë disertacioni të kësaj natyre, aq më tepër nga një kandidat që vinte nga një organizatë prodhuese, fillimisht pati njëfarë ngurrimi rreth arsyeshmërisë së një teme të tillë, megjithatë Dega caktoi Komisionin për vlerësimin e arsyeshmërisë së temës në fjalë në këtë përbërje: prof. dr. Rexhep Ismajli, akad. Idriz Ajeti dhe prof. dr. Latif Mulaku. Pas një takimi që pata me prof. Rexhep Ismajlin, ky pranoi të më ndihmonte, madje në bazë të arsyetimit të parashtruar nga prof. dr. Rexhep Ismajli në emër të Komisionit të Degës, Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Prishtinës më 28. V. 1986 miratoi kërkesën time.

Pas miratimit të temës iu përvesha punës edhe më me shumë vullnet rreth grumbullimit dhe mbarështimit të materialit sipas koncept-idesë (elaboratit) të paraprezentuar. Lënda e tillë paksa e konceptuar dhe e punuar iu paraqit për shikim të parë prof. dr. Rexhep Ismajlit, i cili e lexoi dhe më dha vërejtje e sugjerime shumë të vlefshme, por pasi që kjo temë, siç thoshte ai, nuk i përkiste specializimit shkencor të tij, nuk pranoi të ishte mentor. Punën e mentorit e pranoi më në fund prof. dr. Latif Mulaku, më 8.III.1989 dhe në konsultim me të mora udhëzime të vlefshme, kështuqë në bazë të të cilave dhe u përfundua tema. Lidhur me këtë, pra, ndihma e prof. Latif Mulakut, edhe ajo mbi bazë shoqërore, nuk ka munguar, edhe pse ai ishte shumë i zënë me punë e detyra të tjera.

Sidoqoftë, shtjellimi i temës që nga fillimi kërkonte kryekëput punë të pavarur.

Së pari, duhej bërë përkufizimi i vendit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në kuadër të sistemit të përgjithshëm emërformues të shqipes, pastaj duhej gjetur e shfrytëzuar burimet përkatëse, ku ishte prekur ose studiuar ekskluzivisht kjo temë dhe

së dyti lypsej orientuar drejt objektivit kryesor që synohej të jepej ndihmesë konkrete në konsolidimin e emërtimeve në fjalë praktikisht, ngase vërtet në organizata tona prodhuese në (Kosovë)si dhe në shkollat e fakultetet tona (teknike e ekonomike) bëheshin lajthitje të rënda në "përkthimin" jo profesional të emërtimeve nga fusha e terminologjisë tekniko-shkencore, andaj edhe të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, pasoja këto, të cilat ende janë të pranishme te ne.

Siç dihet, emërtimet e njerëzve sipas profesionit në suazat e sistemit formëzues dhe fjalëformues të emrit në përgjithësi zënë një vend mjaft të rëndësishëm, sepse kemi të bëjmë me kryerësit e punëve, përkatësisht emërtimet e tyre sipas veprimtarisë, kur është i njohur fakti sesa rëndësi dhe vlerë ka puna dhe veprimtaria e njeriut si për individin veçantisht, ashtu edhe për zhvillimin e shoqërisë njerëzore në të gjitha fushat e jetës si dhe për vetë natyrën shkencore përgjithësisht.

Në kuadër të punës prodhuese dhe lidhur ngushtë me të, gjuha si element i qenësishëm social a si "mjete më i mirë për marrëveshje në mes të njerëzve", d.m.th. të bartësve të veprimtarisë, del e ndërlidhur edhe funksionalisht me komunikimin dhe zhvillimin e vetë teknologjisë a të punës prodhuese dhe të veprimtarisë mendore që domosdo lypset emërtuar ata bartës. Në shkencat ekonomike theksohet me vend fakti se procesi i prodhimit "nuk krijon vetëm objektin për subjektin, por edhe subjektin për

objektin"² që do të thotë se edhe praktika gjuhësore luan rolin e vet në raportin ndërmjet objektit dhe subjektit e anasjelltas. Ç'është e vërteta, kur kemi parasysh faktin se vetë njeriu si qenie e ndërgjegjshme a si veprues i vetëdijshëm kryen punë e veprimtari të caktuara për të arritur objektivat që synon, atëherë vetvetiu del sesa i dobishëm dhe me interes është trajtimi i temës "Struktura fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe".

Duke i ndjekur krijimet a formëzimet e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë së tyre në kohë e në hapësirë, ne mund të shohim dhe të mësojmë, sadokudo, edhe për historinë e bashkësisë së caktuar folëse të gjuhës përkatëse, mënyrën e jetës së tyre, lidhjet dhe raportet edhe me popujt e tjerë, bashkëpunimin ekonomik e politik si dhe nivelin kulturor e ekonomik të tyre. Këto të dhëna i vërejmë edhe për popullin tonë e lidhur me të nëpërmjet gjuhës së tij, më mirë me thënë, emërtimet e njerëzve sipas profesionit i vërejmë, qoftë në toponime (emërvende), qoftë në dokumentet e hershme të shqipes së shkruar, qoftë edhe në burimet e caktuara leksikografike të periudhave të caktuara deri në kohën tonë.

Pikërisht në materialin e regjistruar në fjalorët përkatës gjatë rrjedhës kohore, sipas periudhave, etapave e fazave historike patëm mbështetjen kryesore edhe në hartimin e kësaj teme. Edhe pse lënda e tillë në burime leksikografike, duke mos qenë e lidhur me kontekste të caktuara fjaliore, në mjaft raste paraqet vështirësi deshifrimi për të dalluar se a kemi të bëjmë thjesht me një emër vepruesi, me emër të njeriut sipas cilësisë ose kemi të bëjmë me formëzime të mirëfillta të emërimit të njeriut sipas profesionit, ne i shfrytëzuar ato për nga forma. Themi për nga forma sepse, ç'është e vërteta, trajtat e caktuara, mund të paraqesin në njëfarë dore vështirësi të natyrës semantike, mirëpo sa i përket anës formale të strukturës fjalëformuese a fjalëndërtuese nuk paraqitet ndonjë vështirësi me peshë, ngase mjetet fjalëformuese, sidomos ato prapashtesore që janë mbizotëruese në emërtime të tilla, janë, pothuajse, plotësisht të njëjta.

Sidoqoftë, lënda e regjistruar në burimet leksikografike ngase është praktikisht më e kapshme dhe e vërejtshme, pikërisht ajo na ka shërbyer si pikëmbështetje e parë mjaft e sigurt për përthëllime të nevojshme lidhur me temën në shqyrtim.

Në drejtim të identifikimit të emrave të vepruesit, përkatësisht të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, kanë dhënë ndihmesën e tyre studiuesit e sidomos hartuesit e gramatikave të gjuhës sonë. Ndër ta dallohen studiuesit (veprat e të cilëve, sadokudo, pata mundësi t'i konsultojta): K. Cipo. Shaban Demiraj, I. Ajeti, A. Kostallari, J. Thomai, L. Mulaku e të tjerë. Në mënyrë të veçantë vlen të përmendet punimi monografik i bashkautorëve Xhuvani - Çabej me titull "Prapashtesat e gjuhës shqipe" (1962), në të cilin dallohen afro 30 formante prapashtesore me të cilat formohen *emrat e njerëzve* përgjithësisht e që shumica pre tyre mund të konsiderohen të formëzuar edhe si *emërtime të njerëzve sipas profesionit*.

Ç'është e vërteta, edhe në ndonjë punim të autorëve të tjerë preken çështje të formimit të emrave, edhe pse në ato punime nuk është bërë përzgjedhja e trajtave dhe e mënyrave të parapëlqyera lidhur me formimin e emërtimeve në fjalë, megjithatë me punimet e tilla u vunë bazat për studime më të specializuara edhe për emërtimet në shqyrtim.

Për të parën herë, me sa di unë, çështja në fjalë u shtjellua në mënyrë më të plotë, si temë e veçantë, nga studiuesit tanë: Kornelja Sima dhe Vaskë Milkani, punime këto që u botuan në fazën e dytë të etapës së konsolidimit të shqipes letrare pas Luftës II Botërore.

Kornelja Sima në punimin "Vëzhgime mbi emërtimet e reja të grave sipas profesionit në fushën e prodhimit industrial pas Çlirimit", e shtron çështjen në mënyrë të drejtë, jo vetëm sa u përket emërtimeve të grave që e ka objekt shqyrtimi, por edhe më gjerë, d.m.th. për emërtimet e tilla në përgjithësi.

Vaskë Milkani në punimin "Vëzhgime mbi emërtimet e njerëzve sipas profesionit"⁴ po këtë temë e trajton edhe më gjerë, duke cekur dhe shtruar edhe çështje të veçanta nga ky lëmë, të cilat mund të shërbejnë si taban për hulumtime të mëtejshme të kësaj fushe semantike.

Nga këto dy punime, sipas tekstit dhe nëntekstit që lë për t'u kuptuar, mund të nxirren katër konstatime a porosi, të cilat po i parafrazoj më poshtë, të cilat, gjithsesi, vlejnë si mbështetje edhe për punime të tjera të kësaj fushe:

1. Me rastin e studimit të problematikës së emërtimeve të njerëzve sipas profesionit krahas treguesve sasiorë lypset pasur në konsideratë edhe treguesit cilësorë, me të cilët nënkuptohen ngjyrimet stilistike si dhe shtresëzimet sipas raporteve shoqërore të emërtimeve të caktuara.

2. Të bëhet dallimi i nevojshëm sipas vlerës së caktuar leksikore, kundrejt formëzimeve të rastit, të hetohet prirja dhe tendencat e ndryshme, qoftë në drejtim të aktivizimit dhe prodhimtarisë, qoftë në drejtim të pasivizimit të mënyrave të caktuara formëzuese a fjalëformuese të emërtimeve në shqyrtim.

3. Si komponente thelbësore mbështetëse me rastin e formëzimit, gjatë përfutimit a përvetësimit të emërtimit, merret karakteri i motivimit dhe me këtë rast do të vihet në pah edhe tipi kuptimor sipas procesit të punës, sipas veglës së punës, sipas vendit të punës a degës së veprimtarisë etj.

4. Përveç komponenteve të përgjithshme del e nevojshme të bëhen studime për komponentet e veçanta, sipas degëve të caktuara të ekonomisë, madje edhe për nëndegë të specializuara veçantisht.

Sigurisht nga këto komponente të nënkuptuara edhe si fakte jashtëgjuhësore edhe si fakte brendagjuhësore del edhe qëllimi kryesor i temave të kësaj natyre. K. Sima në punimin e sipërcekur, po në këtë vazhdë citon dhe përcakton qëllimin: "të zbulohen shkaqet e zhvillimit dhe rrugët e pasurimit, të përcaktohen tipat kryesorë dhe më produktivë, për të gjetur mbi këtë bazë prirjet e zhvillimit të mëtejshme, si dhe rrugët për ngulitjen e termave të formuarë nga brumi i shqipes dhe sipas modeleve të saj".

Po këto konstatime a porosi jam përpjekur t'i kem parasysh dhe t'i sendërtoj sadopak në kumtesën time "Çështje rreth emërtimit të njerëzve sipas profesionit" (të botuar te "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, historinë dhe kulturën shqiptare" nr. 9/84,

⁴ Po aty f. 285 - 293.

Prishtinë 1984), ku përveç disa çështjeve specifike që jepen nga realiteti gjuhësor në Kosovë, në mënyrë të veçantë theksohet konkurrenca ndërmjet mënyrave a modeleve fjalëformuese, posaçërisht të prapashtesave speciale për emërtimet në shqyrtim, konkurrencë kjo që nuk dilte aq e vërejtshme në punimet e mëpërparshme. Pikërisht kjo konkurrencë do të ritheksohet e do të përndriçohet edhe më në hollësi në këtë punim monografik.

Vlen të përmendet edhe punimi tjetër, prej nesh, me titull "Çështje rreth emërtimit të njerëzve sipas veprimtarisë në gjuhën shqipe lidhur me ndërkombëtarizmat me -IK(Ë) fundore" të botuar në revistën "Përparimi" të Prishtinës nr. 3/86, në të cilin jo vetëm shtrohet në një trajtesë të veçantë kjo çështja, por edhe jepet ndonjë sugjerim se si është më së miri të zgjidhen çështjet e hapura konkretisht, siç ishte tema e trajtuar. Aty jepen mënyrat e mundshme a të reflektueshme të zgjidhjes që vërehen nga realiteti ynë gjuhësor. Mendimin teorik si dhe përvojën rreth përdorimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit e çon më tej studiuesi Ardian Vehbiu në punimin: "Emërtime të njerëzve sipas mjeshtërisë me prapashtesën -AR, -OR, -TAR, -TOR në shqipen e sotme letrare"². Autori në këtë punim pos tjerash jep edhe këtë konstatim me interes, kur thotë se "emrat e njerëzve sipas mjeshtërisë përbëjnë një klasë leksiko-semantike mjaft të afërt me klasën e emrave të vepruesit". Po ashtu duke e vështruar çështjen nga aspekti leksiko-semantik vëren se këto emërtime "afrohen me emrat e njerëzve sipas cilësisë". Përveç rëndësisë teorike punimi i A. Vehbiut ka rëndësi praktike kohore, sepse është shkruar dhe botuar pas botimit të Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe (1980), ngase me botimin e këtij fjalori fillon fazë e re në etapën e normëzimit të gjuhës sonë letrare kombëtare, e së këtijmi edhe të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit. Në këtë fazë edhe nga pikëpamja stilistike e terminologjike shumë gjëra nga kjo fushë e leksikografisë ishin vënë në binarë të tjerë, sigurisht më të avancuar, se në punimet e mëparshme.

Hiq disa artikuj të autorit të këtyre rreshtave³ për ndonjë rast konkret nga ky lëmë, punime të tjera ekskluzivisht mbi temën në fjalë me peshë, me sa dihet prej nesh, nuk janë botuar, mirëpo nga këto që u cekën më sipër si dhe në bazë të ndonjë punimi tjetër me objekt studimi të karakterit të përgjithshëm a analog, por që në ndonjë pikë trajtohet edhe lëndë e veçantë nga fusha e emërtimit në fjalë, formohet bazamenti, sadokudo, i shëndoshë që studimi i problemeve të emërtimeve në shqyrtim të çohet më tej, qoftë nga pikëpamja e sintezimit dhe e favorizimit të lëndës dhe e shembujve të caktuar nga kjo nënfushë, qoftë gjithandej duke u vënë në pah e të zbulohen prirjet formëzuese e fjalëformuese me qëllim të zgjidhjeve sa më me lehtësi të të gjitha problemeve që sfidojnë para gjuhësisë sonë edhe në këtë fushë të semantikës gjuhësore.

Vëtë tema e formuluar "Struktura fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe" impononte nevojën që lënda të zbërthehet ashtu siç del e trajtuar në krrerët përkatës të këtij punimi:

² Shih: Studime filologjike nr. 1/86, Tiranë 1986.

³ Ndër afro 20 artikuj të botuar prej nesh për raste të veçanta me tematikë të kësaj natyre, po e përmend vetëm artikullin: "Barasvlerësi terminologjik për shprehjen "njeriu që edukohet", të botuar në gazetën "Rilindja", më 21.I.1989, f. 13 si dhe kumtesën: "Çështje rreth emërtimit të profesioneve në shkollat tona të mesme" të botuar në revistën "Gjuha në shkollë", SHGJA, Prishtinë 1989.

Së pari, doli e nevojshme të bëhen zberthimi dhe përkufizimi i pjesëve përbërëse të formulimit siç është fjalë-termi "**profesion**", togfjalëshi "**njeriu sipas profesionit**" të sinonimeve përkatëse si dhe të vetë fjalës "**emërtim**" etj.

Së dyti, doli me interes që formëzimet të vështrohen kronologjikisht ashtu siç i ndeshim në literaturën përkatëse sipas periudhave, etapave e fazave të caktuara historike duke i vënë në spikamë rrugët e formëzimit si dhe mënyrat e fjalëformimit duke i vënë në pah elementet më aktive dhe prodhimtare të prapashtesimit që nga tradita e hershme deri në ditët tona.

Së treti, përveç vështrimit kronologjik diakronik thelbi i temës kërkonte që në rrafshin sinkronik të shihet më në hollësi struktura fjalëformuese, strukturë kjo që vështirë se mund të ndahet nga struktura e përgjithshme e formimit të emrave të vepruesit, të emrave të njerëzve sipas cilësisë a të atyre sipas përkatësisë a veprimtarisë shoqërore - politike etj. Sigurisht në këtë kuadër theksi vihet në faktin, sa është e mundur, në momentin e vetë aktit të formëzimit të emërimit të njeriut sipas profesionit, d.m.th. kur një emër vepruesi merr tipare që lidhet funksionalisht me profesionin e caktuar të njeriut. Formëzimi i emrave në shqyrtim shikohet sipas rrugës së përvetësimit, qoftë me anë të formimit vetjak autokton, qoftë me anë të huazimit a të përvetësimit që do të thotë mbi bazë të ligjeve të brendshme të vetë gjuhës. Në mënyrë të veçantë trajtohet përdorimi dhe përhapja e emrave të njeriut sipas veprimtarisë mbi bazë të tipave kuptimorë: sipas procesit të punës, sipas veglës së punës, sipas objektit të punës, sipas rezultatit të punës, sipas vendit të punës dhe sipas degës a veprimtarisë së caktuar ekonomike. Gjithashtu në mënyrë të veçantë dhe mjaft të përimtuar do të trajtohet formimi i emrave të prejardhur me prapashtesim, qoftë mbi temë foljore, qoftë mbi temë emërore, por edhe të mënyrave të tjera emërformuese, ku preken veç emrave të prejardhur me prapashtesim edhe emrat e parmë, ata me përgjitime si dhe emrat e përbërë. Poashtu puna kërkoi që të trajtohen edhe emërtimet jonjëfjalësha të profesioneve, siç janë emërtimet me dyfishin a me gërshetim profesionesh si dhe emërtimet togfjalësha.

Së katërti, ndonëse është bërë zakon që emrat në funksion të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në emërtesa (nomenklatura) dhe në burime të caktuara leksikografike të shënohen kryesisht në gjininë përfaqësuese mashkullore, u pa e nevojshme që të trajtohen veçan edhe emërtimet e njerëzve sipas profesionit me gjini përfaqësuese femërore. Kjo u bë për shkak se disa raste dalin të kushtëzuara nga vetë natyra e punës, që të dalin të regjistruara ekskluzivisht në gjininë përfaqësuese femërore. Kjo dukuri do të trajtohet këtu mjaft në përhollësi. Si prapashtesa speciale për formimin e emrave të gjinisë përfaqësuese femërore përveç prapashtesës -E, dhe asaj -ESHË del e vërejtshme edhe prapashtesa -ATORE, e cila del më e pavarur nga dy të parat në raport me elementet prapashtesore të emrave në gjininë mashkullore.

Së pesti, procesi i konkurrimit të mënyrave dhe të mjeteve të caktuara fjalëformuese do të trajtohet edhe nga aspekti i lidhjeve të fjalës për nga kuptimi dhe forma e në këtë kuadër kuptohet se doli e nevojshme të trajtohen kategoritë leksikore të sinonimisë, antonimisë dhe të homonimisë të involvuara edhe në emërtimet e profesioneve.

Së gjashti, vend të veçantë iu dha dallimit ndërtimeor e kuptimor emërtimeve të njerëzve sipas profesionit pa e me profilim të ngushtë nga nënfusha semantike sipas procesit të punës dhe në këtë kuadër doli dallimi ndërmjet emrave hiperonimë ose profesione pa

profilim të ngushtë ndaj atyre me profilim të ngushtë.
ë shtati, meqenëse kjo temë me këtë gjërësi dhe thellësi nuk është shtruar asnjëherë më parë doli e nevojshme që në kuadër të rezultateve të përgjithshme që dalin nga analiza, të nxirren edhe konkluzionet më të rëndësishme përmbyllëse, të cilat edhe mund të shërbejnë si material konkretizimi që rezultatet e tilla të vihen re më me lehtësi dhe të shfrytëzohen e sendërtohen si duhet në praktikën tonë gjuhësore.

* * *

E lyp puna që në fund të kësaj paraqitjeje të përmend edhe ndonjë vështirësi që pata lidhur me hartimin e këtij punimi. Së pari, po e cek faktin se nuk m'u dha kurrnjë ndihmë "zyrtare" a institucionale për grumbullimin e materialit përkatës që nevojitej, madje edhe nomenklaturat e profesioneve a të "librave të kategorizimit" si dhe të "organikave" të ndërmarrjeve dhe të institucioneve më të mëdha, te ne, m'u desh t'i bëja privatisht (me lidhje e ndihmë shoqërore, kurse për Shqipëri as që kisha farë mundësie të kontaktoja, as për punë të librave as me ndonjë studiues, ngase nuk më lejohej të shkoja asgjëkundi jashtë vendit të punës, madje as brenda Jugosllavisë, qoftë edhe për qëllime studimore. Kjo është edhe arsyeja që u shërbeva a u orientova kryesisht nga burimet leksikografike, siç është *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* e të tjerë që kisha mundësi t'i konsultoja.. Gjithsesi atë material që kisha mundësi ta shtija në dorë e shfrytëzoja deri në fund. Kështu në Kosovë konsultova pothuajse të gjitha "sistematizimet e punëve dhe të detyrave" të ndërmarrjeve dhe të institucioneve më kryesore përkatëse, megjithatë nuk mund të thuhet se kam shfrytëzuar tërë materialin që kam pasur dëshirë, madje as atë leksikografik nga bibliotekat te ne etj.. Ç'është e vërteta, ky punim (si dhe punimet e tjera të mia) është kryer pa pasur asnjë ditë të lirë pushimi nga marrëdhënia e punës e mos të flasim për ndonjë benificion tjetër si ndihmë materiale a ndonjë lehtësi tjetër organizative a morale, ngase për veprime të tilla hulumtuuese nuk ishin të interesuara as organet ku isha i punësuar, por as organet e tjera *oficiele*. Madje edhe konsultimet gjatë punimit të temës kanë qenë, si të thuash, tejet modeste.

Sidoqoftë, me ato mundësi që pata në dispozicio, punimi që po prezentohet sadokudo mund të quhet i përfunduar, edhe pse, siç dihet janë afro 20.000 emërtime të profesioneve që i kanë nëpër duar organizmat përkatës, qoftë në Tiranë, qoftë në Prishtinë, të cilat kërkojnë rishikim, harmonizim dhe konsolidim, jo vetëm sa i përket objektivitetit të "vërtetësimit" tekniko-teknologjik, por edhe sa i përket verifikimit gjuhësor fjalëformues. S'do mend se përthellime e sqarime për çështje të veçanta dalin të domosdoshme edhe për këtë fushë semantike. E tërë kjo flet mjaft për rëndësinë shoqërore dhe gjuhësore që ka trajtimi i temës së tillë përgjithësisht si në planin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar, prandaj lidhur me këtë kjo temë nuk duhet konsideruar shteruese, përkundrazi ka vend për angazhime ekipore, të përbërë jo vetëm nga gjuhëtarë, por edhe nga kuadro të profileve të tjera.

Është e vërtetë, se lënda e trajtuar këtu i takon sa morfologjisë po aq e më tepër leksikologjisë, por në njëfarë dore kalon përtej rrahëve të tillë e lidhet edhe me fushën e të

drejtës, teknikës (kibernetikës së organizimit) dhe të ekonomisë (organizimit të punës)⁴ etj.

Meqenëse ky punim u vlerësua si i sukseshëm a si një ndihmesë pozitive për shkencën albanologjike, merita për këtë u takon edhe profesorëve të nderuar dhe për këtë sinqerisht i shpreh falenderim akad. prof. dr. Idriz Ajetit për zemër që më dha filimisht, prof. dr. Rexhep Ismajlit për vërejtjet, këshillat dhe vlerësimet me shkrim që ka bërë lidhur me këtë si dhe në veçanti i shpreh mirënjohje e falenderim prof. dr. Latif Mulakut, i cili veç tjerash proceduralisht e bëri të mundshme që kjo punë më në fund të kurorëzohet me sukses, duke u mbrojtur si "disertacion doktorate".

E ndjej detyrim ta falenderoj edhe prof. Androkli Kostallarin, i cili pasi e lexoi dhe e vlerësoi këtë punim në versionin përfundimtar (dorëshkrim), u deklarua se pranonte me kënaqësi të ishte edhe ai njëri nga oponentët për mbrojtjen publike të disertacionit në fjalë. Madje në kohën, kur për shkaqe të njohura, u pengua puna në fakultetet e Kosovës, ai jo vetëm sugjeroi, por dha pëlqimin dhe propozoi që mbrojtja publike të organizohej në Tiranë. Megjithatë fati e desh që mbrojtja të bëhej në Prishtinë, në lokalet e Institutit Albanologjik, më 24.XII. 1992, po pa praninë e prof. A. Kostallarit, tani të ndjerë. Shfrytëzoj rastin ta falenderoj gjithashtu edhe dr. Mehmet Halimin, i cili pati durimin ta lexonte tërë punimin dhe ta shkruajë recensionin për botimin e tij, në emër të Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Prishtinë, maj 2000

Autori

⁴Në "Leksikonin e kontabilitetit" ("Knjigovodstveni leksikon", Beograd 1965, f. 457) sipas "teorisë dhe praktikës ekonomike" në sistemin klasifikues të dukurive të vrojtura, "nomenklatura e veprimtarive" si dhe "nomenklatura e profesioneve" përbëjnë llojet më të dalluara.

KREU I

RRETH PËRKUFIZIMIT TË TERMIT "PROFESION" DHE TOGFJALËSHIT "NJERIU SIPAS PROFESIONIT"

Për të zbërthyer më lehtë kuptimin leksikor të fjalë-termit "**profesion**" si dhe të kërjt termit togfjalësh "**njeriu sipas profesionit**" del e nevojshme që të shkoqitet togfjalëshi sipas pjesëve përbërëse. Së pari, të sqarohet kuptimi leksikor i ndërkombëtarizmit "profesion" dhe së dyti, ai i togfjalëshit: "njeriu sipas profesionit" në përjasje me sinonimet e tjera të gjuhës sonë, por edhe në ndërlidhje me konceptet përkatëse ndërkombëtare, ngase çështja e emërtimeve të profesioneve ka karakter universal, andaj i kalon përmasat kombëtare.

1. Profesionit si veprimtari specifike e njeriut

Fjala **profesion** (nga lat. proffesio) si ndërkombëtarizëm ka përdorim në shumë gjuhë të botës (angl. profession, fr. profession, it. professione, sp. profesion, serb. profesija) me përkufizimin "puna kryesore a zanati që ushtron një njeri në jetë"⁵, përkatësisht kështu quhet "veprimtaria kryesore e njeriut në një fushë të prodhimit, të kulturës etj., e cila kërkon një shkallë të caktuar të dije, shprehish, përgatitje dhe përvojë ..." ose kështu emërtohet "puna a mjeshtëria me të cilën njeriu merret për ditë për të siguruar jetesën e për t'i dhënë shoqërisë"⁶.

Edhe pse në përkufizimet e mësipërme nuk mund të bëhet vërejtje, megjithatë e shohim të nevojshme të sjellim nga burime të tjera edhe ndonjë version tjetër formulimi, përkufizime këto që ndryshojnë paksa në nuanca. Ndryshimet e tilla vijnë si përplotësim lidhur me nocionin strumbullar në shqyrtim, sepse kemi të bëjmë me një dukuri a me veprimtarinë e njeriut në "të gjitha fushat e jetës dhe të punës" së tij, të cilat vështirë se mund të përmbledhen vetëm me disa fjalë.

Studiuesi V. Milkani në punimin e tij, të cekur në hyrjen e këtij punimi, thotë se "me fjalën profesion kuptojmë të ushtruarit e një aktiviteti me karakter mendor e artistik, të një pune të njeriut në jetë, të një fushe të caktuar të veprimtarisë".

Nga ky formulim vërejmë se autori si karakteristikë të nocionit të profesionit, së pari shënon "aktivitetin me karakter mendor ose artistik" e pastaj aktivitetet e tjera, gjë që në burime të tjera nuk del kështu. Çështje e vërteta, varësisht nga qasja a pikëvështrimi i caktuar i studiuesit, bëhet edhe mbarështrimi i elementeve të nënfushave të caktuara

⁵ Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë 1954 f. 433.

⁶ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, f. 1553.

semantike.

Në "Fjalorin e psikologjisë" të P. Nushit për fjalën *profesion* thuhet: "zeje që kërkon kulturë të gjerë, të përgjithshme e të specializuar, që ka *kodeks etik* dhe përcakton disa detyrime ndaj shoqërisë dhe praktikës së saj, që u jep pozitë të konsiderueshme shoqërore të veçantë atyre që e ushtrojnë. Me anën e tyre krijohen të mira materiale e shpirtërore të dobishme për plotësimin e nevojave të njerëzve"⁷. Këtu bie në sy theksimi i togfjalshave: "kodeksi etik" si dhe "të mirat shpirtërore" përveç atyre materiale.

Mjaft gjerësisht dhe hollësisht kuptimin e fjalë-termit **profesion** e ndeshim të shpjeguar në "Enciklopedinë pedagogjike" të Beogradit (1989)⁸, ku pos tjerash shpjegohet se nga "ndarja ekstreme e punëve janë zhvilluar profesionet e ndryshme si dhe profilimet e shumta të tyre". Përveç "profesioneve të vjetra" - siç theksohen aty për profesionet nga fusha e "së drejtës, religjionit dhe e mjekësisë", në jetën bashkëkohore dalin aq shumë profesione sa që disa prej tyre mund të quhen edhe "gjysmëprofesione". Me rëndësi është se në "shqyrtimet sociologjike" për llojllojshmërinë e profesioneve të ekzistojë një "pajtueshmëri minimale" siç janë b.f. të ashtuquajturat "profesione ideale a të zhvilluara", të cilat i karakterizojnë veçoritë, siç janë: "fondi sistematik teorik i njohurive, kontrolli shoqëror dhe sanksionet shoqërore, monopoli në ekspertizat profesionale, (sub)kultura dhe kodeksi etik profesional", gjithashtu disa autorë këtyre karakteristikave u shtojnë edhe: "kohëzgjatjen e ushtrimit të profesionit, autonominë si dhe shoqërimësinë profesionale". Përgjithësisht, konstatohet aty, koncepti i "profesionit nuk ka aq përkufizim të përcaktuar", ngase me kohë, në përdorim e sipër, fjala e tillë ka pësuar "zgjerim kuptimi", prandaj është vështirë që në kohën tonë të jepet përkufizimi i këtij termi me pak fjalë. "S`na mbetet tjetër - thuhet aty - pos të pranojmë përkufizimin ashtu siç praktikohet dhe në Evropën Lindore edhe në atë Perëndimore" se me fjalë-termin "profesion" kuptohet: "zanati a zeja" (e zgjedhur, themelore, e përhershme), përkatësisht kuptohet të kryerit e një pune a të një veprimtarie, e cila për njeriun "është burim i përhershëm i të ardhurave për ekzistencë". "Profesioni" - së fundi, siç thuhet aty - "është term gjenerik ose i përgjithshëm" i cili, si të themi, ndërthen: "llojin e veprimtarisë, të zanatit (mjeshtërisë), të thirrjes (kualifikuese), titullit, të punës, punësimit (vendit të punës) a të degës (profesionale)"⁹¹⁰.

Ky formulim gjithsesi del më i plotë në krahasim me ato përkufizime që u cekën më sipër, por edhe ky nuk është gjithpërfshirës.

Në librin shkollor "Bazat e teknikës dhe të prodhimit",¹¹ duke u bazuar në "Ligjin për punën e bashkuar" thuhet se me "profesion" kuptojmë "punët kryesore që

⁷ Dr. Pajazit Nushi, Fjalor i psikologjisë, Prishtinë 1987, f. 228.

⁸ Shih: Pedagoška enciklopedija, Beograd 1989 f. 256.

¹⁰ Po aty f. 257.

¹¹ Shih: Bazat e teknikës dhe të prodhimit (tekst për shkollat e mesme), Prishtinë 1980.

ushtron një njeri në prodhim, në veprimtari dhe shërbime të tjera me të cilat krijon mundësi për fitimin e të ardhurave për jetë".

Në "organikat" (sistematizimet e punëve dhe të detyrave) të organizatave punonjëse (ndërmarrjeve prodhuese industriale) me fjalën profesion nënkuptohet "një grup punësh e detyrash që i kryen punëtori (individi) i caktuar për të "prodhuar" të mira materiale e të tjera".

Të vihet re fakti se në dy formulimet e pakmësipërme nuk ceket fare "kodeksi moral" apo "karakteri mendor a artistik".

Në dispozitat e "Ujdisë shoqërore mbi bazat unike për klasifikimin e profesioneve dhe të përgatitjes profesionale" ("Gazeta zyrtare e RSFJ-së" nr. 29/1980)¹² është precizuar kuptimi standard i termit profesion (serb. zanimanje), me formulimin: "punët dhe detyrat e caktuara si dhe shërbimet që kryen personi i caktuar për prodhimin (krijimin) e të mirave materiale e të tjera, përkatësisht fitimin e të ardhurave personale pa marrë parasysh degën e prodhimtarisë". Po ky përkufizim vlen, siç thuhet aty, edhe për të punësuarit edhe për të papunësuarit, kuadër ky i cili përgatitet a aftësohet për të kryer punë, detyra e shërbime të caktuara.

Edhe në doracakët përkatës dedikuar për nevojat e Entit Federativ të Statistikës të RSFJ-së në të cilët janë shënuar emërtetat e profesioneve, kërkohet që të shënohen sipas profesioneve (grupprofesioneve) sipas rubrikave përkatëse, jo vetëm ata që janë të punësuar dhe i kryejnë punët, detyrat dhe shërbimet e caktuara, por edhe numri i ndividëve, sipas emërtimeve përkatëse që kërkojnë punë dhe janë të aftë ose të aftësuar të kryejnë punë e detyra të caktuara.

Gjithsesi, siç po shihet në dokumentacionin zyrtar për definicionin e fjalë-termit profesion si karakteristikë e parë shënohen "të ardhurat personale", të cilat i fiton (merr) personi i caktuar për punët, detyrat a shërbimet që kryen.

Para se të përfundoj lidhur me këtë po e shënoj edhe këtë se në "Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e punëve dhe të detyrave në ndërmarrje" fjala *profesion* përkufizohet kështu: "*një seri punësh e detyrash të ngjashme që i ushtron individi me qëllim të prodhimit (realizimit) të të mirave materiale e të tjera*"¹³.

Siç mund të vërehet nga sa u tha më sipër fjalët më të shpeshta në kuadër të përkufizimit të nocionit të fjalë-termit profesion dalin termat: "**punë, detyra dhe shërbime**". E shoh të nevojshme dhe me interes që të cekim paksa se çfarë përkufizimesh jepen në stilin administrativo-ekonomiko-juridik lidhur me fjalë-termat e tillë¹⁴.

Me "**punët**" kuptohen "aktivitetet permanente të caktuara të individit (njeriut

¹² Shih: Slu_beni glasnik SFRJ, br. 29/80, Beograd 1980.

¹³ Shih edhe te "Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e punëve dhe të detyrave të punëtorëve të "Uzinës së Amortizatorëve të Prishtinës" (tekst i shaptilografuar), Prishtinë 1989.

sipas profesionit) në kryerjen e veprimtarisë së organizatës bazë", kurse me "**detyrat**" kuptohen "një seri veprimesh e operacionesh të organizatës bazë që individi (njeriu sipas profesionit) duhet t'i kryejë, ngase aktivitetet e tilla përfaqësojnë një pjesë të detyrave të tërësishme të organizatës bazë".

Çështje e drejta, detyrat dalin nga punët që duhet t'i kryejë organizata bazë dhe se me detyra bëhet konkretizimi i zbatimit të punëve të organizatës së caktuar.

Puna mund të shenjohej si aktivitet permanent i punëtorit i konfirmuar që më parë me aktin e përgjithshëm të organizatës bazë, kurse detyra mund të cilësohet si një aktivitet i caktuar kohor e lëndor i caktuar. **Detyra** ka të bëjë konkretisht me personin e caktuar, kurse **puna** del në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme, prandaj detyrat e caktuara të individit përkatës nuk përcaktohen me aktin e përgjithshëm të ndërmarrjes, por gjithsesi detyrat kanë mbështetje në punët që janë përcaktuar me aktin e përgjithshëm në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të organizatës punonjëse.

Në kuadër të përkufizimit të kuptimit leksikor të fjalës "profesion", siç u tha më sipër, cekeshin, përveç punëve e detyrave edhe **shërbimet**. Lidhur me **shërbimet a veprimtaritë shërbyese** që lidhen me "njeriun sipas profesionit" vlen të theksohet fakti se varësisht nga shërbimi që kryen personi i caktuar bëhet edhe emërtimi i "profesionit" të tij. Sipas burimeve të caktuara të shkencave ekonomike "**shërbim**" quhet "puna që bëhet nga një sistem i organizuar njësisht të posaçme ekonomike për të përmbushur nevoja të ndryshme të jetës së përditshme të popullit"¹⁵, përkatësisht kështu quhet "lloji i veprimtarisë prodhuese me të cilën prodhuesi bën ndonjë shërbim për llogari të porositësit"¹⁶ ose "kryerja e punëve të ndryshme profesionale me të cilat plotësohen nevojat individuale të personave të caktuar, për ndryshim nga veprimtaria prodhuese, e cila sipas rregullit punon për treg"¹⁷.

Sidoqoftë, siç mund të shihet nga formulimet e mësipërme përkufizimi i fjalë-termit profesion bëhet varësisht nga veprimtaria bazë e organizatës a institucionit të caktuar, por nuk mungojnë vende - vende edhe emërtimet sinonimike lidhur me këtë nocion. Kështu p.sh. në "Ligjin për arsimin e lartë të KSA të Kosovës"¹⁸ për kuptimin e fjalës **profesion** thuhej se më të nënkuptohen "njohuritë dhe aftësitë për kryerjen e punëve të caktuara për prodhimin e të mirave materiale e shpirtërore ose për kryerjen e shërbimeve dhe fitimin e të ardhurave personale, pa marrë parasysh llojin e veprimtarisë". Njëherazi në këtë burim jepen edhe përkufizimet për termat togfjalësh "**përgatitje profesionale**", "**dega profesionale**" dhe "**profili arsimor**" - për të cilët nuk do të bëhet fjalë këtu, po pakëz më poshtë, pasi të analizohet kuptimi leksikor i termit togfjalësh "njeriu sipas profesionit".

¹⁵ Shih: Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, f. 1836.

¹⁶ Knjigovodstveni leksikon, Beograd 1965 f. 785.

¹⁷ Shih: Pravna enciklopedija, Beograd 1985 f. 1796.

¹⁸ Shih doracaku "Ligji për arsim të lartë të Kosovës" Prishtinë 1988.

Prandaj koncepti i fjalë-termi "profesion" me të cilin lidhet shprehja "njeriu sipas profesionit" ka të bëjë me punët, detyrat si dhe shërbimet, qoftë në organizatat punonjëse, qoftë edhe në institucione a organizata të tjera ku kryhen pune, detyra e shërbime.

Gjithsesi puna dhe detyrat e njeriut sipas profesionit varen nga "vendi i punës" si dhe nga "përgatitja profesionale a kualifikuese" e personit të caktuar. Mirëpo para se të bëj shqyrtimin e këtyre dy termave do të ndalem paksa më në hollësi, siç u paracek, rreth kuptimit leksikor të termi togfjalësh "njeriu sipas profesionit", sepse pas një analize të tillë edhe kuptimi leksikor i termi "profesion" do të jetë më i plotë dhe më i qartë.

2. Termi togfjalësh "njeriu sipas profesionit" në përjasje me sinonimet përkatëse

Është e vërtetë se krahas emërtimit togfjalësh "njeriu sipas profesionit" në praktikën tonë gjuhësore dalin edhe sinonimet si "njeriu sipas kualifikimit", "njeriu sipas përgatitjes shkollore", "emërtimi i njeriut sipas zejes" "emërtimi i njeriut sipas mjeshtërisë", pastaj dalin edhe fjalët hiperonime si: punëtor, punonjës, kuadër, personel, i punësuar, punues etj. Me fjalë të tjera, në situata të caktuara emërtimi "njeriu sipas profesionit" quhet: punëtor, punonjës (punues), kuadër, nëpunës, zyrtar etj. dhe njëherësh profesioni i njeriut varet edhe nga kualifikimi shkollor, përgatitja profesionale si dhe nga punët e detyrat si dhe funksionet a shërbimet që kryen ose është i aftë a i aftësuar t'i kryejë personi i caktuar.

Në vazhdim po përmend përkufizimet rreth emërtimeve - termave: **punëtor**, **punonjës**, **kuadër** e ndonjë tjetër me qëllim që të dalë edhe më qartë koncepti si dhe përkufizimi i fjalë-termi "profesion" që është nyje kyçe e këtij kreu të punimit tonë.

Shpeshherë në ligjërimin e përditshëm a asnjë fjalë **punëtor** e **punonjës** përdoren për të njëjtin koncept, mirëpo në stilin administrativo-juridik në veprimtaritë shtetërore - administrative të kohës domosdo bëhet dallimi i qartë i kuptimeve leksikore të këtyre dy fjalë-termave.

Me fjalën **punëtor** kuptohet "çdo njeri që bën vazhdimisht punë drejtpërdrejt në prodhim (në industri, në ndërtimtari, në transport, në shpërndarje e në shërbime të ndryshme, aty ku përdoret fuqia e krahut", d.m.th. punëtori që bën punë fizike me fuqinë e krahëve, përkundrajt atij që merret me punë mendore.

Me fjalën **punonjës** në FGJSSH jepet ky përkufizim "ai që rron me të ardhurat që ka nga puna e vet, të ardhura këto që i fiton në një ndërmarrje, në një institucion", përkatësisht **punonjës** quhen "të gjithë njerëzit pa marrë parasysh se a punojnë apo prodhojnë me mjetet e veta ose të shoqërisë (nën kushtin të mos jenë të eksploatuar)"(!), me një fjalë të gjithë ata që "mbahen me punën e vet" që do të thotë se kjo fjalë del me kuptim më të përgjithësuar sesa del fjala **punëtor**, pasi që me këtë fjalë quhen edhe "punëtorët e punëdhënësit privatë", gjithashtu edhe ata që ushtrojnë "veprimtari artistike e të tjera kulturore" si dhe veprimtari zejtare, shoqërore, shkencore etj.

Sipas Kushtetutës së RSFJ-së **punonjës** (punues a njerëzit punues serb. radni ljudi, njëjës: radni çovek) quhen personat që kryejnë funksione shtetërore, publike e shoqërore pa marrë parasysh faktin se e ruajnë edhe cilësinë e punëtorit, po ashtu në kuadër të këtij koncepti hyjnë edhe studentët e nxënësit, të cilët në njëfarë mënyre janë aftësuar ose aftësohen për profesionet e caktuara dhe se aktivisht janë të udhëzuar (aftësuar) të jetojnë nga puna e vet, edhe pse momentalisht nuk janë të punësuar.

Në jetën praktike si sinonim me i dalluar i fjalë-termave punëtor e punonjës (punues) del fjala **kuadër**. Me fjalën kuadër që është ndërkombëtarizëm kuptohet "tërësia e punonjësve (punëtorëve dhe nëpunësve) të një ndërmarrjeje, të një insitucioni etj.", përkatësisht "kuadër" quhet çdo punonjës (punues) që "bën një punë të caktuar sipas organikës".

Me fjalën "**organikë**" në shqipe kuptohet "tërësia e vendeve të punës të një institucioni, të një ndërmarrjeje, të një reparti a të një njësie ushtarake", përkatësisht kështu quhet "lista e nëpunësve dhe e punëtorëve që zënë këto vende pune së bashku me emërtimet e detyrave, të titujve ose gradave të tyre" me një fjalë "**organikë**" quhet akti normativ juridik (nënligjor) që ndër ne (Kosovë) quhej "Rregullorja mbi sistematizimin e punëve dhe të detyrave" të institucionit a të organizatës së caktuar, akt nënligjor ky ku pasqyrohet fuqia punëtore a kuadri i nevojshëm për kryerjen e punëve a të detyrave, përkatësisht të veprimtarisë themelore të organizatës a të institucionit të caktuar¹⁹.

Edhe nga sa u tha më sipër, edhe pse jo në mënyrë shteruese po fragmentare, del se me togfjalëshin "njeriu sipas profesionit" nënkuptohet njeriu në radhë të parë si qenie e arsyeshme aktive shoqërore e aq më tepër si qenie prodhuese që në jetën e përditshme me punën e aktivitetin e vet jo afatshkurtër krijon e vepron në kuadër të një veprimtarie të caktuar, qoftë si punëtor (krahu), qoftë si punonjës (shkencor), nëpunës, apo qoftë si kuadër a personel (udhëheqës, ndihmës, shërbyes etj.).

Emërtimi i njeriut sipas profesionit kushtëzohet jo vetëm nga puna që kryen a zeja që ushtron momentalisht punëtori, por edhe nga fakti se çfarë titulli ka fituar me kryerjen e ndonjë shkolle a që e ka fituar nga përvoja në punë e sipër, por edhe nga aftësia se çfarë pune mund të kryejë dhe se krejt këto bëhen me qëllim të realizimit të të mirave materiale e shpirtërore, për t'i siguruar vetes ekzistencën, por në njëfarë dore edhe për karrierë vetjake e prestigj në shoqëri.

Gjithsesi puna a veprimtaria e "njeriut sipas profesionit" kërkohet që të jetë me leverdi edhe për personin edhe për shoqërinë.

3. Njeriu sipas profesionit dhe "vendi i punës"

Në organizimin e punës e të veprimtarisë së organizatave punonjëse ceket edhe termi "vendi i punës" me të cilin kuptohet "një varg punësh nga veprimtaria e

¹⁹ Për këtë shih edhe artikullin "Rreth aktivizimit të fjalë-termit **organikë** te ne", të botuar në gazetën "Rilindja", më 17. III. 1989 f. 11.

organizatës bazë, të cilat mund t'i kryejë një punëtor ose disa punëtorë". Vendi i punës formëzohet me grupimin e punëve të lidhura funksionalisht në kuadër të veprimtarisë së organizatës së caktuar. Sipas *Enciklopedisë juridike*²⁰ thuhet se termi "**vendi i punës**" është identik me emërtimin "grupi i punëve", përkatësisht, siç sqarohet mëtej aty "sipas *Ligjit për punën e bashkuar* në vend të termit "vendi i punës", përveç disa klauzolave, tashti përdoret termi "**punët dhe detyrat**" me kuptimin siç është cekur më sipër. Në përputhje me këtë që sapo u citua mund të jepet përkufizimi se "vendi i punës" është "njësia fillestare organizative-tekologjike, e krijuar si rezultat i ndarjes së punëve, njësi kjo të cilën e përbëjnë një ose disa punë të lidhura reciprokisht, të cilat mund t'i kryejë një ose disa punëtorë me aftësi të caktuar profesionale e punuese"²¹.

Pra lidhur me kuptimin leksikor të togfjalëshit "njeriu sipas profesionit" del edhe kuptimi i nocionit "vendi i punës" si dhe "përgatitja profesionale", e cila ka sinonimi me termin "përgatitje shkollore", por që përfshin në vete edhe përgatitjet që njihen me ligj ose me dispozita të tjera, madje përgatitja profesionale ka kuptim më të gjerë nga sinonimi "përgatitja shkollore".

Njeriu sipas vendit të punës dhe njeriu sipas profesionit si terma sinonimikë nuk janë identikë, megjithatë në punimin tonë edhe emërtimet sipas vendit të punës, pozitës, gradës etj. konsiderohen si "emërtime të njeriut sipas profesionit", aq më tepër kjo arsyetohet edhe nga fakti se nga aspekti fjalëformues e formëzues te këto forma nuk hetohet kurrfarë dallimi me peshë.

Në doracakun "Regjistrimi i personelit të inkuadruar" (të punësuar) të EFS²², Beograd 1977, për ilustrim ndaj konceptit të vendit të punës a grupimit të punëve shënohen këto lloje të punëve:

1. punët manuale individuale,
2. punët manuale të ndërlikuara,
3. punët me makina,
4. punët a manipulimi me mjete të transportit dhe të komunikacionit,
5. punët e përgjithshme,
6. punët profesionale,
7. punët drejtuese a të udhëheqjes së përgjithshme dhe
8. punët hulumtuese - shkencore.

Aty për secilin lloj të punëve jepen sqarime më të hollësishme, sipas degës a nëndegës së caktuar ekonomike etj. që nuk është pa interes të dihen.

Ne, për arsye vendi po i cekim vetëm fushat e përdorimit të llojit të parë:

²⁰ Shih: Pravna enciklopedija, Beograd 1985 f. 1373.

²¹ Po aty f. 1373.

²² EFS = Enti Federativ i Statistikës.

punët manuale individuale, ku bëjnë pjesët punët në: 1. bujqësi (si p.sh. mbledhja e frutave, prashitja, mihja, prodhimi i fidaneve; ruajtja e kafshëve, punët në prodhimin e bulmetit, të mishit; puna e bletarëve etj.); 2. pylltari; 3. miniera; 4. industri dhe zejtari; 5. ndërtimtari; 6. transport; 7. tregti; 8. hoteleri; 9. shërbimet personale e familjare; 10. veprimtari jashtëkonomike - punë këto të shumta, pothuajse pakufi, prej nga del e nevojshme të bëhen edhe emërtimet përkatëse të njeriut sipas profesionit që i kryen punët e tilla.

4. Parimet rreth klasifikimit të profesioneve

Në botën bashkëkohore çështja e emërtimit të profesioneve del si çështje mjaft e ndërlikuar, për arsye se numri i profesioneve dhe "gjysmëprofesioneve" etj. është aq i madh dhe se në saje të teknologjisë së zhvilluar dhe në zhvillim e sipër vazhdimisht sfidohen emërtime të reja.

Si në shkallë kombëtare ashtu edhe në shkallë ndërkombëtare si detyrë e parë del klasifikimi i profesioneve dhe lidhur me këtë dalin këto parime që patjetër duhen pasur parasysh:

a) kufizimi (dallimi) i bashkësive të profesioneve nga profesionet e veçanta, kështu së pari bëhet dallimi në mes të profesioneve të karakterit të përgjithshëm, nga profesionet e karakterit të veçantë;

b) thjeshtësimi dhe grumbullimi sa më i madh i profesioneve sipas karakteristikave të përbashkëta që i lidhin ato. Gjithsesi për nevoja praktike del e nevojshme të bëhet bashkimi i nënlojeve dhe i llojeve të caktuara të profesioneve në një grup të caktuar profesionesh. Në grupe të njësuara përfshihen zakonisht ato profesione që janë në grupe të vogla.

c) përngjashmëria e punëve dhe detyrave përkrahet si prirje për klasifikimin e profesioneve, duke pasur parasysh edhe nivelet e caktuara ndërlidhëse e përkimore ndërmjet tyre.

Parimet e mësipërme ndiqen dhe sendërtohen në praktikë për arsye se këto parime japin mundësi që të klasifikohet, sadokudo, një numër sa më i madh i profesioneve në grupe të caktuara. Ç'është e vërteta, këto parime të zbatuara nga e kaluara janë të pranishme edhe aktualisht. Zakonisht zbatimi i tyre del më i theksuar në situata kur ndërmerren a organizohen reforma shkollore e ekonomike, të cilat janë të domosdoshme dhe ndërlidhen patjetër me procesin e përgjithshëm të zhvillimit shoqëror të çdo vendi dhe më gjerë.

Për jetësimin e parimeve të sipërcekura dalin edhe kritere mbështëse. Përveç kriterit të respektimit të traditës që ka të bëjë lidhur me përdorimin dhe klasifikimin e profesioneve lypset respektuar edhe kriteri ndërkombëtar i klasifikimit standard të profesioneve, sidomos kur kemi të bëjmë me veprime a operacione që lidhen me mjetet e punës dhe të proceseve teknike - teknologjike që janë të pranuar a të shtrira në suaza ndërkombëtare.

5. Rreth strukturës së klasifikimit të profesioneve

Struktura e klasifikimit të profesioneve është e kushtëzuar edhe nga aspekti organizativ i proceseve teknike-teknologjike, procese këto që kryhen nga punëtorët me përgatitje të caktuara profesionale. Madje sa më e ulët të jetë shkalla e përgatitjes profesionale, atëherë edhe lloji i punëve është më heterogjen që do të thotë se emërtimet e profesioneve e gjysmëprofesioneve të profilizuara është në numër më të madh, pothuajse, nuk ka kufizim, ngase kjo kushtëzohet nga shumëllojshmëria e punëve dhe e detyrave që kryhen, të cilat janë të panumërta. Mirëpo siç është përmendur edhe më sipër për arsye praktike grupimi bëhet sipas ngjashmërive të punëve, sipas tipave kuptimorë dhe karakteristikave të tjera duke pasur parasysh këto katër kritere:

- operacioni i punës,
- objekti a lënda e punës,
- mjetet e punës dhe
- mënyra e punës.

Lidhur me ligjësitë që dalin nga këto kritere dhe në mbështetje të raportit rreth formëzimit të emërtimeve të caktuara në gjuhën tonë do të bëhet fjalë më gjerësisht në kreun III të këtij punimi.

Gjithsesi parimet dhe kriteret e sipërcekura gërshetohen, ku më pak a ku më shumë, edhe në strukturën e tërësishme të klasifikimit të profesioneve.

Në bazë të lëndës që konsultuam struktura e klasifikimit të profesioneve bëhet në këto tri mënyra:

- a) sipas niveleve të strukturës klasifikuese,
- b) sipas profilizimit të profesioneve dhe
- c) sipas shkallëve të ndërlikueshmërisë

a) Në strukturën e tërësishme të profesioneve del e nevojshme të ceken nivelet e strukturës klasifikuese, të cilat si organizim kërkojnë mund të paraqiten në formë piramide dhe sipas nivelizimeve të tyre janë emërtuar (përkthyer) kështu:

- 1) grupet e profesioneve,
- 2) llojet e profesioneve,
- 3) nënllojet e profesioneve,
- 4) bashkënjësitë e profesioneve dhe
- 5) profesionet e veçanta (të profiluara).

Sipas doracakut "Sistematski pregled zanimanja" (Pasqyra sistematike e profesioneve), SZS Beograd 1986 si dhe "Abecedni spisak zanimanja" (Regjistri alfabetik i profesioneve), SZS, Beograd 1986, paraqitja skematike e sasisë së profesioneve sipas

niveleve të mësipërme duket si vijon:

Paraqitje skematike piramidore e sasisë së profesioneve sipas niveleve të caktuara:

| | |
|-------------|---------------------------------|
| <u>10</u> | <u>grupe</u> |
| <u>58</u> | <u>lloje</u> |
| <u>227</u> | <u>nënllaje</u> |
| <u>1021</u> | <u>bashkënjësi profesionesh</u> |

mbi 21000 profesione të profiluara (të veçanta)

Pra për të pasur të qartë kuptimin leksikor të fjalë-termit profesion del e nevojshme të njihen emërtimet konkrete të të gjitha niveleve. Këtu po për arsye vendi do të cek vetëm 10 grupet, ashtu siç janë shënuar në doracakët e sipërcekur dhe janë në përdorim e sipër në jetën e përditshme të ne dhe shërbejnë, qoftë për nevojat e statistikës, qoftë për nevojat e tjera të administratës:

- I. Bujqit dhe punëtorët²³ e ngjashëm;
- II. Xehetarët dhe punëtorët e ngjashëm;
- III. Punëtorët në tregti;
- IV. Punëtorët në shërbime;
- V. Personeli i mbrojtjes shoqërore;
- VI. Punëtorët e administratës e të ngjashëm;
- VII. Personeli udhëheqës;
- VIII. Ekspertët dhe artistët;
- IX. Punëtorët e profesioneve të tjera;
- X. Punëtorët pa profesion.

Pra në mbështetje të këtyre grupeve bëhet ndarja në lloje, nënllajë, bashkësi e profesione të profilizuara.

Në punimin e Ardian Vehbiut, të cekur në hyrje të këtij punimi, përmenden këto nëntë fusha të veçanta të veprimtarisë: bujqësia, blegtoaria, zejtoaria, ushtria, arti, feja, etnografia, zejtoaria, detaria dhe industria.

Këtë ndarje a klasifikim po e cek me qëllim, ngase varësisht nga synimi i studiuesit dhe fushat e interesimit të tij, atëherë edhe mënyra e klasifikimit mund të jetë e ndryshme, por kur është fjala në përmasa ndërkombëtare duhen respektuar

²³ Me fjalë-termin **punëtorët** këtu përfshihet edhe koncepti i fjalë-termit punonjësit.

ato kriteret që i zbatohen edhe të tjerët.

b) Është me interes të theksohet edhe grupimi a klasifikimi tjetër të profesioneve që është kriteri i klasifikimit sipas profilizimit.

Në doracakun "Udhëzim për plotësimin e "Deklaratës" së nevojës për punëtorë, praktikantë dhe nxënës, të BFPP, Beograd 1969²⁴, të gjitha profesionet nga nomenklatura e profesioneve janë grupuar në gjashtë profile, varësisht nga shkalla e përgatitjes profesionale:

1) **Profesionet e profilit të ngushtë** (profesione që arrihen duke mësuar në vendet e punës, në ndërmarrjet ekonomike (punëtorët me gjysmëkualifikim ose punëtorët e mësuar (sprvuar) dhe ndihmës nëpunësit). Në këtë grup përfshihen edhe punëtorët e pakualifikuar.

2) **Profesionet e profilit të gjerë** (profesione të cilat arrihen në shkollat për profesione, në shkollat për nxënës në ekonomi, në shkollat për punëtorët e kualifikuar, në shkollat analoge e të ngjashme, me një fjalë këtu përfshihen punëtorët e kualifikuar dhe punëtorët me kualifikim të lartë).

3) **Profesionet e profilit "teknik" dhe të ngjashëm me të** (profesione që fitohen në shkollat e mesme, siç janë shkollat teknike, shkollat ekonomike e të ngjashme).

4) **Profesione të profilit "inxhinier" dhe të ngjashëm me të** (profesione që nxjerrin shkollat e larta, përkatësisht kryerja e shkallës I të fakultetit përkatës).

5) **Profesione të profilit "inxhinier i diplomuar" dhe të ngjashëm me të** (profesione që merren në fakultete dhe shkollat superiore).

6) **Profesione të profilit "magjistër"** (profesione që arrihen me kryerjen e shkallës III të studimeve në fakultet - studimet pasuniversitare.

Po këtë grupim e ndeshëm edhe në doracakun "Paraqitja e nevojave për punëtorë - formularët, udhëzimet dhe ekstrakti nga nomenklatura e profesioneve" lëshuar nga Enti Krahinor për Inkuadrim, Prishtinë (1972). Po theksojmë faktin se në realitetin tonë gjuhësor në praktikë te ne ishte duke u përdorur ndarja a klasifikimi si më sipër.

Është me interes të njihet fakti se në kuadër të grupimit sipas profilimeve, profesioni aktiv i grupimit të caktuar mund të jetë i shënuar veçan në të gjashtë nivelëzimet. Më poshtë po e shënoj një shembull nga grupi I: d.m.th. "bujqit dhe punëtorët e ngjashëm":

| | | |
|-----------------------------------------|------------|---------|
| - profili i ngushtë: punëtor bujqësor | ose shifra | 101.01; |
| - profili i gjerë: bujk, | " | 201.01; |
| - profili "teknik": teknik i bujqësisë, | " | 301.01; |

²⁴ Uputstvo za popunjavanje "Izjave" o potrebama za radnike, pripravnike i u_enike", Beograd 1963.

| | | |
|-----------------------------------------------------------------------|---|---------|
| - profili "inxhinier": inxhinier i bujqësisë, | " | 401.01; |
| - profili "inxhinier i diplomuar": inxhinier i diplomuar i bujqësisë, | " | 501.01; |
| - profili "magjistër": magjistër i shkencave të bujqësisë | " | 601.01. |

Po kështu veprohet edhe në raste të tjera, dhe se me këtë rast bëhet edhe dallimi i numrit të shifrës që e shoqëron a që e simbolizon.

Mënyrat klasifikimit të paraqitura më sipër janë përsosur dhe janë plotësuar vazhdimisht. Gjithsesi paraqitja e nomenklaturës së profesioneve ndërlidhet edhe me përgatitjen profesionale a me kualifikimet që merren në shkollat e caktuara si dhe nga institucionet e tjera varësisht nga sistemet shkollore.

Zhvillimi ekonomik industrial që është karakteristikë e vendeve të zhvilluara si dhe e vendeve në zhvillim si dhe ndërlidhjet e domosdoshme të bashkëpunimit ekonomik e tregtar ka imponuar nevojën që secili vend të harmonizojë edhe emërtimet e profesioneve duke bërë herëpashërë reformat shkollore apo reformat e arsimit të të gjitha niveleve.

Është i njohur fakti se tashti, sidomos me zhbërjen e sistemit socialist u pa e domosdoshme të bëhet rishikimi i mbarë rrjetit shkollor, planprogrameve etj. me një fjalë domosdo rishikohen dhe organizohen reforma shkollore, ndërmarrje këto që do t'u përshtaten patjetër zhvillimeve të reja të sistemeve shoqërore e ekonomike, jo vetëm në vendet e Evropës Lindore (pas rënies të ashtuquajtur *epokë të socializmit*), por përgjithësisht në botë, prandaj edhe emërtimet e njerëzve sipas profesioneve të vendeve e popujve të caktuar do të harmonizohen a do të përshtaten gjithsesi me barasvlerësit e gjuhëve të zhvilluara të Evropës, qoftë me përshtatje gjuhësore, qoftë me shifime të caktuara që i simbolizojnë.

Përpjekje për unifikime të tilla ishin të vërejtshme edhe në doracakun "Propozim i shkallës unike të kualifikimeve si bazë e sistemit të arsimit të orientuar" (Beograd, tetor 1975) në të cilin pasi kritikohet mënyra e vjetër e klasifikimit, derisa ishte në fuqi opozicioni i profesioneve të punëtorëve (të krahut) në njërin anë ndaj profesioneve të nëpunësve (të lapsit (!)) në anën tjetër jepen edhe parimet mbështetëse për propozimin e ri, i cili merr parasysh ndërlikueshmërinë e punëve dhe të detyrave dhe mbi këtë bazë parashihen 11 shkallë unike të profesioneve duke u dhënë përparësi profesioneve prodhuese.

c) Pra duke marrë para sysh ndërlikueshmërinë e punëve dhe të detyrave fillon pothuajse klasifikim i ri i profesioneve, edhe pse sipas shkallëve inkorporohen pak a shumë edhe profesionet e profilizuara që u cekën në pikën e mësipërme.

1) Kështu që në **shkallën I** përfshihen profesionet e profilit "të ngushtë" pa shkollë të arsimit të mesëm të orientuar dhe për këto punë kryerësi i caktuar i punëve merr titullin "**punëtor i mësuar**".

2) Edhe në **shkallën II** përfshihen profesionet që fitohen pa kryer shkollën e mesme të orientuar por me ndërlikueshmëri pak më të shkallëzuar, prandaj punëtori

fiton titullin "**punëtor i specializuar**".

3) Në **shkallën III** me titull "**punëtor profesional i specializuar**" përfshihen profesionet që arrihen me kryerjen e shkollës përkatëse të AMO-s, është fjala për profesione të profilit "të gjerë".

4) Edhe **shkalla IV** fitohet në shkollat e mesme dhe përshtat me titullin "teknik", por që tashti ka titullin "**punëtor i profesional**".

5) Në **shkallën V** kemi të bëjmë me profesionet që merren me arsimim të mëtejshëm profesional prej dy vjetësh pas kryerjes së shkollimit të tillë jepet titulli "**punëtor profesional - specialist**".

6) Në **shkallën VI** përfshihen profesionet që arrihen në shkollën e lartë apo në rang të shkallës I të fakultetit që përshtat me profesionin e profilizuar "inxhinier", por që sipas këtij "Propozimi" jepet titulli "**punëtor i lartë profesional**".

7) Nëse punëtori kryen ndonjë kurs a specializim dhe ka titullin nga pika e mësipërme atëherë fiton titullin e ri të **shkallës VII: "punëtor i lartë profesional - specialist"**.

8) Kuadrot me fakultet janë përfshirë në **shkallën VIII** me emërtimin "**punëtor profesional superior**" që përshtat me emërtimin e profilizuar "inxhinier i diplomuar".

9) Në **shkallën IX** përfshihen profesionet e emërtuara "**punëtor profesional superior - specialist**" që do të thotë se personi i caktuar ka bërë specializimin përkatës pas kryerjes së fakultetit përkatës.

10) Në **shkallën X** janë përfshirë profesionet e rangut "**magjistër i shkencave**".

11) Në **shkallën XI** janë përfshirë profesionet me ndërlikueshmëri të tillë që personi i caktuar duhet të ketë gradën "**doktor shkence**".

Me qëllim u cekën të dhënat nga "Propozimi" i sipërcekur, sepse në realitetin tonë gjuhësor ende mund të ndeshen emërtimet e tilla dhe për arsye se po ky propozim me ndonjë modifikim del i miratuar në "Ujdinë shoqërore mbi baza unike të të klasifikimit të profesioneve dhe të përgatitjes profesionale", dokument obligues zyrtar ky për kohën, i cili edhe është botuar në Gazetën zyrtare të RSFJ-së nr. 29/80.

Pjesëmarrësit dhe miratuesit e "Ujdisë" në fjalë janë pajtuar që profesionet dhe përgatitjet profesionale të klasifikohen në tetë grupe, varësisht nga ndërlikueshmëria e punëve të profesioneve të caktuara, të qëllimeve të përmbajtjes së arsimimit dhe të përcaktohen kushtet minimale për arritjen e shkallës së përgatitjes profesionale.

Sipas kësaj "Ujdie" janë përcaktuar tetë shkallë të përgatitjes profesionale, të cilat përputhen me tetë shkallët e ndërlikueshmërisë së punëve. Ç'është e vërteta, aty janë përcaktuar 10 shkallë, përkatësisht kategori të ndërlikueshmërisë së punëve, kur kemi parasysh faktin se shkalla VI përbëhet prej dy shkallësh: shkalla VI-1 dhe shkalla VI-2, ashtu si edhe shkalla VII ndahet në dy shkallë: shkalla VII-1 dhe shkalla VII-2.

Në këtë dokument zyrtar nuk janë shënuar emërtimet e profesioneve, madje as titujt e kualifikimit sipas përgatitjes profesionale që arrihen në shkollat përkatëse, mirëpo në mbështetje të formulimeve të rubrikave të caktuara, sidomos në rubrikën "karakteristikat e përbashkëta të qëllimeve dhe të përmbajtjes së arsimimit" dhe në

rubrikën "kushtet minimale të arritjes së përgatitjes profesionale", mund të nënkuptohet edhe përcaktimi i kualifikimit shkollor.

Ç'është e vërteta, profesioni, dega e kualifikimit, titulli i fituar nga përgatitja profesionale a shkollore nënkuptohet në bazë të ndërlikueshmërisë së formuluar në shkallën përkatëse, si p.sh. punët me ndërlikueshmëri të thjeshtë - shkalla I, punët me ndërlikueshmëri të vogël - shkalla II, pastaj punët me ndërlikueshmëri të mesme të llojllojshme - shkalla III etj., kështu që punët e operacionet e ndryshme dhe me rritje ndërlikueshmërie të llojllojshme janë përfshirë në shkallët e tjera deri te shkalla VIII, ku janë përcaktuar "punët më të ndërlikuara e tejet të ndërlikuara", madje edhe ato punë e detyra, ku është evidente edhe puna krijuese e kryerësit që argumentohet edhe me gradën e "doktorit të shkencave".

Në mbështetje të kësaj "Ujdie" dhe të zgjidhjeve të mëparshme në ndërmarrje e në institucione të caktuara te ne është bërë harmonizimi i klasifikimeve të mëparshme me klasifikimin e ri të shkallëve të përgatitjes profesionale sipas kësaj skeme:

Skema e klasifikimit të profesioneve sipas shkallëve të ndërlikueshmërisë së punëve

| Klasifikimi i mëparshëm -emërtimi | Shkurtesa -inicialet | Klasifikimi i tashëm -shkalla |
|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|--------------------------------------------------------|
| 1. punëtor i kualifikuar me a pa shkollë të plotë profesionale | PK | shkalla I e përgatitjes |
| 2. punëtor i sprovuar me gjysmëkualifikim ose me me përgatitje të ulët profesionale | PUP | shkalla II e përgatitjes profesionale |
| 3. punëtor i kualifikuar | K | shkalla III e përgatitjes profesionale |
| 4. punëtor me përgatitje të mesme profesionale | PMP | shkalla IV e përgatitjes profesionale |
| 5. punëtor me kualifikim të lartë | KL | shkalla V e përgatitjes profesionale |
| 6. punëtor me arsim të lartë shkollor (profesional) | PLSH-1 | shkalla VI-1 e përgatitjes profesionale |
| 7. punëtor me arsim të lartë shkollor (profesional) | PLSH-2 | shkalla VI-2 e përgatitjes profesionale me specializim |
| 8. punëtor me përgatitje profesionale superiore profesionale (me fakultet) | PSP-1 | shkalla VII-1 e përgatitjes profesionale |
| 9. punëtor me përgatitje superiore profesionale | PSP-2 | shkalla VII-2 e përgatitjes profesionale |

| | | |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-----|--------------------------------------------|
| me specializim a magjistraturë | | |
| 10. punëtor me përgatitje superiore profesionale me gradën "doktor shkence" | PSP | shkalla VIII e përgatitjes profesionale |

Gjithsesi shkallët e përgatitjes profesionale shprehin qartësi e saktësi më të madhe në krahasim me shkurtesat që përdoren për kualifikimet përkatëse, madje shkurtesat mund të ndryshojnë sipas autorëve të caktuar. Këtu u paraqiten shkurtesat më të njohura që janë praktikuar në gjuhën shqipe në disa organizata a rrethe të caktuara te ne

Mendoj se ia vlen të theksohet ajo që është përcaktuar në nenin 9 të këtij akti ligjor. Aty thuhet se "varësisht nga lloji i profesionit dhe varësisht nga programi i arsimit, punëtori me fitimin e shkallës së caktuar të përgatitjes profesionale mund të aftësohet për kryerjen e punëve dhe të detyrave:

- në kuadër të profesionit të kategorisë së caktuar të ndërlikueshmërisë'
 - në kuadër të disa profesioneve të kategorisë së njëjtë të ndërlikueshmërisë dhe
 - në kuadër të disa profesioneve të disa kategorive të ndërlikueshmërisë
- (Aty f. 1002).

6. Harmonizimi i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit çështje e hapur në mes të qendrave shqipfolëse²⁵

Me ligje dhe akte të tjera juridike në dy qendrat kryesore shqipfolëse (Tirana e Prishtina) ishin rregulluar e sanksionuar "emërtimet zyrtare" të profesioneve (titujve, thirrjeve, gradave), mirëpo këto emërtime për arsye objektive dhe subjektive nuk dalin të harmonizuara përfundimisht as nga ana formale shkrimore as nga ana përmbajtësore, prandaj del detyrë e ngutshme që problemet e tilla të njihen (nostrifikohen) dhe sa më parë të harmonizohen d.m.th. të njësohen.

Sa për të ilustruar këtë mospërkim po i krahasoj disa "tituj profesionalë të përcaktuar për konceptet e caktuara te ne, sipas "Ligjit mbi titujt profesionale dhe shkallët akademike" të botuar në "Gazetën zyrtare" KSA të Kosovës nr. 26/86, me përkufizimet që janë dhënë në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe" (1980), ku do të shohim se sa ndryshime dalin.

Në "Ligjin" në fjalë shpjegohet fakti se "kategoritë dhe titujt profesionalë" të shënuar këtu "janë përshtatur sipas dispozitave të Ligjit federativ sipas "Gazetës zyrtare të RSFJ-së nr. 13/63", që do të thotë se janë "përkthyer"

²⁵ Si qendra kryesore shqipfolëse këtu emnohen Tirana dhe Prishtina. Dihet se Shkupi e Podgorica etj. për hir të sistemit etj. mbështeteshin në "gjuhën terminologjike shqipe" të Prishtinës.

përshtatur a kalkëzuar nga gjuha serbokroate.

Në këtë Ligj janë përcaktuar "titujt profesionalë" sipas shkollës së lartë dhe të fakultetit. Meqenëse titujt e tillë janë tituj zyrtarë ndër ne e që nuk përkojnë plotësisht me thirrjet e titujt përkatës në dokumentet zyrtare në Shqipëri, sa për ilustrim më poshtë po i shënojmë katër-pesë shembuj (duke i vënë pranë tyre edhe barasvlerësit përkatës edhe në gjuhën serbokroate):

Shembuj ilustrues të titujve profesionalëshqip/serbokroartisht

| Titulli profesional me shkollë të lartë a me shkallën I të fakultetit | Titulli profesional me fakultet |
|-----------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|
| 1. arsimtar (nastavnik) | profesor (profesor) |
| 2. arsimtar i gjuhës shqipe (nastavnik albanskog jezika) | profesor i gjuhës shqipe (profesor albanskog jezika) |
| 3. inxhinier (inzh_enjer) | inxhinier i diplomuar (diplomirani inzh_enjer) |
| 4. ekonomist (ekonomista) | ekonomist i diplomuar (diplomirani ekonomista) |
| 5. jurist (pravnik) | jurist i diplomuar (diplomirani pravnik) |

=====

Më duket se shembujt që u shënuan këtu mjaftojnë sa për të paraqitur çështjen e hapur që ekziston në gjuhën tonë, pasi që nocionet e emërtimeve "titujve profesionalë", siç janë saktësuar me ligj ndër ne nuk përkojnë me kuptimin leksikor të termit të caktuar në dokumentet që i patën në dispozicion për mbarë truallin e gjuhës shqipe, përkatësisht në Shqipëri.

Më poshtë po jap pasqyrën e disa emërtimeve të sipërcekura në përdorim se si duket në raportin Kosovë dhe Shqipëri:

Pasqyra e disa shembujve në raportin Kosovë / Shqipëri

| Në Kosovë: | Në Shqipëri: |
|-------------------------------------------------------------|------------------------|
| 1. - arsimtar i gjuhës shqipe - profesor i gjuhës shqipe | mësues i gjuhës shqipe |
| 2. - inxhinier - inxhinier i diplomuar | inxhinier |
| 3. - ekonomist | ekonomist |

- ekonomist i diplomuar
 - 4. - jurist
 - jurist i diplomuar
- jurist

Sigurisht "zgjidhjet" te ne janë kalkëzime a përkthime nga gjuha serbokroate, por siç u tha më sipër kanë arritur të zyrtarizohen, madje tash një kohë relativisht të gjatë janë në përdorim të gjerë, madje mund të konsiderohen si emërtime konkurruese, pasi edhe shprehin koncepte të diferencuara.

T'i ilustruam dallimet paksa më hollësisht: Fjala **arsimtar** b.f. sipas FGJSSH-së ka kuptimin "ai që punon në fushë të arsimit, duke dhënë mësim në shkollë; mësues ose pedagog (FGJSSH f. 54), kurse në gjuhën serbokroate me fjalën **nastavnik** (arsimtar) kuptojmë "punëtor i arsimit me përgatitje të lartë profesionale (me shkollën e lartë pedagogjike të kryer ose me shkollë të ngjashme)" /RSHKJ 3 f. 630 nën b./²⁶.

Pra fjala *arsimtar* te ne duke qëndruar si barasvlerës i mirëfilltë i fjalës *nastavnik* ka kuptim më të përcaktuar. Sigurisht te ne s'mund të përdoret kjo fjalë për konceptin mësues (në vend mësues në ciklin e ulët të shkollës fillore, dhe as për profesor të shkollës së mesme). Edhe fjala "pedagog" (në vend të profesorit a të ligjëruesit në fakultet) nuk përkon. Gjithsesi ndeshim në dallime edhe lidhur me përcaktimin e fjalës mësues (u_itelj), profesor e pedagog. Siç dihet te ne titullin "pedagog" e fitojnë studentët që e kryejnë Fakultetin e pedagogjisë, ndërsa në Shqipëri, siç u tha quhen profesorët a ligjëruesit që japin mësim në fakultet.

Mjaft problemore del çështja e lidhur me dallimin e shkallëve të përgatitjes profesionale: përgatitja profesionale me shkollë të lartë" kundrejt "përgatitja profesionale me fakultet", siç u ceken më sipër tre shembujt e fundit: inxhinier // inxhinier i diplomuar, ekonomist // ekonomist i diplomuar, jurist // jurist i diplomuar. Sipas FGJSSH-së në Shqipëri vazhdon të përdoret për të dyja konceptet emërtimi përkatës pa shtesën "i diplomuar". Vetë sistemi shkollor që ende funksionon te ne domosdo imponon një ndarje të tillë. Gjithsesi kjo çështje mbetet e diskutueshme. Mbase me harmonizimin e sistemit shkollor si dhe të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, si te ne ashtu edhe në Shqipëri, problemi i tillë do të zbutet a do të zgjidhet më së miri.

Është e vërtetë, se në realitetin tonë gjuhësor është i domosdoshëm dallimi i koncepteve, jo vetëm se është sanksionuar me ligj, por për arsye praktike, sepse për titullin b.f.: inxhinier (ekonomist, jurist) kandidati mjafton të kryejë shkollën e lartë 2 vjeçare ose dy vjet të fakultetit të shkallëzuar, ndërsa për titullin: inxhinier i diplomuar (ekonomist i diplomuar, jurist i diplomuar) kandidati patjetër duhet ta kryejë fakultetin, i cili zgjat 4 - 5 vjet, prandaj ky fakt lypset dalluar patjetër, ngase mund të ketë pasoja jo të vogla në punësim e në sfera të tjera të jetës.

Gjithsesi çështja e harmonizimit të termave në qendrat kryesore

²⁶ RSHKJ = Re_nik srpskohrvatskoga knji_evnog jezika, Matica srpska, Novi Sad 1969 (fototip 1982).

shqipfolëse del i domosdoshëm.

Në Shqipëri, me sa dihet, emërtimet e kualifikimit pasuniversitar a tituj shkencorë (akademikë) janë vendosur kështu:

- "docent", "bashkëpunëtor i vjetër shkencor" dhe "profesor", përkatësisht këto grada shkencore:

- "kandidat i shkencave" dhe "doktor i shkencave".

Për hir të njohjes me realitetin tonë gjuhësor në bazë të "Ligjit mbi arsimimin e lartë" (Prishtinë 1988) po i shënojmë titujt e mësimdhënësve në shkollat e larta dhe fakultet e Kosovës:

a) Në shkollat e larta të mësimdhënësve, sipas këtij ligji, kanë këta tituj:

- "ligjërues" dhe "profesor", kurse bashkëpunëtorët marrin titujt:
- "asistent" dhe "mësimdhënës i mësimi praktik".

b) Në fakultete titujt e mësimdhënësve dhe të bashkëpunëtorëve janë si vijon:

-docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar (mësimdhënës të fakultetit);

- ligjërues dhe ligjërues i lartë (mësimdhënës të gjuhës së huaj dhe të kulturës fizike);

- asistent-praktikant, asistent, lektor dhe lektor i lartë (bashkëpunëtorë);

-bashkëpunëtor profesional dhe bashkëpunëtor i lartë profesional, përkatësisht bashkëpunëtor i lartë artistik (në fakultetin e arteve).

Pa marrë parasysh ndryshimet që ndodhin në mes të nocionit "përgatitje profesionale" nga nocioni "njeriu sipas profesionit" në punimin tonë nga aspekti formëzues e fjalëformues nuk trajtohen veçan, sepse edhe titujt zyrtarë të shkollave të larta dhe të fakulteteve si emërtime të njerëzve sipas profesionit bëjnë pjesë në kuadër të emrave të vepruesit. Siç është përmendur edhe më përpara në realitet emrat e vepruesit normalisht formëzohen (shndërrohen) në emërtime të njerëzve sipas profesionit.

7.Emërtimet e njerëzve sipas profesionit çështje e hapur e bashkësisë shoqërore

Jo vetëm në gjuhën tonë a në shoqërinë tonë, siç u cek më sipër, por edhe në gjuhë e kombe të tjera, ku më pak a ku më shumë, ekzistojnë probleme të kësaj natyre. Kështu që çështja e regjistrimit, harmonizimit, përkthimit dhe e ndërkëmbimit të ekuivalencave të emërtimeve të profesioneve mbetet gjithnjë çështje e hapur edhe te ata popuj, por edhe përgjithësisht del çështje e brishtë, kur kemi të bëjmë me emërtime të reja si rezultat i "revolucioneve" të caktuara tekniko-teknologjike. Kështu që edhe në suaza ndërkombëtare po bëhen përpjekje të organizuara rreth

harmonizimit të barasvlerësve përkatës të emërtimeve të profesioneve. Organizata e organizma të caktuara ndërkombëtare veprojnë në këtë drejtim, siç është edhe Organizata Ndërkombëtare e Punës "ILO"²⁷. Edhe Konferenca evropiane e sindikatave ka dhënë kontributin e vet të konsiderueshëm në këtë fushë. E kemi të njohur "Rezolutën" e vitit 1988 me të cilën pos tjerash ekskluzivisht kërkohet edhe "unifikimi i emërtimeve të profesioneve"²⁸.

Në Jugosllavi b.f. edhe sa ishte shtet unik ka pasur përpjekje të organizuara, jo pa sukses, për harmonizimin e emërtimeve të profesioneve, ngase ekzistonin probleme të hapura të pazgjidhura brenda republikave e krahinave si dhe qendrave të caktuara universitare.

Është i njohur fakti se zgjedhja e profesionit në jetën e njeriut ka rëndësi tejet të madhe edhe për suksesin personal të njeriut. Edhe me konventa përkatëse e kushtetuta sanksionohet e drejta e çdo personi për "zgjedhjen e lirë të profesionit"²⁹, mirëpo, ç'është e vërteta, çështja e zgjedhjes së profesionit nuk është vetëm çështje e individit, por edhe e mbarë shoqërisë... ajo ndërlidhet me një sërë faktorësh të brendshëm e të jashtëm, sidomos kur dihet supozimi se "çdo njeri a çdokush është i aftë për një profesion dhe askush nuk është i aftë për të gjitha profesionet", atëherë del me vend konstatimi se "në të gjitha shoqëritë e përparuara ekzistojnë shërbime të veçanta për orientimin profesional të kuadrove", shërbime këto që marrin parasysh të gjitha kushtet lidhur me kandidatët: interesimin personal, gjendjen shëndetësore si dhe kushtet e natyrës objektive d.m.th. ekzistimin e profesioneve të caktuara në rrethe të caktuara, gjendjen e nevojat ekonomike dhe mundësitë e punësimit, nevojat e tregut etj.

Është e vërtetë, pra, se çështja e emërtimeve të profesioneve lidhet edhe me reformat e caktuara shkollore ose me mënyrën e zhvillimit të sistemit shkollor dhe se llojet e nënlojet e profesioneve e profilizimet e tyre do të varen nga rrethanat e nevojat që sjell koha dhe mundësitë që krijon baza ekonomike e sociale e shoqërisë së caktuar. Gjithashtu duhet pasur parasysh faktin se nga përimtimet e profesioneve d.m.th. nga profilizimet dhe specializimet dalin vështirësi sa u përket kushteve të shkollimit, të sigurimit a të aftësisimit të kuadrit arsimor profesional si dhe sigurimit të mjeteve të caktuara materiale, siç janë edhe mjetet mësimore të konkretizimit etj.

Ndërsa në Jugosllavi sipas doracakut "Lista alfabetike e profesioneve të arsimit të mesëm të orientuar" (EFS, Beograd 1981) ishin të regjistruar 2654 profesione dedikuar shkollave të mesme. Ndërkaq në Kosovë, sipas gazetës "Rilindja" të datës 7. V. 1986 jepet e dhëna se në vend të "57 profesioneve sa ekzistonin në shkollat

²⁷ ILO - International labour organisation, shih B. Klai_, Veliki rje_nik stranih rje_i, izraza i kratice, Zagreb 1968 dhe te gazeta "Shkëndija" (Kosovë) nr. 8/91 f. 11.

²⁸ Shih te revista "Zaštita rada", Beograd 1989 f. 10, Rezolucija Kongresa "Evropske konferencije sindikata" Stokholm 1988.

²⁹ Shih edhe te "Ustav SFRJ 1974" (Kushtetuta e RSFJ 1974).

tona të mesme tashmë janë saktësuar 300 profesione", me sa di, aktualisht jepen (lëshohen) diploma për afro 200 profesione³⁰.

Nga të dhënat e mësipërme nuk del vetëm çështja e numrit të pa përfshirë të profesioneve të ne, por del edhe çështja se si do të shënohen (pagëzohen) emërtimet e tilla, del problemore çështja e saktësisë së formulimit përkatës në gjuhën shqipe të emërtimit përkatës. Në këtë drejtim vërtet dalin çështje ende të pazgjidhura jo vetëm drejt-fjalëformuese, por edhe profesionale e logjike. Pra kur probleme gjuhësore ndeshim në emërtimet që shënohen në diplomat e shkollave të mesme, ku personeli dhe kuadri kompetent është më i ngrituri dhe i organizuari, atëherë dihet sesa të mëdha dalin problemet rreth formulimeve të profesioneve të caktuara të profilizuara (specializimeve etj.) në organizatat tona punonjëse. Sigurisht gjendja ishte dhe është alarmante, prandaj lypset qasje për zgjidhjen e çështjeve të tilla sa më parë e në mënyrë më të organizuar mbi bazë shtetërore.

Më sipër është konstatuar me vend se çështja e emërtimit të njerëzves sipas profesionit nuk duhet lënë stihisë, ajo është çështje që duhet të zgjidhet nga shoqëria me organizmat e veta. Në radhë të parë duhen sforcuar organet shkollore në mënyrë klearkike. Lidhur me formulimet e caktuara duhet bashkëpunuar faktorët kyç të ekonomisë, sipas degëve përkatëse të veprimtarisë, por edhe gjuhëtarët si dhe kuadrot kompetentë që i njohin problemet si në shkallë kombëtare ashtu edhe në shkallë ndërkombëtare.

Është i njohur fakti se me rastin themelimit të çdo ndërmarrjeje private a shoqërore, çdo institucioni apo çdo njësie të re punonjëse a shërbyese siç është "biznesi i vogël" a "ekonomia e vogël" patjetër në elaboratin a tekstin koncept-ide rreth arsyeshmërisë ekonomike duhet cekur edhe procesin tekno-teknologjik etj., por edhe vendet e punës, d.m.th. parashihet domosdo kuadri drejtues (përfaqësues) si dhe fuqia punëtore e profiluar që do të punësohet në prodhim të drejtpërdrejtë, duke cekur edhe strukturën kualifikuese të tyre sipas shkallëve të përgatitjes profesionale etj.

Me një fjalë në të gjitha llojet e veprimtarisë ekonomike siç janë: bujqësia, pylltaria, ndërtimtaria, komunikacioni dhe lidhja, hoteleria e turizmi,

³⁰ Me rastin e përgatitjes së këtij kreu u konsultuan shumë doracakë, ndër të cilët po veçojmë: 1. Regjistrimi i personelit të inkuadruar, EFS, Beograd, 1977; 2. Planii regjistrimit të nxënësve në AMO për vitin shkollor 1985/1986 në territorin e KSAK, Prishtinë 1985; 3. Doracak informativ për zgjedhjen e profesionit, EKIN - Shërbimi për orientim profesional, Prishtinë 1968; 4. Nevoja për kuadro gjer në vitin 1985 (BVIAEK) - nomenklatura e profesioneve, Prishtinë 1981; 5. Nevojat vjetore për punëtorë dhe plani i punësimit për vitin 1985 - BKVIP, Prishtinë 1985; 6. Vendim i BAE e KSAK (emërtimi i profesioneve të nxënësve), Prishtinë 1980; 7. Nomenklatura e profesioneve me shifrarin, EKP, Prishtinë 1979; 8. Lista e shkollave, EFS, Beograd 1982; Zakon o visokom obrazovanju, Beograd 1074; 10. Propozim i shkallës unike të kualifikimit si bazë e sistemit të AO, Komisioni ndërrepublican e krahinor për reformën e edukimit dhe të arsimimit, Beograd 1981; 11. Ligji për titujt profesionalë dhe shkallët akademike (propozim), KEK të KSAK, Prishtinë 1986; 12. Projektligji për asimin e lartë, gazeta "Rilindja", më 31. III. 1988, etj.

zejtaria e sidomos industria, imponohet nomenklatura e profesioneve si teori edhe si praktikë, së këtejmi del se edhe emërtimet e tilla të njerëzve sipas profesionit duhen të jenë të arrira edhe gjuhësisht.

8.Vendi i emërtimit të njeriut sipas profesionit në kuadër të koncepteve të tjera emërore

Siç kemi pasur rast të shohim nga paraqitja e mëparshme në këtë punim emërtimi i njeriut sipas profesionit kishte lidhje të ngushtë por nuk ishte identike me emërtimet e caktuara, qoftë të vendit të punës, qoftë të përgatitjes kualifikuese a profesionale, qoftë me emërtimet e titujve a të gradave akademike etj., por përfshinte në konceptin e përgjithshëm edhe emërtimet e tilla.

Gjithashtu tashti mund ta kemi më të qartë se emërtimi i njeriut sipas profesionit ka mbështetje kryesore në termin "përgatitje profesionale" me të cilin nënkuptohen "njohuritë dhe shprehjet e përgjithshme profesionale, shkencore ose artistike" që i fiton njeriu zakonisht në mënyrë të organizuar për të kryer "punët e detyrat sipas shkallës së ndërlikueshmërisë" dhe se termi i tillë ka lidhje ta pandashme me emërtimin e degës a të drejtimit profesional me të cilën nënkuptohet "grupi i profesioneve të afërta përkah përmbajtja e punës, pa marrë parasysh shkallën e përgatitjes profesionale". E kemi më të qartë sigurisht edhe faktin se qoftë "përgatitja profesionale", qoftë "dega a drejtimi profesional", përcaktohen me plane e programe sipas "profilimit arsimor" të shkollës a institucionit përkatës. Me termin "profil arsimor" kuptohet "shkalla dhe lloji i njohurive, aftësive dhe shprehjeve të punës" të nevojshme këto për të kryerë punët dhe detyrat sipas ndërlikueshmërisë së njëjtë a të ngjashme të degës a të profesionit të caktuar të emërtuar, qoftë sipas profilimit arsimor, qoftë sipas përcaktimit specialistik.

Përveç emërtimeve (titujve, gradave etj.) që arrihen në institucione publike legale shkollore etj. ndeshim edhe në emërtime të njerëzve sipas profesionit, të cilat nuk fitohen sipas atij organizimi, por si të themi në mënyrë "ilegale", por janë të legalizuara, si të themi, në jetën e përditshme.

Nëse me fjalën "profesion" sipas kuptimit të gjerë kuptojmë çdo veprimtari të njeriut, e cila atij i sjell mjete për ekzistencë (të mira materiale), atëherë koncepti i emërtimit të njeriut sipas profesionit del shumë më i gjerë se sa fitohet në shkolla a institucione të organizuara publike shoqërore. Kështu p.sh. patëm rastin të ndeshim një shpallje publike në shtypin tonë me të cilën kërkohet "një pastruese e shkallëve të ndërtesës", "profesion" ky që nuk mësohet asgjëkundi dhe nuk ndeshet i regjistruar në nomenklaturën e profesioneve, por realisht ekziston dhe për këtë "zanat" personi merr pagën dhe siguron mjetet për ekzistencë. Pastaj na është e njohur dukuria sesi në disa vende "mësohet", me sa dihet, jo legalisht "zanati" i lypësisë, ai i hajnisë etj., prandaj edhe rastet e tilla e të ngjashme, domosdo hyjnë në konceptin e gjerë të "emërtimit të njeriut sipas profesionit", edhe pse emërtimet e tilla nuk figurojnë asgjëkundi në "nomenklaturën e profesioneve". Siç dihet personat e caktuar me "zanatet" e tilla sigurojnë ekzistencën, prandaj edhe formëzimi i

emrave të tillë si profesione gjithsesi hyn konceptualisht si probleme gjuhësore në kuadër të temës që po trajtohet në këtë punim.

Nga sa u shtjellua më sipër del e nevojshme të sqarohet fakti se togfjalëshi "**njeriu sipas profesionit**" si term nuk është identik as me emërtimin "**nomenklatura e profesioneve**", sepse siç vëren studiuesi Xhevat Lloshi: "Parimi i emërimit (tek emërtesat) nuk është si te terminologjia, ku klasifikimi bëhet nëpërmjet të abstraktimit, synon t'u përgjigjet marrëdhënieve objektive të zbuluara nga depërtimi në thelbin e dukurive", kurse tek emërtesat (nomenklatura), për çka si shembull tipik ilustrimi merr "emërtimet e njerëzve sipas profesionit" siç e shpjegon autori "mjafton të arrihet dallimi i sipërfaqshëm, të arrihet kategorizimi duke iu përgjigjur nevojave të përdorimit, të administrimit, të hierarkisë së pranuar etj."³¹.

Edhe Hajrullah Gorani lidhur me këtë çështje konstaton gjithashtu me vend, dallimin ndërmjet këtyre dy termave, me fjalët: "ndërsa terminologjia paraqet tërësinë e shprehjeve shkencore me të cilat emërtohen nocionet e një fushë të caktuar të dijes, nomenklatura bën emërtimin e sendeve konkrete të teknikës, të proceseve teknologjike materialit, makinave të ndryshme etj."³².

Po ashtu edhe në Fjalorin e R. Simeonit për fjalë-termin **nomenklaturë** jepet përkufizim i ngjashëm, ngase siç theksohet aty, me fjalën nomenklaturë kuptohen "emërtimet e objekteve tipike të dijes së caktuar për ndryshim nga terminologjia, e cila përfshin emërtimet e koncepteve abstrakte"³³.

Pra në këtë punim togfjalëshi "emërtimi i njeriut sipas profesionit" do të kuptohet në radhë të parë si term e më pak si njësi nomenklature (emërtesë), ndonëse në shumë raste merren shembuj pikërisht nga nomenklatura e profesioneve, prej nga edhe është grumbulluar shumica e materialit që i është shtruar analizës formëzuese e fjalëformuese.

Gjithsesi nomenklatura e profesioneve është lëndë bazë për studime të terminologjisë së emërimit të njerëzve sipas profesionit, edhe pse çdo emërtesë e shënuar nuk mund të cilësohet si term i mirëfilltë i njeriut sipas profesionit.

Nga aspekti i strukturës fjalëformuese "emërtimet e njerëzve sipas profesionit" në gjuhën shqipe kërkojnë shkoqitje të veçantë. Gjatë analizës së strukturës fjalëformuese, edhe pse është konstatuar me vend se emërtimi i njeriut sipas profesionit nuk mund të identifikohet me emrin, sepse "emërtimi" del jo vetëm si emër, por edhe si togfjalësh a shprehje perifrastike, d.m.th. me nocion më të gjerë, megjithatë edhe emërtimi i tillë s' mund të ndahet dot nga analiza e ndërtimit të emrit si njësi leksiko-gramatikore. Ç'është e vërteta, emërtimet në fjalë si emra bëjnë pjesë në kuadër të kategorisë së emrave të vepruesit dhe nga ana e ndërtimit as që mund të dallohen. Me fjalë të tjera, nga pikëpamja e strukturës fjalëformuese, përkatësisht

³¹ Shih: Xhevat Lloshi, Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe, Prishtinë 1988, f. 205

³² H. Gorani, te Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, Prishtinë 1988 f. 198.

³³ R. Simeon, Enciklopedijski rje_nik lingvistikih naziva, Zagreb 1969.

nga forma shkrimore ata paraqiten identikë. Ndërmjet tyre nuk shihet kurrfarë dallimi, ngase shërbehen me elemente të njëjta fjalëformuese. Nga ana kuptimore emërtimet e profesioneve dallojnë nga emrat e vepruesit vetëm në çastin e formëzimit, d.m.th. që në çastin kur emri i caktuar funksionalisht merr tiparin e profesionit, andaj vetë aktiviteti i veçantë që nënkuptohet e bën të dallueshëm.

Lidhur me këtë dallim po e sjell konstatimin e qëlluar të studiuesit Ardian Vehbiu, i cili thotë ndër të tjera se "siç dihet emrat e njerëzve sipas mjeshtërisë përbëjnë një klasë leksiko-semantike mjaft të afërt me klasën e emrave të vepruesit ... ndryshe nga emrat e mirëfilltë të vepruesit, emrat e njerëzve sipas mjeshtërisë emërtojnë dikë jo sipas veprimit që ai kryen në një çast të dhënë, por sipas veprimit që ai është i aftësuar të kryejë, pavarësisht nëse e kryen apo jo në atë çast të dhënë. Në këtë vështrim emrat e njerëzve sipas mjeshtërisë afrohen me emrat e njerëzve sipas cilësisë, që emërtojnë dikë sipas një tipari të tij kryesisht shpirtëror që mendohet si i përhershëm dhe zgjidhet për të emërtuar... Mund të thuhet se në semantikën e tyre emrat e njerëzve sipas mjeshtërisë ndërthurin veçori semantike të emrave të vepruesit dhe të një tipari", d.m.th., siç nënkutohet, kemi të bëjmë me tiparin emrit a të nocionit që tregon njeriun sipas profesionit.

Emri i vepruesit e bashkë me të a brenda tij edhe emri si emërtim i njeriut sipas profesionit herë-herë del identik për nga forma me mbiemrat përkatës, por ndonjëherë edhe me emrat përkatës të veglave, pajisjeve a të veglave të caktuara.

Prandaj nga sa u tha më lartë, kur kemi të bëjmë me analizën fjalëformuese do të theksohen shembuj nga fusha e emërtimeve të njerëzve sipas profesioneve, por veçoritë e caktura vlejné përgjithësisht për emrat e vepruesit, për emrat e njerëzve sipas cilësisë dhe emrat e njerëzve sipas përkatësisë shoqërore politike a të lëvizjes së caktuar përkatëse etj, për mbiemrat homofomë si dhe për emrat homonim të veglave a pajisjeve të caktuara.

Pikërisht ndërlikueshmëria që del nga ngjashmëritë dhe dallimet në kuadër të anës kuptimore a semantike të emrave të caktuar të së njëjtës formë shkrimore dhe shqiptimore paraqet interes shkencor dhe atraktiv për hulumtime më të thella gjuhësore, gjë që do të përpiqemi ta kemi parasysh a ta dallojmë paksa në kërret vijues të këtij punimi.

P ë r m b y l l j e

Në togfjalëshin "njeriu sipas profesionit" kuptojmë emërtimet e njerëzve sipas punëve që bëjnë, sipas detyrave që kryejné, sipas veprimtarive që ushtrojnë dhe sipas pozitës që zënë në kierakinë shoqërore. Emërtimi i njeriut sipas profesionit bëhet në bazë të kualifikimit shkollor e profesional që posedon individi i caktuar, qoftë sipas shkollimit të rregullt e me korrespondencë, qoftë të fituar sipas përvojës në punë e sipër.

Kriter themelor për emërtimin e caktuar është institucionalizimi, d.m.th. njohja e veprimtarisë së tillë nga shoqëria e rrethi ku jeton a vepron njeriu dhe për emërtimin e pagëzuar zakonisht paguhet materialisht ose ka satisfaksion moral, por ka raste që

"profesionet" e caktuara të dalin edhe jashtë suazave të shkollimit publik, qoftë për arsye se veprimet e tilla i përkasin një pune që nuk kërkon "përgatitje të veçantë shkollore", qoftë për arsye se "veprimet e tilla" bien ndesh me normat etike të shoqërisë së caktuar, edhe pse nga ato punë individi i caktuar mund të fitojë mjete materiale për ekzistencë.

Emërtimet e njerëzve në fjalë mund të kenë vlerë historike dhe vlerë aktuale varësisht nga puna, detyra a shërbimi që është kryer, kryhet ose mund të kryhet nga personi i caktuar.

Çështja e emërimit të njerëzve sipas profesionit nuk është çështje individuale, por në radhë të parë ajo është çështje shoqërore, d.m.th. është çështje e shkollës, e ekonomisë, e administratës, e drejtësisë, por është edhe çështje gjuhësore dhe si të tillë emërtimet njerëzve sipas profesionit lypset sanksionuar me aktet ligjore, pasi të vlerësohen edhe gjuhësisht.

Gjendja e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit lypset ndjekur vazhdimisht nga organet e kuadrot kompetente. Për të qenë zgjidhjet më të drejta dhe afatgjata formëzimi dhe formimi i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit lypset ndjekur e vlerësuar duke i pasur parasysh ligjet e brendshme të gjuhës, por edhe marrëdhëniet me jashtë si dhe zhvillimin teknikuteknologjik të kohës si dhe sistemin më të përparuar shoqëror ekonomik e politik bashkëkohor.

Në gjuhën shqipe në suazat mbarë kombëtare del e nevojshme dhe e domosdoshme të bëhet harmonizimi "zyrtar" i të gjitha emërtimeve të njerëzve sipas profesionit dhe se ky harmonizim nuk duhet të bie në kundërshtim me emërtimet e tilla në suaza ndërkombëtare, sidomos kur është fjala të kualifikimet shkollore të rangut të njëjtë profesional. Sistemi i shifrimit të profesioneve duhet të zbatohet edhe në gjuhën shqipe.

KREU II

VËSHTRIM KRONOLOGJIK I FORMËZIMIT TË EMËRTIMEVE TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT NË GJUHËN SHQIPE SIPAS BURIMEVE PËRKATËSE

Emërtimet e njerëzve sipas profesionit në kuptim të gjerë lidhen gjithsesi me jetën e shoqërisë njerëzore, me gjuhën e me gjendjen shpirtërore e materiale të popujve. Krahas zhvillimit të bashkësisë së caktuar folëse lindën edhe nevojat për të emërtuar punën a veprimtarinë e personave të caktuar, por edhe punën e grupeve të caktuara dhe këto punë e veprimtari doli e nevojshme të dallohen, përkatësisht të emërtohen si koncepte të reja të kushtëzuara nga puna e veprimtaria e individëve dhe të grupeve të caktuara. Pra, tashti në rrethana të caktuara me elemente të ndryshuara dhe me karakteristika të veçanta punët a veprimet e tilla mund të cilësohen edhe si profesione të para dhe së këtejmi doli e nevojshme edhe të emërtohen ose fjalët ekzistuese të formëzohen veçan me ndonjë kuptim të ri polisematik. Kjo u kushtëzua sigurisht për shkak a si rrjedhojë e ndarjes së punës (detyrave), sipas funksionit përkatës që do të kryejë personi i caktuar, sipas rolit a pozitës së tij në familje, në shoqëri, në kiarëkinë shoqërore etj., qoftë në varësi nga karakteri i punës prodhuese, qoftë sipas tipave të punës jo prodhuese, me një fjalë, doli, sikurse del edhe sot, e nevojshme të bëhen dallime sipas degëve të caktuara të ekonomisë a të kulturës së bashkësisë së caktuar folëse në etapa të caktuara historike.

Sigurisht zhvillimi shoqëror-gjuhësor i një bashkësie folëse a i një populli mund të vështrohet edhe nga prizma e formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit nëpër etapat e caktuara historike, d.m.th. që nga mbledhja e frutave e deri te etapa e industrializimit: automatizimit dhe kompjuterizimit.

Në gjuhën shqipe procesin e formëzimit të emërtimeve në fjalë kemi mundësi ta ndjekim që nga monumentet e para të shkrimit shqip, aty nga shekulli XV, XVI, kur panë dritën e shtypit shkrime të ndryshme e ndër to më e dallueshmja del vepra "Meshari i Buzukut" (1555). Mirëpo sipas studiuesve emërtimet e tilla kemi mundësi t'i ndjekim edhe para këtij monumenti, ngase ndeshen të dhëna të pamohueshme fosilizuese e jo dhe aq të fosilizuara, që dëshmojnë se disa emërtime të njerëve sipas veprimtarisë ishin përdorur edhe më përpara kësaj faze. Për këtë dëshmojnë sidomos disa emërvende. E. Çabej (ashtu si edhe H. Pedersen) toponimet: Kudhës, Lëkurës, Lopës, Bulqesh, Mashtërkorë i shpjegon "si apelativa që shënojnë ushtruesin e një mjeshtërie popullore"³⁴. Siç dihet, fjala Kudhës shpjegohet me apelativin: farkëtari

³⁴ Shih te Xhuvani - Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980 f. 470, 478.

që punonte kudhat, Lëkurës - përpunuesi i lëkurave, Lopës - ruajtësi a mbajtësi i lopëve (lopar³⁵), Bulqesh - nga bulk bujq /bujq/ - ai që punonte tokën" (FGJSSH f. 190), Mashtërkor - bërësi i mashtërqeve, e kështu me radhë. Në "Fjalorin enciklopedik shqiptar" (1985)³⁶ ndeshim edhe këta emra vendesh: Dardan, Pëllumbar, Shalës, Shpatar (Elbasan), Kordhës (Kurvelesh) etj. që shpjegohen si ata që u shpjeguan më sipër, përkatësisht si kultivues dardhash, pëllumbash, prodhues shalash, shpatash, kordhash ë kështu më radhë. Zgjon interes shpjegimi që jep prof. dr. L. Mulaku³⁷ për toponimin: Mazërak që asociacionon njeriun sipas profesionit (ruajtës, kultivues i mëzave) si p.sh. nga maz (mëz): Mazrak (mazrek), pastaj toponimet e gjuhës serbokroate në truallin shqipfolës: Strelc që asociacionon në shqipe barasvlerësin "Shigjetar" (strela- shigjetë), Llukar(i) - Harkës (serb. luk - hark) dhe Sedlari - Shalës (serb. sedla - shalë) /Aty f. 128/.

Nuk zgjojnë vetëm kërkshërinë, por edhe cysin interesin shkencor të dhënat me shumë interes që i jep prof. Dh. Shuteriqi në punimin "Fjalë nga leksiku i shqipes para Buzukut"³⁸, ku janë dhënë afro 80 emërtime të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë si fjalë të shqipes të përdorura në dokumentet e caktuara para se të botohej vepra e Buzukut (1555), ndër të cilat po veçoj disa emra prapashtesorë: kaluer; lopar, moknar, lundrar; lopëç; murës; lugës, lugarës, manës, melës, marrës, rripës; arbanës, buljarës, kapës, kishës, kripës, kudhës, livadhar, dardhan etj.

Sigurisht përthellimi i mëtejshëm në studimin e kësaj lëndë nga aspekti ndërdisiplinor do të sjellë rezultate më të mira, por edhe kështu sa u cek këtu flet për një kulturë të vërejtshme të shqipfolësve edhe në periudhën para dokumentuese të shkrimit të shqipes.

Meqenëse emërtimet e njerëzve sipas profesionit si terma i takojnë fushës së leksikologjisë, në këtë vështrim kronologjik lëndën e vjelë do ta trajtojmë të ndarë në dy periudha të mëdha, në dy nënkrerë, duke u mbështetur kryesisht në burimet leksikologjike e leksikografike e të tjera të gjuhës sonë:

- A. Nënkreu I ose Periudha para Luftës II Botërore dhe
- B. Nënkreu II ose Periudha pas Luftës II Botërore.

Për një ndarje të tillë gjithnjë patëm parasysh metodën më të lehtë të përkapjes si dhe konstatimin e drejtë të Jani Thomait, ngase siç thotë ai "të dyja periudhat janë pjesë

³⁵ Akad. I. Ajeti, Rreth disa albanizmave të Fjalorit të V. Karaxhiqit, Gjuha shqipe 1/89, ku pos tjerash del i shënuar edhe topinimi Lopar "mal sipër Zenicës".

³⁶ Akademia e Shkencave e RSPSSH, *Fjalor enciklopedik shqiptar*, Tiranë 1985. Shih edhe gazeta *Rilindja*, 24.11.'99 f. 10 dhe *Gazeta shqiptare*, 24.02.'92, f. 19.

³⁷ Shih: Latif Mulaku te "Gjurmime albanologjike -Seria e shkencave filologjike nr. 19/89, Prishtinë 1989 f. 128.

³⁸ Shih: Dh. Shuteriqi te "Gjurmime albanologjike" ser. e shk. filologjike, nr. 19/89, Prishtinë 1989 f. 879 -1553.

të një organizimi të vetëm, që është zhvilluar pandërprerje, por edhe me dallime të qarta ndërmjet tyre".³⁹

Dhe pikërisht kjo vazhdimësi me "pandërprerje" por dhe me "dallime" do të hetohet sadopak sipas etapave e fazave të caktuara brenda periudhave të sipërcekura në punimin tonë në vazhdim.

Mirëpo qëllimi ynë kryesor nuk është vetëm të vëmë në spikamë emërtimet në faza të caktuara, edhe pse nuk mohohet rëndësia e caktuar nga pikëpamja historike, por kemi për qëllim të hetojmë mënyrat dhe modelet fjalëformuese si dhe vazhdimësinë e qëndrueshmërinë e mënyrave dhe të gjedheve të tilla deri në gjendjen e sotme të gjuhës sonë letrare, duke ia vënë në pëqi për shfrytëzim shqipes standarde. Një trajtim i tillë sigurisht nuk do të paraqesë vetëm interes për gjendjen aktuale të gjuhës, por ajo do të ketë edhe interes sadopak edhe historik, por me vlerë edhe për të ardhmen.

Gjithsesi gjatë këtij trajtimi do të kihet parasysh, aq sa jepet mundësia, edhe ndryshimet në semantikën e fjalë-emrave të caktuarë, siç është zgjerimi i kuptimit, ngushtimi, mbase edhe ndryshimi eventual i kuptimit leksikor etj.

Në raste gjithashtu do të theksohet dukuria e huazimeve, kalkëzimeve si dhe krijimi i fjalëve të reja, qoftë në kuadër të gjedheve të pranuar popullore, qoftë edhe si krijime të rastësishme (kontekstore), qoftë edhe si krijime të mëvetësishme sipas modeleve të gjuhëve të huaja. Pra qëllimin e kemi që nga shembujt e vjelë të vëmë në pah sadokudo një pasqyrë më të qartë rreth strukturës së formëzimit dhe të fjalëformimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe gjatë zhvillimit historik deri në ditët e sotme.

A. PERIUDHA PARA LUFTËS II BOTËRORE

Në periudhën para Luftës II Botërore përfshihen tri etapat që e karakterizojnë këtë interval mjaft të gjatë kohor, siç janë:

1. Etapa e shkrimit shqip para Rilindjes Kombëtare Shqiptare;
2. Etapa e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe
3. Etapa shkrimit shqip në kohën e Pavarësisë së shtetit shqiptar (1912 - 1944), d.m.th. etapa ndërmjet dy luftrave botërore.

1. Etapa para Rilindjes Kombëtare

Kjo etapë karakterizohet prej katër burime shkrimesh:

- a) Shkrimet e vjetra geqe (të konfesionit katolik);
- b) Shkrimet e vjetra toske (të konfesionit ortodoks);

³⁹ Jani Thomaj, Zhvillimi i teorisë dhe i praktikës leksikografike shqiptare pas Çlirimit, te "Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe" II, Tiranë 1972, f. 367.

- c) Shkrimet e arbëreshëve dhe
- d) Shkrimet e bejtexhinjve (të konfesionit mysliman).

a) Nga shkrimet e vjetra gege (të konfesionit katolik)

Si shkrime të vjetra gege këtu nënkuptojmë të gjitha shkrimet e vjetra të shkruara në dialektin gegë deri në etapën e Rilindjes Kombëtare. Si burime më me interes për temën në shqyrtim është padyshim vepra e Gj. Buzukut, si vepër e parë e shkruar në gjuhën tonë, pastaj Fjalori i F. Bardhit, edhe kjo si vepër e parë e mirëfilltë e leksikografisë shqiptare.

Këto dy vepra u konsultuan në hollësi, por për materialin e lëndës në shqyrtim nuk u lanë anash as veprat e shkrimtarëve të tjerë të këtij grupi. Nga këto burime u nxorën shembuj me interes, sidomos të atyre që bien në sy nga aspekti formëzues e fjalëformues.

Siç dihet, vepra e Gj. Buzukut "Meshari"⁴⁰ ka për objekt një lëndë mjaft universale me karakter fetar. Ajo, ç'është e vërteta, është përkthim a reflektim në gjuhën tonë i një lëndë mjaft të gjerë, në të cilën pos materialit tjetër zënë vend edhe disa emra të njerëzve sipas veprimtarisë së tyre. Po kështu edhe nga "Fjalori" i Frang Bardhit⁴¹ paraqitet mjaft lëndë me vlerë edhe nga fusha e emrave të njerëzve sipas veprimtarisë. Nga emrat e tillë, vërtet, mësojmë paksa për gjendjen gjuhësore të asaj kohe, por edhe të periudhës parashkrimore, lëndë kjo me interes edhe sa i përket mënyrës fjalëformuese të emërtimeve në shqyrtim.

Në vazhdim po i paraqes disa shembuj konkretë të emërtimeve në shqyrtim të vjelë nga veprat e shkrimtarëve të vjetër gegë. Në radhë të parë tërhiqet vëmendja tek emrat e prejardhur me prapashtesim si p.sh.:

a) Te Gj. Buzuku: urdhënuos, zotënuos, shpëtuos, guvernues, shërbuos, munduos; ruojtës, bas; ndjekës, korrës, përrallës, përderës, pagëtorës, detuor (detorës); shërbëtuor, gjatuor e gjahtar, kaluor, punëtor, letëtar, gojëtare (gojëtar), rrogëtar, peshkëtar, tregëtar.

b) Te P. Budi⁴²: nkrijuos, shkruos, ntruos, detuor, sqimatar, portëtar, veshtëtar, paditar, vreshtar, grabëtar, shtamptar, lodëtar, rrogëtar etj.

c) Te F. Bardhi: shkruos, rruos, krijues, kërkues, përgjues, bas, pis, ngadhënjyes, dashës, kullotës, lyes, lypës, lutës, mbjells, mshis, shitës, përrallës, vjedhës; kundërtar, banjëtar, derëtar, furrëtar, luftëtar, mifëtar, shpifëtar, bdeshtëtar, vozëtar, vjershtëtar, fqinjëtar, ndjekëtar, këshilltar, pajëtar, rrogëtar; këpucar; shërbëtuor e shërbëtuor (por shërbëtorja), kalor, punëtuer.

⁴⁰ Gjon Buzuku, Meshari, Ribotuar nga "Rilindja", Prishtinë 1987.

⁴¹ Frang Bardhi, Fjalor latinisht - shqip (1635), ribotoi "Rilindja" Prishtinë 1983.

⁴² Materiali është nxjerrë nga libri: Pjetër Budi, Poezi, Prishtinë 1986 si dhe nga burime të tjera, siç janë punimet e E. Çabejt, të Sh. Demirajt etj., të cilat do të cekem në këtë punim.

ç) Te P. Bogdani⁴³: krijues, shikues, pagësues, shëlbues, xgjedhës; ronjës, therës, bas, vras, pas, lese, mbjellës, përpis, lypës, lyes; gjakës; dvekëtar, luftëtar, shgjetar, landëtar, gjuhëtar, kankëtar, detar, rrezmëtar, lodërtar; detuer; përbalças, bajbukës.

d) Te Kuvendi i Arbënit: farues, arrëtues, përgjues, shpifëtar, përtues; betar, meshtar, shpifëtar; sherbëtor ... dhe te Gramatika e Gratoferatës: kankatar, krijues.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm shumica e emrave të prejardhur janë formuar me prapashtesat -TAR e -(Ë)S, formante këto të cilat edhe sot janë ndajshitesat më prodhimtare për këtë tip emërtimesh.

Ja si duket pasqyra e numrit të përafërt të emrave të vepruesit sipas prapashtesave përkatëse të vjelë nga "Meshari" i Gj. Buzukut në përqasje me "Fjalorin" e F. Bardhit:

**Pasqyra e numrit të disa emrave me prapashtesim
te Buzuku e F. Bardhi**

| Numri i shembujve | Te "Meshari" | Te "Fjalori" |
|-------------------|--------------|--------------|
| -Ë/S | 24 | 64 |
| -TAR | 10 | 28 |
| -AR | 3 | 6 |
| -TOR | 4 | 9 |
| -NIK | - | 3 |
| -XHI | 1 | 2 |

Prapashtesa

Me qëllim që të vihet në spikamë tipi i caktuar fjalëformues në pasqyrën e mësipërme (sidomos në rubrikën e emrave më -TAR dhe -(Ë)S u përfshinë të gjithë emrat e vepruesit, madje edhe ndonjë mbiemër (homofor), i cili në rrethana të caktuara mund të marrë edhe tiparin (funksionin) e një emri të vepruesit, sipas kuptimit të gjerë madje edhe me mundësi formëzimi edhe si emërtim i njeriut sipas profesionit.

Përveç emrave të prejardhur me prapashtesat që u shënuan në pasqyrën e mësipërme në dy veprat e mësipërme, por edhe te të tjerat ndeshim edhe mjaft emra të parmë të kësaj nënfushe semantike. Në veprën e Gj. Buzukut b.f. numri i emrave të parmë të tipit në shqyrtim arrin numrin 20, kurse në Fjalorin e F. Bardhit dyfishi, 40.

Te vepra e Gj. Buzukut ndeshim emrat: plak, bujk, bari, kapedan, xhakon, shtrazë, dragoman, ministër, regj, patriark, eqim etj., ndërsa në veprën e F. Bardhit: soldat, teolog, berber, xhambaz, kasap etj. Në veprën e P. Bogdanit ndeshim këta emra me karakter ndërkombëtar: doktor (doktor për dijetar), vojvodë (për udhëheqës), strazëtar (për rojtar), dragoman (për interpret), regj (për mbret), terzi (për rrobaqepës)

⁴³ Shih: Pjetër Bogdani, Çeta e profetëve, ribotuar nga "Rilindja", Prishtinë 1989.

matematik (tash matematikan), (p)salmist, anatomist si dhe kozmograf.

Gjithsesi edhe nga emrat e tillë mund të kuptohet fakti se që në atë fazë historike huazimet në fjalë i kishin rrënjët e shtrira në gjuhën tonë.

As në "Mesharin" e Gj. Buzukut dhe as në Fjalorin e F. Bardhit nuk ndeshim ndonjë kompozitë në cilësinë e emërimit të njeriut sipas profesionit, por hasim togfjalësha që emërtojnë nocion të ngjashëm. P.sh.:

- te Buzuku: "krenët e zotnive", "krenët e gjindsë". "të parët e profetnet", "shenjtit e Tinëzot", "i zoti i shtëpisë";

- te F. Bardhi: "at i fëmijës" (për kryefamiljar), "atnit e kuvendit", "plejt e kuvendit", plejt e motshëm", kryet e gjatarëve (kryegjahtari), "kryet e ushtëtarëve" (kryekomandantët) etj.

Ndërtimet e mësipërme pothuajse u paraprijnë kompozitave që u përhapën me të madhe më vonë, siç është kompozita e tipit me siparashësën krye- (kryefamiljar) e të tjera.

Te "Kuvendi i Arbënit" kemi togfjalëshin "çobani i shpirtënive" për emrin "prift", kurse në "Gramatikën e Gratoferatës": "prifti i madh" për emërtimin "papë" si dhe "kasap dyqani" për emërtimin që po përdoret sot: "mishtar" a "mishshitës".

b) Nga shkrimet e vjetra toske (të konfesionit ortodoks)

Krahas shkrimeve gege (veriore) dolën edhe shkrimet toske (jugore), por, me sa dihen, në një vëllim më të vogël, por që ndërkohë numri i shkrimeve të tilla vjen suksesivisht duke u rritur. Pas "Perikopesë së Ungjillit" në dialektin toskë u botuan shkrimet e Th. Kavaljotit, të Dh. Haxhiut dhe të të tjerëve. Ndër ta dallohen K. Berati, V. Meksi dhe sidomos Th. Haxhifilipi, i cili konsiderohet si pararendës i Rilindjes Kombëtare⁴⁴.

a. Te Fjalori i Th. Kavaljotit⁴⁵ hasim emërtimet: igumen, dhaskall, heqim, kurvar, magjistrik, akçi, shahit, kullotës, lëkëtar e lajkatar, kaluar (për kalorës), çartës (për xhelat), ndjekës, (paskëmbës).

b. Te Dh. Haxhiu ndeshim: koxhabash, kadi/lerë, pasha/llarë, milonahi (për mullis), kursar (për kusar) dhe (m)bret.

c. Më hollësi u konsultua Fjalori i Uliam Martin Lik-ut (1814), sepse aty gjendet i regjistruar material më i vëllimshëm se në burimet e tjera të asaj etape. Në Fjalorin në fjalë shihet se edhe në dilektin toskë në atë kohë përdorehin emrat e profesioneve si: gjikatës (gjykatës), lipës (lypës), (n)dihmës, këmbës (për kombësor), gjatuar (për

⁴⁴ Për hartimin e këtij nëntitulli, veç tjerash, u shfrytëzuan këto materiale: R. Qosja, Antologji historike e shqipes, Prishtinë 1985; M. Hysa, Kristomaci e letërsisë së vjetër shqiptare, Prishtinë 1986; F. Sulejmani, E mbësuarë e krështenë e Lekë Matrëngës, IAP, Prishtinë 1979.

⁴⁵ Për Fjalorin e Th. Kavaljotit, shih te revista, "Leka" nr. 3 - 11/36, Shkodër 1936.

gjahtar), kalorës, (m)notëtar (notar), përgjonjës (për spiun) si dhe kopile (me kuptimin: vajzë shërbëtore).

Siç po shihet edhe nga shembuj e mësipërm, për emërtimin e njerëzve sipas profesionit mbizotëronin emrat e prejardhur me prapashtesat: -Ë/S dhe -TAR. Në veprën e Lik-ut, përveç emrave kusar, mjeshtrë, magjistric, dhespot e kallogjer, hasim edhe huazimet turke si: çoban, hamall, heqim, hyzmetqar, sejmen, xhelat, terzi, bahçevan, çirak etj. Vend të konsiderueshëm gjithashtu zënë emërtimet e huazuara a mbi bazë të prapashtesës -XHI (-ÇI), si p.sh.: jazexhi (shkrues), qiraxhi, bojaxhi, bekçi (rojtari), avexhi (gjahtar), ahçi (gjellëbërës), fallexhi, qerrexhi, mullixhi, mardhaxhi (mashtgues).

Shembujt e mësipërm dëshmojnë mjaft bindshëm se në atë etapë emrat e mësipërm kishin përdorim të gjerë. Disa nga ata emra si bojaxhi, qiraxhi etj. përdoren edhe sot e kësaj dite e disa prej tyre kanë kaluar në shtresën pasive të leksikut. Vëmë re edhe rastet mullixhi, qerrexhi, ku formanti -XHI me origjinë turke është vënë mbi temat fjalëformuese të emrave popullorë: mulli, qerre të shqipës. Tashti zakonisht përdoren trajtat: mullis, qerrtar ose qerrepuues.

Edhe në burimet e tjera të toskërishtes së vjetër është i përfutueshëm kryesisht po ky leksik, me ndonjë ndryshim të vogël si p.sh.: te V. Meksi: magjistiar (magjistar), gramatepsur (shkrues), por: prift, mpret, rrogëtar, shërbëtor. Te Th. Haxhifilipi: dhespot, mbret, urdhënar. Te Dh. Todri veçuan: besës, shëresës, vërtetës, mjekës, mundëtar (për ngadhënjyes).

Edhe pse dokumenti "Anonimi i Elbasanit" i përket dialektit gegë, për hir të konfesionit që i përket dhe të kohës kur dhe ku u përfutua, po i përmend këtu disa emërtime që i ndeshëm aty: psois (mësues), argjandashun, fjalëparë (profet), fajbami (fajtorët), kryezonjë (perëndeshë), dhaskall etj., ku bien në sy emrat e përbërë që në shkrimet e mëhershme nuk i ishin të vërejtshme.

Të vihet re fakti se dallimet nga dialekti a konfisioni në dialekt a konfesion lidhur me formimin e emrave në shqyrtim, nuk janë aq të mëdha, madje pikat konvergjente janë evidente, d.m.th. me tipare të përbashkëta ndeshim sidomos te mjetet fjalëformuese.

c) Nga shkrimet e arbëreshëve të Italisë

Në veprën e parë të arbëreshit L. Matrënga "E mbësuar e kërshënë" pos tjerash ndeshim këto emërtime: detirës (detyrës), perëndeshë (mbretëreshë), vashë (shërbëtore), papë, prift, dishepull.

Në veprën e Jul Varibobës veçuan emërtimet: regjë (për mbret) e regjin (për mbretëreshë) kaçiapris dhe pekurar (për bari) dhe marinar. Nikollë Filja përdori emrat: liruas (për shpëtimtar), përgjuas, krijuas si dhe rodhar (për uratës). N. Brankati përdori emrin popullor *delmer* (për bari delesh), të cilin e përdori edhe Jeronim de Rada. Te De Rada ndeshim të përdorur edhe emrin ndihtare (ndihmëse). Te G. Dara i Riu hasim në kompozitat e mirëfillta: rrahader (lypës endacak), kriekusar (kryekusar), pastaj ushtar, kalorës etj.

Interes të veçantë zgjojnë disa trajta emërtimesh që përdori Z. Skiroi si p.sh. shesor

(shitës), deshatar (dashnor), mbrojtur (mbrojtës), mundësor (ngadhënjyes), por edhe më shumë tërheqin disa trajta emrash që përdori A. Santori në "Satirat" e tij⁴⁶, si p.sh.: nëmëtare, dëshmimtar, shërbejtat (shërbyes mëditës), mjekërar (trojtar), punonjer (punëtor), kallonjer (mashtues), jatrisher (farmacist); qerras (qerrepuues), zarritas (thërritës a propagandues) si dhe togfjalëshin mjeshtri druhtar. Vend të veçantë zënë emrat me prapashtesën femërore -ESHË si p.sh.: noiteshë (zonjë shtëpie), këngëtorjeshë (këngëtare) dhe spiuneshë (spiune). Ky përdori edhe fjalëtermat e huazuar: avokat dhe jatro (mjek). Po nga ky autor e kemi të sajuar emrin dardhan për konceptin pemëtar (nga dardhë + prapashtesa -AN: dardhan)⁴⁷.

c) Nga shkrimet e bejtexhinjve

Nga shkrimet e bejtexhinjve⁴⁸ ndeshim mjaft emra si emërtime të njerëzve sipas profesionit a pozitës së caktuar shoqërore me burim oriental. P.sh.: myfti, myderris, kurra, kadi, pasha, bej, vezir, shair (H. Z. Kamberi); ashik (N. Frakulla); zabit, kajmekam, imam, nebetçi, esnaf (Z. Distari); Gjithashtu i ndeshim edhe huazimet si: haznetar, hizmeqar, veçil, berber, (h)alim, heqim, hoxhë, sheh, ylema etj. pa i përmendur edhe emrat e mirëfilltë të njerëzve sipas profesionit me prapashtesën speciale të turqishtes -XHI, e cila atëherë kishte shtrirje jashtëzakonisht të madhe në ligjërimin e të gjitha shtresave, por sidomos në gjuhën e qyteteve tona, gjë që vërtetohet edhe me shembujt e caktuar që edhe sot e kësaj dite përdoren në ligjërimi a në stilin bisedor të ne.

Mirëpo përveç fjalëve të huaja me origjinë orientale në veprat e bejtexhinjve ndeshim edhe emra nga brumi i gjuhës shqipe ose që ishin përvetësuar që moti në shqipe, sidomos në gjuhën e popullit. Ja disa shembuj: shërbëtuat, mbret, kalor, qeshëtar, gjykatës (M. Kyçyku), mëkëmbës, kujdestar (B. M. Shëmbellënjë); kalor, këmbës (Anonimi i Gjirokastrës) etj.

Po i veçoj disa emërtime të vjela nga vepra "Vehbije" e autorit Tahir E. Boshnjaku⁴⁹, ku pos emrave: hoxhë, (h)alim, beg, pashë, vezir, rob, hyzme(t)qar, ylema - përmenden edhe emrat: shkues, ndihmues, kallxues, (n)digues, msues, nxans, marrës, mbytës e myts, folës, dis, shti(n)s e kështu me radhë, gjë që dëshmon për shtrirjen në vazhdimësi të mënyrës fjalëformuese popullore të emrave të vepruesit në mbështetje edhe të pjesores së shkurtër të gegërishtes, mënyrë kjo që dëshmohej edhe në shkrimet e shkrimtarëve të vjetër gegë.

⁴⁶ Për "Satirat" e A. Santorit, shih edhe te revista "Jeta e re" nr. 2/84, Prishtinë 1984.

⁴⁷ Sh. Demiraj, Historia e gjuhës së shkruar shqipe, Prishtinë 1970.

⁴⁸ Shih edhe te libri: Poezia e bejtexhinjve, Prishtinë 1987.

⁴⁹ Vepërza "Vehbije" e T. E. Boshnjakut është përfshirë te libri "Poezia e bejtexhinjve", Prishtinë 1987.

N. Frakulla përdori togfjalëshin "kryet e asqerit" për fjalë-termin e sotëm "komandant".

Gjithsesi edhe kontributi i bejtexhinjve lidhur me formimin a emërzimin e emrave në shqyrtim duhet të vlerësohet dhe të kihet në konsideratë. Madje nga ata nuk munguan as farkëtimet mbi fjalë-temat e brumit të shqipes.

P ë r m b y l l j e

Përveç huazimeve që janë pothuajse dukuri normale në shkrimet e vjetra shqipe si gege ashtu edhe toske, si tek arbëreshët ashtu edhe te bejtexhinjtë, shihet edhe dukuria e trashëguar e përdorimit dhe e krijimit në vazhdimësi e emrave të prejardhur si emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë me prapashtesat përkatëse të specializuata: -TAR e -S, madje dallimet e përkimet edhe mbi këtë bazë janë të pranishme. Kështu p.sh. në shkrimet e vjetra gege mbizotëron formimi i emrave në mbështetje të gjedhit fjalëformues popullor mbi temë emërore, por edhe më shumë mbi bazë të temës foljore me ndihmën e prapashtesës speciale -S, të tipit krijues (nga tema \me] *krijue*), d.m.th. pjesorja e variantit të shkurtër gegë). Te N. Filja patëm analog me këtë: *krijuas* etj., ndërsa te Fjalori i Lik-ut ndeshëm rastin *përgjonjës*, që ka për temë fjalëformuese të tashmen e dëftores së foljes përgjonj- (përgjoj), d.m.th. trajtën e toskërishtes, dukuri kjo popullore që si gjedh fjalëformuese do të jetë e përqaftuar nga shkrimtarët toskë të Rilindjes sonë Kombëtare.

Ndërsa te bejtexhinjtë mbizotërojnë trajtat e huazuara të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, tek arbëreshët shihet prirja e formimeve në frymën "popullore". Në shkrimet e tyre sapo dallohen krijimet me prapashtesat -S, -TAR - ESH/Ë (te Santori edhe -ER, -AS etj.).

Edhe pse jo me shumicë në numër, edhe në shkrimet e shkrimtarëve të vjetër vërehen se lëshojnë rrënjë në përdorim edhe disa kompozita si p.sh. bajbukës (te P. Bogdani), kaçiapris (te J. Variboba), rrahader, kryekusar, zarritës, formime këto që te shkrimtarët e mëvonshëm do të jenë gjithnjë e më të pranishme. Mbase, në të vërtetë, ndonjë nga përftuesit e kompozitave të tilla ishin prekur paksa nga idetë e Rilindjes Kombëtare, të cilat sapo kishin filluar t`u ngrohnin flatrat e zemrat veprimtarëve si këtej ashtu edhe më fort andej Adriatikut.

Gjithsesi materiali i vjelë nga shkrimet e kësaj etape na ndihmon për të kuptuar më mirë rrënjët e formimeve të emrave si emërtime të njerëzve sipas profesionit, qoftë mbi bazë trashëgimore popullore, qoftë mbi bazë tjetër (huazuese), në gjuhën tonë që ngjiteshin edhe më tej në lartësi kohore, bazë kjo që do të shfrytëzohet me ndërëgjegje në etapat vijuese të zhvillimit të gjuhës sonë.

2. Etapa e Rilindjes Kombëtare

Etapa historike e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, siç na është e njohur, është e etapa

e zgjimit kombëtar dhe se ky zgjim ishte më i ndjeshëm pikërisht në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kur në Evropë tashmë kishte arritur një shkallë relativisht të lartë "shfaqja e hapët e zhvillimit të shkencave të ndryshme, të teknikës e të proceseve përparimtare". Është kjo etapë kur edhe për gjuhën shqipe u krijuan parakushtet që të shtroheshin kërkesa të reja, ngase tashti tashmë lindi një koncept i ri në vetëdijen kombëtare të shqiptarëve dhe në kuadër të platformës së përgjithshme të synimit kombëtar, kur u vlerësua drejt edhe çështja e gjuhës dhe e shkrimit shqip. Në këtë kontekst edhe sa i përket çështjes së terminologjisë teknike-shkencore kemi qasje tjetër. Nuk kopjohen a huazohen më ashtu pa ndonjë kriter termat e gjuhëve të huaja, sidomos nga turqishtja. Tashti bëhen përpjekje të ndërgjegjshme që të krijohen a të përkthehen (qoftë edhe me kalkëzim) termat më të nevojshëm shkencor e të stileve të ndryshme funksionale nga gjuhët perëndimore. Pikëmbështetje kryesore për një veprim të tillë rilindësit patën gjuhën popullore, modelet fjalëformuese të saj, gjedhe këto që edhe nuk ishin pa traditë. Me fjalë të tjera, u shfrytëzuan si rezultatet e zhvillimit të brendshëm aktual të gjuhës, por ashtu edhe tradita që kishte arritur paksa të ruajë vazhdimësinë që nga thellësitë kohore e deri në përditshmërinë e atëhershme.

Në këtë etapë i bëhet ledh modës a praktikës që kishte zënë rrënjë, sidomos në shkrimet e bejtexhinjve, por edhe të tjerëve, lidhur me përdorimin pa kriter të fjalëve të huaja e të barbarizmave nga gjuhët orientale. Simpatia ndaj kulturës perëndimore shihej qartë edhe në leksikun që filloi të përdoret në këto rrethana.

Me fjalë të tjera, për të dalë më e suksesshme puna, rilindësit tanë u mbështetën, përkatësisht e studiuan gjuhën e popullit, në radhë të parë krijimet gojore si dhe për aq sa lejonin rrethanat edhe traditën shkrimore, ndonëse kjo traditë ishte paksa më modeste në krahasim me gjuhët e tjera të zhvilluara.

Padyshim veprimtaria e Naum Veçilharxhit, që nuk ishte i vetëm, si dhe puna e rilindësve të tjerë, sidomos në qerthullin e Stambollit e gjetkë, nuk është pa merita, punë kjo që nuk mbeti pa jehonë. Gjithsesi në këtë etapë vërehet për nga suksesi vepra e K. Kristoforidhit, sidomos në përkthimet e përshtatjet që ua bëri ky disa librave me karakter fetar. Përveç kësaj K. Kristoforidhit i takon merita e jashtëzakonshme për kohën, ngase ai e hartoi "Fjalorin" e tij, i cili me të drejtë u quajt "gur i themelit" jo vetëm I leksikologjisë shqiptare, por edhe i "gjuhësisë shqiptare", sepse Fjalori u punua sipas kritereve të shëndosha shkencore. Aty jo vetëm se ndeshim një pasqyrë mjaft e plotë të asaj etape të gjuhës sonë edhe për emërtimet e njerëzve sipas veprimtarsisë, por është njëherësh ndeshim edhe një pasqyrë të prirjes së gjuhës letrare shqipe si edhe e drejtimit të kultivimit që do të marrë ajo në të ardhshmen.

Këtë e dëshmojnë edhe neologjizmat që i krijojnë vetë autori, ndër të cilat ka edhe emra si emërtime të njerëzve sipas profesionit a veprimtarsisë, të cilat përdoren edhe sot. Ndiheza intelektuale e Konstantin Kristoforidhit dhënë kulturës e gjuhësisë shqiptare nuk mund të ndahet nga ndihmesa që i dhanë kësaj kulture edhe Naim e Sami Frashëri si dhe rilindësit e tjerë.

Prof. Shaban Demiraj konstaton drejt kur thekson se "shkrimet e Kristoforidhit, të

Naimit e të Samiut tregojnë qartë se sa mirë e njihnin ata gjuhën amtare, të cilën e çmonin shumë" dhe përfundon me fjalët se "këta kishin një përgatitje dhe një shije të mirë në të krijuarit e fjalëve të reja" dhe se në këtë drejtim "kanë ndjekur në përgjithësi rrugën e kalkeve gjuhësore, duke u mbështetur më shumë në modelet e gjuhës greke dhe të atyre neolatine", por "në të krijuarit (...) kanë shfrytëzuar drejt e bukur mjetet e gjuhës popullore - parashtesat, prapashtesat dhe bashkimin e fjalëve në kompozita"⁵⁰.

Duke e pasur parasysh faktin se "Fjalori i Konstantin Kristoforidhit u botua disa vjet pas botimit të veprave të Naimit dhe atyre të Samiut"⁵¹, edhe pse materisli ishte mbledhur dhe hartuar mbase para se ata t'i shkruanin veprat, këtu, së pari, po i shënoj emrat si emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë nga veprat e vëllezërve frashëri e pastaj ato nga "Fjalori"i K. Kristoforidhit.

1) Nga veprat e Naimit dhe të Samiut

Në veprat e Naimit përveç emërtimeve si emra të parmë: imam, hoxhë, dërvish, kallgjer, prens, kardinal; bari, bujk, kusar, mbret, plak (për pleqnar) etj. ndeshim edhe në emra të prejardhur. Prijnë emrat me prapashtesën -S si: mundonjës, shkronjës, shëronjës, gjykonjës (edhe gjyketër), mësonjës e mësonjëse, peshonjës, sharronjës, mburonjës; çpërblenjës, rrëfenjës; gdhendës, qepës, mbanjës, shitës, blerës, shpënës, dhënës, vrrasës, ruajtës, ndihmës, lipës, kamës, pasës, prishës, kthisës, gjykatës, kalorës; falëtor.

Zgjojnë kërshtërinë nga aspekti fjalëformues rastet rrotullohës dhe përtës.

Me prapashtesën -TAR Naimi përdori këta emra: ushtëtar (por edhe ushtar e ushëtar), kordhëtar, lajmëtar, tregëtar; dëshmitar, zbulimtar e krijimtar.

Me prapashtesën -AR Naimi përdori jo shumë fjalë të prejardhura si emra me cilësinë e emërtimeve të njeriut sipas veprimtarisë. Përveç kurvar, stërpar i përdori edhe emrin druvar.

Me prapashtesën -TOR Naimi përdori këta emra: vjershëtor, gjahëtor, punëtor e falëtor (prift).

Në veprën "Shqipëria..." të S. Frashërit ndeshim këta emra si emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë a pozitës në shoqëri, me prapashtesën -S. Përveç mësonjës, shkronjës, shëronjës, mburonjës; kalorës që i ndeshim të përdorur nga Naimi, kemi edhe urdhëronjës, ruanjës, qyrës e nënqyrës, mijës për gradën: major.

Edhe në veprën e Samiut hasim emërtime me formantin -TAR, si p.sh.: vjershëtar, luftëtar, arkëtar, urdhëtar e qeverindar (qeveritar). Me prapashtesën -AR: ushtar, katundar e nënkatundar (për nocionet: kryetar e nënkryetar bashkie).

Samiu përdori këta emra me burim të huaj: patrik, dhespot, mis (anëtar). eksark

⁵⁰ Shaban Demiraj, Historia e gjuhës së shkruar shqipe, Prishtinë 1970, f. 57 - 58

⁵¹ Përveç burimeve të ndryshme teorike të studuesve tanë u konsultuan kompletet e veprave të Naimit dhe të Samiut që u ribotuan nga "Rilindja", Prishtinë në vitet '70.

(mëkëmbës), pastaj edhe: theolog e filolog që janë ndërkombëtarizma të mirëfilltë të pranishëm edhe në gjuhën e sotme.

Edhe Naimi edhe Samiu përdorën në veprat e tyre emra kompozita me cilësi të emërimit të njeriut sipas ushtrimit të profesionit.

Nga vepra e Naimit po veçoj këto kompozita: mirëbënjës, shitblerës, pyll-mburonjës, udhë-rrëfenjës, rgjend-punonjës, flori-punonjës, jeshëkëndonjës, qendërbukuronjës, ëndërrrëfenjës, kartë-shpënës, shtyp-shkronjës, shigjetë-hedhës, pastaj: nëkëmbës e mësimdhënas etj.

Edhe Samiu futi në përdorim disa kompozita si p.sh.: nënqeverindar (nënprefekt), dheshkronjës, kamareshkronjës, sumashkronjës, kryeshkronjës, kryeministër, hekurpunonjës e ventruanjës.

Gjithashtu zgjojnë interes edhe disa emërtime togfjalësha që i përdor (krijon) Samiu, si p.sh.: ushtarët e ruanjës (xhandarët), ushtarët e gatitjës (rezervistët), qyrës të punëve të përgjithshme, qyrës të gjyqit, qyrës mësimi, nënqyrës bagëtije (Në vend të konceptit të fjalës **qyrës** sot përdoret zakonisht termi **inspektor** a **mbikëqyrës**) pastaj: krei i Pleqësisë, vezir i madh, myfti i madh, të parë të besëve etj.

Nuk janë pa interes edhe emërtimet që i përdorën rilindësit e tjerë, madje pararendës e bashkëkohës të Samiut e të Naimit. Si p.sh. N. Veçilharxhi përdori emërtimet: *punëtor e hyzmeqar, nismëtor, kamës* (pasanik), *mfsherës* (spiun). Po për fjalën spiun J. Vreto përdor fjalën *shpjessjellës*. Th. Mitko përdori emërtimin *ndihmëtar* (për i ibonuar), *bukëtar* (për furrëxhi), *gjyqtar* (për kadi), pastaj *dhjetar, shëkues e ruajtës* etj.

Me paraqitjen e shembujve të nxjerrë nga veprat e Naimit, të Samiut dhe të tjerëve ne kemi për qëllim të vëmë në pah prirjen rreth krijimit të fjalëve të reja mbi bazën e gjuhës popullore në këtë etapë zgjimi të ndërgjegjës së popullit tonë edhe ndaj gjuhës të prirë nga intelektualët rilindës. Kjo rrugë e përdorimit dhe e krijimit të fjalëve të reja ishte mjaft masive, kur kemi parasysh numrin e intelektualëve shqiptar shqiptarisht të orientuar drejt të asaj kohe.

Të gjithë shkrimtarët tanë rilindës, kush më pak e kush më shumë, dhanë ndihmëse të çmuar edhe në fushën e leksikologjisë, përkatësisht në krijimin e fjalëve të reja ose në përqafimin e fjalëve popullore të burimit vendës nga tradita.

2) Nga Fjalori i K. Kristoforidhit

Është thënë me vend se Konstatin Kristoforidhi është fytyrë e ndritur në kulturën shqiptare. Ndhimesa e tij është e konsiderueshme edhe në fushën e gjuhësisë. Ai dha kontribut në fushën e "fonetikës të pasqyruar në ortografi", pastaj në fushën e "formave morfologjike" e sidomos në fushën e leksikografisë. Ka të drejtë prof. A. Kostallari kur thotë se "Fjalori i K. Kristoforidhit është një nga gurët e themelit jo vetëm të leksikografisë, por edhe të gjuhësisë shqiptare", siç u përmend kalimthi edhe më përpara, ngase ai "padyshim është fjalori më i mirë i shqipes para Çlirimit".

Para Luftës II Botërore lidhur me emrat e vepruesit Fjalori i K. Kristoforidhit⁵² paraqet burim me interes. Emërtimet e tilla aty dalin në disa forma, zakonisht ashtu siç ndesheshin "në terren" prej nga i voli, por edhe në veprat e shkrimtarëve tanë të vjetër (P. Budi e P. Bogdani). Në vazhdim po cek një shembull, në të cilin shihet shumëformësi trajtash për të njëjtin nocion. Nga tema fjalëformuese **ndihmë-** ai shënon këto trajta: ndihmëtar, ndifmëtar; ndihmës, ndifmës si dhe ndihmëtuer.

Në "Fjalor" ai parapëlqen trajtat: **ndihmës** e **ndihmëtar**, kundrejt atyre që mbetën dialektore ndifmës e ndifmëtar. Trajtën **ndihmëtuer** e shënon të vjelë nga vepra e P. Budit. Është interesant të përmendet fakti se në gjuhën e sotme letrare është e favorizuar trajta **ndihmës**, ashtu siç e favorizonte edhe K. Kristoforidhi, por edhe trajta **ndihmëtar** ka gjedhe.

Po e përmend edhe një veçori të lëndës në shqyrtim që vërehet në Fjalorin e K. Kristoforidhit. Është fjala për praninë e formimit të fjalëve paralele nga tema e përbashkët fjalëformuese, por me prapashtesë të ndryshme sinonimike. Sa për ilustrim po rikujtoj shembullin që u dha pak përpara; ndihmë-: ndihmës, ndihmëtar, ndihmëtuer (-tor). Vlen të përmendet nga ky burim edhe një mënyrë tjetër fjalëformimi të emrave të vepruesit, po për të njëjtin koncept, duke i pasur të ndryshme jo prapashtesën, po temën fjalëformuese që është emër prejfoljor i veprimit me prapashtesën -IM, përkatësisht me prapashtesën -ESË. Ja disa shembuj: shpagimtar/shpagesëtar, përdëllimtar/përdëllesëtar, shtrëngimtar/shtrëngesëtar, rashëgimtar/trashëgesëtar, shpëtimtar/shpëtesëtar.

Përveç këtyre trajtave paralele aty ndeshim edhe raste më -IM/TAR pa korresponduesen -ESË/TAR, si p.sh.: adhurimtar, kursimtar, kallëzimtar, por edhe rastet, si: çpagesëtar, kriesëtar (kriues, krietar, por jo krijimtar).

Ne Fjalorin e K. Kristoforidhit ndeshim edhe emrat foljorë të formuar mbi temën përkatëse me fundoret -UE (karakteristikë e gegërishtes) dhe -ONJ fundor (karakteristikë e toskërishtes). Ja disa shembuj:

- a) më -UE/S: pritues, adhurues, ankues, rrues, shkues, shtrëngues, kriues, shëlbues;
- b) më -ONJ/Ë/S: kërkonjë, shkronjë, muronjë, përgjonjë, rronjë (rrues), ronjë (rojtari) etj.

Vlen të thuhet edhe kjo e dhënë se në këtë Fjalor emrat foljorë nga foljet më -OJ mbi të dyja bazat më -UE/S dhe -ONJ/Ë/S janë në numër të vogël në krahasim me tipat e foljeve të tjera si dhe ata me temë emërore. Ja disa shembuj:

- mbyllës, korrës, leçitës, matës, mbledhës, lagës, mbjellës, mielës, dhanës e dhënës, grindës, shpallës, kamës, hamës, pëgërës (lypës), pimës e pirës;
- mpkatës, qerres, përderës, mblatës, ftesës.

⁵² Shih: K. Kristoforidhi, Fjalor shqip-greqisht, ribotim i "Rilindjes" Prishtinë 1977.

Në Fjalorin e K. Kristoforidhit për nga numri prijnë emrat e vepruesit, përkatësisht emërtimet e njerëzve sipas profesionit të formuar me prapashtesën -AR, si p.sh.: dhenar, derrar, dhiar, farkar, urdhënar, tjegullar, gjizar, këpucar, pelar, notar, sfungar, kashtar, mungar (për kallogjer), kamatar, trauezar etj.

Nga shembujt e tillë dëshmohet se në kohën e K. Kristoforidhit emrat më -AR kishin përdorim mjaft të gjerë, por nuk mungonin as emrat me prapashtesën -TAR. Ja disa shembuj: ndihmëtar, fushtar, shortëtar, pishtar, pjesëtar, shtrazëtar, ungjilltar, gjuetar e gjahtar, lanjëtar e lajtar etj.

Në këtë burim ndeshim disa emra të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë me prapashtesën -OR e -TOR, të cilët në njëjës in e pashquar shënohen me diftongimin e -O-së, p.sh.: letërues, fyellues, punëtues, kankatues etj.

Edhe lidhur me dukurinë e sapocekur vlen të rikujtohen tri gjëra: E para, zanorja -O- e formantit -OR, përkatësisht -TOR që te Buzuku dhe Budi dilte e zbërthyer me togun -UO-, por që te F. Bardhi del vetëm në dy raste, pasi që në veprën e tij mbizotëron zbërthimi në -UE-, te K. Kristoforidhi gjithashtu mbizotëruese del trajta më -UE-.

E dyta, meqenëse në disa të folme popullore të gegërishtes togu UE del i reduktuar në -U-, ashtu e ndeshim si formë paralele të shënuar edhe në Fjalorin e K. Kristoforidhit. Njëherazi si formë paralele e shënon edhe trajtën më -UA- që është karakteristikë e toskërishtes lidhur me të njëjtën tingull. Kështu aty ndeshim b.f. trajtat: fyelluar fyellues fyellur, gjakëtuar e gjaksues, harkëtuar harkëtuues e harkëtur, krye-ushtëtuar, krye-ushtëtuues e krye-ushtëtur etj.

E treta, rikujtohet se në gjuhën e sotme letrare, d.m.th. në realitetin tonë gjuhësor shembujt e tillë kanë gjetur zgjidhje, qoftë duke e ruajtur zanoren -O- të pa zbërthyer edhe në njëjës in e pashquar, si p.sh. jo punëtuar, punëtues a punëtur por vetëm punëtor punëtor-i, qoftë duke marrë në vend të prapashtesës -TOR, prapashtesën -TAR si p.sh.: harkëtar (jo: harkëtuar, harkëtuues a harkëtur) etj.

Edhe pse K. Kristoforidhi, jo pa të drejtë, njihet si harrës i madh i turqizimave, prapëseprapë në Fjalorin e tij ka mbetur ndonjë shembull të emërtimeve të profesioneve e ndonjë tjetër me prapashtesën turke: -XHI (-AXHI), si p.sh.: kutrovaxhi e kokmexhi, prinxhi dhe tunxhi, mirëpo K. Kristoforidhi për trajtën kurtrovaxhi shënon barsvlerësin e brumit të shqipes: shtëmbar (shtëmbë+AR shtëmbar).

Kompozitat në Fjalorin e K. Kristoforidhit zënë vend të konsiderueshëm. Përveç kompozitave të tipit: katrudhuratës, gjithpushtetës, kryeprift, në numër mjaft të madh ndeshen kompozitat e tipit: dhunëbërës a dhunëbamës, venë-qitës, verëpirës ose verëpimës, udhëçelës, zadhanës, udhëheqës, ligdhënës, jetëdhënës, udhëheqës, dorëzënës, gjakbërës e gjakbamës, idhull-lutës, pagëdhënës, huadhënës, bukëpjekës, argjendruejtës etj., mënyrë kjo e fjalëformimit, e cila gjithnjë e më shumë pushtoi terren dhe që e mban të pushtuar atë shtrirje sidomos në gjuhën e sotme letrare dhe se është treguar si modeli më i favorshëm për të plotësuar nevojat që dalin për të shprehur konceptet e caktuara edhe në gjuhën standarde kombëtare.

Studiuesi A. Xhuvani na bën me dije se "shumë neologjizma, të cilat i ka përkthyer (K. Kristoforidhi) më të shumtat nga origjinali por me ndërtim shqip" e që gjenden nëpër veprat e tij "nuk i ka shtimë të gjitha në Fjalort", prandaj edhe ndonjë kompozitë nuk e ndeshim në Fjalorin e tij, mirëpo edhe nga shembujt, sa u paraqiten këtu, besoj se mund të shihet pasuria e mënyrave të formimit të emrave qoftë me prapashtesim, qoftë me kompozim.

Siç dihet përveç Fjalorit të K. Kristoforidhit a paralel me të në këtë etapë historike për kah rëndësia zë vend edhe Fjalori i "Bashkimit".

3. Nga Fjalori i "Bashkimit"

Edhe pse në Fjalorin e "Bashkimit"⁵³ shihen "gjurmë të ndikimit të Fjalorit të K. Kristoforidhit", megjithatë aty hasim mjaft veçori të veçanta që e karakterizojnë këtë burim. Madje nga aspekti fjalëformues të disa tipave të emërtimeve mund të thuhet se ndikimi i Fjalorit të K. Kristoforidhit nga kjo pikëpamje nuk duket aq i madh, për të mos thënë se nuk duket fare.

Së pari, në Fjalorin e "Bashkimit" nuk ndeshim shumë emërtime me prapashtesën -UE/S, madje ndeshim më pak se që kishte në Fjalorin e F. Bardhit. Aty gjetëm këto emërtime: shumues, kënuës e knuës, shkues, pagzues e peshues. Trajta peshues madje nuk është e shënuar në skedë të veçantë, por shënohet si barasvlerës sqarues i emrit me origjinë turke: bazhdar, ashtu si edhe emri trazues që del për belaxhi a belaçuer, po ashtu me rrënjë orientale.

Së dyti, nuk ndeshim asnjë shembull sipas modelit fjalëformues më -ONJ/ËS të tipit mësonjës, siç e ndeshim te Naimi e Kristoforidhi, mirëpo këtu ndeshim vetëm trajtën **mësojs** që në të vërtetë është krijim sipas mënyrë së njëjtë fjalëformuese, d.m.th. ka për bazë veten e parë njëjës të dëftores mësoj (tosk. mësonj) plus prapashtesa -S.

Së treti, në Fjalorin e "Bashkimit" kemi një shumësi emrash me prapashtesën -TAR që janë më në epërsi ndaj atyre më -AR që në Fjalorin e K. Kristoforidhit dilnin mjaft me shumicë. Prej emrave më -TAR po dallojmë nëntipat:

- *adhrimtar, pagimtar, pjesimtar, dëshimimtar, kërkimtar, mësimtar, pagimtar, kursimtar;*

- *anijetar, xehetar, magjëtar, gazetetar, rojetar, armetar, mnoretar, papetar (papë), magjitar etj.;*

- *rregulltar, rrogtar, sihariqtar, shkencëtar, shtrazëtar, vargëtar, urdhëntar, bejlegtar, voztar, kishtar, konoptar, nevojtar, antar, anërrtar, arktar, flamurtar, remtar, detyrëtar, furrtar, fushëtar e fushtar, letërtar, gjobtar, gjuhtar, gjiztar, bugtar, oborrtar, idhulltar, kostar, kryetar, psalmtar, kshilltar, shkrojtat etj.*

Së katërti, dallojmë edhe disa emra të këtij tipi me variantin prapashtesor -ATAR, si p.sh. lulnatar, kangatar, kpuccatar, lkuratar, barnatar. Ndonjë emër nga shembujt e

⁵³ Fjalori i "Bashkimit" (Fjaluer i ri shqypes), ribotim i "Rilindjes", Prishtinë 1978.

mësipërrshënuar kanë mbështetje në shumësin e emrit më -A fundore si barna barnatar, hokatar etj. Te K. Kristoforidhi ndeshim nja dy shembuj të tjerë mbi këtë bazë: mjekatar dhe sqimatar.

Së pesti, me prapashtesën -AR, siç u cek më sipër, në këtë burim ndeshim shembuj në numër të vogël. Zgjojnë kërshtërinë emrat: **mungar** për kallogjer, **urdhënar** për ordinar, **tryezar** për bankier dhe **smunar** për infermier.

Së gjashti, është e vërtetë se në këtë burim ndeshim emra me prapashtesën -S si hjekës, njeftës (për hesapexhi), shitës, vras, gërgas, kalorës etj., por edhe kemi raste kur prapashtesa -S është shndërruar në -C, si p.sh.: shtypc, shprrrallc, vajtojc. Madje ndeshim edhe dyfishim prapashtese si te rastet: korrcar e lopçar.

Së shtati, në Fjalorin e "Bashkimit" një numër emrash del me prapashtesën -OR dhe -TOR, por që në njëjës in e pashquar (si trajtë përfaqësuese) dalin të shënuar me diftongimin e zanores -O- në -UE kryesisht. Ja disa shembuj: latuer, pagzuer, letruer, vatuer, ushtuer, vjershuer, kaluer, auktuier, apostolluer etj.; armetuer, peshkatuer, mshehtuer, barrtuer, batetuer, bisedetuer, harktuier, fjaltuer etj.

Siç na është e njohur në gjuhën e sotme letrare parapëlqehen në njëjës in e pashquar format më -OR ose -TOR e jo me -UER a -TUER. Gjithashtu dihet se shumë shembuj që aty i ndeshim me prapashtesën -TUER (-TOR) tashti janë të favorizuar dhe të normëzuar me prapashtesën -TAR ose -AR.

Së teti, hartuesit e këtij Fjalori, sigurisht të ndikuar nga realiteti gjuhësor i kohës, patën kriter më të butë ndaj emërtimeve me origjinë turke, nga sa kishte K. Kristoforidhi. Sigurisht trajtat e tilla kishin përhapje të gjerë në gjuhën e masës në atë kohë, sidomos nëpër qytete, ku zanatet dhe administrata ushtronin më tepër ndikim. Në Fjalor ndeshim emrat: bahçevan, serasqer, berber, jeniçer, kadi, kajmekam, kalif, koxhabash etj. Dallojmë gjithashtu emërtimet e profesioneve me prapashtesën -XHI (-ÇI), si p.sh. topçi, konopçi, akçi, farkaçi; haberxhi, hallvaxhi, hanxhi, kazanxhi, bojnaxhi etj., shembuj këta që konsiderohen si huazime turke, por ndeshim gjithashtu edhe formime mbi temën e fjalës shqipe me këtë prapashtesë, p.sh.: kpucaxhi, barnaxhi, postaxhi, qerraxhi etj.

Sipas mendimit tim autorët e këtij Fjalori nuk kanë bërë keq që i kanë shënuar emërtimet në fjalë me prapashtesën -XHI (-ÇI) të turqishtes, ngase në shumë raste ato në atë formë ishin rrënjësor në gjuhën tonë, por ata bënë jo pak mirë, kur përkrah tyre vunë barasvlerësit përkatës të brumit të shqipes, qoftë duke e zëvendësuar vetëm formantin fjalëformues prapashtesor, qoftë duke gjetur si zëvendësim tërë fjalën përkatëse si barasvlerës adekuat mbi bazë të fjalës shqipe. Ja disa shembuj: arkxhi (arkëtar), haberxhi e habertar (fjaltuer), kafexhi (kafetuer), kpucaxhi (kpucar), shataxhi (shatëtar), gomaraxhi (gomariar), mnorexhi (noretar), hengxhi (muziktar), peshkaxhi (peshkatuer), konopçi (konoptar), akshi (pjektar) etj.

Së nënti, për disa emra të njerëzve sipas punës që kryejnë jepen togfjalësha sqarues, si p.sh.: koxhabash - kreu i katunit, hamarxhi - raisi i grunarit, jorganxhi - punëtor jorganash, kazanxhi - shitës a bas kazanash, mehanexhi - shitës pinash, beldxhi, punëtor me vangë, hallvaxhi - shitës hallvet, krypaxhi - shitës krypet, letraxhi - lojtar letrash, buçukxhi - shitës i seneve të vocrra etj.

Është me inters të ceket fakti se -A-ja para prapashtesës -XHI në disa raste del e

paqëndrueshme si p.sh.: trapaxhi e trapexhi, komataxhi e komatexhi, kopallaxhi e kopallëxhi, karrocaxhi e karrocexhi.

Së dhjeti, në Fjalorin e "Bashkimit" është regjistruar një numër jo i madh i kompozitave si emërtime të njerëzve sipas profesionit. Veçojmë dy raste: bukëpjekëse, të regjistruar vetëm në gjininë femërore si dhe rastin dheshkrojtuer për termin gjeograf.

Siç u pa edhe nga lënda e shënuar më sipër, hartuesit e këtij Fjalori më shumë u kanë dhënë përparësi krijimeve me prapashtesën -TAR, madje edhe -TUER (-TOR) mbi temë emërore sesa atyre me prapashtesën -S (UE/S, -Ë/S) mbi temë foljore si dhe kompozitave me siprapashtesa (me emra prejfoljorë përcaktues). Ç'është e vërteta, prirja e formimeve të tilla me kompozim që në letrarishten e sotme është bërë mënyrë shumë prodhimtare fjalëformuese, sapo vihet re në burimin në fjalë. Krahaso rastet: shitës pinash - sot pijeshitës, shitës hallvet - sot hallvashitës, shitës a bas kazanash - sot kazanbërës a kazanshitës, punëtor jorganash - sot jorganpunues, dhe/shkrojtuer - sot -shkrues si firmashkrues, letërshkrues etj.

Gjithsesi lënda e këtij Fjalori si burim mbështetës ka ndikuar konkretisht te hartuesit e fjalorëve të tjerë në etapat e mëvonshme.

P ë r m b y l l j e

Ndonëse materiali që u paraqit këtu nuk është shterues, megjithatë nga materiali i konsultuar në krahasim me etapën e mëparshme lidhur me temën në shqyrtim, mund të nxirren këto konstatime të përgjithshme:

1. Në këtë etapë shihet vazhdimësi e trajtave dhe e mënyrave të caktuara fjalëformuese, madje shihet një ringjallje e mënyrave të fjalëformimit, sidomos kur është fjala te formimi i emrave prejfoljorë të tipit *mësues* (karakteristikë e dialektit gegë), por edhe në mbështetje të së tashmes së dëftores të foljes përkatëse të tipit mësonjës (karakteristikë e dialektit toskë). Në përgjithësi tek emrat prejfoljorë mbizotëron prapashtesa -S, kurse tek emrat mbi temë emërore mbizotërojnë formimet me prapashtesën -TAR, -AR, -TOR etj.

2. Në këtë etapë ndeshim formime të emrave të vepruesit mbi temën e emrit përkatës të veprimit më -IM dhe -ESË, si p.sh. dëshmitar, mendimtar; shpërblesëtar, dërgesëtar etj.

3. Edhe pse mbahet qëndrim i drejtë ndaj disa ndërkombëtarizmave si filolog, teolog etj. në përgjithësi në këtë etapë parapëlqehet prirja për gjetjen e barasvlerësve përkatës nga brumi i shqipes, madje edhe vihen re krijime të reja (neologjizma) që shumë prej tyre u përgjithësuan, por ndonjëri prej tyre, edhe pse i krijuar sipas modeleve të natyrës së gjuhës shqipe, nuk gjeti përhapje në fazat e mëvonshme.

4. Lidhur me turqizmat si emërtime të njerëzve sipas profesionit, sidomos ato me prapashtesën speciale (turke) -XHI (-ÇI) në këtë etapë bëhet përpjekje për zëvendësimin e tyre, qoftë duke zëvendësuar vetëm atë formant, qoftë duke krijuar

barasvlerës nga brumi i shqipes për të njëjtin koncept.

5. Po në këtë etapë i lëshojnë rrënjët e rritin shtat edhe emërtimet kompozita të tipit hekurpunues, shigjetëhedhës, shitblerës etj., mënyrë kjo fjalëformuese, e cila në periudhën e mëpastajme do të ketë shtrirje gjithnjë e më të madhe.

Gjithsesi të gjitha këto karakteristika do të favorizohen edhe në etapat vazhduese, siç do të vërtetohet në vazhdim të këtij punimi.

3. Etapa ndërmjet dy luftërave botërore

Peripecitë rreth formimit të shtetit të pavarur shqiptar u shprehën gjithashtu edhe në fushën e terminologjisë. Me formimin e elementeve të para të shtetit doli e domosdoshme të bëhej edhe emërtimi i organeve dhe të organizmave të caktuara, prandaj edhe emërtimi i njerëzve sipas pozitës, veprimtarisë, profesionit etj. Që me shpalljen e Pavarësisë në qeverinë e parë të Ismail Qemalit, kur filloi edhe zbatimi konkret i administratës në gjuhën shqipe, filloi edhe emërtimi i kryerësve të punëve dhe të detyrave të caktuara shtetërore më me kompetencë në gjuhën shqipe. Një kërkesë e tillë edhe zyrtarizohet. E kemi të njohur faktin se më 13 dhjetor 1913 në një "Lajmërim" të Kryesisë së Përkohshme të Qeverisë së Vlorës thuhet se "Duhet të gjithë ta dinjë mirë se ç`në ditën fatbardhë që kur Shqipëria doli më vehte, gjuha shqipe u bë gjuhë zyrtare e vendit". Gjithashtu në një Urdhëresë të Ministrisë së Arsimit të kësaj Qeverie, po të kësaj dite, thuhet se edhe shkollat "duhet të përdorin gjuhën shqipe si gjuhë mësimi"⁵⁴.

Dihet se edhe në Qeverinë e Princ Vidit po ashtu edhe në përpjekje të tjera brenda vendit e jashtë çështja e gjuhës dhe e emërtimeve të caktuara terminologjike paraqitej si problem i ndjeshëm dhe i mprehtë aktual, mirëpo nuk dimë për ndonjë organizëm të emëruar zyrtarisht nga ekspertët e gjuhës e të tjerë për sanksionimin e emërtimeve të caktuara.

Si formë më e organizuar e kësaj etape mund të konsiderohet mbajtja e "Komisisë Letrare të Shkodrës", në të cilën u trajtuan çështje të gjuhës letrare shqipe e ndër to në një nga mbledhjet e kësaj Komisie ceket edhe çështja e disa emërtimeve të veprimtarisë së njerëzve, çështje kjo për të cilën kërkohet që të merrej qëndrim, kështu, në vend të fjalës turke **zabit** kërkohet të hyjë në përdorim fjala **oficier** (oficer), për **ehli ibre** të përdoret fjala **ekspert** etj. Ç`është e vërteta, kjo çështje vetëm sa u prek, sepse rrethanat politike, shoqërore e të tjera të kohës ishin shumë të vështira dhe aspak të volitshme për ndërmarrje më të mëdha në këtë fushë. Është e vërtetë, se veprimtaria a konkluzionet që u nxorën nga punimet e Komisisë Letrare të Shkodrës nuk mbeten pa jehonë në rrjedhat e mëpastajme.

Fryma e vendimeve të Komisisë Letrare të Shkodrës u ravijëzua më mirë në Kongresin e Lushnjës, mirëpo sa i përket temës që po e trajtojmë këtu mund të jepen

⁵⁴ Shih edhe te gazeta "Bujku", 12. III. 1992, f. 9.

vetëm konstatime të përgjithshme me hamendje, pasi që për konstatime të veçanta nuk patëm mundësi të konsultonim dokumentet përkatëse që mbase mund të ekzistojnë, por që ne nuk i dijmë, pasi, me sa di unë, nuk janë të publikuara. Me fjalë të tjera, nuk patëm mundësi të konsultonim dokumentet konkrete se si janë zgjidhur së paku emërtimet zyrtare të kohës, në vitet `10 - `20 të hartuara qoftë nga individët, qoftë nga ndonjë institucion i caktuar, por edhe të viteve `30, kur në pikëpamje shtetërore Shqipëria sadokudo del më e organizuar dhe se mund të thuhet pa druajtje se sa i përket administratës shtetërore ishte mjaft e konsoliduar dhe stabile. Kjo nënfazë mbetet temë e hapur e patrajtuar, edhe pse studiuesit e terminologjisë e të leksikologjisë shqiptare konstatojnë se "në periudhën 1912 - 1944 nuk është bërë ndonjë punë e rregullt e sistematike për pasurimin dhe spastrimin e terminologjisë" (Leka -Morska), përkatësisht "në mes të dy luftrave", siç konstaton Lirak Dodbiba, "as që mund të flitej për një problem të terminologjisë shqipe. Në atë kohë çështja e terminologjisë ishte çështje bisedash në mes mësuesish e profesorësh, çështje polemikash për ndonjë gazetë e revistë", ngase siç përfundon autori: "çështja e terminologjisë nuk kishte asnjë mbështetje në realitetin ekonomik e shoqëror të kohës"⁵⁵.

Sidoqoftë, edhe në këtë periudhë patjetër lypsej përdorur një terminologji sadokudo sa më shqipe, pasi që pos shkollave fillore tashti u hapën edhe shkolla të mesme (ndonëse në numër të vogël kundrejt kërkesave që sfidonin). Edhe aparatit "administrativ e gjyqësor të feudo- borgjezisë" i nevojitej një terminologji e re, e kohës, pasi që ishte e pamundur të manipulohesh me terminologjinë e trashëguar nga etapat e mëparshme. "Në ato rrethana, thotë. L. Dodbiba, u morën si model gjuha dhe kultura e Perëndimit. Studentët tanë të shpërndarë në të katër anët e Evropës kur u kthyen andej sollën edhe përhapën bashkë me kulturën edhe një barrë fjalësh e termash të huaj, secili sipas vendit që vinte. Në një periudhë të mëvonshme fitoi epërsi të veçantë gjuha italiane, sepse pushtuesi fashist hapi për nevoja të veta punishte, fabrika, shkolla italiane e gjysmë italiane"⁵⁶.

Ne për të pasur sadopak njëfarë pasqyre rreth emërtimeve të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë konsultuam diçka nga lënda leksikografike e asaj kohe. si p. sh.:

a) materialin përkatës nga dy fjalorë: Fjalorin shqip-italisht të A. Leotti (1937)⁵⁷ si dhe Fjalorin italisht-shqip të F. Kordinjanos (1938)⁵⁸ si dhe

b) materialin përkatës rreth emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë nga shkrimet rreth çështjeve gjuhësore të A. Xhuvanit të kësaj etape.

⁵⁵ Për konstatimet e Lirak Dodbibës shih edhe te revista "Përparimi" nr. 1/85, Prishtinë 1985.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Angelo Leotti, Dizionaria, albanese - italiano, Roma 1937.

⁵⁸ P. Cordignano, Dizionario italiano - albanese, Milano 1938.

1) Nga Fjalori i Leottit dhe ai i Kordinjanos

Fjalori i A. Leottit ka për bazë dialektin toskë, kurse ai i Kordinjanos dialektin gegë, mirëpo që të dy kanë elemente a trajta të të dy dialekteve. Atë që e thotë N. Jokli për Fjalorin e A. Leottit se "toskënishtja ja jep veprës temelin edhe petkun, ndonëse autori s'e len dot mbas dore gegënishten"⁵⁹, vlen edhe për Fjalorin e Kordinjanos, vetëm se emri i dialektit ndërron vend.

Nga kjo që u cek më sipër del fare kuptueshëm se në Fjalorin e Leottit mbizotërojnë trajtat e prejfoljorëve më -ONJ/ë/s si p.sh.: gatonjës, përmbaronjës, shpëtonjës, shtypshkronjës, pleqësonjës (arbitër) etj., ndërsa te Kordinjano mbizotërojnë trajtat e prejfoljorëve të tipit me -UE/S si p.sh.: botues, besues, spërbitues, pikzues, mësues, farkues, mbarështues (administrator), punues etj.

Në të dy fjalorët ndeshim një numër të konsiderueshëm të emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë (profesionit) po ashtu me prapashtesën -S mbi tema të foljeve të tjera si p.sh.: shitës, zgjedhës, pjekës, mbathës, derdhës, rritës, mihës, etj. pastaj mbi temë emërore si b.f.: kalorës, zëvendës, këshillës, mbëkëmbës, nëpunës etj. Siç pritet, ndërsa te Leotti ndeshim trajtat: bërës, pirës, larës, shpërndarës, fshirës etj. te Kordinjano hasim trajtat pris, bles, shkris, ngjyes, bas (bërës), përbas, përtris etj.

Siç dihet në gjuhën e sotme letrare rekomandohen prejfoljorët mbi bazë të foljeve më -R(Ë) siç i shënon Leotti, ndërsa prejfoljorët mbi bazë të foljeve më -O-rekomandohen trajtat më -UE/S, siç i shënon Kordinjano.

Me prapashtesën -AR veçuan këta shembuj të diskutueshëm, të cilët përgjithësisht nuk u përgjithësuan:

- te Leotti: reshtar (rreshter), statistikar (statistikan), timonar (timonier), karrocar (karrocier) topar (topçi), grushtar (boksier), kyçar (kyçëtar), farkar (farkëtar)

-te Kordinjano: (m)notar, fyellar, fletorar (gazetar), shtëpijar.

Mbi temë-emrash me prapashtesën -IM +TAR bien në sy këta emra të njerëzve sipas veprimtarisë: ngadhënimtar, dëfrimtar, kallëzimtar, urdhërimtar, kërcimtar, adhurimtar (te Leotti), pajtimtar, përzimtar (agjitues), mësimtar (te Kordinjano).

Në Fjalorin e Leottit ndeshim këta emra me prapashtesën -TOR: anijetar, garantor, vallëtor, rrojtor, të cilët në gjuhën e sotme janë stabilizuar me prapashtesa të tjera si: anijetar, garantues, vallëtar a vallëzues, rrojtar.

Te Fjalori i Kordinjanos veçuan këto trajta të diskutueshme: orishtar (orëndreqës), pastaj dialektizmat: lyc, korrcë, korrcar, kuvendçar (për kuvendar), shpisak (për shtëpiak).

Sipas burimeve në fjalë në këtë etapë kishin depërtuar në gjuhën tonë këto ndëkombëtarizma si emërtime të njerëzve sipas profesionit: avukat, ambasador, astrolog, komisionar, organizator, oficer, veterinar, senator, deputet, psikolog,

⁵⁹ Shih: A. Xhuvani, Kritikë mbi fjalorë të shqipes, te Studime gjuhësore, Rilindja, Prishtinë 1968.

pedagog, filozof, profesor, rapsod, piktor, himnograf, glatolog, patolog, gjeneral, gjeolog, rektor, fotograf e ndonjë tjetër.

Për të parën herë hetohet një numër jo i vogël i emërtimeve me origjinë të huaj me formantin fundor -IST, formant ky që në shqipen letrare më vonë fiton "qytetarinë" e një prapashtese të specializuar, siç do të shihet në vazhdim të këtij punimi. Në Fjalorin e Leottit janë të shënuara si barasvlerës të shqipes këta emra më -IST: kimist, jurist, telefonist e rezervist, kurse në Fjalorin e Kordonjanos: analist, panigjerist, motoçiklist, çiklist, ritualist, arkivist, artist, lanist, metodist, orientalist, polemist.

Siç vëren me të drejtë prof. A. Xhuvani, autorët në fjalë "ishin dorëllirë sa u përket turqizimave"⁶⁰, sidomos kur është fjala te emërtimet e njerëzve me prapashtesën -XHI (-ÇI), të cilat tashmë edhe historikisht kishin kaluar në shtresën pasive të leksikut si p.sh.: çauash, kajmekam, jyzbash, por edhe ngjyraxhi, konduraxhi, qerrexhi, vajaxhi, fshesaxhi, peshkëxhi, konopçi, zarzavatçi, ahçi (akçi).

Siç dihet zëvendësimi i trajtave të tilla kishte filluar më herët, në etapën e mëparshme dhe prirja për një veprim të tillë ende ishte e gjallë.

Në këto burime ndeshim emërtimet femërorëzuese me prapashtesën -ESHË si p.sh.: profesoreshë, aktoreshë, regjineshë, blegtoreshë, dhaskalleshë etj.

Tek të dy autorët i ndeshim të shënuara kompozitat, të cilat kishin lëshuar rrënjë dhe bimë frytdhënëse që në etapën e Rilindjes sonë Kombëtare, të tipit: mësimdhënës, kyçmbajtës, oxhakshirës, rrobalarës, shtypshkrues e shtypshkronjës, murndreqës, letërprus, letra-shpërndarës, grushtgoditës (për boksier), lajmdhënës, punëdhënës, gjellëbërës, mbarështues (për administrues) etj.

Tek A. Leotti, veçuam kompozitat: pyll-rojtës, fillrojtës për barasvlerësit e gjuhës italiane guarda boschi, guardiafilii, guardilinea, ku vërtet shihet njëfarëdore procesi i kalkëzimit, padyshim nën ndikimin e gjuhës italiane.

Natyrisht për të qenë edhe më komplete pasqyra e emërtimeve në shqyrtim në këtë etapë historike lypset konsultuar edhe burime të tjera, të cilat unë nuk pata mundësi t'i kisha në dorë, por edhe kjo sa u paraqit besoj se jep njëfarë vijëzimi të përdorimit të emërtimeve në fjalë.

2) Nga shkrimet e A. Xhuvanit të kësaj etape

Për të pasur sadokudo një pasqyrë më të kompletuar, siç u cek pak përpara, rreth problematikës së çështjes në trajtim, në mungëse të dokumentacioneve përkatëse, ne konsultuam shkrimet e A. Xhuvanit të kësaj etape, d.m.th. shkrimet e tij të botuara që nga viti 1906 deri më 1944. Në hollësi u vol materiali përkatës edhe nga libri i A. Xhuvanit dhe K. Cipo si bashkautorë me titull "Fillime të stilistikës e të letërsisë së përgjithshme, Tiranë 1930"⁶¹.

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Shih: A. Xhuvani - K. Cipo, Fillime të stilistikës e të letërsisë së përgjithshme (ribotim), Prishtinë 1982.

Edhe nga shkrimet e A. Xhuvanit (dhe Cipos) del se në këtë etapë disa ndërkombëtarizma tashmë dalin të ngulitur në gjuhën tonë. P.sh.: linguist, komentator, fotograf, akademik, albanolog, arqitekt, kinematograf, imperator, dramaturg, artist, filozof, sekretar, orator, arkeolog, aktor, korist, bursist, logograf, funksionar, novelist, kronist, piktor, inspektor, prefekt, administrator, agronom, edukator, infermier, inxhinier, komandant, politikan, historian, veterinar, metematikan, romancier etj.

Nga shembujt që hasëm në veprat e A. Xhuvanit, po edhe të burimeve të tjera të kësaj etape vihet re njëfarë prirje e favorizimit të prapashtesës -AN në krahasim me formante të tjera, kështu p.sh, ndërsa më 1906 e ndeshim emërtimin *historiar* në shkrimet e viteteve '30 del **historian**, *matematik* më 1930, ndërsa **matematik** më 1942, pastaj **elektrikan** (1937), komandant e **komandan** (1930), **komedian** (1930), **politikan** (1930), **gramatikan** (1930) etj.

S'do mend se nga shembujt e tillë del se prapashtesa -AN del më e favorizuar ndaj formanteve të tjera të burimit të huaj si: -ANT, -(q)AR, -C/IST etj.

Gjithashtu shihet njëfarë animi drejt kristalizimit të trajtave më -UE/S dhe -TAR ndaj trajtave të tjera si p.sh. msojtor - mësues, ndëpunës - nëpunës, njehsuer - njehtar (për hesapexhi), përkthenjës - përkthyes, shkronjëtor shkronjëtuër - shkruës, vjershëtor - vjershëtar, këndonjës - këndues, përgjegjës (neologjizën i parapëlqyer nga A. Xhuvani).

Në këtë etapë fillojnë të depërtojnë emrat më -IER (-J/ER) si inxhinier, financier, infermier, noter, pastaj fabrikant, regjent, personel që në të vërtetë janë huazime nga gjuhët evropiane, kryesisht nga italishtja. Lidhur me këtë etapë mendoj se del i drejtë mendimi i prof. M. Bejtës, kur thotë se "huazimet nga italishtja morën përpjesëtime më të mëdha se frëngjishtja... edhe në gjuhën e folur edhe në gjuhën e shkruar, nën frymën e pushtuesve italianë e të shtresave të pasura vendëse që ishin lidhur ngushtë me ekonominë, me politikën dhe me ideologjinë e sundimtarëve, italianizmat vazhdojnë në gjuhën shqipe në shumë lëmë të leksikut"⁶².

Më duket se konstatimin e M. Bejtës e ilustronë mjaft mirë shembujt që u sollën edhe në këtë punim, sidomos kur është fjala tek emërtimet me prapashtesat përkatëse: -IST, -ANT, IER, -(A)TOR(e) që janë prapashtesa karakteristike të gjuhëve romane a neolatine, siç është edhe italishtja.

P ë r m b y l l j e

Si karakteristika themelore të kësaj etape lidhur me temën në shqyrtim në vija të trasha mund të konsiderohen këto tri:

1. Vazhdon prirja e përdorimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në

⁶² M. Bejta, te "Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe", Prishtinë 1983, f. 111 - 112.

mbështetje të gjuhës burimore, siç ishte vijëzuar në etapën e Rilindjes Kombëtare. Kështu që u vazhdua me krijimin e emrave mbi bazë të temave foljore, qoftë mbi bazë të njëjësit të dëftores (veçori e shqipes letrare mbi bazë të dialektit toskë), qoftë mbi bazë të pjesores (veçori e ish -shqipes letrare mbi bazë të dialektit gegë), por vazhdonte edhe shfrytëzimi i prapashtesave të përbashkëta të tjera, qoftë mbi temë foljore, qoftë mbi temë emërore, siç janë prapashtesat: -TAR, -S, -AR dhe -AN.

2. Emërtimet me origjinë turke më -XHI (ÇI), tashti fillojnë të kufizohen, por në këtë etapë kemi një pranim gjithnjë më të madh të emërtimeve me prapashtesën -IST, karakteristikë kjo e gjuhëve romane e të tjera. Shihet edhe një shumim emrash me prapashtesën -AN(!), -IER, -(A)TOR me origjinë të huaj.

3. Numri i kompozitave si emërtime të njerëzve sipas profesionit suksesivisht vjen gjithnjë duke u rritur. Mbizotërojnë kompozitat e tipit emër + emër përcaktues. Gjithsesi kjo etapë do të ketë ndikim për periudhën vijuese pas Luftës II Botërore.

B. PERIUDHA PAS LUFTËS II BOTËRORE

Periudhën pas Luftës II Botërore e karakterizojnë "shndërrime të mëdha", siç e thotë Jani Thomai⁶³, si në të gjitha sferat e jetës edhe në punën e gjuhës", sidomos të leksikut dhe të përpunimit të terminologjisë teknike-shkencore. Në këtë kuadër del edhe interesimi edhe ndaj emërtimeve të njerëzve sipas profesionit.

Në pamundësi që të kem në dorë të gjitha nomenklaturat e profesioneve të kësaj periudhe (sidomos ato në Shqipëri, ngase këto në Kosovë në kohë të fundit i kam konsultuar përgjithësisht, ne u mbështetëm kryesisht në burimet leksikografike, d.m.th. të fjalorëve të botuar në etapa e faza të caktuara të kësaj periudhe. Në këto raste vumë theksin në përzgjedhjen e trajtave të caktuara, drejtshkrimin dhe drejtfjalëformimin e tyre sipas burimeve përkatëse. Për ta perceptuar më lehtë, ne, këtë periudhë e ndamë, jo pa arsye, në dy etapa e që secila etapë ka fazat e veta të veçanta. Etapa e para përfshin kohën prej mbarimit të luftës deri në vitet `70, të cilën e quajtmë **etapë të konsolidimit**, të cilën e ndamë në dy faza që përputhet me emërtimin, siç del në mjaft burime të kohës "**gjuhë e sotme letrare**", sidomos më i ndjeshëm ky emërtim del në fazën e dytë të kësaj etape. Ndërsa etapa e dytë përfshin kohën pas viteve `70 deri në ditët e sotme, të cilën e quajtmë **etapë të normëzimit**, e cila përshtat me emërtimin e ashtuaquajtur, siç del në mjaft burime autoritative edhe sot: "**gjuha (e njësuar) letrare kombëtare**", të cilën e ndamë në katër faza.

1. Etapa e konsolidimit

⁶³ Jani Thomai, te "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve" II, Tiranë 1972, f. 362.

Kjo etapë sipas tipareve që e karakterizojnë, siç e thamë, e pamë të arsyeshme ta ndajmë dy faza: në fazën e parë, e cila përfshin kohën prej mbarimit të Luftës II Botërore deri në vitin 1954, kur u botua Fjalori i gjuhës shqipe dhe faza e dytë, e cila përfshin kohën prej vitit 1954 deri në fund të viteve '60, kur u botuan dhe u pranuan edhe në Kosovë "Rregullat e drejtshkrimit të shqipes"(1967).

a) *Faza e parë e etapës së konsolidimit*

Në mungesë të dokumentacionit përkatës ne u shërbyem, siç u tha më përpara, me materialin e vjelë nga fjalorët përkatës, ku i ndeshim të shënuar emrat e njerëzve sipas verimtarisë së tyre, kryesisht emrat e vepruesit, siç janë burimet: Fjalori serbokroatisht - shqip (1947), Fjalori i Bariqit (1950), Fjalori i Mannit (1977), Fjalori i Sokol Dobroshit (1953) dhe Fjalori rusisht-shqip (1954).

1) **Nga Fjalori serbokroatisht - shqip (1947)**

Pas Luftës II Botërore u shtruan detyra të reja edhe nga aspekti leksikografik. Kështu për nevoja të dygjuhësisë, përkatësisht për nevoja ndërshtetërore e meskombëtare në vitin 1947 u botua në Tiranë *Fjalori serbokroatisht - shqip*, i hartuar nga një grup punonjësish, kryesisht nga Tirana, por edhe nga Beogradi. Ky si fjalor i parë i botuar pas "Çlirimit" përbën edhe "hapin e parë për të dalë nga kufijtë e një dialekti". Në këtë Fjalor është përfshirë një fond i konsiderueshëm i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit a si emra të vepruesit. Edhe pse ende nuk ishte e vendosur çështja e drejtshkrimit a baza dialektore e gjuhës letrare në atë fazë zhvillimi një pjesë e mirë e emërtimeve në shqyrtim dalin të shënuar sipas prirjes drejtshkimore, e cila u sanksionua më vonë si normë e vetme letrare, pra mbi bazë të ish-shqipes letrare a variantit letrar mbi bazë të toskërishtes. Rastet që bëjnë përjashtim janë të vogla, siç janë rastet më -ONJ/ëS, -ENJ/ëS dhe -OJ/S. Këtu ndeshim mjaft emra më -ONJËS si p.sh. çmonjës, gjykonjës, kritikojës, themelonjës, mbëltonjës, por nuk mungojnë as trajtat më -UES si p.sh.: shëlbues, mësues, shikues. Ndonjëherë ndeshim edhe bashkë variantet si: krijues e krijonjës, shkrues e shkronjës. Ndeshim edhe ndonjë rast më -OJS si p.sh. *frekuentojs, frekuentojsë* si barasvlerës i fjalës *polaznik polaznica* të serbokroatishtes. Sa për të dëshmuar faktin se ky material do t'u ketë shërbyer edhe hartuesve të tjerë si material mbështetës i gatshëm po i paraqit sa për ilustrim nja dy-tre shembuj:

- peqar - sobaxhi, furrtar;
- pisar - sekretar, shkronjës, shkrues;
- posmatrač_ - vërejtës, vështronjës, kqyrës, shikues, spektator etj.

Sigurisht ky fjalor do t'u paraprijë dy fjalorëve të tjerë përkatës që pasojnë: Fjalorit të H. Bariqit dhe Fjalorit të Sokol Dobroshit, "dy fjalorë këta të vëllimshëm që u hartuan për qëllime praktike në Jugosllavi"⁶⁴.

⁶⁴ Jani Thomaj, po aty.

2. Nga Fjalori i H. Bariqit (1950)

Ç` është e vërteta, Fjalori i H. Bariqit "*Reçnik srpskoga ili hrvatskoga i albanskog jezika*" Zagreb 1950, sa i përket lëndës në shqyrtim paraqet një shumësi sinonimesh që paksa kalon cakun e "qëllimit praktik" të fjalorit, ngase sa i përket laryshisë së trajtave shkrimore e barasvlerëse për përgjegjësit e gjuhës serbokroate ia kalon atij "qëllimit praktik" të Fjalorit të vitit 1947. Me një fjalë, aty ndeshim një laryshi trajtash të vjela nga burime të ndryshme, prandaj nga aspekti fjalëformues e drejtshkrimor lënda e këtij Fjalori paraqet mjaft interes, pa marrë parasysh faktin se mjaft trajta që i ndeshim aty në gjuhën e sotme nuk kanë përdorim as gjasë për favorizim a riaktivizim. Këtë do ta ilustruam më së miri me disa shembuj konkretë:

- uvar - 1. rojë, rojtës, rojtar, ronjës, ruejës;
 - 2. rojë, sogjetar;
 - 3. penkruajtës (depozitar);
 - 4. bekçi çuvar imanja - ruajtës i pasurisë);
 - 5. kullëtar, pìrgar (stra_a na kuli - roja e pìrgut);
 - 6. dragat, pojak, strazëtar, pëndar, kanosqar (polar, poljak);
 - 7. kështjellar, tujar çuvar zamka-roje e kështjellës)
- . nauçnjak - ditës, dijtat, dijetar, dijtunar, ditunak, shkencëtar.
 - kovaç - farkar, farkatar, farkatuer, farkaxhi, farkëtar, farktuer, farkuer, farkues, kovaç, mjeshtër i hekurit; shpatëtar (kovaç_ hladnog oruzhja; kallpabas (kovaç lazhnog novca).
 - brijaç - rrues, rruës, rruajtës, rrojtar, berber (frizer).
 - branilac - mpronjës, mprojtuer, mprojtës, mbrojtar, i mbrojtuesi (për štì_enik).

Edhe pse në shikim të parë për fjalën *çuvar* do të mjaftonte vetëm barasvlerësi *rojtat*, për *nauçnjak dijetar* e për *kovaç farkëtar*, trajtat e tjera si ruajtës, shkencëtar, farkues e farkëtues janë të domosdoshme për t`u përdorur në kontekste të caktuara, mirëpo edhe trajtat e tjera zgjojnë interes, sepse me to pasqyrohet realiteti, ashtu, siç ekzistonte në faza të caktuara, kur emërtimet e tilla si barasvlerës nuk ishin ende të konsoliduara.

Me fjalë të tjera, ndonëse të shënuara pa ndonjë seleksionim trajtat e tilla zgjojnë interes, sidomos për shkencëtarët që duan të njohin më në thellësi e përhollësi rrugën e formimit dhe të formëzimit të emërtimeve të caktuara të njerëzve sipas veprimtarisë a profesionit në gjuhën tonë.

Ç` është e vërteta, sa herë që bëhet fjalë për llojllojshmërinë fjalëformuese sipas elementeve përkatëse të emrave në përgjithësi është mirë të konsultohet, përkatësisht të shfrytëzohet edhe materiali i regjistruar në Fjalorin e H. Bariqit.

Edhe në Fjalorin e H. Bariqit në raste të caktuara ndeshim pranë e pranë të dyja trajtat dialektore toske e gege si p.sh.: furnizues e furnizonjës, çmues e çmonjës, botues e botonjës etj.

Është karakteristike në këtë Fjalor se këtu ndeshim edhe emërtime të njerëzve sipas profesionit me prapashtesën -AS, e cila në të vërtetë del e specializuar vetëm për emërtimin e njerëzve sipas vendbanimit a origjinës. Në këtë burim ndeshim emrat: nënflotas për fejtunist, kryeqytetas për kryetar bashkie (serb. gradonačelnik), yshtas (opçinitelj - yshtës), optikas (optiqar - optikan), kullotas (çoban - bari) - emërtime këto që në gjuhën e sotme letrare formohen duke marrë prapashtesën -Ë/S ose ndonjë foprmant tjetër e jo atë -AS.

Gjithashtu bien në sy formimet me prapashtesën -Ë/S të sforcuar a shtuese, si p.sh. lirikës, botanikës, akrobatës, smuetorës. Siç dihet emrat e tillë mund të qendrojnë pa prapashtesën -Ë/S, si lirik, botanik, akrobat, smuetor(!).

Po i përmendim edhe disa raste të diskutueshme si fshitës/fshirës, lëshuetës/lëshues, smuetorës, ku elementi -T- del i panevojshëm, madje trajta e tillë me -t- nuk përsëritet ose nuk ndeshet në burime të tjera. Fundja këtu po përmenden si raste të vetmuara, të cilat për konceptin e caktuar tashmë përdoren të normëzuara në ndonjë trajtë tjetër.

Zgjojnë kërshërinë edhe disa formime si: kadështar (kadë + shtar, është fjala për kacëtar kacëpunues), magjistar, valltorkë, dhenarkë, hyzmeqarkë, dhençobankë, fajdedhëntar, mushkash, martues (për noter, serb. matiçar), regjues, syzar (për optiqar - aptikan), kryeradh (për komandir çete), dashnitare, hajdutkë etj. - shëmbuj këta, të cilët nuk i ndeshim në burime të tjera.

Zgjon kërshërinë edhe dukuria e shkrimit të trajtave dysore drejtshkrimore në këtë Fjalor, si p.sh.: (zen(g)jinkë, kuvend(t)ar, thëngjill(t)ar, gjuh(ë)tar, (r)regulltar ... - që do të thotë se fjala e caktuar mund të ketë qenë e shënuar, përkatësisht e përdorur edhe ashtu edhe kështu, d.m.th. edhe thëngjillar edhe thëngjilltar, zengjinkë e zenjinkë etj.

Emrat si përthikës, sprovues, mëditor, sipërmarrës, msymës - të formuar më përngjitje + prapashtesim zënë vend të dukshëm në këtë Fjalor. Edhe fjalët e përbëra (kompozita) zënë vend të konsiderueshëm. Këtu do të përmend vetëm disa raste që në këtë trajtë nuk janë normëzuar në gjuhën letrare sot, edhe pse nuk janë krijuar në kundërshtim me mënyrat a modelet e pranuar fjalëformuese të shqipes së sotme: zadrž - basist, flokëndreqës - vlasuljar, këpucabanës, çudibanës, orëbanës, karrocabaës e karrobaës, gjellëbanës (edhe gjellëbërës), akullshitës, penkruajtës, bujashkëshitës, çorapapunues, formëdhanës e trajtëdhanës, detshtëtitës (për moreplovac - marinar) etj.

Duke e shikuar Fjalorin e Bariqit me kërshëri studimore mund të themi se është mëkat që nuk e pa dritën e shtypit edhe pjesa tjetër e Fjalorit, d.m.th. materiali pas shkronjës -O-, ngase edhe pjesa tjetër sigurisht do të paraqiste material jo më me pak interes.

3) Nga Fjalori i S. Manit

Si në Fjalorin e Bariqit ashtu edhe në Fjalorin e S. Manit (*Stjuart Mann, An english - albanian dicrtionary, Cambridge, 1977*) paraqitet material mjaft interesant dhe me interes, pikërisht sa i përket mënyrës së formimit (formëzimit) të emërtimeve të

njerëzve sipas profesionit.

Po i cek vetëm disa nga neologjizmat a fjalët karakteristike që i ndeshim të shënuara aty për barasvlerësit përkatës të anglishtes si: lëvizjetar (agitator), ndihmues (aider), bimtar (botanist), ngatërrestar (anarkist), stërhollues (analyst), fluturues (aviator), grushtar (boxer), kryesuer (chief), përrallues (fabulist), vizatues e zograf (illustrator), vocrrinar a tregtar voglinash (haberdasher), majmunisës (imitator). Pastaj: përgjajtës a përgjasues (plagiarist), dridhues e përdredhës a bishtnues (previcator), fletërar (journalist, reporter), ligjtar (jurist), kontatar (stipulator), teneqar (tinmen, tinker), velëzues (yachtman) etj.

Vlen të ceket fakti se, edhe pse shumë nga neologjizmat e sipërcekura nuk patën shtrirje në gjuhën letrare, ndonjëri prej tyre pasi që është i krijuar në frymën e modeleve fjalëformuese të gjuhës sonë, mund të jetë i përdorueshëm në stile të caktuara edhe në kohën tonë, kështu që mund të thuhet se ndonjëri nga krijimet e caktuara të kësaj natyre mund të paraqesë sot fuqi potenciale të kapshme.

Si pikë të veçantë po e theksoj çështjen e disa emërtimeve me prapashtesën -AN, ngase është veçori e këtij Fjalori, por që një prirje të tillë e pamë edhe në shkrimet e A. Xhuvanit. Përveç rastit **historian**, por edhe **historiak** që shënohet në këtë Fjalor në vend të parë, hasim edhe raste të tjera më -AN, si p.sh.: teknikan, elektroteknikan, elektrik, methodikan (methodist), taktikan (strategist), statistikan e ndonjë tjetër. Rastet e sipërcekura mund të thuhet se ende plotësisht nuk kanë gjetur konsolidim në letrarishten e sotme shqipe, ndonëse, prapashtesa **-an** në rastet e tilla nuk është, pra, pa traditë.

Edhe pse S. Mani është mbështetur në veprat (fjalorët) e Kordinjanos dhe të Th. Floqit, të hartuara kryesisht mbi bazë të dialektit gegë, në këtë Fjalor hasim edhe trajta toske. Kështu ndeshim trajtat si: rendës, ngamës e ngarës, punëtues e punëtor, por në përgjithësi i përmbahet drejtshkrimit që praktikohet a ishte në fuqi në etapën e Pavarësisë. S. Mani, siç del nga ky Fjalor, nuk ishte në korrent me prirjen që kishte marrë gjuha letrare pas "Çlirimit", kur pa mëdyshje filloi të favorizohet toskërishtja si bazë e gjuhës së njësuar të ditës (si e ashtuquajtur *gjuhë e sotme letrare*). Pra lënda e Fjalorit të tij i takon periudhës së Pavarësisë. Kjo është pra edhe arsyeja që ne e trajtuam lëndën e këtij Fjalori para Fjalorit të Sokol Dobroshit (1953) dhe atij rusisht-shqip (1954), edhe pse dihet se Fjalori i S. Mannit është botuar në vitin 1957, d.m.th. tri vjet pas botimit të Fjalorit të gjuhës shqipe (1954). Pra, e pranojmë plotësisht si të drejtë konstatimin e J. Thomait, i cili sqaron se "Fjalori i Manit pasqyron gjendjen e leksikut të shqipes para Çlirimit", d.m.th., pas Luftës II Botërore.

4) Nga Fjalori i Sokol Dobroshit (1953)

Fjalori i S. Dobroshit nuk del i rëndësishëm vetëm pse "është një ndër fjalorët e mëdhënj që ka dalë gjatë kësaj periudhe, pse përmban 40.000 fjalë", por pse ka rëndësi pikërisht për lëndën që përfshin dhe për shërbimin që ka bërë, sidomos te ne. Lidhur me rëndësinë e tij në radhë të parë po vë theksin në kultivimin e termave të caktuar si në stilin administrativ, ashtu edhe në fusha të tjera letrare - shkencore e të

ndryshme, ngase ky Fjalor ka shërbyer edhe si doracak normativ për ne për një kohë relativisht të gjatë. Në krahasim me burimet e mëparshme në këtë Fjalor materiali që ka të bëjë me emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë a profesionit paraqitet në mënyrë mjaft të plotë dhe mjaft të konsoliduar. Pavarësisht nga vërejtjet që mund t'i bëhen ky Fjalor ka merita të shumanshme.

Drejtshkrimi në këtë Fjalor është drejtshkrimi që përdorej në atë fazë në gjuhën e shkrimit të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, mirëpo fytyra e atij drejtshkrimi nuk është e kthyer kah divergjenca, por drejt konvergencës me drejtshkrimin e variantit letrar mbi bazë të toskërishtes.

Në këtë burim emrat e vepruesit që kanë për temë një folje më -O/J shënohen me prapashtesën -UE/S, si p.sh. ngjyrues, drejtues, notues, shpenzues, kundrues, përpunues, sprastues, administrues, importues, vizatues, lexues, vallëzues, ndërtesues, krijues, shiques, mbarështrues, gërmues etj - mënyrë kjo fjalëformuese që u favorizua në gjuhën letrare kombëtare shqipe. Mirëpo S. Dobrosi nuk lë fare pa përdorur edhe ndonjë trajtë më -ONJ/ë/S. Ai përkrah dërgues shënon dërgonjës, krahas prodhues prodhonjës. Pranon dyformësinë kur shënon trajtën **shtypshkronjës** për **tipograf** e në anën tjetër **shtypshkrues** për **stampar**. Aty del e regjistruar edhe trajta *bartës* (ranëbartës, tejbartës).

Në këtë Fjalor ndeshet e regjistruar edhe trajta **vërejtues** që mund të diskutohet, ngase siç dihet kjo fjalë është formuar në mbështetje të foljes vërej e sipas rregullit mund të dalë emri i vepruesit **vërejtës** (me vërejtë), ndërsa trajta vërejtues mund të shpjegohet vetëm si rast i krijuar me analogji ose duke e supozuar foljen vërejttoj(?) (me vërejtue), çka nuk është diçka e pamundshme. Edhe largpamësia e autorit rreth emërtimeve më -UE/S edhe mbi bazë të fjalëve me rrënjë-temë të karakterit ndërkombëtar si administrues (administrator), dezertues (deserter, dezertor), referues (referent) etj., flet në të mirë të prirjes, e cila pati jehonë dhe vazhdon të favorizohet edhe sot e kësaj dite në gjuhën letrare kombëtare.

Përveç nga foljet më -O/j edhe nga foljet e tipave të tjerë pothuajse rregullisht kemi të bëjmë me formimin e emrave prejpjesorë si p.sh.: tretës, sharritës, ndeshës, leçitës, shtytës, përhapës, pëshpëritës, pajisës, shitës, ndukës, këqyrës etj. - mënyrë kjo e sanksionuar më vonë edhe në gjuhën e sotme letrare.

Edhe në këtë burim si në disa burime të mëparshme mbizotërojnë emërtimet e profesioneve me prapashtesën -TAR, si p.sh.: sapuntar, kallajtar, samartar, opingtar, fshistar, muziktar, zhguntar, kapeltar, farkëtar, shejtar, derëtar, kazantar (mbi temë emërore); lidhëtar, liritar, pretar, prestar etj. (mbi temë foljore). Nuk mungojnë as emërtimet me prapashtesën -AR (edhe pse janë në numër më të vogël në krahasim me emrat më -TAR e -S, si p.sh: vozgar, djathar, dhjar, lopar, magazinari, detar, arushar, sitar, tjegullar, bujtinar, druvar(!) etj.

Edhe te ky Fjalor janë të vërejtshme disa formime me prapashtesën -ATAR, si p.sh. kankatar, pëllumbatar, arnatar, peshkvatar, farkatar, arkatar.

Me prapashtesën a fundoren -IST ndeshim këto emërtime: aferist, beletrist, rezervist, arshivist, dentist dhe gardist.

Zgjon interes formëzimi i trajtave më -AN fundor si akademikan e kronikan, të cilat ende nuk kanë gjetur zgjidhje në gjuhën e sotme letrare, ndonëse, siç u tha, formimet

e tilla kishin traditë përdorimi që në etapën ndërmjet dy luftrave botërore. Edhe pse në numër jo aq të madh në këtë burim hasim edhe emrat me formantin fundor -IER (-JER) si p. sh.: boksjer, infermjer, karrosjer, artiljer; pasticier, kamerier, tapetier, financier.

Autori vazhdon paksa traditën duke shënuar edhe disa emërtime me prapashtesën -OR e -TOR duke i shënuar në trajtën e pashquar me diftongimin e zanores -O- (-UE-r), si p.sh.: punëtuer, muratuer, kaluer e ndonjë tjetër, por: drejtor, ambasador etj.

Në Fjalorin në fjalë hasim disa emërtime të formuara në mbështetje të trajtës së pjesores së foljes përkatëse të gegërishtes, si p.sh. shkris, bas, çelesbas, pëlhurëbas, rrybas, por edhe bamës, përbamës, papuçbamës, vorrbamës, bles e blemës, shkris, ndas, frys, laes, pres - trajta këto që në gjuhën letrare të njësuar sot priren të formohen mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme (toskërishtes) si p.sh.: shkrires, bërës, përbërës, blerës, ndarës, fryrës, larës, prerës e kështu me radhë.

Në këtë burim kompozitat lënë përshtypje të veçantë, si p.sh. punëdrejtues, hekurpunues, lëkurëpunues; perimeshitës, gëlqerepjekës, teneqepunues, qumështshitës, pijeshitës, ranëbartës, gastareshitës, por urdhëdhënës etj., të cilat shpeshherë shënohen krahas emërtimeve njëgjymtyrëshe me prapashtesim, si p.sh. mishtar e mishshitës, fshistar e fshisëshitës, ngrofës e zjarrndezës, lidhëtar e libërlidhës etj.

Vend të konsiderueshëm në Fjalorin e S. Dobroshit zënë togfjalëshat korrespondues të emërtimeve njëfjalësh të serbokroatishtes si p.sh. rojtës shtëpieje (pokuqar), shitësh zogjsh (piliqar), mjeshtër dorëzash (rukaviqar), punëtuer mëndafshi (svilar), shitës barnash (travar), rojtës pylli (šumar), nëpunës statistike (statistiqar), shitës farash kungulli (semenar), rojtës i udhëve (cestar), herrës bari (plevaç), laese enësh (kompozita: sudopera) etj. - emërtime këto që nuk mund të quhen të paqëndrueshme, por në kohën tonë shumica e tyre janë njëfjalëzuar, qoftë duke kaluar në emra njëfjalësh me prapashtesim si pylltar, mëndafshëtar etj., qoftë duke kaluar nga togfjalëshi në kompozitë si p.sh. pyllruajtës, mëdafshpunues etj.

5) Nga Fjalori rusisht - shqip (1954)

Sigurisht rreth paraqitjes së emërtimeve në shqyrtim në lëndën e regjistruar në *Fjalorin rusisht-shqip* të botuar në Moskë më 1954, kemi ecje përpara. Aty drejtshkrimi i shqipes është më i qëndrueshëm në krahasim me burimet e mëparshme, pasi që në këtë Fjalor është praktikuar gjuha letrare mbi bazë të toskërishtes, e cila praktikohet si gjuhë zyrtare në Shqipëri. Për këtë arsye në këtë burim nuk shihet laramani e madhe trajtash drejtshkimore e fjalëformuese, megjithatë nga hartuesit e këtij Fjalori përkrahet mënyra fjalëformuese me formantin -ONJ/ËS e jo më -UE/S, siç favorizohej në Fjalorin e S. Dobroshit. Në këtë burim ndeshim trajtat: mësonjës, vëzhgonjës, prodhonjës, hartonjës, montonjës, zbatonjës etj., madje edhe më -ENJ/ËS e jo më -YE/S, siç u normëzua më vonë në letrarishten e sotme. Aty ndeshim trajtat: përkthenjës, rrëmbenjës - pa u cekur fare trajtat përkthyes, rrëmbyes. Me një fjalë autorët si temë prodhuese nuk morën pjesoren e

foljes përkatëse, por njëjës in e dëftores të foljes së caktuar që është karakteristikë e të folmeve të toskërishtes. Në këtë Fjalor ndeshim dy trajta të diskutueshme: planerist dhe metalurgjist, d.m.th. me prapashtesën përforcuese -IST, mbase pa nevojë, pasi që trajta e shkurtër planer a planëzues, përkatësisht metalurg do të mjaftonte për të shprehur konceptin e caktuar. Pastaj aty ndeshim trajtën fizikant e jo fizikan, siç ndeshim në burime të mëparshme. Po aty hasim trajtën skiator e jo skitar. Trajta skitar do të bëhet trajtë e rekomandueshme në burimet e mëvonshme. Për dispeçer që aty e ndeshim në trajtën dispetçer, jepet sinonimi *punëndarës*, emërtim ky që ndoshta mund të përdoret edhe aktualisht si konkurrent për të zëvendësuar në raste të caktuara përgjegjës in *dispeçer* të origjinës së huaj.

Në fund po e cek edhe emërtimin **motër (spitali)** për infermiere që është shënuar si barasvlerës për emërtimin **medicinskaja sestra**, Edhe serb. del emërtimi **medicinska sestra**, nën ndikimin e secilës te ne ka gjetur përdorim kalku **motër medicinale** a motër mjekësore, përshtatshmëria e këtij termi vlen të diskutohet.

b) Faza e dytë e konsolidimit

Kjo fazë e re sipas mendimit tim, fillon me botimin a zbatimin në jetë të *Fjalorit të gjuhës shqipe* (1954) dhe vazhdon deri kah fundi i viteve '60 dhe fillimi i viteve '70.

1. Nga Fjalori i gjuhës shqipe (1954)

Është e vërtetë se në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (1954), të parin fjalor të tipit shpjegues normativ u "përfshi pjesa më e madhe dhe e rëndësishme e leksikut të shqipes". Gjithashtu është i drejtë konstatimi se lënda e shtruar në këtë Fjalor kalon suazat e fjalorëve të mëparshëm që kishin gjithsesi karakter të theksuar dialektor, madje edhe të atyre që kishin ambicie të jenë fjalorë të mbarë shqipes. Fjalori i gjuhës shqipe (1954) u hartua në kushte dhe rrethana të tjera, të cilat e favorizonin një punë të tillë, ngase tashti, pas disa konsultave e konferencave gjuhësore (1952), gjuha letrare kishte marrë fytyrë stabilizimi e konsolidimi bashkë me stabilizimin e shtetit dhe të formacioneve politiko-shoqërore. Autoriteti i rekomandimeve lidhur me trajtat e parapëlqyera si nga aspekti drejtshkrimor, ashtu edhe nga ai fjalëformues ishte më i nivelizuar, qoftë nga arsyetimi shkencor teorik, qoftë nga zbatimi praktik në shkollë, në administratë, në mjete të informacionit, në gjuhën e librave etj. Ndonëse edhe në atë fazë për "problemet e ortografisë" kishte mjaft "pika të diskutueshme" dhe se Fjalori nuk kishte mundur "t'u shpëtojë plotësisht të gjitha lëkundjeve", siç e thotë A. Kajrakdiu, "ky Fjalor jo vetëm plotësoi njëfarëdore një mungesë në jetën tonë kulturore, po u bë edhe orientues, strumbullar i përdorimit të shqipes ndër ne ... Ky Fjalor luajti një rol të vërtetë historik në konsolidimin e shqipes".

Fjalori në fjalë "ka shërbyer si vepër leksikografike themelore për gjuhën shqipe" thuhet në *Fjalorin enciklopedik shqiptar*, Tiranë 1985, f. 275.

Pra me botimin e Fjalorit të gjuhës shqipe (1954) fillon një fazë e re edhe lidhur me emërtimet e njerëzve sipas profesionit në gjuhën tonë, pasi që trajtat e parapëlqyera

nga komisionet e caktuara të gjuhëtarëve aty morën, si të themi, vizë zyrtare e morale që pa druajtje të mund të përdroreshin në jetën e përditshme, qoftë në gjuhën e shkruar, qoftë në gjuhën e folur. Madje lënda e këtij Fjalori u ka shërbyer si mbështetje, gjë që u shërben edhe sot, hartuesve të fjalorëve të tjerë, sigurisht edhe atyre normativë.

Çështje e vërteta, në këtë Fjalor, siç u tha, u shënuan edhe mjaft raste "të lëkundshme" a trajta sinonimike që kanë të bëjnë edhe me përzgjedhjen e formanteve të caktuara fjalëfomuese. Aty mbeten edhe mjaft çështje të pazgjidhura përfundimisht, por gjithsesi edhe çështjet e tilla tashti ishin nën mbikëqyrjen e komisioneve a të organizmave të caktuar, të cilat edhe do të kenë qenë objekt diskutimi, ngase siç thuhet aty "në këtë Fjalor... ortografia ndjek në vija të përgjithshme projektin e ortografisë t'Institutit të Shkencave", që do të thotë se në fazën paraprake çështja e ortografisë e siç nënkuptohet edhe ajo e fjalëformimit është trajtuar në mënyrë të organizuar nga organet kompetente edhe shkencore, siç ishte edhe "Institutit të Shkencave".

Edhe në këtë Fjalor ndeshim të regjistruara emërtimet e caktuara në variante të ndryshme si p.sh.: *ergat* e *argat*, *gjizar* e *ngjizar*, *gdhëndës* e *gdhendës*, *dheltar* e *dhelatar*, *dylmer* e *delmer*, *daktilograf* e *daktilografist*, *burizan* e *borizan* etj. që në burimet e tjera, sidomos në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980) shënohet vetëm njëra trajtë, zakonisht ajo që del e rekomanduar edhe sipas Fjalorit të gjuhës shqipe (1954).

Në këtë Fjalor për nga numri më shumë emërtime të njerëzve sipas profesionit janë përfshirë me prapashtesën -TAR, pastaj më -AR, më -S (UE/S, -ONJ/Ë/S, -Ë/S), -XHI, -IST e kështu gjithnjë më pak me formante të tjera.

Meqenëse Fjalori i gjuhës shqipe (1954) do të jetë burim bazë i këtij punimi, ku bëhet fjalë për veçoritë konkrete të formimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën tonë, nuk do të ndalem më në hollësi në veçoritë dalluese të tjera të lëndës në shqyrtim, por do të përmend ndonjë veçori dalluese të fjalorëve të tjerë që u botuan pas këtij Fjalori në kohën deri sa doli në dritë "Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe" (1976).

Gjithsesi lënda e përfshirë në *Fjalorin e gjuhës shqipe* është pasqyra më reale e realitetit të kohës edhe për emërtimet e njerëzve sipas profesionit, edhe pse aty nuk janë përfshirë të gjitha fjalët e kësaj natyre që ishin në përdorim aktiv.

2) Nga Fjalori terminologjik serbokroatisht-shqip (1961)

Vetë zhvillimi shoqëror-ekonomik shtroi nevojën edhe për fjalorë terminologjikë. Këtij tipi fjalorësh si më i kompletuar i paraprindoracak u "Fjaluer terminologjik serbokroatisht - shqip" (grup autorësh) që u botua në Prishinë në vitin 1961.

Në këtë Fjalor, kur kemi parasysh numrin e tërësishëm të fjalëve që përfshihen në të, emrat e njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë zënë vend të konsiderueshëm. Në këtë kontekst po përmend ndonjë shembull që nuk përkon me trajtën e normëzuar në gjuhën e sotme letrare: *barnator* (*barnatar*), *daktilograf* (*daktilografist*), *pionier* (*pionier*), *gramatikant* (*gramatikan*), *dëshmitar* (*dëshmitar*) etj. Hartuesit

parapëlqyen në raste emrat prejfoljorë mbi bazë të dialektit gegë, si p.sh. shkrimës e shkris (shkrirës), bas, bator (bërës).

Edhe në këtë Fjalor ndeshet ndonjë trajtë e diskutueshme si p.sh. vendar (vendës a vendas), plakor (plak). Edhe këtu parapëlqehet trajta **tragjedian**, e cila ende nuk del e stabilizuar në gjuhën tonë, ngase nuk del e përfshirë në fjalët e tjerë normative.

3) Nga fjalorët e terminologjisë tekniko-shkencore

Në këtë fazë në Tiranë fillon botimi i fjalorëve të terminologjisë tekniko-shkencore (1-15 doracakë) sipas degëve përkatëse shkencore. Ndër këta doracakë nuk ndeshim numër të madh të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, por nuk mungojnë, si me thënë, ata emra të profilizuar karakteristike sipas fushës së caktuar shkencore. Në Fjalorin e terminologjisë së botanikës b.f. domosdo del emërtimi agronom, lultar etj. Në fushën e terminologjisë tekniko-shkencore të matematikës dhe të mekanikës teorike ndeshim këto emërtime të profilizuara: algjebri e kinograf. Në fushën e terminologjisë elektroteknike: *elektroteknik e përcjellës pune*, kurse në atë të arkitekturës: përveç emrit *arkitekt* del edhe emërtimi: *inxhinier - arkitekt*. Nga fusha e terminologjisë së minierave është shënuar një numër i konsiderueshëm i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit. Aty i ndeshim të regjistruara këto emërtime: argënist, frenues ose manovrues, llambëtar, kryemjeshtër, kryepunëtor, kryeminator ose kryexehetar, vagonist, minator ose xehetar, minator mjeshtër edhe mjeshtër minator (është fjala për vende të ndryshme pune); ndihmës minator, numërtues vagonash, përzgjedhës ose punëtor seleksionues, punëtor armatose pusesh, punëtor bartjeje, punëtor mbushës, punëtor në sipërfaqe, punëtor ngarkimi ose sojëtar, punëtor përzgjedhës, punëtor pusash, punëtor shkarkues, punëtor shplarës; punëtore përzgjedhëse (që është emërtim i vetëm në gjinië femërore). Gjithashtu në këtë burim janë të regjistruara edhe këto emërtime: spastrues, shpues, tërheqës e thellues. Në Fjalorin e terminologjisë tekniko-shkencore nga fusha e letërsisë janë shënuar këto emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë: aktor, aktor komik ose komediant, aktor tragjik; diletant, dramaturg, estete, ëndëronjës e fantazist, fejtonist, folklorist, gazetar, humorist, komediograf, komentues, kujtimshkrues ose autor kujtimesh; letrar, nënpletist (ose fejtonist), novelist, orator ose gojtar, përralltar, prozator, romancier, skenarist, poet e poeteshë, shkrimtar, tragjediograf, tregimtar, trubadur.

Gjithsesi bie në sy fakti se vetëm në dy tri fusha shkencore dalin të shënuara emërtimet e njerëzve sipas profesioneve edhe ato jo në mënyrë të plotë, sidoqoftë nga aspekti që po trajtohet këtu zgjojnë interes format si: algjebri, numërtues, ëndëronjës (ëndërrimtar) për fantazist, përzgjedhës për seleksionues, kujtimshkrues, thellues, shpues, poeteshë etj.

Meqenëse trajtat e caktuara dalin më tepër në kuadër të emërtesave d.m.th. nomenklaturës, kuptimi i tyre del i qartë vetëm në kuadër të fushës së caktuar shkencore, kurse në stilin e përgjithshëm mund të marrin nuanca të tjera kuptimore.

Madje kjo është arsyeja që në fjalorë të përgjithshëm, b.f., emërtimet algjebriest e numërtues nuk dalin të shënuar, jo pse nuk përdoren në lëmin e caktuar, por pse në stilin e përgjithshëm konceptet e tyre paksa mund të përfshihen në kuadër të emërtimit hiperonim **matematikan** si emërtim përfaqësues, ngase, siç dihet, në profesionin e matematikanit bën pjesë edhe **algjebriesti** si specialist, edhe **numërtuesi** me kuptimin e llogaritarit a të statistikanit etj.

Vërejtjet rreth lëndës së përfshirë në fjalorët terminologjikë tekniko-shkencorë po i përfundoj me konstatimin e J. Thomait se në këta fjalorë "janë shfrytëzuar mundësitë për të krijuar terma me mjetet dhe mënyrat e formimit të fjalëve të gjuhës së sotme shqipe", prandaj për këtë arsye çdo studiues detyrimisht duhet t'i konsultojë edhe fjalorët e tillë.

2. Etapa e normëzimit

a) Faza e parë e etapës së normëzimit

Vitet '60-'70 i karakterizon "zhvillimi i vullshëm i gjuhës letrare dhe sukseset e gjuhësisë shqiptare" sidomos në njohjes e gjithanshme e të thelluar të strukturës së shqipes letrare, kështu që si "hap cilësor përpara" dolën "Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt)" që u botua në vitin 1967 në Tiranë. Siç dihet këto "Rregulla" patën jehonë në të gjitha trojet shqipfolëse. Në "Konsultën gjuhësore" të Prishtinës në pranverën e vitit 1968 u pranuan këto "Rregulla" së bashku me parimin se pranohet jo vetëm drejtshkrimi, por edhe çka është tejet me peshë: "një formë e vetme të gjuhës sonë letrare" ashtu siç do të praktikohet a zbatohet në Shqipëri. Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të vitit 1967 solli rrafshimin e mëtejshëm të shumë lëkundjeve drejtshkrimore që u përmenden në Fjalorin e gjuhës shqipe (1954), por që ishin të pranishme edhe në Fjalorin e S. Dobroshit dhe bëri që të njësohet pothuajse plotësisht gjuha shqipe letrare në të gjitha trojet shqipfolëse, siç do të konstatohet më vonë edhe në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe që u mbajt në Tiranë më 1972.

Për që "Rregullat" në fjalë patën ndikim edhe në fjalëformim në veçanti për temën tonë në shqyrtim po cek disa fakte:

1. U përkrah prirja që të formohen emrat e vepruesit (të profesioneve) me prapashtesën -UE/S e jo -ONJ/Ë/S si p.sh. parashikues, pastruese, shkruer, bakërpunues.
2. U parapëlqye mënyra e formimit të emrave më prapashtesën -YE/S e jo më -ENJ/Ë/S, si p.sh. hekurthyes, udhërrëfyes.
3. U parapëlqye pjesorja e trajtës toske (tash e letrarishtes së sotme) për emërtimet e tipit: pirës, bërës etj., si p.sh. dobiprurës, këpucëbërës etj, jo pis a pimës, bas a bamës etj.
4. Gjithashtu në bazë të shembujve të pasqyruar këtu edhe pse me qëllim drejtshkrimor shihet se emërtimet me prapashtesën -TAR të tipit: gjyqtar, këngëtar,

pajtimtar etj. janë më të parapëlqyera në krahasim me prapashtesat: -TOR, -ATAR etj.

5. Ndeshim edhe emërtimet me fundorin -IER si inxhinier, bankier e jo më -JER a me -ER, siç reflektoheshin herë-herë në burime të ndryshme më përpara.

Sidoqoftë, dalja në dritë e këtyre "Rregullave" pati lehonë shumë të madhe, ngase në frymën e këtyre u hartuan pastaj edhe fjalorët normativë, ndër ta po përmend dy vepra leksikografike që ndër ne qenë shumë të dobishëm: Fjalorin serbokroatisht - shqip të vitit 1974 dhe Fjalorin shqip - serbokroatisht të M. Ndrecës (1976).

1) Nga Fjalori serbokroatisht - shqip (1974)

Fjalori serbokroatisht - shqip i vitit 1974, i hartuar nga një grup autorësh, paraqitet si një fjalor mjaft komplet. "Jemi përpjekur, thuhet në parathëniën e këtij Fjalori, t'i japim të gjitha elementet që kërkon fjalori i këtij lloji" si një "fjalor praktik i përdorshëm". *"Jemi kujdesur, -sqarohet po aty,- që në fjalor të përfshihet sa më shumë lëndë e re, e gjallë, kurse nga terminologjia shkencore profesionale dhe fjalë të huaja ato më të nevojshmet"*. Dhe me të vërtetë, Fjalori në fjalë përmban material të konsiderueshëm nga fusha e terminologjisë në përgjithësi si dhe nga nënfusha e emërtimeve të profesioneve në veçanti. Ky Fjalor aq më shumë ka vlerë, sepse ka shërbyer ashtu siç shërben edhe sot ndër ne, si një burim normativ me përdorim të gjerë. Po e theksoj edhe këtë në parantezë se në variantin e plotësuar të ribotuar në vitin 1986 ky Fjalor nuk pësoi ndryshime drejtshkimore e fjalëformuese të dallueshme.

Meqenëse shumica e emrave në shqyrtim të përfshirë në këtë burim përshtatet me normën e letrarishtes së sotme, këtu po veçoj vetëm ndonjë rast të diskutueshëm, si p.sh. dorëzar (për rukaviçar), atletist e atlet (atletiqar), kontribues (prinosilac), daltues (dubac), sytar (gadjaç), lundrar (ladjar), testatar (oporuçilac), teniser (tenisaç - tenist), majës e mahës (mbase më drejt: majmës) për tovlaç, editorialist (uvodniçar).

2) Nga Fjalori shqip - serbokroatisht (1976)

Po kësaj faze i takon edhe Fjalori shqip - serbokroatisht i Mikel Ndrecës, i botuar në Prishtinë në vitin 1976.

Në këtë Fjalor nuk ndeshim numër të madh të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë. Ndër ato që janë shënuar si trajta të diskutueshme po përmendim shembujt: mjelcuer, shpërndas dhe blemës - pasi që kështu nuk dalin në burimet e tjera të mëvonshme normative. Siç dihet në vend të trajtës arkaike mjelcuer del e parapëlqyer trajta mjelës, për shpërndas del shpërndarës dhe për blemës parapëlqehet trajta blerës.

Shikuar në tërësi edhe lënda e këtij Fjalori mund të cilësohet si burim normativ.

b) Faza e dytë e etapës së normëzimit

1) Nga Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe (1976)

Me botimin e Fjalorit drejtshkrimor të gjuhës shqipe (1976) fillon fazë e re jo vetëm në fushën e konsolidimit të drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit të fjalëve të gjuhës letrare, por edhe në fushën e fjalëformimit, pasi që tashti disa modele e mënyra fjalëformimi dalin të favorizuara qartazi e disa jo.

Në këtë burim është paraqitur njaft material përfaqësues e orientues edhe nga nënfusha e emërtimeve në shqyrtim. Pasi shumica e shembujve të emrave të njerëzve sipas profesionit janë përfshirë në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980) dhe në Fjalorin shqip - serbokroatisht (1981), këtu do të përmenden vetëm disa emra të kësaj nënfushe semantike, të cilët nuk u përfshinë në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980) e këta janë: *hamëtar, smilatës, financues, figurant e figurante, apologjist, centrifugist, betonist, epistolar, granatier, kapelan, hasraxhi, harmaxhi, husar, restaurator, virusolog, skreperist, toreador, plantator, kolaudator, kameraman, logjicist, lubrifikator, legjislator, motovelier, mekanicist, narodnik, spektograf* e ndonjë tjetër.

Përveç ndonjë trajte arkaike si lëvrues, këmbëcor etj. edhe të ndonjë shembulli që hartuesve të Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe iu duk e panevojshme të shënohen siç është edhe shembulli blerëse, shumica e shembujve janë fjalë të karakterit ndërkombëtar, të cilët qoftë në këtë qoftë në ndonjë trajtë tjetër duhet të zënë vend në fjalorët përkatës të fjalëve ndërkombëtare.

Ndonjë rast i veçantë nga ky burim siç është trajta profesionalist në vend profesionist është diskutuar në një artikull gjuhësor, gjë që jep për t'u kuptuar se ka edhe raste të tjera që mund të diskutohen.

Sidoqoftë, lënda e *Fjalorit drejtshkrimor* të gjuhës shqipe shërbeu si lëndë mbështetëse për hartimin e fjalorëve të tjerë që u botuan fill pas tij, siç është *Fjalori frëngjisht-shqip* i V. Kokonës (1977).

2) Nga Fjalori frëngjisht - shqip (1977)

Në Fjalorin frëngjisht - shqip të V. Kokonës ndeshim disa emra të vepruesit që mund të diskutohen, pasi ndryshojnë nga trajtat e regjistruara më vonë në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980). Bie në sy trajta arkaike *faquer* për *faqosës*, *demonstrues* për *demonstrues*, *artilier* e *trainer* (të cilët në FGJSSH dalin : *artiljer* e *trajner*), *dorëzanë* e *dashamirë* (të cilët në FGJSSH dalin *dorëzanës* e *dashamirës*); trajta *shkes* del me përparësi ndaj trajtës *shkues* që në FGJSSH radhitja del e kundërt. Emërtimet *tekstiliste* dhe *yshtëse* janë të regjistruara vetëm në gjininë femërore (në FGJSSH shënohen në të dyja gjinitë). V. Kokona në këtë Fjalor e shënon trajtën *pësonjës* edhe pse përparësi i jep trajtës *pësues*.

Në përgjithësi lënda e këtij Fjalori del e përfshirë në *Fjalorin e gjuhës së sotme*

shqipe (1980).

c) *Faza e tretë e etapës së normëzimit*

1) **Nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980)**

Sigurisht kurorëzimi më kulmor e kësaj etape është dalja në dritë e *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980. Kjo vepër madhore edhe pse është fjalor i tipit të mesëm për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare pati dhe ka një domethënie të madhe. Me këtë Fjalor, siç thuhet në parathënien e tij, synohen të zgjidhen dy detyra:

a) të japë shpjegime dhe normat e përdorimit të fjalëve dhe të shprehjeve që tashmë kanë zënë vend të qëndrueshëm në gjuhën e sotme letrare shqipe dhe

b) të hedhë në përdorim fjalë e shprehje të reja pak të njohura ose të panjohura, sidomos të gurrës popullore që deri më sot nuk janë pasqyruar në fjalorë e në botime të tjera, por që i kanë të gjitha vlerat e mundësitë për të qenë pjesë e pandarë e fondit leksikor e frazeologjik të gjuhës sonë letrare.

Nga konstatimet e mësipërme mësojmë se në këtë Fjalor nuk është përfshirë vetëm lënda e përzgjedhur nga fjalorët e mëparshëm, të cilët "janë shfrytëzuar kurdoherë me sy kritik në dritën e parimeve dhe të kërkesave të reja shkencore", por është përfshirë edhe mjaft lëndë e re e krijuar nga nevoja për të paraqitur edhe konceptet e reja që kanë dalë si rezultat i zhvillimit të hovshëm ekonomik e shoqëror, qoftë në plan kombëtar qoftë në atë ndërkombëtar. Në këtë Fjalor janë mbi 70 fusha të ndryshme stilistike e kuptimore që, ç'është e vërteta, kemi të bëjmë pothuajse me tërë kompleksitetin që ngërthen jeta bashkëkohore, ku janë përfshirë në një masë mjaft përfaqësuese edhe emërtimet e njerëzve sipas profesioneve.

Lënda e këtij Fjalori për punimin tonë është lëndë strumbullare rreth së cilës sillen e trajtohen çështjet e caktuara, prandaj këtu nuk do të zërthehen çështje të veçanta.

2) **Nga Fjalori shqip - serbokroatisht (1981)**

Edhe *Fjalori shqip-serbokroatisht* që u botua në Prishtinë në vitin 1981 me plotgojë mund të cilësohet si fjalor normativ i formatit të mesëm. Në këtë Fjalor janë përfshirë afro 50.000 fjalë, d.m.th. ka fond më të madh fjalësh sesa Fjalori i gjuhës së sotme shqipe.

Fjalori shqip - serbokroatisht ndonëse është botuar një vit më vonë nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, sa i përket karakterit normativ në disa pika del më i "vjetër", edhe pse lënda duket e njësuar sa i përket drejtshkrimit, ngase "Rregullat e drejtshkrimit" të shqipes letrare janë respektuar në të dyja burimet.

Hiq ndonjë ndryshim të vogël, pasi që janë hartuar pavarësisht në dy qendra të ndryshme dhe se paraqesin sadokudo edhe ndonjë rast specifik për shkak të sistemeve të ndryshme shoqërore, politike e ekonomike, që të dy fjalorët kanë lëndë të konsiderueshme të përbashkët. Edhe në *Fjalorin shqip-serbokroatisht* ndeshim mjaft material që ka të bëjë me emërtimet e njerëzve sipas profesionit. Edhe emërtimet e këtij burimi trajtohen më në hollësi në krahasim me trajtat e shënuara në

Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe.

Meqenëse që të dy këta fjalorë u botuan, si të thuash, në të njëjtën kohë, mund të thuhet se me botimin e tyre fillon fazë e re edhe në konsolidimin e normëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe, por edhe më gjerë të leksikut shqip në përgjithësi.

ç) Faza e katërt e etapës së normëzimit

Pas daljes në dritë të dy fjalorëve të sipërcekur, si të themi, u krijuan parakushtet që të ecej më tej më normalisht edhe për hartimin e fjalorëve të tjerë të leksikografisë shqiptare sipas disiplinave e të degëve të caktuara të profilizuara. Në këtë kuadër po përmend botimin e dy fjalorëve të fjalëve ndërkombëtare (a të fjalëve të huaja, siç i kanë pagëzuar autorët përkatës), pastaj fjalorët mjaft cilësorë të hartuar nga H. Gorani nga fusha e terminologjisë ekonomike, Fjalorin krahasues të termave ushtarakë (1982) dhe fjalorë të tjerë, siç është Fjalori frëngjisht - shqip i M. Bejtës.

U konsultuan gjithashtu edhe doracakët mbi nomenklaturën e profesioneve që u botuan (përkthyen) gjatë kësaj etape te ne.

1) Nga Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja të M. Ndrecës

Në *Fjalorin e fjalëve dhe të shprehjeve të huaja* të Mikel Ndrecës (Prishtinë 1986) është përfshirë lëndë mjaft e gjerë nga nënfusha e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, emërtime këto të karakterit ndërkombëtar. Për të fituar një pasqyrë sadokudo sa më të qartë rreth sasisë së emërtimeve të tilla, po theksoj se sipas formanteve fundore fjalëformuese vendin e parë për nga numri e zënë emrat me prapashtesën -IST, tipi: traktorist, seleksionist, fabulist etj. Pastaj vijnë me radhë emrat më -XHI të tipit: bojaxhi, bejtexhi, daullexhi etj. Ata me prapashtesën -ATOR, tipi: dekorator, administrator, frezator etj. Nuk janë të pavërejtshëm as emrat më -OR, të tipit: ekspeditor, kontrollor, prokuror etj. Edhe pse në numër edhe më të vogël, nuk janë të përjashtuar as emrat me fundorët a prapashtesat e tjera si -IER, -ER, -ANT, -AR, -ENT, madje edhe me -AN ndonjë me -TAR, të cilët nuk mund të përfillen si formime të shqipes.

Në këtë Fjalor bien në sy disa emra me prapashtesat përkatëse të gjuhës shqipe si: -TAR, -UE/S dhe -S. Rastet e tilla, d.m.th. me prapashtesat shqipe, kur kemi parasysh tipizimin e fjalorit, mund të diskutohen. Sipas mendimit tim rastet e tilla kanë vend aty vetëm si fjalë sqaruese e nuk duhet të konsiderohen si fjalë ndërkombëtare e aq më pak si "fjalë të huaja", pasi që ato janë krijime brendapërbrenda vetë gjuhës shqipe, edhe pse mbi bazë të fjale-temës së huazuar. Kjo çështje do të trajtohen në kreun tjetër më në hollësi.

Gjithashtu në këtë Fjalor bie në sy sinonimia e barasvlerësve sipas varianteve të caktuara si p.sh.: abonent e abonues, parapagues e pajtimtar, adaptues e përvetësues, afarist e sipërmarrës, aferist e komplotist, akrobat e gjimnast(ist), çelnikore e stopaneshë, ashik e dashnor, pastaj demontuer e çmontues, diletant e amator, desimilues e shpërngjashmues, kurator e kujdestar, formalist e trajtësor, mynafik e përgojues, myzevir e shpifës a shtieqeq, myshteri e blerës, navigator e lundruer, fraksionist e grupash, shenjëtar e nishanxhi, pacifikues e paqëtues, prepotent e dhunues a mujshar, remtar e bakërpunues, suksesor e trashëgimtar, shnajder e rrobaqepës, terzi e rrobaqepës, veçilharxh e ekonom a intendant etj.

Është me interes gjithashtu të ceket edhe sinonimia e emërtimeve mbi temë të njëjtë fjalëformuese, por me formantin prapashtesor të ndryshëm si p.sh: administrator-administruer, armator-armatues a armues, betonier-betonues, dekorator-dekorues, normist-normues, redaktor-redaktues, obligator-obligues, pagator-pagues, referent-referues, revizionist-revizionues, recitator-recitues, rregullator-rregullues, saldator-saldues, vizitor-vizitues etj.

Në raste të tilla, ç'është e drejta, kemi të bëjmë me mënyra të ndryshme formëzimi a fjalëformimi, njëra mënyrë ka të bëjë me një emër të formëzuar nga huazimi, ndërsa mënyra e dytë ka të bëjë me emërtime mbi bazë të një temë foljore të shqipes dhe në të dyja rastet në njëfarë mënyrë kemi të bëjmë me temë të qartë fjalëformuese, ngase edhe nga ky aspekt mund të zbërthehen edhe fjalët e huazuara në gjuhën tonë.

Janë për t'u diskutuar rastet kur fjala e ashtuquajtur "e huaj" del e shënuar vetëm me prapashtesën karakteristike të shqipes si p.sh.: kritikues, koordinues, zaptues, meremetues, montues, obligues, ofertues etj. E themi se janë trajta për t'u diskutuar, ngase nuk e kanë formën e fjalës së huaj, për këtë arsye më sipër u quajtën trajta të shqipes e jo huazime, ngase fjala e huaj apo e huazuar ka formë tjetër b.f. kritik, kritikant(!) kritizer; koordinator, obligator, ofertant, montator ... etj.

Në këtë Fjalor, çka më duket pak e çuditshme, hasim nja dy raste në trajtën arkaike drejtshkrimore: kontrolluer dhe demontuer, të cilat normalisht duhet të dilnin me prapashtesën -OR: kontrollor a kontrollues, demontator demontues a çmontues.

2) Nga Fjalori i fjalëve të huaja (1988)

Edhe *Fjalori i fjalëve të huaja*, botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës, i botuar më 1988, ka pothuajse ato veçori të përgjithshme që u thanë për Fjalorin e M. Ndrecës pak më sipër, mirëpo lidhur me të del edhe ndonjë karakteristikë e veçantë që zgjon interes dhe kërkon sqarim. Lidhur me emërtimet e njerëzve sipas profesionit do të veçonim këto raste: muzicent, protetik, degustues, doktorand, bandëtar, organ inokos etj. Me fjalë të tjera, secili nga rastet e sipërcekura në vetvete paraqet lëndë të diskutueshme, qoftë për të arsytuar trajtën e caktuar, qoftë për të tërhequr vërejtjen mbi paqëndrueshmërinë e trajtës së tillë.

Sidoqoftë, të dalët në dritë e **fjalorëve të fjalëve ndërkombëtare**, tregon për pjekurinë e zhvillimit të gjuhës dhe të gjuhësisë sonë për të hapur e për të kapur edhe shtigje të reja drejt kompletimit, karakteristikë kjo e çdo gjuhe të zhvilluar dhe të

përpunuar. Natyrisht edhe për ndërmarrje të tilla mund të jepen vërejtje, qoftë nga ana teorike, qoftë nga ajo praktike, vërejtje të nevojshme dhe të natyrshme këto që shtrohen para çdo pune fillestare, siç është b.f. vetë titullimi "fjalë e huaj" e krijuar mbase nën ndikimin e serbishtes "strana reč" ashtu si edhe fjala "shprehje" nga "naziv", rreth qëndrueshmërisë së të cilave jo pa të drejtë shprehet rezervë.

3) Fjalorët terminologjikë të fushës ekonomike të dr. Hajrullah Goranit

Është cekur me të drejtë në fillim të këtij punimi se pikërisht janë shkencat ekonomike ato, të cilave u takon interesimi i posaçëm rreth emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, përkatësisht rreth sigurimit a konstatimit të kuadrit të caktuar sipas vendeve të punës te çdo institucioni a ndërmarrjeje prodhuese, shërbyese a të përzier. Kështu që edhe te Fjalorët e dr. Hajrullah Goranit çështja e emërtimeve të profesioneve nuk mbetet e pahetuar. Ky konstatim vërtetohet konkretisht nga lënda e regjistruar te këta fjalorë: *Fjalor i termave dhe i shprehjeve ekonomike serbokroatisht-shqip*, Prishtinë 1985 dhe *Fjalor i termave dhe i shprehjeve ekonomike shqip - serbokroatisht*, Prishtinë 1986.

Në fjalorët e H. Goranit hetohet animi drejt përkrahjes së trajtave me formantet prapashtesore të shqipes, kundrejt trajtave sinonimike të huazuara si p.sh.: depozitues /depozitar, anketues /anketar, ekspozues / eksponent, falsifikues / falsifikator etj. Bie në sy edhe ndonjë neologjizëm i përvetësuar si: gatimtar për praktikant, gostar për hotelist, shembuj këta që nuk i ndeshim të regjistruar në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980).

Mjaft shembuj të përfshirë në këtë burim pasqyrojnë realitetin gjuhësor te ne lidhur me përdorimin e emërtimeve të caktuara si barasvlerës, ndaj përgjegjësve të serbokroatishtes, prirje kjo e vërejtshme që shtron nevojën për të trajtuar çështjet e caktuara edhe nga kjo nënfushë semantike. Prandaj nga ky pikëvështrim lënda e paraqitur te këta fjalorë ka rëndësi të posaçme.

Ja disa shembuj sinonimikë: *besorës kreditor, saktësues vërtetues, realizues sendërtues, peshues kandarxhi, përvetësues uzurpator, ndërmjetësues sekser, shpërdorues abuzues, bisedues negociator, detyrës debitor, lëshues trasant, harxhues konsumator, riblerës matrapaz, kritikues kritizer(!), metalgdhendës(!) tornitor, kambialnënshkrues indisator* etj.

Në veprën e H. Goranit i ndeshim të diferencuara kuptimet e fjalëve sinonimike: **ofertues** serb. ponudilac, ndaj **ofrues** serb. nudilac. Aty e ndeshim barasvlerësin **kopjues** për kopist serb. prepisivač **arkëtues** për inkasant, **planifikues** për planer, **saktësues** (vërtetues) për proverilac etj.

Nga fjalorët e H. Goranit shihet, paksa, edhe karakteristika që vjen nga ndryshimi i sistemeve të caktuara ekonomike e shoqërore si dhe përpjekja e autorit për të harmonizuar sadopak dallimet e tilla në terminologji. Po e cek emërtimin **përgjegjës prodhimi** serb. upravnik proizvodnje. Siç dihet te ne praktikohet kalkëzimi **drejtues prodhimi** (serb. upravnik proizvodnje), por pasi që në Shqipëri përdorej më tepër termi **përgjegjës**, ashtu rekomandon edhe autori. Krahaso barasvlerësit: përgjegjës –

serb.. odgovorni (zaduzheni; drejtues serb, upravnik.

4) Nga Fjalori komparativ i termave ushtarakë (1982)

Në "Fjalorin komparativ të termave ushtarake", Beograd 1982. ndër 15.000 terma nga fusha e ushtrisë që janë dhënë në gjuhën serbokroate paralele edhe në gjuhë të tjera: maqedonisht, sllovenisht, shqip e hungarisht, jepen edhe emërtimet e njerëzve sipas gradave e profesioneve të caktuara më të spikatura që përdoren në ushtri a lidhur me ushtrinë.

Pasi kemi të bëjmë pak a shumë me një fushë specifike, ma merr mendja se ashtu si në çdo fushë tjetër edhe më shumë te ne dalin çështje që kemi nevojë t'i mësojmë dhe njëherësh t'i harmonizojmë.

Më poshtë po i cek disa emërtime, të cilat del e nevojshme të sqarohen në trajtesa të veçanta. Së pari, po e përmend fjalët *desetar* dhe *razvodnik* të serbokroatishtes që në shqipe aty kanë barasvlerësin e shënuar **tetar**. Gjithashtu edhe emërtimet *pomoqnik komandanta* dhe *pomoqnik komandira* në shqipe kanë barasvlerësin **ndihmës-komandant**. Edhe *dezhurni* dhe *redar* në shqipe e kanë të shënuar barasvlerësin: **kujdestar**. Të diskutueshme dalin edhe trajta: *kadrovik*, *bombagjues*, *skiator*, *mariner*, *sinoptist*, *bujtinësigurues*, *udhëheqës (prijës) i qenit*, *kryeshef* etj.

Rreth cakut të kuptimeve leksikore mund të diskutohen edhe emërtimet e qëndrueshme jo vetëm të trajtave: *tetar*, *kapter*, *rreshter*, *aspirant*, *toger*, *kapiten*, *major*, *kolonel*, *gjeneral*, *admiral* - por edhe emërtimet e tjera si *oficer*, *ushtar*, *luftëtar*, *snajperist*, *dispeçer*, *gardist*, *shifrant*, *tankist*, *zhytës*, *infirmier*, *ushtar-obligues*, *ngasës prijes*, *pranues-përcjellës i aeroplanave*, *korrier* etj.

Sa për kërshtëri po cek rastin e "profesionit" **korrier** që në jetën civile jemi mësuar të dëgjojmë për konceptet b.f.: *korrier i shkollës*, *korrier i ndërmarrjes*, *korrier i letrave* etj, kurse nga jeta ushtarake, siç del i shënuar në Fjalorin në fjalë, dalin emërtimet e profilizuara si p.sh.: *korrier i fshehtë*, *korrier i rregullt*, *korrier thirrës*, *korrier kalorës*, *korrier këmbësor*, *korrier skitar*, *korrier i kuvertës*, *korrier i jashtëzakonshëm ...etj.* etj.

Pa mëdyshje termat e përdorur (të përkthyer) në këtë burim komparativ, edhe pse më tepër kanë të bëjnë me terma teorikë (jo realë) për shqipen, sidomos te ne, por gjithsesi kjo punë mund të vlerësohen si kontribut edhe për pasurimin e gjuhës shqipe me fjalë e shprehje terminologjike edhe të kësaj fushe, siç është jeta ushtarake.

Natyrisht ka vend për diskutime të përgjithshëm, por edhe për çështje të veçanta terminologjike edhe mbi këtë fushë.

5. Nga Fjalori frëngjisht - shqip i Murat Bejtës

Në Fjalorin frëngjisht - shqip të M. Bejtës, Prishtinë (1985) ndeshim disa emërtime njerëzish që janë ose neologjizma ose fjalë pak të njohura në realitetin tonë gjuhësor si p.sh.: *shmagës*, *përdorës*, *sitës*, *praktikues*, *parafrazues*, *pingruës*, *pushkatues*, *zvetnues*; *frymëzënës*, *modelepunonjës* etj.

Mbase i ndikuar nga trajtat e gjuhë frënge në veprën e tij hasim edhe këto trajta emrash të njerëzve më -CI/EN si p.sh. aritmeticien (fr. arithmeticien) për aritmetikën, statisticien (fr. statisticien) për statistikën. Po rikujtojmë se në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* këtë trajtë shkrimore e kemi vetëm te emërtimi teoricien, trajtë kjo që sipas mendimit tim del e diskutueshme dhe si një rast i vetmuar aspak s'ka nevojë të përthith pas vetes shembuj të tjerë.

Janë karakteristike edhe emërtimet stoician (fr. stoicien), tragjedian (fr. tragédier), logjicient (fr. logicien). Rastet e tilla vërtet shtrajnë nevojën për zgjidhje më sistemore të rasteve të tilla, ngase nuk përkojnë me zgjidhjet që praktikohen në strukturën fjalëformuese formëzuese të gjuhës sonë letrare sot. Po cek edhe rastet dialekticist (fr. dialecticien) dhe klinicist (fr. clinicien), raste këto që në shqipe kanë si "yrnek" vetëm rastin elektricist dhe asnjë tjetër, prandaj sipas mendimit tim edhe rastet e tilla duhet të gjejnë zgjidhje të tjera sipas frymës së shqipes (dialektist, klinikan) e jo pikërisht kështu me c/ist, sipas formës italiane.

Në Fjalorin e M. Bejtës ndeshim një numër të konsiderueshëm të emërtimeve në shqyrtim me prapashtesën me origjinë turke -XHI, si p.sh: tullaxhi, bufexhi, kazanxhi, teneqexhi, sobaxhi, mushkaxhi etj. Këto raste tregojnë se autori është treguar disi dorëlibër ndaj formimeve të tilla, edhe pse dihet në gjuhën tonë letrare kjo prapashtesë nuk del e favorizuar. Në vend të saj qysh në etapat e mëparshme është vërejtur përdorimi i prapashtesës -TAR si b.f. tipi: tullëtar ose janë parapëlqyer farkëtimet me kompozim si b.f. tipi: tullëpunues.

Gjithsesi edhe materiali i përfshirë në këtë burim zgjon interes dhe meriton të konsultohet lidhur me formëzimin a zgjidhjen e çështjeve të caktuara të lëndës në shqyrtim, edhe pse jo gjithçka duhet parapëlqyer pa rezervë nga ky burim.

6) Nga Fjalori i shqipes së sotme (1984)

Edhe pse prej viti 1980 deri në vitin 1984, kur në Tiranë u botua: "Fjalori i shqipes së sotme" është një kohë relativisht e shkurtër, megjithatë nga lënda që konsultuam nga ky burim, për temën që po trajtohet këtu, mund të jepen konstatimet si vijon:

1. Vazhdon përdorimi dhe favorizimi i mënyrave dhe trajtave formëzuese e fjalëformuese si në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980), por del i regjistruar edhe ndonjë emërtim i ri. Ndeshen këtu këto emërtime më -TAR që nuk ishin të regjistruara në burimin e mëparshëm krahasues: ndriçimtar, ngrohtar, qarrishtar(!), britar, dushkatar.

2. Përveç emrave më -TAR, ndeshim emra me S (-UE/S, -yes) si p.sh. edukues (edukator), mjekues (mjek) këshillues (këshilltar), garantues (garant); zbardhës, kërcyes (atlet).

3. Po përmend prirjen rreth krijimit të termave mbi bazë të pjesores, qoftë të ish-gegërishtes letrare (shkrues, përkthyes, mësues, mbajtës shitës etj., qoftë mbi bazë të letrarishtes së sotme si p.sh.: gjuajtës, ruajtës; lyrës, shkrirës, përpirës, shfryrës e

thyerës (thyes).

Mënyra e formimit të emrave të përbërë si pemëshitës, xhamprerës, jorganpunues, gëzofpunues etj., pothuaj del e konsoliduar dhe se numri i emërtimeve të tilla tregon rritje të konsiderueshme.

Gjithsesi edhe lënda e këtij burimi jep ndihmesë për konsolidimin e plotë të mënyrave të caktuara të fjalëformimit të gjuhës sonë dhe së këtejmi edhe për disa emërtime të njerëzve sipas profesionit.

c) NGA DORACAKËT ZYRTARË (NORMATIVË) MBI NOMENKLATURËN E PROFESIONEVE TE NE

Për të qenë paraqitja sa më e plotë e pamë të arsyeshme që në vazhdim të paraqesim ndonjë veçori të emërtimeve në shqyrtim nga doracakët përkatës të nomenklaturës së emërtimeve të njerëzve sipas profesionit të botuar te ne në gjuhën shqipe, dokumente këto "normative" e "zyrtare", ndonëse jo të përkryera dhe jo pa të meta, që ishin në përdorim në administratën tonë dhe që shërbenin e mund të shërbejnë si mostër nga nevoja për të shënuar emërtimet e caktuara sipas nevojave statistikore e të tjera edhe sot e gjithë ditën, për deri sa të dalin manualët e rinj.

1. Në vitin 1969 nga Byroja Federative për Punë të Punësisë u botua "Nomenklatura e profesioneve" në një "Udhëzim" për plotësimin e nevojave për "punëtorë, praktikantë e nxënës" në të cilin në versionin në gjuhën shqipe janë shënuar 910 profesione të profilizuara.

Në këtë burim shumica e emërtimeve mbi bazë të temave foljore dalin me prapashtesën -ONJ/Ë/S si thërmonjës, prodhonjës, fermentonjës, vajpunonjës etj, por nuk mungojnë as emërtimet më -UE/S si p.sh.: pastrues e pastruese, frenues, përçues e ndonjë tjetër. Si trajta të diskutueshme dalin emërtimi **parapunëtor** për **predradnik** të serbokroatishtes (një kalkëzim semantikisht i paqëlluar) si dhe emërtimi togfjalësh: **rojtës i udhëve** për **cestar** si dhe të emërtimeve të tjera si: **grirës** (metalesh) për **rendisaç**, **përçues cilindri**(!), për **vozaç** (vozaç valjka) etj. Paqëndrueshmëria e emërtimeve të tilla del e hetuar nga "përkthyesit" më vonë, prandaj në burimet e tjera dalin trajtat të korigjuara, sigurisht më të qëndrueshme.

2. Në vitin 1972 Enti Krahinor për Inkuadrim (Prishtinë) në doracakun "Paraqitja e nevojave për punëtorë" botoi një regjistër të nomenklaturës së profesioneve të profilizuara, ku janë përfshirë 962 emërtime.

Sa i përket drejtshkrimit përgjithësisht në krahasim me tekstin në doracakun nga viti 1969 shihet njëfarë përparimi, megjithatë edhe ky përcillet me mjaft lajthitje, ngase shihet një shpërputhje me normën, jo vetëm sa i përket drejtshkrimit, por sa i përket vërtetësisë logjike. Aty janë bërë shkelje të rënda semantike. Ç`është e vërteta, meqenëse një shumicë emërtimelesh pasi që nuk përkonin praktikisht me realitetin tonë, aty dilnin vetëm sa për qëllime përkthimi, pra, vetëm si barasvlerës të supozuar

në letër, prandaj përkthyesi bie pre e lehte e anës formale. Kështu që si të themi sa për sy e faqe edhe në instancat më të larta të "vetqeverisjes" plotësohej formaliteti që edhe emërtimet në "shqipe" të bëjnë pjesë a të qëndrojnë, si me thënë, barabar si një "instrument unik për tërë vendin (Jugosllavinë)".

Pra pasi që lënda dilte aq e gjerë dhe përkthyesi nuk mund t'i njihte të gjitha ato nënfusha të caktuara të veprimtarive ekonomike etj., u bënë lajthitje mjaft të rënda. Madje, sipas këtij dokumenti del se në atë kohë nuk do të jetë bërë përpjekje që të harmonizohen së paku ato trajta barasvlerëse që njiheshin a ishin në përdorim e sipër, mbase kishte edhe ndonjë arsye tjetër. Sidoqoftë, teksti në shqipe doli i hartuar jo si duhet.

Në versionin shqip të gjithë emrat si emërtime të profesioneve të profilizuara dalin të regjistruar në trajtën e shquar, si p.sh. portiri, kryesi, shkririsi, ziersi, frymësi, ngjyrosësi, formeri i gypave dhe i sheshirëve (!), kalinci (fisnikëruesi i çelikut), si dhe oxhakqari, drektori e gjelltori e ndonjë tjetër.

Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm një shumicë rastesh janë përkthim kuturu dhe si të tilla u paraqitën si mish i huaj për gjuhën tonë, prandaj në burimet e tjera me të drejtë u flaën tej, nuk patën vend, edhe pse në mbështetje të dokumentit të tillë zyrtar si "*instrument unik për tërë vendin*" aty-këtu mund të jenë reflektuar në ndonjë organizatë punonjëse a institucion nga ndonjë përkthyes a nëpunës i papërvojë.

3. Enti Federativ i Statistikës (Beograd) në vitin 1981 botoi doracakun: "Klasifikimi standard unik i profesioneve", në të cilin janë përfshirë pothuajse të gjitha emërtimet më të përdorura (përfaqësuese) në Jugosllavi.

Në këtë dokument, në versionin në gjuhën shqipe, shihet njëfarë stabilizimi i trajtave drejtshkrimore, madje formëzuese e fjalëformuese, megjithatë mund të bëhet ndonjë vërejtje për raste të veçanta. Aty ndeshim trajtën **veglar** në vend **vegëltar**, **tertor** në vend **terës** a **tharës**, **magazinues** (sinonim për magazinier), **paratrajner** për **kryetrajner** e ndonjë tjetër, por në përgjithësi mund të thuhet se nuk janë bërë shkelje të rënda.

Zgjojnë kërshërinë dhe interes trajtat si **magazinues** që u cek më sipër, por edhe rastet: kripësues, përgjegjës shtëpiak, metalgdhendës, zdrukthues, shminkëvënës e ndonjë tjetër.

4. Aty nga fillimi i viteve '80 Bashkësia Krahinore për Punësim e Kosovës botoi doracakun "Nevojat për kuadro", në të cilin janë shënuar 1398 emërtime profesionale të profilizuara (të shifruara), shembuj këta që shërbejnë si model se si duhen shënuar në rubrikat e caktuara të formularëve përkatës "*nevojat*" e *organizatave punonjëse për kuadro, sipas shkallëzimeve a sipas profileve të profesioneve: profesionet e profilit të ngushtë, profesionet e profilit të gjerë, profesionet e profilit "teknik" e të ngjashëm, profesionet e profilit "inxhinier" e të ngjashëm, profesionet e profilit "inxhinier i diplomuar" e të ngjashëm si dhe profesionet e profilit "magjistër"*.

Versionin në gjuhën shqipe e përshkruan një numër i konsiderueshëm emërtimeve të diskutueshme si p.sh.: **flotonjës** (floter), shkrinjës a shkrinjëtor (shkrirës), grinjës (grirës), përgatitor (përgatitës), ballsor (fasader), finiar (finjëtar), agjuster

(axhustator), hekurues (hekurosës), kurdistar (kurdisës), montier (montues), motorik anijesh (motorrist), sprovues (ekzaminues), mondene (modiste), pedikir (pedikurues), portir (portier), dokumentalist (dokumentist), udheheqës i lokomotivës më avull (drejtues i lokomotivës me avull), prehës (mprehës i veglave), formëtar (formëzues a trajtësues) etj.

Vërtet, trajtat e mësipërme tregojnë se përkthyesit e caktuar nuk i njihnin barasvlerësit adekuat në shqipe, që, së paku, në rrethe të caktuara atëherë ndesheshin, si me thënë, në përdorim normal. Te shembujt e mësipërm ilustrues, në kllapa, janë shënuar trajtat e parapëlqyera barasvlerëse, të cilat, gjithsesi, janë më të drejta se të parat.

5. Edhe në burime të tjera të mëvonshme në organizata të punës së bashkuar, sidomos në "Librat e kategorizimit", përkatësisht në "Sistematizimet e punëve dhe të detyrave", siç qubeshin te ne, dalin mjaft çështje të diskutueshme rreth emërimit të njerëzve sipas profesionit. Sa për ilustrim po cek këtu doracakun e shaptilografuar të BVI-së Komunale për Punësim - Prishtinë me titull "*Nevojat vjetore për punëtorë dhe plani i punësimit për vitin 1985*", ku janë shënuar afro 250 emërtime profesionale. Ndër to si emërtime të diskutueshme a të paqëndrueshme po cekim vetëm këta shembuj: sharrgji (sharrëtar), daktilograf (daktilografist), bravar (mekanik axhustimi), presar (presist), montues i stabilimenteve për ngrohje (montues i pajisjeve a të instalimeve për ngrohje), elektrikist reparti (elektricitist i makinave elektromotorike a elektrikist i makinave repulsore), magazioner (magazinionier), xhampres (xhamprerës), fotografist (fotograf), ripunëtor automekanik(!) (kryepunëtor automekanik), ekonomist financist (ekonomist financier), instalues uji a ujinjalues (instalues ujësjellësi), muzicant (muziktar a muzikant). elektronist (elektronikan) etj.

Gjithsesi trajtat e sipërcekura lypset vlerësuar, pasi që ka raste që edhe ato që janë shënuar në kllapa si raste të favorizuara, mund të jenë të diskutueshme, pasi që ende nuk i ndeshim të sanksionuara a të shënuara në tekstet tona normative të gjuhës letrare.

P ë r m b y l l j e

Periudha fill pas Luftës II Botërore e deri në ditët e sotme karakterizohet nga disa veçori, të cilat janë të vërejtshme edhe lidhur me emërtimet e njerëzve sipas profesionit. Lënda rreth emërtimeve të njerëzve sipas profesionit mund të ndahet në dy etapa:

- 1) Etapa e konsolidimit dhe
- 2) Etapa e normëzimit.

Çështje e vërteta, secila prej këtyre etapave karakterizohet nga faza të caktuara dhe të gjitha këto mund të përmbliidhen në këto dy pika:

1. Emërtimi i njerëzve sipas profesionit, duke bërë pjesë në kuadër të leksikut të përgjithshëm të shqipes gjeti përfshirje në gjirin e çështjeve morfologjike (gramatikore) e së kendejmi edhe në kuadër të gjuhës letrare. Në fazën fill pas "Çlirimit" në Shqipëri gjuha letrare përgjithësisht mbartte pakashumë po ato

karakteristika që kishte zhvillimi i gjuhës letrare në periudhën e mëparshme, por, siç u tha, me favorizim të trajtave të toskërishtes, andaj edhe tek emërtimet e njerëzve sipas profesioneve mund të thuhet se në fazën e parë të etapës së parë në vitet pas Luftës II Botërore më tepër keshin të bënim me regjistrimin e emërtimeve përkatëse, duke respektuar gjithsesi traditën e përdorimit me qëllim konsolidimi, edhe pse tashti çështja e emërtimeve (e leksikut dhe termave të caktuar përgjithësisht) nuk mbetet vetëm çështje individësh, por çështje shtetërore e shoqërore, çështje e komisioneve të përbërë nga studiues kompetentë. Edhe te Fjalori i H. Bariqit në ndonjë rast edhe te Fjalori i S. Mannit më tepër kemi të bëjmë me rëgjistrim trajtash si ekuivalentë pa përgjegjësin e caktuar të gjuhës së huaj, ndërsa te Fjalori i S. Dobroshit dhe Fjalori rusisht - shqip (1954) (grup autorësh) shihet animi i qartë drejt prirjes a favorizimit të trajtës së caktuar drejtshkrimore mbi bazë të variantit të caktuar letrar (dialektor), i cili me ndonjë modifikim do të merret edhe si bazë e gjuhës letrare (zyrtare) të kohës. Siç dihet kur është fjala tek emërtimet mbi bazë të temës fjalëformuese foljore në Fjalorin e S. Dobroshit mbizotëronin trajtat e dialektit gegë, ndërsa te Fjalori rusisht - shqip (1954) trajtat e dialektit toskë.

Pas botimit të Fjalorit të gjuhës shqipe (1954) fillon fazë e re e konsolidimit të ashtuquajturës "**gjuhë të sotme letrare**", edhe pse kryesisht mbi bazë të ish-shqipes letrare në nbështetje të toskërishtes, kjo shihet në konsolidimin jo vetëm të drejtshkrimit, por edhe të drejtëfjalëformimit a formëzimit edhe të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, ndonëse mjaft çështje drejtshkrimore, formëzuese dhe fjalëformuese ende mbesin të hapura.

2. Me botimin e *Rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe (projekt) 1967* dhe me miratimin dhe zotimin për zbatimin e tyre në *Konsultën gjuhësore të Prishtinës (1968)*, të cilat u kurorëzuan në *Kongresin Drejtshkrimit (1972)*, vërtet fillon, jo vetëm një fazë e re, por fillon një etapë e re e gjuhës letrare, d.m.th. fillon etapa e quajtur "**shqipe letrare kombëtare e njësuar**". Fazë tjetër e kësaj etape shënohet me botimin e Fjalorit serbokroatisht -shqip (1974) e sidomos pas daljes në dritë të "Fjalorit drejtshkrimor të gjuhës shqipe" (1976), por normëzimi si përkrah cilësia ashtu edhe për nga sasia do të shenojë ngritje e nivelizim të kënaqshëm vetëm pas botimit të "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe" (1980), i cili u pasua edhe me botimin e "Fjalorit shqip - serbokroatisht" (1981). Që të dy këta fjalorë, sidomos te ne, të dy së bashku, ndikuan në hartimin dhe botimin e fjalorëve të tjerë, qoftë me karakter të përgjithshëm, qoftë edhe më tepër me karakter ose me lëndë paksa më të specifikuar sipas fushave e degëve të caktuara të profilizuara.

Nga lënda e përfshirë në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980* dhe *Fjalori shqip-serbokroatisht, Prishtinë 1981*, fitohet pasqyrë sadokudo e plotë e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe, sidomos kur është fjala për strukturën fjalëformuese. Në këtë kuadër bie në sy prirja e krijimeve të reja sipas modeleve prodhuese dhe aktive që kishin mbështetje edhe në gjuhën e traditës së folur, por edhe në traditën e shkruar, sidomos në stilin administrativo-juridik. Prirja e tillë frymon edhe në burimet e tjera që pasojnë pas tyre. Dhe vërtet, në shenjë të sendërtimit të mëtejshëm të shqipes letrare e në kontekst të përsosjes së mëtejshme të normës letrare edhe nga lëmi i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në fjalorët

e caktuar të ndarë sipas degëve e specializimeve të caktuara u paraqit lëndë me vlerë. Ç'është e drejta, megjithëse, nga fusha e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit kanë mbetur jo pak çështje të hapura, ngase pikërisht leksiku është pjesa më e lëvizshme e gjuhës, shikuar në përgjithësi gjuha jonë letrare kombëtare del e aftë dhe me mundësi reale për të zgjidhur të gjitha çështjet problemore që sfidojnë para saj edhe nga lëmi i emërtimeve në shqyrtim. Në kohën tonë, jo vetëm se është ravijëzuar mënyra e huazimeve dhe të përvetësimeve të nevojshme në trajtën e caktuar nga gjuhët e huaja vetëm për raste të caktuara të domosdoshme, por është ravijëzuar mjaft qartë sistemi i formimeve të emrave të vepruesit sipas modeleve tashmë prodhimore dhe aktive e frytdhënëse, sidomos me burim vendës, qoftë me prejardhje me prapashtesim, qoftë si emra vepruesi me kompozim. Ekzistojnë të gjitha parakushtet, që emërtimet në shqyrtim në **gjuhën tonë të njësuar standarde** në proces përkryerjeje të marrin ravijëzim edhe më të konsoliduar.

* * *

Nga shtegtimi që bëme në periudha, etapa e faza, që nga kohët më të hershme e deri në ditët tona të shkrimit të shqipes pamë mjaft qartë se emërtimet e njerëzve sipas profesionit a sipas veprimtarisë shoqëronin në çdo hap ligjërimin tonë shqip, përkatësisht shoqëronin bashkësinë tonë folëse përherë, duke e paraqitur paksa pasqyrën e kësaj shoqërie në rrethana të caktuara historike se si shkonte në hapin e vet a krahas gjuhëve dhe popujve të tjerë.

Pamë gjithashtu se bashkë me problemet edhe zgjidhjet e caktuara që ofroheshin nëpër ato shtigje historike, kur gjuha jonë paraqitej gjithnjë më e mëkëmbur, më e zhvilluar, sidomos në fazat e konsolidimit shoqëror e shtetëror, letrarishtja funksiononte më me sukses dhe në të gjitha stilet funksionale, që tani pretendojmë të jetë një gjuhë sa më standarde e barabartë me sishoqet e saja të zhvilluara me modele fjalëformuese e formëzuese të ravijëzuara qartë.

Kreu III

EMËRZIMI I EMËRTIMEVE TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT NË GJUHËN SHQIPE

Në kuadër të strukturës së përgjithshme të fjalëformimit në gjuhën shqipe, si njësi themelore e mëvetësishme leksiko-gramatikore, në nënsistemin e formimit të emrit, emërtimet e njerëzve sipas profesionit zënë vend të rëndësishëm, duke u karakterizuar si një kategori a klasë më vete "shumë e pasur"⁶⁵. Ç`është e vërteta, shikuar më tepër nga aspekti i formëzimit d.m.th ai kuptimor, emërtimet e njerëzve sipas profesionit si "emra të përgjithshëm të personave" përfshihen në një klase me emrat e personave të emërtuar sipas një tipari të caktuar që i karakterizon, edhe pse dihet se çdo veprim a veprimtari e njeriut nuk mund të cilësohet si një profesion dhe se çdo tipar nuk mund të paraqesë njeriun sipas profesionit. Sigurisht tipari i profesionit do të përcaktohet sipas funksionit a punës që kryen individi i caktuar në fushën e caktuar të prodhimit, të shkencës ose të veprimtarisë a të doktrinës që ndjek. Në këtë punim emrat e njerëzve sipas profesionit, që gjithsesi përfshihen në kuadër të emrave të vepruesit (nomina agentis)⁶⁶, për nga formëzimi, duke pasur parasysh komponentët e jashtëm (të përgjithshëm) dhe ata të brendshëm (të veçantë), do të trajtohen nga këto tri këndvështrime, në tre nënkrerë:

Së pari, do të vështrohen dy rrugët kryesore të formëzimit të tyre që janë: 1. si fjalë krijime autoktone (vendëse) dhe 2. si fjalë të huazuara, d.m.th. me burim të huaj.

Së dyti, si krijimet autoktone ashtu edhe emrat e huazuara si terma të kësaj natyre do të përtrajtohen në gjithsej gjashtë grupe, mbi bazë të tipave kuptimor të tyre, sipas nënfushave të caktuara semantike.

Së treti, të gjitha emërtimet sipas tipave kuptimorë të sipërcekur, qofshin këto krijime autoktone, qofshin fjalë të huazuara do të shqyrtohen nga aspekti strukturor fjalëformues dhe këtë rast në qendër të vëmendjes nuk do të jenë vetëm emërtimet njëfjalësha (emra të parmë, të prejardhur, me përngjitje plus prapashtesim ose ata të përbërë), por paksa edhe emërtimet jo njëfjalësha (emërtimet me dyfishim a gërshetim profesionale si dhe

⁶⁵ Përveç punimeve të cituara këtu të V. Milkanit dhe A. Vehbiut, shih edhe punimin e A. Kostallarit: "Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese" të botuar në "Studime mbi leksikon dhe mbi forminin e fjalëve" I, Tiranë 1972 f. 96.

⁶⁶ Shih edhe te L. Mulaku, Formimi i emrave me prapashtesën -SHMËRI, Jehona 5/84, Shkup 1984, f. 53.

emërtimet togfjalësha).

A. RRUGËT E FORMËZIMIT TË EMËRTIMEVE TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT

Sikurse në gjuhë të tjera edhe në gjuhën tonë procesi i formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit është bërë dhe bëhet në dy rrugë: së pari sipas krijimeve vendëse dhe së dyti, mbi bazë të huazimit nga gjuhët e tjera.

Që të dyja këto rrugë, d.m.th. edhe fjalët e krijuara brenda gjuhës me mjetet e brumit autokton, ashtu edhe emërtimet e huazuara nga gjuhët e tjera, në shikim të parë mund të duken të thjeshta, por në realitet këto dy rrugë paraqiten mjaft të ndërlikuara. Ka raste kur elementet e brendshme të gjuhës formëzohen nën ndikimin e elementeve të gjuhëve të huaja, nga njëra anë, por ka raste, nga ana tjetër, kur elementet e gjuhëve të huaja me rastin e interferencës a të përvetësimit nën ndikimin e elementeve të brendshme a të sistemit të gjuhës marrëse, pësojnë ndryshime të natyrës morfologjike, qoftë shqiptimore, qoftë drejtshkrimore.

Rreth këtyre proceseve të ndërlikuara dhe të ndërlidhura, të cilat në gjuhën tonë nuk di sa janë trajtuar në hollësi më përpara, në vazhdim do të paraqitet ndonjë konstatim me interes.

1. Emërtimet autoktone

Emërtime autoktone, siç dihet, quajmë ata emra të parmë (të pamotivueshëm) dhe ata emra jo të parmë (të motivueshëm)⁶⁷ të krijuar:

- 1) me elemente origjinale vendëse (me autoktoni të qartë) dhe
- 2) me elemente plotësisht të përvetësuara nga gjuha jonë, edhe pse etimologjikisht origjina e huaj e elementeve të tilla mund të jetë e pakontestueshme ose e diskutueshme.

a) Krijime me autoktoni të qartë

Siç e pamë në kreun e mëparshëm të këtij punimi, si krijime autoktone, në cilësinë e emrit të njeriut sipas profesionit a të veprimtarisë (mjeshtërisë), hasim që në filltet e para të formëzimit historik të popullit dhe të gjuhës sonë, por që edhe më në thellësi kohore dëshmohej rrënjëzimi i tyre, që aksiomativisht del i nënkuptueshëm. Ky fakt dokumentohet nga disa toponime a emërve që vijnë nga lashtësia, siç u përmendën në kreun e mëparshëm (rikujto: dardan, kudhës, lopës, shpatar etj.). Që në fillimet e shkrimit të shqipes ndeshim emrave të parmë në cilësinë e njeriut sipas profesionit a veprimtarisë si: bari, bujk, plak etj. ndeshim gjithashtu edhe emra të prejardhur prejfoljorë e prejemërorë me prapashtesim që kanë shtrirje të gjerë edhe në kohën e sotme, si p.sh.: *zotënues, shkrues, urdhënues, shpëtues, krijues, kërkues,*

⁶⁷ Shih burimet: Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë (1976) dhe "Gjuha letrare shqipe për të gjithë", Tiranë 1976 f. 197.

*kullotës, shitës, këshillës; uratës, përrallës, gjykatës; gjahtar, ushtëtar, derëtar, furrëtar, vjershëtar, gjuhëtar, landëtar, kalorës etj.*⁶⁸

Është e vërtetë se krijimet e mësipërme duken si të ishin krijime të shqipes së sotme, ndonëse janë fjalë të farkëtuara a të ndeshura si të tilla në dokumente para 3-4 shekujsh.

Në shqipen standarde të kohës sonë farkëtimi i emrave me autoktoni të qartë mbetet mënyra mbizotëruese favorizuese e formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit. Gjithashtu procesi i tillë mbetet të ndiqet dhe të favorizohet edhe në të ardhmen, prandaj struktura e tillë fjalëformuese del e nevojshme të trajtohet më në përhollësi dhe në përthellësi seç është bërë deri tashti. Një përpjekje e tillë është provuar të bëhet në nënkreun e tretë të këtij punimi.

b) Krijimet a formëzimet me elemente plotësisht të përvetësuar

Shikuar nga gjendja e sotme emërtimet: bujar, peshkëtar, bajraktar, oborrtar, mjeshtër, rrogëtar etj.⁶⁹ në ndërgjegjën e çdo shqipfolësi dalin si krijime autoktone, edhe pse etimologjikisht fjalë-temat e tilla mund të cilësohen si huazime hibride nga ndonjë etimon i gjuhës së huaj, krahaso tipat si: komandar, bajraktar; sharraxhi, tezgjahist/e etj.

Meqenëse huazimet e tilla janë të vjetra dhe si të tilla fjala dhe forma e fjalëve në shqyrtim plotësisht është përvetësuar në gjuhën tonë, jo vetëm sa i përket fjalës si temë fjalëformuese, por edhe sa u përket formanteve prapashtesore si -AR, -TAR, -IST, atëherë mendohet dhe gjykohet se fjalët e tilla për hir të asimilimit relativisht të hershëm formësues e semantik duhet të konsiderohen si fjalë të fondit autokton aktiv të shqipes letrare.

Krijime autoktone të gjuhës sonë do të quhen edhe ata emra që janë krijuar ose janë në përdorim brenda gjuhës sonë mbi fjalën temëfjalëformuese, por me prapashtesën e caktuar të burimit të huaj, e cila është përvetësuar a është bërë si e "shtëpisë" në rastet e caktuara. Shembuj konkretë emrash të këtij nëntipi do të kemi rast të japim në vazhdim të punimit, kur të bëhet fjalë për emrat e formuar me prapashtesat e caktuara speciale. Këtu sa për ilustrim do të përmend ndonjë shembull, së pari, me prapashtesën me origjinë turke -XHI dhe së dyti, me prapashtesën -IST të origjinës neolatine.

- a. Ja disa shembuj formimesh autoktone me prapashtesën turke
-XHI: *hekurxhi, sharraxhi, djathaxhi, kosaxhi etj.*

⁶⁸ Shembujt në origjinal janë dhënë në kreun e mëparshëm të këtij punimi.

⁶⁹

Shih për këtë fjalorët e "fjalëve të huaja" (ndërkombëtare) të cekur në kreun e mëparshëm të këtij punimi si dhe veprën e prof. Sh. Demirajt "Gjuha shqipe dhe historia e saj" Prishtinë 1989 f. 113.

Siç u vërtetua në kreun e mëparshëm, emërtimet e tilla qiten krye në gjuhën tonë që në kohën para Rilindjes sonë Kombëtare, por që vazhduan edhe më vonë, por me një tempo shumimi gjithnjë e më të pakësuar, qoftë për arsye objektive, qoftë për arsye subjektive.

b. Emërtimet me prapashtesën -IST të kësaj kategorie emrash u takojnë etapave më të vona dhe ndonjëri emërtim me këtë formant i takon kohës sonë. Ja disa shembuj me prapashtesën -IST: moto-sharrist, gjuhësisht, shkollarist, shqipërist, nënflotist, tezgjahiste, hekurist, llamarinist, teorist etj.⁷⁰ Emërtimet më -IST, si krijime autoktone, në cilësinë e emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë si dukuri e kohës sonë, i ndeshim në nomenklaturat e caktuara të profesioneve a në emërtimet e njerëzve sipas përkatësisë partiake a të nënfushës semantike të emërtimit të njerëzve sipas doktrinës që ndjekin si p.sh. ballist, zogist, djathtist, majtist, enverist, pësëist, pëdëist etj.

Nuk është e tepërt të ceket këtu se emërtimet më -XHI si dhe ato më -IST në cilësinë e emrave të njerëzve sipas profesionit (mjeshtërisë), edhe pse janë krijime aktoktone, në gjuhën e sotme standarde, në stilin neutral, nuk duhet të konsiderohen trajta të normëzuara, atëherë kur në vend të tyre ekzistojnë barasvlerës të parapëlqyer, të cilët janë normëzuar në trajta të tjera shkrimore, si p.sh. në vend të trajtës hekurxhi a hekurist më drejt del trajta hekurtar ose hekurpunues (sipas rastit), në vend sharraxhi a sharrist më drejt sharrëtar a sharrues, në vend djathaxhi - djathtar, djathëshitës a djathëbërës, në vend gjuhësisht - gjuhëtar etj.

Lidhur me disa krijime të cilësuar si autoktone ma merr mendja se nevojiten sqarime plotësuese, si p.sh.: *e para*, si do të cilësohen huazimet a formëzimet e vjetra, të cilat si fjalë të huaja tashmë nuk e kanë të ruajtur asnjë gjurmë në ndjenjën gjuhësore në shqipe? dhe *e dyta*, si do të cilësohen krijimet e reja në mbështetje të foljeve më -O/j, të cilat (foljet) janë formuar mbi temat e fjalëve të huazuara, origjina e huaj e të cilave nuk kontestohet?

Përgjigjen do të përpiqem ta jap tash fill.

a) Sipas mendimit tim, b.f., emrat: *mbret*, *mjek*, *prift*, *sherbëtor*, *drejtor* e të ngjashme duhet të përfillen tashmë si emra vendës, edhe pse etimologjikisht mund të shpjegohen si huazime të vjetra. Krahaso *mbret* /lat. *imperator*, *prift* /lat. *preisbyter*, *mjek* /lat. *medicus*, *sherbëtor* /lat. *servi(ta)tore*⁷¹, *drejtor* /it. *direttore*⁷² etj.

Siç shihet nga shembujt në origjinal trajta shkrimore e shqiptimore në shqipe ka pësuar ndryshime aq të mëdha saqë mund të themi, se forma u është tjetërsuar, ngase nuk ruan sot për sot kurrfarë tipari të një fjalë të huaj, por ndjehet plotësisht si një

⁷⁰ Shembujt janë marrë nga punimet e cituara të V. Milkanit dhe të prof. Shaban Demirajt. Shëmbulli "teorist" është përmendur në artikullin e N. Veselajt "Rreth fjalës **teoricien** si rast i vetmuar", të botuar në gazetën "Rilindja", më 7. XII. 1985 f. 15.

⁷¹ Pos tjerash shih edhe te vepra e prof. B. Bokshi "Rreth formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes", Prishtinë. 1980 f. 202.

⁷² M. Ndreca, në Fjalorin e tij "të fjalëve dhe të shprehjeve të huaja" f. 169, fjalën **drejtor** e shënon si fjalë ndërkombëtare.

fjalë shqipe. Për rrënjëzimin e fjalëve të tilla flet edhe vetë fakti se fjala e tillë mund të shërbejë, siç ka shërbyer edhe shërben natyrshëm edhe sot si temë fjalëformuese për farkëtimin e një varg fjalësh të prejardhura, si p.sh. *mbret: mbretëroj, mbretëri, mbretërues, mbretërim; mjek: mjekoj, mjekësi, mjekësoj, mjekues, mjekësor* etj., të cilat si strukturë mund të mos kenë fare lidhje me zhvillimet e caktuara që mund të ketë origjinali në gjuhën fillestare, madje edhe në gjuhët pasardhëse neolatine e të tjera.

b) Në jetën e përditshme, pothuajse, normalisht dalin prej pjesorë si emra të vepruesit të tipit: komentues, bisedues, frezues, simpatizues etj. të krijuar nga tema përkatëse e foljeve: komentoj, bisedoj, frezuj, simpatizoj - më konkretisht nga pjesoret ose paskajoret e mirëfillta të këtyre foljeve: (me) komentue, (me) bisedue, (me) frezue, (me) simpatizue që janë trajta të ish-variantit letrar mbi bazë të gegërishtes. Unë mbështet supozimin se emrat e tillë janë krijime autoktone, edhe pse burimi i fjalëve a i temave fillestare fjalëformuese i takon shtresës së fjalës së huaj, pra fjalë-temat janë të huazuara. Kjo nuk kontestohet ngase të gjitha foljet që u morën më sipër si shembuj përfaqësues, kanë si mbështetje një temë a fjalë të huazuar të karakterit ndërkombëtar. Krahaso: koment (lat. *commento*) bisedë (sll. *beseda*), frezë (fr. *fraise*), simpati, me simpatizue (it. *simpatia, simpatizzare*). Nga këta emra që edhe në shqipe mund të shërbejnë si tema motivuese u përfatuan në gjuhën tonë foljet përkatëse më -O/j: komentoj (me komentue), bisedoj (me bisedue), frezuj (me frezue), simpatizoj (me simpatizue) e së këtejmi dolën emrat përkatës të vepruesit: komentues, bisedues, frezues, simpatizues. Prandaj emrat e tillë kurrsesi nuk mund të cilësohen si huazime të mirëfillta. Ç'është e vërteta, huazime të mirëfillta për të njëjtin koncept a me funksion sinonimik, mund të përfillen përgjegjësit përkatës sinonimikë që mund të dëgjohen aty-këtu edhe në jetën tonë të përditshme si p.sh.: **komentator** (komentues), **frezator** (frezues), **simpatizant** (simpatizues), mbase edhe **besednik** (bisedues)(!).

Në këtë kuadër çështje më vete paraqesin emrat foljorë të nëntipit montues, operues, incizues, konspirues, transkriptues etj., sepse kanë një shkallë më të largët abstraksioni kundrejt nëntipit të mësipërm, ngase në gjuhën tonë si mbështetje kanë vetëm foljen përkatëse më -O/j, prej nga janë përftuar, por nuk kanë ndonjë fjalë tjetër, nga e cila do të mund të motivohej folja e tërthorazi edhe emri prejfoljor: montoj montues, operoj operues, konspiroj konspirues, transkriptoj transkriptues. Prandaj formimet e tilla si emërtime profesionale mund të quhen huazime të pjesshme a hibride. Është e vërtetë se është huazuar folja e shqipes nga folja e gjuhës së huaj dhe në shqipe është bërë automatikisht modifikimi i drejtpërdrejtë i menjëhershëm duke u zëvendësuar prapashtesë-mbaresa e gjuhës së huaj me prapashtesën speciale të gjuhës shqipe -O/j e së këtejmi doli emërtimi a emri i vepruesit më -ue/s. Për ta parë më mirë këtë farë formëzimi të përftuar me rastin e huazimit mjafton të krahasojmë përgjegjësit e dy foljeve të sipërcekura: operoj (me operue) dhe montoj (me montue), në disa gjuhë:

1) (lat. *operaro*): fr. *operer*, it *operare*, angl. (to) *operate*, sp. *operar*, serb. *operirati*, *operisati*, shq. *operoj* (me *operue*);

2) (lat. mons!), fr. monter. it. montare, sp. montar, gjerm. montieren, serb. montirati, shq. montoj (me montue).

Nga shembujt e mësipërm shihet qartë se trajta e foljes së caktuar në shqipe ndryshon nga gjuhët e tjera vetëm sa i përket prapashtesës a mbaresës. Krahaso: fr. -ER, it. ARE, sp. -AR, gjerm. -IEREN, serb, -IRATI, -ISATI. shq. -O/J (-UE). Edhe prej këtyre shembujve del se emrat përkatës: operues, montues, bisedues, simpatizues e të ngjashëm janë krijime autoktone në mbështetje të foljes përkatëse të shqipes, e cila është huazim hibrid a huazim i modifikuar, kur kemi parasysh mbaresën a formantin fundor të foljes që ka origjinë vendëse. Edhe këtë rast do të quhej huazim i mirëfilltë jo trajta operues, por ajo **operator**, jo montues po **montator** etj. - trajta këto që edhe hasen si huazime të mirëfillta në jetën tonë të përditshme nganjëherë a herëpas-herë në rrethe të caktuara. Ç`është e vërteta, trajta operator mund të përfillet si një ndërkombëtarizëm, pasi që në këtë trajtë ndeshet edhe në gjuhë të tjera si p.sh.: (lat. operator): fr. operateur, it, operatore, angl. operator, sp. operador, serb. operator, e kështu me radhë, kurse fjala montator jo, kjo mund të cilësohet vetëm si një fjalë ndërkombëtare pa cilësinë e ndërkombëtarizmes.

Sigurisht kriteri se çka do të quhej emërtim autokton e çka emërtim i huazuar do të jetë edhe më i qartë pasi të analizohen edhe emërtimet si terma të huazuar, qoftë si fjalë ndërkombëtare, qoftë si ndërkombëtarizma.

2. Emërtimet si terma të huazuar a si fjalë ndërkombëtare⁷³

Emërtime të njerëzve sipas profesionit si terma të huazuar do të konsiderohen ata emra "që janë marrë prej një gjuhë tjetër dhe përdoren në gjuhën amtare" (FGJSSH f. 695). Për ndryshim nga emrat plotësisht të përvetësuar, siç u përmend në nëntitullin e mëparshëm, te emërtimet e huazuara gjurma e burimit të huaj nuk është e zhdukur, madje edhe ngjashmëria shkrimore e shqiptimore në disa raste nuk është e largët nga gjuha dhënëse dhe mund të jetë e diktueshme pa vështirësi. Dihet se fjalët e huazuara nuk përvetësohen njësoj. Ndodh që një fjalë e huaj të mos lëshojë rrënjë në gjuhë, ngase pushon nevoja për një fjalë të tillë ose ndodh që konceptin e caktuar e mbulon ndonjë fjalë tjetër më e përshtatshme a më e pranuar në rrethana të caktuara. Nga ana tjetër ndodh që ndonjë fjalë e huaj, sidomos ato me karakterit ndërkombëtar, të jenë të domosdoshme në stile të caktuara, pa të cilat mendimet a gjykimet nuk mund të shprehen qartë e me saktësinë e duhur.

Disa fjalë të huazuara ndodh të zëvendësohen me fjalë të brumit vendës, por ndodh edhe ndryshe që ndonjë huazim të zëvendësohet me një huazim tjetër nga një gjuhë

73

Rreth kundërvënies "fjalë e huaj" "fjalë ndërkombëtare" më hollësisht shih në artikullin "Rreth termit togfjalësh **fjalë e huaj** dhe **fjalë e huazuar**" të N. Veselajt të botuar në gazetën "Rilindja" të datës 13. I. 1990, f. 11.

tjetër. Kështu p.sh. fjala *regj* (nga lat. rex, regis - mbret) e përdorur nga Gj. Buzuku, por edhe më vonë nga individë të tjerë, nuk arriti të përgjithësohet në gjuhën tonë, as në gjuhën popullore as në gjuhën e shkruar, ngase ky nocion kryesisht ishte mbuluar me fjalën simotër sinonime *mbret*.

F. Bardhi përdori fjalën *strazhnik* (nga sll. strazhnik sinonim i fjalës strazhar), ngase ky nocion u shpreh plotësisht nga emrat gjegjës të shqipës: rojë, *rojtar*, ruajtës e ndonjë tjetër, trajta e tillë e huazuar doli plotësisht e panevojshme, prandaj edhe u flak nga përdorimi. Gj. Buzuku përdori edhe ndonjë huazim tjetër që sot nuk qëndron, si p.sh. **harami** për **kusar**. P. Bogdani përdori turqizmat **elç** për **lajmëtar**, **nazer** për **sundimtar**. Shembuj të tillë të kësaj natyre mund të hasim edhe tek autorë të tjerë. Në këtë kontekst po e përmend edhe rastin kur fjala me origjinë turke "zabit" u zëvendësua me fjalën tjetër me origjinë të huaj, por me karakter ndërkombëtarizmi "oficer", që u propozua në njerën nga seancat e Komisionit Letrare të Shkodrës (1917) si dhe termi "ehli ibre" me ndërkombëtarizmen "ekspert"⁷⁴.

Në etapa a faza të caktuara kohore, herë më shumë e herë më pak, bëhen huazime të fjalëve të huaja. Sigurisht çdo huazim bëhet nga nevoja që ndjen individ i caktuar për një fjalë të tillë, mirëpo sa është e qëndrueshme një ndërmarrje e tillë është çështje tjetër. Huazimet mbesin në gjuhën e caktuar vetëm nëse ato i pranon rrethi i caktuar gjuhësor, dhe shtrihen në bashkësinë folëse në stilin neutral ose në stilin e caktuar profesional. Fjalët e huazuara mund të jenë të fushave të ndryshme. Shikuar nga një prizëm më i gjerë të gjitha huazimet mund t'i merendojmë në dy grupe të mëdha (kufiri i të cilave nuk mund të ndahet prerazi):

- a) në huazime me cilësi të mirëfilltë ndërkombëtarizmi dhe
- b) huazime pa cilësi të mirëfilltë ndërkombëtarizmi.

a) Emërtime me cilësi ndërkombëtarizmi

Si emërtime me cilësi ndërkombëtarizmi konsiderohen termat "me prejardhje të njëjtë dhe me formë të ngjashme që ndeshen në shumë gjuhë të botës" (FGJSSH f. 1209), të cilat zakonisht nuk i përkasin "një grupi farefisnor". Shikuar nga ky formulim ndërkombëtarizëm quhet ajo fjalë që shtrihet pak a shumë në trajtë të ngjashme në të gjitha gjuhët a grupet e gjuhëve të njohura botërore, siç është b.f. grupi i gjuhëve gjermanike (më të njohura: anglishtja, gjermanishtja), grupi i gjuhëve romane (më të njohura: frëngjishtja, italishtja, spanjishtja), grupi i gjuhëve sllave (më të njohura, rusishtja, serbokroatishtja etj.), pastaj mund të ketë shtrirje edhe në gjuhë të tjera si në greqisht, turqisht, arabisht, persisht etj.

Si shembull i fjalës me cilësi ndërkombëtarizmi mund të shërbejë p.sh. emërtimi "shofer" - "punonjës i përgatitur që nget automobilin". Fjala **shofer** ka origjinë frënge, po me etimologji latine: calafacere. Ja si del ky term në gjuhë të ndryshme: fr. chauffeur, angl. chauffeur, gjerm. Schaufeur, sp. chofer, rus. shofjot, hol.

⁷⁴ Shih edhe te Sh. Krasniqi, në artikullin "Komisioni Letrare e Shkodrës" për Kongresin e Manastirit", gazeta "Fjala" nr. 9-10/89 f. 12.

shuafeur, serb. shofer, turq. soför, greq. (o) shofer, shq. shofer-i etj. Ndërkombëtarizëm është edhe fjala konduktor "punëtor që jep a kontrollon buletat në autobus, në tren etj." (M. Ndreca, Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, f. 399), trajtë kjo që ka origjinë të drejtpërdrejtë latine: conductor. Këtë fjalë-term në gjuhë të ndryshme e ndeshim kështu: fr. conducteur, it. conduttore, gjerm. Konduktor, angl. conductor, serbokr. konduktër, turq. kondüktör, shq. konduktor etj.

Vlen të theksohet fakti se në gjuhë të ndryshme, krahas ndërkombëtarizmës përkatëse përdoren sinonime fjalësh të ndryshme të cilat mund të zëvendësojnë fjalëtermin e caktuar, si p.sh. për fjalën *shofer* në serbokroatishte përdoret fjala vozaç, në gjerm. Fahrer, kurse për *konduktor* në gjuhën shqipe është i rekomandueshëm fjalëtermi *shoqërues* (autobusi, treni). Nga sa u cek mund të nxjerrim përfundimin se edhe ndërkombëtarizmat në gjuhë të ndryshme mund të kalojnë në shtresën pasive të leksikut, madje të konsiderohen si fjalë të huaja dhe si të tilla mund të nxirren jashtë përdorimit, përkatësisht të zëvendësohen me terma të tjerë. Zakonisht rastet e tilla në të shumten mbesin si lëndë rezerve a nuk konsiderohen të tepërta, ngase ndërkombëtarizmat e njohja e tyre në shumë raste paraqet *njeriun me kulturë*, prandaj përkundër faktit se në stile të caktuara, qoftë edhe në stilin zyrtar të rekomandohet sinonimi i burimit vendës, në stilin e përgjithshëm në raport me gjuhë të tjera ruhet edhe emërtimi ndërkombëtar, qoftë si rezervë në shenjë kulture, qoftë si nevojë e komunikimit më të lehtë. Në stile a situata të caktuara, pra sinonimet e tilla a njëri nga sinonimet gjithnjë kalon në pjesën rezervë, pra nuk zhduket.

Sidoqoftë, në gjuhën tonë si huazime të mirëfillta me tiparin e ndërkombëtarizmës do të cilësohen emërtimet si më poshtë: pilot, specialist, motorist, sociolog, traktorist, aeronaut, avokat, flautist, kardiolog, albanolog, muzikant, profesor, inxhinier, akademik, lektor, leksikolog, biolog, gjeograf, monark, teolog, dragoman, ministër, sekretar, metalurg, xhelat, berber, bojaxhi etj.

Ç`është e vërteta, emrat e njerëzve sipas profesionit me karakter ndërkombëtarizmi, nuk janë në numër aq të madh, pasi që secila gjuhë ka ndajshesat e veta speciale për emërtimet në fjalë. Kështu ndërsa emër-termi matematikë, më të cilën emërtohet "shkenca që studion madhësitë, raportet sasiore dhe format hapësinore" (FGJSSH f. 1070) mund të cilësohet si një ndërkombëtarizëm i mirëfilltë (krahaso lat. *mathematica* (nga greq. *mathema*), angl. *mathematics*, fr. *mathématiques*, it. *matematica*, gjerm. *Mathematik*, rus. *matematika*, serb. *matematika*, shq. *matematikë* etj.), emri i njeriut si "specialist me arsim të lartë në fushën e matematikës" (FGJSSH f. 1070) nuk mund të cilësohet si ndërkombëtarizëm i mirëfilltë, ngase në shumë gjuhë, përkundër temës së përbashkët, del me prapashtesë të ndryshme fjalëformuese. Krahaso: lat. *mathematicus*, angl. *mathematician*, fr. *mathématicien*, it. *matematico*, rus. *matematik*, gr. *mathematicos*, serb. *matematiçar*, gjerm. *Mathematiker*, shq. *matematikan* etj.⁷⁵ Pra këtu kemi të bëjmë me prapashtesat karakteristike të gjuhëve të ndryshme si p.sh. lat. -US, gr. -OS, gjerm. -ER, it. -O,

⁷⁵ Shih lidhur me këtë edhe te "Emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë në gjuhën shqipe lidhur me ndërkombëtarizmat me -IK(Ë) fundore" të N. Veselajt, në revistën "Përparimi" nr. 3/85, f. 394.

rus. -(zero), serbokroatisht -_çAR, fr. -C/IEN (-sjen), angl. -CIAN(-shën) dhe në shqipe -AN.

Ndërsa tek emri i shkencës kishim të bënim me ndryshime të vogla mbaresore të fjalës, tek emri i njeriut sipas veprimtarisë kemi të bëjmë me ndryshimin e tërë një elementi të veçantë fjalëformues, siç është prapashtesa, prandaj për këtë shkak themi se ky proces mund të quhet një sihuazim a huazim i pjesshëm (hibrid). Meqenëse tek gjuhët e tjera formanti prapashtesor del si prapashtesë speciale, në gjuhën shqipe formanti -AN nga kjo pikëpamje, d.m.th. pikëpamja e autoktonisë, del i diskutueshëm, a është refleks i formës së anglishtes -IAN apo është angazhim i prapashtesës të brumit të shqipes -AN, ia vlen të sqarohet. Sidoqoftë, unë mendoj, se formanti **-an** i shqipes, qoftë i trashëguar, qoftë disi i përvetësuar asocianisht si ndajshesë emërformues del i nevojshëm, andaj edhe duhet të përgjithësohet si model edhe te rastet e tjera ende të pakonsoliduara.

Në kontekst të kësaj paraqitjeje mbasin çështje të diskutueshme edhe lidhur me cilësimin e ekzotizmave, profesionalizmave, historizmave, madje edhe të barbarizmave a fjalëve të huaja ndërkombëtare me cilësi e pa cilësi ndërkombëtarizmi.

Po e përmend kalimthi edhe çështjen e disa turqizmave si historizma, siç janë emrat: shah, pasha, padishah, sulltan, kadi, myfti, vezir - pastaj nebetxhi, nefer, kajmekam, çauş, bimbash etj., të cilët në kohën kur janë përdorur kanë qenë fjalë aktive, por me kohë kanë kaluar në shtresën pasive të leksikut, prandaj këto fjalë mund të quhen **historizma**, kur i hasim në burime të caktuara e sidomos në këngë të ndryshme popullore që mund të ndeshen edhe sot. Me fjalë të tjera fjalët e tilla duhet të quhen **historizma** e jo barbarizma, siç janë quajtur në një punim shkencor të botuar në revistën "Gjuha shqipe".⁷⁶

Kështu mund të cilësohen si historizma edhe disa emra të origjinës sllave si p.sh.: kralj, kraljicë, vlladikë, vojvodë, çetnik, pastaj edhe ata me origjinë të gjuhëve të tjera si prefekt, patron, naçelnik, xhandar, karabinjer etj. Ndërkaq, ç'është e vërteta, barbarizëm mund të quhet edhe ndonjëra nga fjalët e mësipërme, nëse ashtu përdoret sot nga disa persona me kuptim asnjës pa qëllime të caktuara tipizimi.

Ndonjëri nga historizmat e sipërpërmendur, edhe pse në gjuhën tonë ka kaluar në shtresën pasive në ndonjë gjuhë tjetër mund ta ruajë cilësinë e ndërkombëtarizmit së mirëfilltë. Ka raste gjithashtu që ndonjë huazim të ketë cilësinë e fjalës ndërkombëtare, por vetëm në disa gjuhë, d.m.th. pa e pasur cilësinë e ndërkombëtarizmit së mirëfilltë në gjuhë të tjera.

b) Emërtime të huazuara pa cilësinë e ndërkombëtarizmit

Shikuar sipas një koncepti parimor çdo fjalë e huazuar, mund të konsiderohet si fjalë ndërkombëtare, sepse u takon së paku dy gjuhëve kombëtare, d.m.th. të gjuhës dhënëse dhe të gjuhës marrëse, por ajo për të fituar cilësinë e ndërkombëtarizmit së

⁷⁶ Rr. Berisha, "Fjalori poetik i këngës popullore", të revista "Gjuha shqipe" nr 1/88, f. 28.

mirëfilltë, siç u tha, duhet të jetë e përhapur së paku në disa gjuhë a grupe gjuhësh botërore, të cilat nuk i takojnë grupit të njëjtë farefisnor gjuhësor në kuptim të gjerë. Për këtë arsye, këtu, disa terma nga fusha e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën tonë, qofshin këta të rrënjësor ose të parrënjësor, por që nuk kanë shtrirje edhe në gjuhë të tjera si ndërkombëtarizmat e mirëfilltë, u quajtën emërtime të huazuara pa cilësi ndërkombëtarizmi.

Në këtë grup huazimesh duhen veçuar disa shembuj si:

- infirmier⁷⁷, retifikator, axhustator, montator, frezator, elektrikist, faturino etj. (nga gjuha italiane) ;
- teoricien, takticien (nga frëngjishtja);
- biznismen, plejboj (nga anglishtja) etj.

Shembujt e mësipër edhe nga forma e jashtme shkrimore mund të lënë përshtypjen se prej kah janë huazuar. Ja si ndeshet barasvlerësi biznesmen, b.f., në disa gjuhë të ndryshme:

angl. businessman, fr. homme d'affaires, it. uommo d' affari, gjerm.

Geschäftsmann, serb. poslovni çovek.

Gjithashtu si fjalë ndërkombëtare të diskutueshme dalin edhe disa emra që kanë shtrirje më tepër ndër ne siç janë b.f. sllavizmat (serbokroatizmat): komandir, bravar, organ inokos, inokorespondent, milicioner, apotekar, bibliotekar etj.

Ç'është e vërteta, shembujt e mësipërm kanë mbetur me shtrirje të kufizuar, por meqë dalin të shënuar apo të përdorur jo në pak burime të caktuara "zyrtare" te ne dhe se prania e tyre nuk mund të injorohet në gjuhën letrare kombëtare përgjithësisht, çështja e tyre vlen të sqarohet.

Nëngrup më vete do të përmenden barbarizmat, të cilat si huazime të panevojshme po përdoren në rrethe të caktuara ndër ne si p.sh. zadrugar për kooperativist, sudija (për gjykac a gjyqtar), predsednik për kryetar, naçelnik për kryeshëf, zborist (pjesëtar i tubimit të caktuar) etj.

Sigurisht fjalët e huaja në cilësinë e barbarizmës kurrsesi nuk bën të lejohen në stilin asnjans të ligjërimin, aq më tepër kur për konceptet e tilla ekzistojnë përgjegjësit e normëzuar në gjuhën letrare.

Barbarizmat ashtu si edhe fjalë-termat me burim të huaj të parrënjësura, të gjysmërrënjësura dhe përgjithësisht ato të panevojshmet, varësisht nga fusha kuptimore që mbulojnë, duhet të zëvendësohen me fjalë të brumit të shqipes sa herë që këtë e mundësojnë faktorët e jashtëm dhe ata të brendshëm të gjuhës sonë. Gjithsesi mbetet detyrë e specialistëve që jo vetëm të hetojnë e të ndjekin dukurinë e tillë, por edhe të luftojnë fjalët e huaja të panevojshme. Lufta më e suksesshme bëhet duke gjetur e favorizuar zëvendësimet përkatëse, por edhe duke farkëtuar e propozuar sinonimet e mundshme për zëvendësimin e tyre në mbështetje të

⁷⁷ Fjalë-termi **infirmier** (infirmiere) është huazuar nga gjuha italiane e jo nga ajo frënge **infirmier**, siç shprehet Sh. Krasniqi në kumtesën "Rreth disa termave dhe shprehjeve të fushave të ndryshme në gjuhën e shtypit dhe të publicistikës sonë" te "Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi", Prishtinë 1988, f. 137.

modeleve aktive e prodhimit të fjalëformimit të gjuhës sonë. Madje kështu duhet vepruar edhe edhe për emërtimet e huazuara, qofshin këto të rrënjësura a gjysmë të rrënjësura, por që zëvendësimi i tyre nuk do të dëmtonte paraqitjen e nocionit të caktuar të shprehur me fjalën përkatëse ndërkombëtare. Këtu nuk duhen ngatërruar arkaizmat, historizmat, ekzotizmat e profesionalizmat kur këto përdoren pragmatikisht në funksione të caktuara stilistike. Shpjegimi i kalimit të formës së caktuar sinonimike në rrethana të caktuara në vendin e rezervës, siç u tha më përpara, duhet të rikujtohet a të kihet parasysh edhe në këto raste.

Nga sa u tha më lartë del se si emërtimet autoktone (vendëse) ashtu edhe termat e huazuar si fjalë ndërkombëtare (me cilësi e pa cilësi ndërkombëtarizmi) i nënshtrohen vlerësimit gjatë procesit të përdorimit. Për të gjitha huazimet vlen gjykimi se poqëse pushon nevoja për përdorimin e tyre, ato do të kalojnë në shtresën pasive të leksikut, duke ua lëshuar vendin formave të favorizuara. Një fat të tillë mund ta ketë edhe ndonjë fjalë e krijuar me brumin e shqipes, sidomos atëherë kur në vend të tyre dalin trajta të reja, të krijuara në mbështetje të modeleve prodhimit që i jetëson dhe i ushqen sistemi fjalëformues që ka bazë psiko-linguistike dhe socio-linguistike.

Në fund të këtij nënkreu do të ngulmoj në një gjykim timin të cekur si nëpër rreshta a mes rreshtash edhe më përpara, është fjala se të gjitha fjalët e huazuara si shenjë kulture etj. me e pa cilësi ndërkombëtarizmi që janë përdorur apo janë në përdorim e sipër në letrarishten e sotme, qoftë si historizma, profesionalizma, ekzotizma, qoftë ndonjëra edhe me ngjyrim sibirbarizme a gjysmëbarabarizme, por që ka nevojë të sqarohet, nuk duhen të quhen **fjalë të huaja**, po ato duhet të quhen **fjalë ndërkombëtare**. Pra, **fjalor i fjalëve ndërkombëtare** e jo fjalor i fjalëve të huaja .

⁷⁸. Këtë duhet ta kenë parasysh në rast ribotimi edhe M. Ndeca edhe Instituti

78

Jo *fjalë të huaja*, po *fjalë ndërkombëtare*, madje me cilësi ndërkombëtarizmi patjetër do të quhen edhe ato fjalë të gjuhës shqipe, që përdoren në gjuhë të tjera, siç është b.f. fjala **besë**, fjala **shqiptar**, **arbër** etj. dhe së këtejmi del se fjalori i tipit të tillë nuk duhet të quhet "fjalor i fjalëve të huaja", por "**fjalor i fjalëve ndërkombëtare**". Pra në këtë punim termi "fjalë ndërkombëtare" përfshin edhe termin "ndërkombëtarizëm", nga i cili ka dallim.

Ja si dallohen me anë të fjalë-termave të caktuar nocionet e tilla në gjuhë të huaja, siç është sqaruar pak më përpara:

| I. shq. | fjalë ndërkombëtare | II. ndërkombëtarizëm (internacionalizëm(!)) |
|---------|---------------------|------------------------------------------------|
| serb. | strana re_ | internacionalizam |
| rus. | inozemnoe slovo | internacionalnoe slovo |
| gjerm. | .Fremdwort | internationales Wort |
| angl. | alien word | internacionales word |
| fr. | mot étranger | internationalisme |
| it. | extranjerismo | internazionalismo |

Meqenëse termi "**fjalë e huaj**" më tepër përkon me nocionin e **barbarizmës** dhe se termat "fjalë ndërkombëtare" dhe "ndërkombëtarizëm" nuk mund të përdoren për të njëjtin nocion, për deri sa ekspertët e gjuhës sonë standarde të mos vendosin ndryshe, propozoj që termat e përdorur këtu për konceptet në shqyrtim të mos hedhen poshtë apriori, por të mirëkuptohen dhe të praktikohen.

Albanologjik i Prish tines, por edhe studiuesit nga Tirana..

B. EMËRTIMET E NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT MBI BAZË TË TIPAVE KUPTIMORË

Nga vështrimi i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit sipas faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm, del se emërtimet në fjalë ndahen në këta gjashtë tipa kuptimorë të motivuar sipas këtyre nënfushave semantike:

1. sipas procesit të punës,
2. sipas veglës a pajisjes së punës,
3. sipas produktit të punës,
4. sipas lëndës a objektit të punës,
5. sipas vendit (lokalit) të punës dhe
6. sipas degës a veprimtarisë së caktuar shoqërore -ekonomike⁷⁹.

Për nga ndërtimi emërtimet mbi bazë të grupeve a nënfushave të caktuara kuptimore të sipërcekura mund të jenë emërtime njëgjymtyrëshe, dygjymtyrëshe dhe emërtime togfjalësha. Për secilin tip dalin emrat përfaqësues në bazë të zberthimit perifrastik që motivon funksionin e tyre. Pikërisht edhe nga ky këndvështrim u pa e nevojshme të vihen re ligjësitë gjuhësore formëzuese e fjalëformuese, në mënyrë që edhe të njihen më mirë modelet për tipat e nëntipat e caktuar të emrave si dhe prirjet e caktuara fjalëformuese.

Sigurisht pas paraqitjes së skemës së mëposhtme rreth zberthimit të emërtimeve në fjalë sipas nënfushave semantike, do ta kemi më lehtë përkapjen e lëndës që do të trajtohet në vazhdim për secilin tip kuptimor si dhe nxjerrjen e rezultateve të përgjithshme e të veçanta nga ky trajtim.

⁷⁹ Ndarja e tipave mbi bazë kuptimore është bërë sipas studiuesve të kësaj teme: V. Milkani, K. Sima dhe A. Vehbiu, punimet e të cilëve janë cekur në **Hyrje** të këtij punimi, me ndonjë riformulim, siç është pika e gjashtë.

S K E M A

e tipave kuptimorë dhe zbërthimi i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit mbi këtë bazë

| Nr. r. | Tipi kuptimor a nëpunës sipas | ai që...+ folja Zbërthimi | Prapashtesa e specifikuar | Shembujt |
|--------|-------------------------------|---------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. | procesit të punës | Ai që ...(+ folja e procesit përkatës) | -S -TAR | punues, mbathës, mbathtar |
| 2. | Mjetit të punës | Ai që punon me...(+ emri i veglës) | -AR -TAR -ATORE -XHI -IST -IER -ER | sëpatar sharrëtar furkatore sharrëxhi shaptilogafist gondolier kombajner |
| 3. | Produktit të punës | Ai që bën, prodhon...(+ emri i produktit) | -TAR -AR -ATORE -XHI | fshesëtar fshesar fshisatore fshisaxhi |
| 4. | Lëndës a objektit të punës | Ai që përpunon, kultivon, përdoron...(+ emri i lëndës a i objektit) | -TAR -AR -XHI -IST | artar argjendar kallajxhi metalistr |
| 5. | Vendit a lokalit të punës | Ai që punon në...(+ emri i lokalit) | -AR -TAR -S -XHI -IST -ER -IER | zyrtar bujtnar mullis furrxhi depoist fermer doganier |
| 6. | Degës a veprimtarisë | Ai që merret me...(+ emri i degës a i veprimtarisë) | ZERO -TAR -AR -AN -TOR -OR -ER -IST -IER | bujk dijetar plenar matematikan punëtor drejtor togër albanist boksier |

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm, prapashtesat përkatëse vendëse dhe të huazuara (gjithsej të identifikuara këtu), përveç prapashtesës –TAR që ka shtrirje në të gjashtë nënfushat përkatëse dhe prapashtesa –AR në pesë, prapashtesat e tjera ndeshen në më pak nënfusha. Kështu prapashtesa –S, b. f. del e specifikuar vetëm për nënfushën e parë, *sipas procesit të punës*, d.m.th. mbi temë foljore, por ka shtrirje edhe në nënfushën *sipas vendit a lokalit të punës*, ku nuk del aq prodhimtare. Prapashtesa –ATORE, karakteristike e emërtimeve me gjini përfaqësuese femërore, del kryesisht në dy nënfusha semantike, ndërsa prapashtesat –OR, –TOR dhe –AN, vetëm në nga një nënfushë, ashtu si edhe prapashtesa *zero* te formimet pandajshesore.

Ti vihet re, gjithashtu, se prapashtesat e përvetësuara –XHI dhe –IST dalin në nga katër nënfusha semantike, por nuk përputhen plotësisht, kështu që prapashtesa –XHI nuk del në nënfushën e gjashtë, ndërsa ajo –IST në nënfushën e tretë. Prapashtesat –ER dhe –IER dalin bashkë në tri nënfusha, por kryesisht, sipas huazimeve transfer dhe nuk janë prodhimtare mbi fjalë tema të brumit të shqipes.

Të shohim tashti në vijim pak më në hollësi rreth këtyre nënfushave semantike.

1. Emërtimet sipas procesit të punës

Për të emërtuar një proces pune, siç është e njohur, normalisht përdoret një folje. Kështu nga foljet punoj (me punue) kuptohet procesi i punës (i të punuarit), nga folja ndërtoj (me ndërtue) kuptohet procesi i ndërtimit (i të ndërtuarit), nga folja mat (me matë) kuptohet procesi i matjes (i të maturit), nga përkthej (me përkthye) procesi i përkthimit (i të përkthyerit), nga prej (me pre) procesi i prerjes, (i të prerit) nga faqos (me faqosë) procesi i faqosjes (i të faqosurit), nga hekuros (me hekurosë) procesi i hekurosjes (i të hekurosurit), e kështu me radhë, kurse për të paraqitur emërtimin e njeriut sipas procesit të caktuar të punës a të veprimit që kryen ai, zakonisht përdoret një emër foljor i vepruesit, kështu që për proceset që u cekën më sipër pothuajse normalisht pa kurrfarë ngurrimi dalin emrat e vepruesit: punonjës e punues, ndërtues, përkthyes, prerës, faqosës, matës, hekurosës.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm emrat e prejardhur janë formuar mbi temë foljore me prapashtesën –S (më variantet: –UE/S, –ONJ/Ë/S, –YE/S, –Ë/S), të cilët zbërthehen "ai që ...(plus shënohet folja që emërton procesin përkatës), përkatësisht trajta emërore b.f. emri **punues** zbërthehet: "ai që punon", **ndërtues** - "ai që ndërton" etj.

Kur kemi parasysh zbërthimin si më sipër, atëherë del se në gjuhën tonë për koncepte të tilla janë formuar edhe emra prejfoljorë më –TAR si p.sh.: ngrohtar, mbathtar, herrtar, ndeshtar etj. Edhe këta zbërthehen si trajtat e mësipërme si p. sh. **mbathtar** - ai që mbath", **ndeshtar** - ai që ndeshet" etj. Edhe emri lajtarore (m. lajtar) që zbërthehet "ajo që lan" përfshihet në kuadër të emërtimeve të këtij tipi kuptimor me prapashtesën –atore.

Ç`është e vërteta, në gjuhën e sotme letrare formimet e reja me prapashtesën –TAR ose –ATORE mbi temën foljore nuk dalin aq aktive e prodhimtare, sepse për

emërtimet e tilla, për të njëjtin koncept, më fort praktikohen trajtat me prapashtesën - S, si p.sh. mbathës, harrës (herrës), ndeshës, mundës, larës e larëse etj., por kur është fjala për koncepte paksa të ndryshme atëherë bashkekzistenca e trajtave të caktuara del e ligjshme.

Edhe pse emri **kundërshtar** shpjegohet me të drejtë se del nga folja kundërshtoj, i cili si i tillë është krijuar relativisht herët, forma e tillë emërformuese nuk doli prodhimtare. Sipas prirjes së sotme më natyrshëm do të dilte trajta **kundërshtues** sesa ajo kundërshtar, e cila mbetet të luftoj për konceptin e caktuar pa mbështetje në modelin e caktuar fjalëformues të pranuar a të favorizuar sot.

Sidoqoftë, në gjendjen e sotme që të dyja trajtat konkurrojnë për koncepte të caktuara të mëvetësishme kuptimore, ashtu si edhe ato të sipërshtënuarat si p.sh. mbath(ë)tar e mbathës, ngrohëtar e ngrohës etj..dhe që nga të dyja format profilizimi i ngushtë bëhet me togfjalësh.

Pasi emërtimet e njerëzve sipas profesionit mbi bazë të procesit të punës nga aspekti fjalëformues do të trajtohen më në hollësi, në analizë të veçantë në nënkreun vijues, madje sipas tipave e nëntipave të të gjitha foljeve të shqipes, këtu nuk do të ndalem më gjatë, por më duket se është me vend të theksohet konstatimi i Ardian Vehbiut, i cili thotë se "për formimin e emërtimeve nga procesi i punës, mjete gjuhësor më i përshtatshëm është edhe praktikisht u tregua prapashtesa -ËS, -UES, -YES që mund të formojë ndër të tjera edhe emra tënjëriut sipas një mjeshtërie duke iu bashkuar drejtpërdrejt temës foljore që shënon procesin e punës"⁸⁰.

2. Emërtimet sipas mjetit a veglës së punës

Në gjuhën tonë ashtu si edhe në gjuhë të tjera në rrethana të caktuara janë formuar e formohen emra të njerëzve sipas profesionit a mjeshtërisë duke pasur si bazë e motiv pikërisht emrin e makinës (veglës, mjetit a pajisjes) së caktuar.

Emrat e këtij tipi kuptimor zërthehen "ai që punon me ... (plus shënohet emri i makinës përkatëse), p.sh. sharrëtar - "ai që punon me sharrë", fshesëtar - ai që punon me fshesë", shaptilografist - "ai që punon me shaptilograf", frezator - "ai që punon me frezë" etj.

Ç`është vërteta, zërthimi "ai që punon me ... (plus emërtimi i mjetit a veglës)" duhet kuptuar në mënyrë të përgjithsueshme dhe me njëfarë kushtëzimi, sepse stilistikisht për raste të caktuara më mirë qëndrojnë formulime të tjera si p.sh. emërtimi fyelltar më mirë zërthehet "ai që i bie fyellit - fyellrënës" sesa ai që "punon me fyell", mirëpo përgjithësisht zërthimi *ai që punon me...* ose *ai që manipulon me ... etj.* del më i kapshëm për shumicën e shembujve, prandaj edhe themi se formulimin e tillë duhet kuptuar si zgjidhje konvencionale.

Nga e kaluara i kemi të trashëguar mjaft emra të tillë nga ky tip kuptimor me prapashtesat përkatëse që si më prodhimtare edhe sot janë:

⁸⁰ Ardian Vehbiu, Studime filologjike nr. 1/86, Tiranë 1986 f. 112.

- AR: heshtar, shigjetar, shpatar, fshesar, barkar, lahutar, trumbetar etj.;
- TAR: sharrëtar, kordhëtar, fshesëtar, fyelltar, zdrukthëtar, harkëtar, çapëtar, beltar, daulltar, skitar, vigtar, qerretar etj.
- ATORE (prapashtesë femërore): furkatore, fshisatore, vekatore etj.
- XHI: sharrëxhi, fshisaxhi, kalemxhi, barkaxhi etj.
- IST: kitarist, ashensorist, makinist, shaptilografist, buldozerist, pompist, traktorist, bagerist, kamerist, kranist etj.

Që të tri prapashtesat: -AR, -TAR dhe -XHI, madje edhe -IST në disa raste i konkurrojnë njëra tjetrës, si p.sh. barkar barkëtar e barkaxhi; sharrëtar sharrist, sharraxhi, trapar trapëtar e trapaxhi etj. por më të shpeshta janë rastet e konkurrencës ndërmjet dy prapashtesave të para simotra: si p.sh. heshtar e heshtëtar, ushtar e ushtëtar etj.

Në etapën ndërmjet dy luftërave botërore u përhapen me shumicë emrat më -IST si emërtime të njerëzve sipas profesionit mbi këtë bazë, dukuri kjo që vazhdoi në fazat e mëvonshme dhe është e pranishme edhe sot e kësaj dite. Shembujt e sipërshënuar mjaftojnë sa për ilustrim dhe argumentim.

Është e vërtetë se emri më -IST, d.m.th. krejt fjala mund të cilësohet si fjalë e huazuar (tipi shaptilografist), por pasi edhe në shqipe fjalët e tilla kanë zberthim të qartë ndërtues fjalëformues, mund të konsiderohen edhe emërtime me prapashtesën -IST. Aq i janë përshtatur shqipes format e tilla saqë as që bëhet farë tentimi që formanti -IST të zëvendësohet më ndonjë trajtë prapashtesore të brumit të shqipes sidomos në fjalët ndërkombëtare, siç ndodhë p.sh. me formantet e tjera të huaja te fjalët e huazuara.

Të periudhës jo të hershme, që fillojnë aty nga etapa e Pavarësisë, janë edhe disa emërtime të këtij tipi kuptimor me prapashtesën a formantin fundor përkatës -IER,-ER, -ATOR që janë huazime librore si p.sh.: gondolier, vinçier; vinkler, kombajner; frezator, retifikator etj. Edhe rastet e tilla, kur kemi parasysh temën e qartë fjalëformuese, janë të zberthyeshme në gjuhën tonë, përkatësisht emërtimin e veglës a të mjetit të caktuar. Krahaso: gondol gondolier, vinç vinçier, kombajn kombajner, frezë frezator etj.

Kështu pra për emërtimet e njerëzve sipas profesionit përdoren prapashtesat -TAR, -AR dhe -ATORE me origjinë vendi, si dhe formantet me origjinë të huaj: -XHI, -IST, -IER, -ER dhe -ATOR.

Po përmend faktin se në gjuhën tonë nuk kam ndeshur ndonjë rast të emërtimeve të këtij tipi kuptimor të formëzuar me emër të përbërë a të huazuar me prapashtesat a formantet fundore të gjuhëve të huaja siç janë: -ANT, -ENT, -CIEN. Këtu nuk duhet nagatërruar rastet kur emrat e këtij tipi kuptimor mund të ndërlidhen edhe me koncepte të tjera ose zëvendësohen me emra të përbërë, si p.sh. sharrëtar “ai që punon me sharrë”, por edhe “ai që shet sharra” (sharrëshitës), fshesëtar “ai që punon me fshesë” ose “i që shet a punon fshesa” (fshesashitës, fshesapunues) etj., ngase atëherë kemi të bëjmë me fushë tjetër të përzier semantike, siç do të shohim në vazhdim, mirëpo del karakteristik fakti se emërtimet nga brumi i shqipes profilizimin

e bëjnë zakonisht me kompozimin përkatës, ndërsa ato me prapashtesa a fundorë të huazuar nuk e kanë si veçori një zhvillim të tillë profilizues.

3. Emërtimet sipas produktit të punës

Në gjuhën tonë janë formëzuar edhe disa emra të njerëzve sipas profesionit të krijuar sipas produktit të punës, ngase semantikisht si temë motivuese shërben pikërisht emërtimi i produktit a i frytit, i cili përfitohet nga veprimi i caktuar.

Emrat e këtij tipi kuptimor zërthehen kështu: "ai që bën (prodhon, ndreq etj.)... (plus emri i produktit përkatës). P.sh. "ai që prodhon (ndreq) shosha" quhet shoshtar, shoshëtar a shoshaxhi; "ai që bën djathë" quhet djathar, djathëtar a djathaxhi, ai qep jorgana jorgantar, ai që prodhon vorba vorbar, vorbëtar, vorbaxhi etj.

Emërtimet e këtij tipi kuptimor sa i përket prodhimtarisë kryesisht i takojnë periudhës së kaluar, por në njëfarë mënyre edhe periudhës së sotme, nëse vazhdohet me traditën e punimeve të caktuara të zanateve shtëpiake e të mjeshtërive kryesisht me dorë a me vegla dore, në të ashtuquajturën "ekonomi a biznes të vogël". Nga tradita shkoqitëm këta shembuj sipas prapashtesave përkatëse si p.sh. më:

-AR: bucelar, djathar, gjizar, këmishar, poçar, shportar, tërkuzar, opingar, fshisar, tjegullar, shishar, bravar etj.;

-TAR: lugëtar, lëndëtar, qivurtar, qymyrtart, samartar, vozëtar, thëngjilltar, zhguntar, këpucëtar, sheqertar, djathëtar, gjizëtar, ortar, bravëtar, jakatar, lavëtar;

-XHI: vorbaxhi, krypaxhi, fshisaxhi, djathaxhi, kosaxhi etj.

Po të këtij tipi kuptimor janë edhe emrat bukatore si dhe murator.

Gjatë vjeljes së materialit përkatës nuk ndeshëm në asnjë rast që ndonjë emër i këtij tipi të dalë me prapashtesat a formantet me origjinë të huaj: -IST, -IER, -ANT etj., por kryesisht me prapashtesat kundërvënëse: -AR, -TAR dhe -XHI.

Në letrarishten e sotme disa emërtime të këtij tipi kuptimor priren të formohen me emra të përbërë si p.sh. ortar - orëndreqës, lugëtar - lugëpunës, djathëtar - djathëbërës, vorbëtar vorbapunës, e kështu me radhë. Madje ka shenja që secila trajtë të konkurrojë për mëvetësinë e vet, sipas nënfushës së caktuar semantike, ngase ka të ngjarë që ortar të jetë pronari i vendshërbesës, ndërsa orëndreqës, të jetë personi specialist i profilit të ngushtë i punësuar nga pronari, e kështu me radhë.

4. Emërtime sipas lëndës a objektit të punës

Edhe pse në numër pak a shumë të vogël në krahasim me tipat e tjerë kuptimorë në gjuhën tonë ndeshim edhe emra të krijuar sipas lëndës a objektit të punës. Ja disa shembuj të merenduar sipas prapashtesave përkatëse fjalëformuese, si p.sh. më:

-TAR: hekurtar, remtar, artar, xhamtar, xunkthëtar, farëtar, sheqertar etj.

-AR: argjendar, deltinar, druvar, dhenar, derrar, dhiar, lopar, gomarjar, pelar, viçar, shtërpar, pular, baltar etj.

-XHI: sheqerxhi, hekurxhi, kallajxhi etj.
-IST: tekstilist, betonist, metalist etj.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm edhe emrat nga ky tip kuptimor janë formuar me prapashtesat speciale vendëse: -AR dhe -TAR, por edhe me -XHI e -IST të burimit të huaj.

Edhe për këtë tip emërtimesh vlen të theksohet fakti se në letrarishten e sotme gjithnjë e më shumë dallohet prirja që emrat më -AR, -TAR e -XHI, por edhe më -IST të zëvendësohen me emrat gjegjëse të përbërë (të profilit të ngushtë (si p.sh.: artar - arpunues, pular - pularritës, argjendar - argjendpunues, hekurtar e hekurxhi - hekurpunues e kështu me radhë, por edhe tekstilist - tekstilpunues, metalist - metalpunues etj., por edhe me mundësi diferencimi sipas profilit të ngushtë.

Zbërthimi i emrave të tillë bëhet sipas formulës: "ai që (për)punon (kultivon, mirëmban, ngjet, rrit etj)..." (plus emërtimi i lëndës së parë, i gjësëndeve e frymorëve të caktuar). Këta emra për nga forma e ndërtimit mund të kenë edhe kuptime polisemantike për disa tipa kuptimorë. Kështu p.sh. sheqertar, mund të quhet personi si pronar, por që njëherazi (për)punon ëmbëlsirat me sheqer (ëmbëlsirapunues), por edhe ai që shet ëmbëlsirat e tilla (ëmbëlsirashitës) etj.

5. Emërtime sipas vendit të punës (lokalit)

Në krahasim me emërtimet e njerëzve sipas profesionit mbi bazë të tipave kuptimorë sipas produktit të punës dhe sipas lëndës a objektit të punës në gjendjen e zhvillimit të sotëm gjuhësor, emërtimet sipas vendit të punës a lokalit të caktuar janë në numër më të madh, përkatësisht emërtimet e tilla, siç e thotë A. Vehbiu "përdoren relativisht më shpesh".

Është e vërtetë se në organika⁸¹ (sistematizimet e punëve dhe të detyrave sipas vendeve të punës) ndodh që emërtimi i njeriut sipas vendit të punës të identifikohet me emërtimin e profesionit a të titullit profesional-shkencor që ka a që duhet të ketë personi i caktuar. Gjithsesi nocioni "vendi i punës", përkundër veçorive të përbashkëta që ka, në raste të caktuara ndryshon nga nocioni "njeriu sipas profesionit". Zakonisht emërtimi i vendit të punës lidhet me funksionin e caktuar a me punët dhe detyrat e caktuara që duhet t'i kryejë personi i caktuar, pavarësisht nga përgatitja profesionale e kualifikuese që posedon.

Edhe tek emrat e njerëzve sipas profesionit mbi bazë të vendit të punës ndeshim emra të prejardhur me prapashtesat përkatëse si p.sh. me prapashtesën:

-TAR: derëtar, zyrtar, kufitar, gjyqtar etj;
-AR: vreshtar, lulishtar, hekurudhar, bujtinar; bibliotekar, stanar etj.
-XHI: furrxhi, dyqanxhi, hanxhi, mullixhi;

⁸¹ Për kuptimin e fjalë-termit "organikë" më hollësisht në artikullin e N. Veselajt "Rreth aktivizimit të fjalës **organikë** te ne", të botuar në gazetën "Rilindja" të datës 12. III. 1989 f. 11.

- IST: depoist, hotelist, farmacist;
- IER: doganier, kuzhinier, portier, magazinier, deponier etj.;
noter, fermer etj.
- S: mullis, gjykatës etj.

Në raport të prapashtesës -AR dhe -TAR në shumicën e rasteve prapashtesa -TAR del mbizotëruese edhe për këtë tip emërtimesh. Ndërsa emërtimet më -XHI i takojnë kohës mbase në përfundim e sipër, ato më -IST dhe -IER i takojnë kohës elativisht të re, etapës së Pavarësisë. Relativisht i ri është në gjuhën tonë edhe emërtimi fermer mbi bazë të emrit fermë: Ferm(ë) plus -ER fermer. Shembujt e tillë që mund të zërthehen edhe me elemente kuptimore të shqipes janë në rritje e sipër.

Ndonëse në numër të kufizuar në këtë tip kuptimor ndeshim edhe disa emra me prapashtesën -S si p.sh. gjykatës, mullis që konsiderohen si krijime vendëse nga tradita.

Siç mund të shihet a të provohet nga shembujt e shënuar emrat e këtij tipi kuptimor që formohen me prapashtesën -TAR, pastaj më -AR, -IST, -IER e -ER dhe -S logjikisht, në shumicën e rasteve, nuk mund të jetë e lejueshme që emrat e tillë të zëvendësohen me emra të përbërë, siç është dukuri e zakonshme te tre tipat kuptimorë të mëparshëm.

Shumica e emrave të këtij tipi kuptimor kanë karakter hiperonimik, pasi që me emërtimin e caktuar përfshihen të gjitha shkallët e caktuara kualifikuese. P.sh. tek emërtimi *kufitar* mund nënkuptohet ushtari, ushtarakët sipas kërkesës a gradave të ndryshme deri te ajo e gjeneralit të ngarkuar për një detyrë a shërbim të tillë në rajonet kufitare. Po ashtu, b.f., tek emri *vreshtar* mund të nënkuptohet: punëtori i pakualifikuar, punëtori i kualifikuar, tekniku i vreshtarisë, inxhinieri i vreshtarisë etj., pra profilizimi bëhet me togfjalësh zakonisht e jo me kompozitë⁸²

Zbërthimi i emrave të këtij tipi kuptimor bëhet sipas formulimit: "ai që punon në ..." (plus emri i lokalit përkatës), p.sh. portier - "ai që punon në portë, në portieri", noter - "ai që punon në noteri, vreshtar - "ai që punon në vreshtë, në vreshtari" etj.

6. Emërtimet sipas degës a veprimtarisë së caktuar shoqërore-ekonomike

Kur kemi parasysh faktin se me veprimtari, sipas kuptimit të gjerë leksikor që ka kjo fjalë, kuptojmë "punën e gjallë që kryen dikush në një fushë të caktuar të jetës" (FGJSSH f. 2130), atëherë edhe emërtimet e njerëzve sipas profesionit mbi bazë të tipit në fjalë dalin në rrafsh mjaft të gjerë.

Ç'është e vërteta, çdo veprimtari a "punë e gjallë" e njeriut nuk mund të cilësohet si "profesion i mirëfilltë", por në njëfarë mënyre çdo njeri mund të emërtohet sipas punës a veprimtarisë që bën me një emër që, siç u përmend më përpara, quhet emër i

⁸² Shih lidhur me këtë shkallët e profilizimit të profesioneve në kreun I të këtij punimi.

vepruesit. Në përgjithësi të gjitha veprimtaritë e njohura, qoftë të natyrës shoqërore-shkencore, qoftë të natyrës ekonomike e shërbyese, kanë emërtime të njerëzve, të cilat formëzohen a mund të formëzohen si emërtime të njerëzve sipas profesionit. P.sh. nga veprimtaria që është e emërtuar me fjalën treg del emërtimi i njeriut tregtar, nga veprimtaria sport del emërtimi i njeriut sportist, mirëpo ka raste kur, si të themi, emri i vepruesit i prin veprimtarisë si p.sh. **gjuhëtar** si emër vepruesi, **gjuhsësia** është emërtimi i veprimtarisë së gjuhëtarit; ekonom a ogranom është emri i njeriut, ekonomi e agronomi quhen përkatësisht veprimtaritë e tyre.

Edhe sipas këtij tipi kuptimor dalin mjaft emra të njerëzve me prapashtesat fjalëformuese që përsëriteshin pothuajse në të gjitha fushat kuptimore a tipat kuptimorë që u trajtuan më sipër.

Ja disa shembuj me prapashtesat përkatëse si p.sh. më:

-TAR: gjuhëtar, dijetar, rojtar, muziktar, tregtar, kryetar, këshilltar, arsimtar, pagëzimtar etj.

-AR: pushtetar, shtetar, ushtar, katundar, vendar, qytetar etj.

-IST: albanist, ballkanist, kimist, sportist, akademist, artist etj.

-ENT: docent, referent;

-ER: oficer, toger, rreshter, veteriner;

-IER: boksier, financier;

-AN: matematikan, fizikan, fonetikan etj.

-ANT: muzikant, komandant, diversant etj.

-ENT: klient, pacient, abonent etj.

Ndonjë shembull që u dha më sipër nuk e ka të zërthyeshme në gjuhën shqipe prapashtesën përkatëse, siç është rasti: docent, diversant, oficer etj.

Prandaj shembujt e tillë do të konsiderohen si huazime tranfer, por s'ka dyshim se edhe emërtimet e tilla bëjnë pjesë në kuadër të emërtimeve të këtij tipi kuptimor.

Ç'është e vërteta, vetëm te ky tip kuptimor përveç emrave të prejardhur e të përbërë dalin edhe emra të parmë si emërtime të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë.

Kjo vërehet edhe nga ndonjëri nga shembujt e sipërshtënuar, siç janë huazimet tranfer të tipit docent, oficer, pastaj edhe ata të gjuhës shqipe si bari, mjek etj.

Ja disa shembuj të emrave të parmë që janë karakteristikë vetëm e këtij tipi kuptimor: plak, mbret, mjek, prift, bari, pastaj profesor, arkitekt, psikolog, ekonom, teolog, albanolog, gjeneral, major, kolonel, teknik, inxhinier, abonent etj.

Zbërthimi i emrit të këtij tipi bëhet sipas formulimit:

1."ai që merret me ...(plus emërtimi i veprimtarisë së caktuar). P.sh.: metalurg - "ai që merret me metalurgji", sportist - "ai që merret me sport", plak - "ai që merret me pleqni (drejtësi)" etj. ose

2. ai që merret me punë... (+ veprimtaria që lidhet me emërtimin përkatës) P.sh.: oficer - ai që merret me punë oficerie (në ushtri), mjek - ai që merret me punë mjekësie e kështu me radhë.

Zbërthimi "ai që merret me ..."ose ai që merret me punë..." duhet të kuptohet si zgjidhje konvencionale, ngase sqarimi mund të bëhet edhe me të tjera fjalë, të cilat mund të jenë më praktike në raste të caktuara. P.sh. metalurg quhet personi "që

punon në metalurgji", kurse në shembullin tonë qëndron "ai që merret me metalurgji", ose "ai që merret me punë metalurgjike", si zgjidhje konvencionale.

Përmbyllje

Në fund të kësaj paraqitjeje nga skema e zbrërthimit dhe nga analiza e emërtimeve në shqyrtim me theks në prapashtesat e specifikuar, sipas tipave kuptimorë a nënfushaveë semantike që mbulojnë, mund të nxirren këto konkluzione a konstatime përmbyllës me interes:

1. Emrat mbi bazë të tipit kuptimor "sipas procesit të punës" si dhe emrat e vepruesit që kanë për temë fjalëformuese një trajtë foljore (zakonisht pjesoren), pothuajse ekskluzivisht formohen me prapashtesën -S (-UE/S, YE/S). Kjo është veçori e gjuhës letrare. Në burime të caktuara nga e kaluara, por edhe tani në gjuhën e sotme ndeshim edhe formime mbi temë foljore edhe me prapashtesën -TAR si p.sh. njehtar, ngjeshtar, mbathtar, por që tani zakonisht mund të shprehin koncept tjetër nga emrat prejpjesorë me -S. Ç'është e vërteta, me prapashtesën -S hasim edhe ndonjë emër të njeriut sipas mjeshtërisë të emërtuar mbi bazë të tipit kuptimor "sipas lokalit a vendit të punës" tipi: gjykatës, mullis etj., mirëpo ky nëntip formimi nuk duket se është aktiv a produktiv në kohën tonë.

2. Prapashtesa -TAR, ndeshet e shtrirë në të gjithë nënfushat semantike sipas tipave kuptimorë, ajo del mbizotëruese në disa nënfusha në raport me prapashtesën -AR. Në të vërtetë, prapashtesa -AR, në krijime "popullore" sidomos në fushën "sipas produktit të punës" dilte mjaft pridhimtare, mirëpo mund të thuhet se ka konkurrencë të fituar vetëm në rastet kur tregon njeriun sipas veprimtarisë politiko-shoqërore, siç janë shembujt: vendar, familjar, kuvendar, pushtetar, pleqnar, shtetar etj, ndersa për nënfusha të tjera ka konkurrencë të forte nga prapashtesa -TAR.

Në të mirë të prapashtesës -TAR dalin këto fakte që sidomos kur është fjala për formime të reja ose kur ka mëdyshje te rastet paralele:

1) Në FSHS (2002) emërtimet me prapashtesën -TAR, për nga numri dalin gjysmë për gjysmë më shumë nga emërtimet më -AR. Kështu ishte edhe në filltet e shkrimit të shqipes. Në veprën e Gj. Buzukut raporti del 10 me 3 e në Fjalorin e F. Bardhit edhe më i thellë 28 me 6.

2) Me prapashtesën -TAR nuk e ndeshim asnjë emërtim të huazuar, ndërsa me -AR po, siç janë rastet: funksionar, bibliotekar, aksionar etj., pra prapashtesa -TAR del më e ngulitur aktualisht.

3) Tek emrat me -AR nga numri i tërësisht afro 1/3 dalin mbi temë prodhuese me -T fundore, tipi detar, kopështar, lulishtar, shigjetar etj. që në burime të caktuara nga e kaluara i ndeshim më -TAR. Krahaso detëtar, kopshtëtar, lulishtëtar, shigjetëtar, si luftëtar e ushtëtar, e kështu me radhë, andaj mund të hamendim se një thjeshtëzim i tillë është bërë, për të mos dalë dy T-ja e jo për hir të specifikimit të formantit -AR.

4) Prapashtesën -AR e ndeshim të përdorur në nënfusha të tjera semantike, siç është b.f. emërtimi i sendeve (mjeteve) konkrete, ndërsa prapashtesën -TAR jo.

Pra kur kemi parasysh këto fakte, atëherë mund të konstatohet se prapashtesa -TAR

në raport me prapashtesën -AR, del si një formant më i specializuar për emërtimin e njerëve sipas profesionit parësisht edhe mbi temë emërore edhe mbi temë foljore.

3. Prapashtesa -XHI (me origjinë turke) e cila nuk del e pranishme vetëm te shembujt a emrat e huazuar nga gjuhët orientale, por edhe mbi fjalë-tema autoktone të shqipes nuk del e përdorur në fushën semantike sipas procesit të punës, sipas degës a veprimtarisë dhe sipas vendit të punës. Prodhimtaria e kësaj prapashtese, që nga Rilindja e këndeje, ka ardhur gjithnjë duke u zvogëluar, saqë në shumë raste mund të themi se ka kaluar në shtresën pasive të leksikut neutral. Sidomos për farkëtime të reja, nuk është e rekomandueshme kjo prapashtesë.

4. Prapashtesën -IST, përkatësisht shembujt me këtë formant nuk i ndeshim vetëm në tipin kuptimor "sipas procesit të punës" dhe "sipas produktit të punës", edhe pse sipas tipit të fundit emërtimet si emra vepruesi formohen zakonisht mbi tema emërore. Vetëm emërtimet mbi bazë të tipit kuptimor "sipas lëndës a objektit të punës" me prapashtesën -IST priren të zëvendësohen me emra të përbërë si p.sh. metalist - metalpunues, tekstilist - tekstilpunues etj., kurse tipat e tjerë jo.

5. Emërtimet me prapashtesën -IER, i ndeshim të përdorura në tri nën fusha semantike, sipas mjetit të punës, sipas vendit të punës, sipas produktit të punës, sipas veprimtarisë së caktuar, ashtu si edhe prapashtesën -ER, mirëpo, ndërsa me prapashtesën -ER janë formuar pak emra mbi bazë të fjalë-temës shqipe si p.sh. delmer, rreshter, toger e me prapashtesën -IER, pothuajse asnjë, prapashtesa -IER del si më e përvetësuar, sidomos në fjalët e huazuara. Për nga numri, shembujt e regjistruar në FSHS 2002 më -ER dhe IER dalin të barabartë.

6. Në tipin "sipas degës a veprimtarisë" ndeshim edhe emërtimet e njerëzve sipas profesionit të formuara më formantet: ZERO, -ENT, -ANT, -OR, -AR, dhe -ENT që nuk i ndeshim në nënfusha të tjera semantike.

7. Prapashtesa -AN që paraqitet vetëm te tipi "sipas degës a veprimtarisë", por përdoret te një numër jo i pavërejtshëm i emërtimeve të profesioneve mbi fjalë-tema në cilësinë e ndërkombëtarizmave më -IK(ë) fundore dhe më -I-në fundor siç janë shembujt: matematikan, historian etj. Në emërtimet e tilla të profesioneve, sidomos mbi bazë të ndërkombëtarizmës me -IK(ë) fundore ky formant vetëm në shqipe del me shkrim shqiptim karakteristik, prandaj këtë formant sipas funksionit për kryen e quajmë prapashtesë vendëse e shqipes, por për këtë më gjerësiht në një vend tjetër.

8. Emërtimet me prapashtesat -OR dhe -TOR nuk paraqiten në numër të madh mbi fjalë-temë të fjalës autoktone. Çështje e vërteta, shëmbujt të rinj më -OR dhe më -TOR nuk parapëlqehen, ndërsa të gjithë shëmbujt më -TOR nga e kaluara priren të dalin më -TAR.

9. Prapashtesa e pavarur femërore, -ATORE, del më shumë e përdorur në tipin "sipas mjetit të punës".

10. Në fund po përmend edhe një karakteristikë të përgjithshme me interes. Për dallim nga emërtimet sipas tri nënfushave: sipas procesit të punës, sipas vendit të punës dhe sipas veprimtarisë shoqërore ekonomike, ku profilizimi i ngushtë bëhej me sqarim togfjalësh, tek tri nënfushat e tjera semantike, d.m.th. emërtimet "sipas produktit të punës", "sipas lëndës a objektit të punës" dhe "sipas mjetit të punës" për profilizime të ngushta, është fjala për emrat e brumit vendës, priren të zëvendësohen

me emra të përbërë si p.sh. lugar, lugëtar a lugaxhi - lugëpunues, jorgantar a jorganxhi - jorganpunues; metalist - metalpunues argjendar - argjendpunues etj. duke e shtuar kështu numrin e emërtimeve mbi bazë të tipit kuptimor "sipas procesit të punës", ku kompozita paraqitet si mënyrë shumë aktive dhe prodhimtare. U cek më sipër se te profilizimet e ngushta kompozitat dalin me diferencim të dukshëm kuptimor.

Sidoqoftë, nga paraqitja e mësipërme, del se formantet e caktuara si p.sh. -ar /-tar, -ier/-er, -tar/-s (-ue/s, -ye/s), ndonëse duket se qëndrojnë në konkurrencë sinonimike, megjithatë ato në nënfusha të caktuara semantike nuk mund ta mbulojnë njëra tjetrën, prandaj këtë fakt duhet ta kenë parasysh studiuesit ashtu si edhe përdoruesit dhe mos t'i ngatërrojnë. Madje, edhe formantet fundore duhen dalluar nga prapashtesat e mirëfillta.

Këto ishin vetëm disa karakteristika të përgjithshme për formantet e caktuara sipas tipave kuptimorë, ndërsa për karakteristika të tjera, më konkretisht rreth procesit të formëzimit e fjalëformimit më në hollësi do të bëhet fjalë në nënkreun vijues, ku do të përfshihen të gjithë tipat e nëntipat sipas kategorisë fjalëformues e fjalëndërtues të emrave që përdoren si emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë a profesionit.

C. RRETH STRUKTURËS SË FORMIMIT TË EMRAVE TË NJERËZVE SIPAS VEPRIMTARISË SË TYRE

Në këtë analizë nuk do të trajtohet prejardhja etimologjike e emrave të caktuar që janë të formëzuar si emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë së tyre. Përqëndrimi kryesor këtu do të bëhet në rrafshin sinkronik dhe vetëm për ato raste kur struktura fjalëformuese e emrit është e qartë apo del e zbërthyeshme.

Në këtë analizë do të kalohet heshtazi edhe problematika e emrave të ashtuquajtur të parmë, edhe pse rreth formimit të tyre mund të dalin çështje që lyphen sqaruar. P.sh. tek emri bari bariu (bëruo) fundori -I mund të krahasohet për analogji me fjalën liri liria (ose Liri emër I përveçëm në trajtë të ngurosur m.e f.), ku elementi -I del qartë si formant fjalëformues.

Edhe çështja e emrave të huazuar që në gjuhën shqipe konsiderohen si emra të parmë nuk do të analizohen në hollësi. Çështje e vërteta, në hollësi do të analizohen vetëm emrat e prejardhur që si emërtime të njerëzve sipas profesionit plotësisht dalin me anë të prapashtesimit, por nuk do të lihen anash as emrat me përngjitje, përngjitje + prapashtesim njëherazi si edhe emrat e përbërë si emërtime të njerëzve sipas profesionit a të veprimtarisë. Në këtë kuadër nuk do të harrohen as emërtimet me dyfishim profesionesh e emërtimet togfjalësha, të cilat do t'i shtrohen më tepër analizës logjike-semantike d.m.th. më tepër nga ana përmbajtësore, se sa nga ajo formale, ngase nga kjo pikëpamje janë fort të tejdukshme.

Në fillim do të bëhet fjalë rreth emrave të prejardhur me prapashtesat speciale me origjinë vendi, siç janë prapashtesat prodhimtare: -S (-UES, -YES, ËS), -TAR, -AR, -OR, -TOR, pastaj ato -AN, -IK, -OK, -EC e ndonjë tjetër. Gjithashtu do të bëhet fjalë edhe për emrat përkatës të kësaj kategorie me prapashtesat me origjinë të huaj, por të përvetësuara, siç janë prapashtesat: XHI, -IST, -IER, pastaj edhe shembujt me formantet e huazuara bashkë me fjalët përkatëse, siç janë: -ER, -ENT, -CIEN -A/TOR etj.

(1) EMRAT E PREJARDHUR ME PRAPASHTESIM

Para se të kalohet në analizë të hollësishme lidhur me formimin e emrave të vepruesit, përkatësisht të emrave të njerëzve sipas veprimtarisë së tyre mbi bazë të prapashtesave e mënyrave të tjera fjalëformuese, më poshtë po paraqesim tabelën e numrit të emërtimeve në shqyrtim, sipas tetë prapashtesave speciale më të përdorura në gjuhën tonë, tabelë kjo që është përfshirë së pari në kuadër të kumtesës së botuar në "Seminarin ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare" nr. 9/84, Prishtinë 1984 me titull "Çështje rreth emërimit të njerëzve sipas profesionit" dhe se këtu po plotësohet vetëm me të dhëna nga Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë 1984.

Tabela e numrit të emrave të njerëzve sipas profesionit sipas fjalorëve përkatës

| Prapashtesa | FGJSH 1954 | | FSHSK 1976 | | FGJSSH 1980 | | FSHSK 1981 | | FSHS 1984 | |
|-------------|------------|----|------------|----|-------------|----|------------|----|-----------|----|
| | numri | % | numri | % | numri | % | numri | % | numri | % |
| -S | 29 | 17 | 94 | 32 | 140 | 35 | 179 | 41 | 390 | 52 |
| -TAR | 37 | 21 | 58 | 20 | 88 | 21 | 58 | 13 | 120 | 16 |
| -AR | 31 | 18 | 20 | 7 | 34 | 8 | 26 | 6 | 73 | 9 |
| -TOR | 21 | 12 | 14 | 5 | 25 | 6 | 27 | 6 | 13 | 2 |
| -OR | 7 | 4 | 3 | 1 | 13 | 3 | 6 | 1 | 6 | 1 |
| -IST | 28 | 16 | 53 | 18 | 72 | 17 | 71 | 16 | 89 | 12 |
| -XHI | 30 | 17 | 39 | 13 | 30 | 7 | 37 | 8 | 29 | 4 |
| -IER/-ER | 10 | 6 | 9 | 3 | 20 | 5 | 30 | 7 | 32 | 4 |
| Gjithsej | 173 | | 290 | | 422 | | 432 | | 752 | |

Këtu në këtë tabelë është përfshirë aqsa ka qenë e mundur vetëm numri i emrave të njerëzve sipas profesionit e jo të gjithë emrat e vepruesit, por për të gjithë fjalorët është respektuar kriteri i njëjtë, edhe pse ndonjë rast mund të jetë i diskutueshëm. Ç'është e vërteta, me rastin e numrimit të emërtimeve të caktuara në Fjalorin e shqipes së sotme (1984) kriteri del më i shprehur (janë numruar edhe kompozitat e disa emra të vepruesit që kanë prirje formëzimi). Mirëpo edhe nëse ka shpëtuar

ndonjë "lëshim" a pasaktësi eventuale, e bërë pa qëllim, supozohet se kjo nuk do të ndikojë në konstatimet e veçanta që jepen gjatë komentimit të tabelës së lartshënuar, interpretim ky që do të bëhet pasi të kryhet analiza përkatëse për secilin tip a nëntip të emrave të prejardhur veç e veç.

Gjithsesi, ia vlen të vërehet rritja suksesive ose gjendja e numrit të emërtimeve prej burimi në burim si dhe përqindja në kuadër të numrit të përgjithsëm brenda vetë burimit përkatës.

a. EMRAT E NJERËZVE SIPAS VEPRIMTARISË ME PRAPASHTESËN -S

Emrat e njerëzve sipas veprimtarisë me prapashtesën -S, për nga tema fjalëformuese ndahen në dy mënyra kryesore:

1. emra mbi temë emërore (ku do të futen edhe ata mbi temë mbiemërore e ndajfoljore) dhe 2. emra mbi temë foljore.⁸³

Që të dyja këto mënyra të formimit dalin të dëshmuara, që në shkrimet më të hershme të gjuhës sonë dhe vazhdojnë të jenë të pranishme edhe në letrarishten e sotme duke hyrë në shqipen standarde të sotme dhe të nesërme barabar të favorizuara, ndonëse krijimet mbi bazë foljore aktualisht janë më shumë aktive dhe produktive ndaj formimeve mbi temë emërore.

Dihet se mundësia e formimeve të tilla, qoftë mbi temë emërore, qoftë mbi temë foljore, ekziston dhe sipas rasteve, situatave e stileve mund dhe duhet të shfrytëzohen pragmatikisht në përputhje me nënfushat e caktuara semantike që shprehen ose priren të mbulohen.

1. Emrat më -S mbi temë emërore

Nga burimet e traditës si dhe në jetën tonë të përditshme, pothuajse normalisht ndeshim emra të prejardhur me prapashtesën -S mbi temë emërore. Ja disa shembuj: mullis, derës, detyrës, lëkurës, gjykatës, dhuratës, ujemës, ftesës, lajmës, kokës, mjekës, automatikës, elektronikës etj.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm para prapashtesës -S, në ato raste ku tema nuk mbaron me elementin -Ë fundor, në shkrim del një -Ë mbështetëse, si p.sh: ujem +Ë/S = ujemës, kurse te rasti lëkurës nuk kemi të bëjmë me një element të tillë mbështetës, sepse -Ë -ja fundore këtë rast është pjesë përbërëse e temës (emrit në trajtën e pashquar).

Edhe pse qëndrueshmëria e krijimeve me prapashtesën -S, siç u cek në shembujt e

⁸³ Shih edhe te Xhuvani - Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, A Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980, f.478.

mësipërm, nuk vihet aspak në dyshim, vlen të përmendet konkurrenca që u bëhet formimeve të tilla, më konkretisht kësaj prapashtese nga sinonimi -TAR si p.sh.: derës derëtar, lëkurës lëkurëtar etj.

2. Emrat më -S mbi temë foljore

Në gjuhën letrare të ditëve tona vërehet vërshim i një numri relativisht të madh të emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë (emrave të vepruesit) që krijohen mbi temë foljore. Në punime teorike rreth kësaj çështjeje nuk mohohet mirëfillësia e prapashtesë -S si element fjalëformues, mirëpo nga autorë të ndryshëm, kjo prapashtesë, përveç -S del e shënuar edhe në tri variante të tjera: -UES, -YES dhe -ËS, të cilat theksohen edhe si prapashtesa të veçanta⁸⁴. Kjo çështje, sipas mendimit tim lypset sqaruar më mirë. Gjithsesi, trajtat -UES, -YES dhe -ËS logjikisht përfshihen në kuadër të prapashtesës -S, madje edhe funksionalisht këto alomorfe nuk shkaktojnë kundërvënie.

Në vazhdim do të analizohen mjaft hollësisht emërtimet e njerëzve sipas kësaj kategorie, përkatësisht të emrave prejfoljorë me qëllim që të vihen në pah, qoftë zgjidhjet e deritashme, qoftë çështjet e diskutueshme që mund të dalin në këtë sferë. Njëherazi kemi për qëllim të spikasim prirjen që është e vërejtshme dhe e favorizuar për formimin e emrave të rinj mbi këtë bazë, përkatësisht do të spikasim përzgjedhjen e trajtave të caktuara të emrave të caktuar që ende nuk janë të regjistruar në burimet përkatëse normative.

Çështje e vërteta, formimi i emrave të vepruesit, mbi temë foljore, përkatësisht mbi trajtën e pjesores, paraqitet si modeli më prodhimtar dhe aktiv i letrarishtes së sotme. Për të arritur deri te emri i vepruesit dhe për të qenë me e kapshme rruga e formimit dhe e përligjjes së emrave në fjalë, në vazhdim po i japim një nga një sipas pasqyrës së mëposhtme, të të gjitha grup-foljeve, të cilat u ndanë në katër grupe të mëdha si vijon:

- I. Folje me temë në zanore dhe togzanor që shoqërohen në trajtën përfaqësuese nga fundore-mbaresa -J;
- II. Folje vokalike me mbaresë zero;
- III. Folje të parregullta (supletive e josupletive) dhe
- IV. Folje me temë në bashkëtingëllore (qoftë pa cilësinë e prapashtesës së mëvetësishme, qoftë me cilësinë e prapashtesës së mëvetësishme).

⁸⁴ Në shkrimet e disa autorëve tanë të njohur, jo vetëm të Xhuvani-Çabejt, por edhe të bashkëkohësve si janë: prof. Sh. Demiraj, A. Vehbiu e të tjerë, variacionet e prapashtesës -S: -UES, YES, ËS, madje edhe -OJS e -ONJËS shënohen a cilësohen si prapashtesa të veçanta. Mendoj se kjo çështje lypset sqaruar. Nuk është i pambështetur konstatimi i prof. Latif Mulakut, i cili në artikullin "Rreth shkrimit të fjalëve me prapashtesën -S" të botuar në revistën "Jehona" të Shkupit nr. 3-4/63 thotë se "Prapashtesa -UES, -YES gjuha shqipe kurrën e kurrës nuk ka pasur ... po kemi të bëjmë me pjesoren e foljes *mësue përkthye* dhe me prapashtesën -S".

Për të gjithë tipat e nëntipat e foljeve sipas grupeve të mësipërme është dhënë nga një shembull karakteristik, sipas këtyre rubrikave:

Nën 1. shënohet trajta e foljes në veten e parë njëjës të dëftores, si trajtë përfaqësuese dhe për arsye se ka raste që kjo trajtë ka shërbyer si temë për formimin e emrit përkatës të vepruesit.

Nën 2. shënohet e kryera e thjeshtë e vetës së parë njëjës me qëllim vërtetimi se ka apo s'ka ndikim qoftë edhe plotësues kjo trajtë në formimin e emrit përkatës të vepruesit, ngase ka raste kur tema e kësaj forme përkon jo vetëm me trajtën e së tashmes, por edhe me atë të pjesores⁸⁵.

Nën 3. shënohet trajta e pjesores (në raste të caktuara në të dyja variantet: në variantin e ish-gegërishtes letrare dhe në variantin e letrarishtes së sotme), sepse pjesorja si komponente fjalëndërtuese e fjalëformuese është trajta bazë e temës së emrave të vepruesit dhe për këtë arsye quhen *emra prejpjesorë* dhe se pikërisht ky komponent është pika që meriton vëmendje më të plotë që ndihmon dhe so të ndihmojë të zgjidhurit e çështjeve në shqyrtim, edhe për ato raste të cilat ende kanë mbetur të diskutueshme ose që nuk kanë pasur zhvillim.

Nën 4. shënohet emri i veprimit, sepse emri i veprimit si emër prefoljor, në të vërtetë, i paraprin në verigë formimit të emrit të vepruesit dhe shërben në njëfarë mënyre si kriter që nxit nevojën për zgjerimin e vargut fjalëformues të prejpjesorëve.

Nën 5., shënohet emri i vepruesit që është caku i qëllimit tonë.

Për ndonjërin nga rastet që dalin jashtë modelit fjalëformues do të bëhet fjalë veças.

PASQYRA E PROCESIT TË FORMIMIT TË EMRAVE FOLJORE TË VEPRUESIT

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|-----|------------|------------|-------------|----------|-----------|
| Nr. | E tashmja | E kryera e | Pjesorja | Emri i | Emri i |
| r. | e dëftores | thjeshtë | (let./geg.) | veprimit | vepruesit |

⁸⁵ Në punimin e Xhuvani - Çabejt "Prapashtesat..." thuhet: "emri e mbiemri ruajtës ruejtës ka dalë nga forma e aoristit ruajta ruejta ose e pjesores ruajtur ruejtë" (A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980, f. 560).

I. Foljet me temë në zanore dhe togzanor:

1. më -OJ:

| | | | | |
|-------|---------|--------------------|----------|----------|
| mësoj | mësova | mësuar (mësue) | mësim | mësues |
| mbroj | mbrojta | mbrojtur (mbrojtë) | mbrojtje | mbrojtës |

2. më -UAJ:

| | | | | |
|---------|---------|------------------|---------|------------|
| shkruaj | shkrova | shkruar (shkrue) | shkrim | shkrues |
| shuaj | shova | shuar (shue) | shuarje | shuarës(!) |
| ruaj | ruajta | ruajtur (ruejtë) | ruajtje | ruajtës |

3. më -EJ:

| | | | | |
|-----------|------------|-----------------------|-----------|------------|
| shpërblej | shpërbleva | shpërblyer(shpërblye) | shpërblim | shpërblyes |
| vërej | vërejta | vërejtur (vërejtë) | vërejtje | vërejtës |
| blej | bleva | blerë (ble) | blerje | blerës |
| mbrej | mbreva | mbrehur (mbrehë) | mbrehje | mbrehës(!) |

4. më -IJ:

| | | | | |
|--------|---------|------------------|----------|----------|
| shkrij | shkrija | shkrirë (shkri) | shkrirje | shkrirës |
| arrij | arrita | arritur (arritë) | arritje | arritës |

5. më -UJ:

| | | | | |
|-----|-------|----------------|--------|--------|
| buj | bujta | bujtur (bujtë) | bujtje | bujtës |
|-----|-------|----------------|--------|--------|

6. më -ËJ:

| | | | | |
|-----|------|-----------------|-------|-------|
| bëj | bëra | bërë (ba, bamë) | bërje | bërës |
|-----|------|-----------------|-------|-------|

7. më -YJ:

| | | | | |
|------|-------|-------------|--------|--------|
| fryj | fryva | fryrë (fry) | fryrje | fryrës |
|------|-------|-------------|--------|--------|

8. më -AJ:

| | | | | |
|------|--------|------------------|---------|---------|
| laj | lava | larë (la) | larje | larës |
| mbaj | mbajta | mbajtur (mbajtë) | mbajtje | mbajtës |

9. më -IEJ:

| | | | | |
|------|-------|--------------------|--------|--------|
| ziej | zjeva | zierë (zie, ziemë) | zierje | zierës |
|------|-------|--------------------|--------|--------|

10. më -YEJ:

| | | | | |
|-------|-------|--------------|---------|----------------|
| kryej | kreva | kryer (krye) | kryerje | kryerës/kryes! |
|-------|-------|--------------|---------|----------------|

II. Foljet vokalike me mbaresë zero:

| | | | | |
|------|--------|------------------|---------|---------|
| vë | vura | vënë | vënie | vënës |
| nxë | nxura | nxënë | nxënie | nxënës |
| ngre | ngrita | ngritur (ngritë) | ngritje | ngritës |

III. Foljet të parregullta (supletive e josupletive):

| | | | | |
|---------|-------|----------------|-------------|-----------|
| a) kam | pata | pasur (pasë) | pasje/kamje | kamës(!) |
| b) vete | vajta | vajtur (vajtë) | vajtje | vajtës(!) |

IV. Foljet me temë në bashkëtingëllore:

1. Foljet me bashkëtingëllore pa cilësinë e prapashtesës:

| | | | | |
|----------|--------|--------------------|----------|----------|
| 1) mat | mata | matur (matë) | matje | matës |
| 2) dëlir | dëlira | dëllirur (dëllirë) | dëllirje | dëllirës |
| 3) marr | mora | marrë | marrje | marrës |

2. Foljet me bashkëtingëllore (me formant) me cilësinë e prapashtesës së mëvetësishme:

| | | | | |
|------------|----------|-----------------------|-----------|------------|
| 1) më -S: | | | | |
| a) mpiks | mpiksa | mpiksurr (mpiksë) | mpiksje | mpiksës(!) |
| b) stolis | stolisa | stolisurr (stolisë) | stolisje | stolisës |
| 2) më -AS: | | | | |
| trokas | trokita | trokiturr (trokitë) | trokitje | trokitës |
| 3) më -IS: | | | | |
| pajis | pajisa | pajisurr (pajisë) | pajisje | pajisës |
| (-ATIS): | | | | |
| bojatis | bojatisa | bojatisurr (bojatisë) | bojatisje | bojatisës |
| 4) më -OS: | | | | |
| hekuros | hekurosa | hekurosurr (hekurosë) | hekurosje | hekurosës |
| 5) më -IT: | | | | |
| kosit | kosita | kositurr (kositë) | kositje | kositës |
| radhit | radhita | radhiturr (radhitë) | radhitje | radhitës |
| 6) më -AT: | | | | |
| cijat | cijata | cijaturr (cijatë) | cijatje | cijatës? |
| rropat | rropata | rropaturr (rropatë) | rropatje | rropatës |

Të shohim në vazhdim këtë proces më në hollësi, sipas tipave, nëntipave, grupeve e nëngrupeve të caktuara.

I. Nga foljet me temë në zanore e togzanor:

1. Foljet më -OJ dhe emrat e vepruesit

Është i njohur fakti se "foljet e tipit më -OJ" (pa zgjerim dhe me zgjerim⁸⁶) si: punoj punova punuar. planëzoi planëzova planëzuar, hapëroj hapërova hapëruar etj., e përbëjnë "shumicën dërrmuese të sistemit foljor të shqipes" dhe se "ky është i vetmi tip prodhimtar në shqipen e dokumentuar" (Sh. Demiraj)⁸⁷ dhe së këtejmi del se edhe emrat e vepruesit mbi bazë të këtij tipi të foljeve janë në numër më të madh, kundrejt atyre që dalin në mbështetje të temës së caktuar të tipave të tjerë të foljeve.

⁸⁶ Shih artikullin e N. Veselajt "Foljet e prejardhura formuar me prapashtesën -O- me zgjerim" te gazeta "Rilindja", 16.IX. 1989 f. 12.

⁸⁷ Sh. Demiraj, Morfologjia historike e gjuhës shqipe, Prishtinë 1988, f. 675 dhe 763.

Ç`është e vërteta, gjatë zhvillimit historik dallohen dy mënyra të formimit të emrave prejfoljorë të vepruesit, nga foljet më -OJ që mbartin, si të thuash, karakteristikat e të dy dialekteve të shqipes. Mënyra e parë, ka të bëjë me formimet mbi bazë të pjesores së gegërishte: me togzanorin fundor -UE, ndërsa mënyra tjetër ka të bëjë me veten e parë të kohës së tashme të dëftores së toskërishtes më -ONJ fundor (kryesisht). Që të dyja këto mënyra, pasqyrohen edhe në gjuhën e sotme letrare, edhe pse kristalizimi është në përfundim të plotë, në të mirë të pjesores, siç u cek më sipër.

Për të pasur edhe më të qartë procesin rreth temës fjalëformuese të emrave përkatës të vepruesit nga foljet më -OJ, në vazhdim, sa për ilustrim, po shënoj procesin e zhvillimit të foljeve: punoj (me punue), besoj (me besue) dhe mësoj (me mësue), në të dyja variantet dialektore: toskërisht e gegërisht, si dhe trajtën e konsoliduar në gjuhën e sotme letrare, ashtu si edhe emrin e vepruesit mbi këtë bazë.

Skema e procesit të zhvillimit të disa foljeve më -OJ:

| ----- | | | | |
|-------------------------------------------------------------|-------------------|--------------------------------------------|--------|-------------------------|
| E tashmja e dëftores / gegërisht/letrarishtje e sotme | P j e s o r j a : | Emri i vepruesit toskërisht letrarishte | | |
| | | toskërisht/gegërisht e sotme | | |
| 1. punonj / punoj | punoj | punuar/punue | punuar | punonjës (!), punues |
| 2. besonj / besoj | besoj | besuar/ besue | besuar | besues |
| 3. mësonj / mësoj | mësoj | mësuar/ mësue | mësuar | mësues |

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm në gjuhën e sotme letrare është përvetësuar trajta e pjesores së toskërishtes punuar, besuar, mësuar, ndërsa për kohën e tashme të dëftores është përvetësuar trajta e gegërishtes punoj, besoj, mësoj, mirëpo në fjalëformim si temë e emrit të vepruesit u favorizua dhe u përvetësua trajta e variantit të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes më -UE fundore, siç janë shembujt: punues, besues, mësues. Ç`është e vërteta, nga kjo rregull paraqitet ndonjë përjashtim, siç është rasti punonjës, si rast i veçantë (i vetmuar) e ndonjë tjetër, siç do të shohim në vazhdim, por marrë në përgjithësi një gjedhe e tillë del mbizotërues në fjalëformim, i cili tashti paraqitet si një model i gjallë i standardizuar.

Emërtimet më -UE/S, formohen në mbështetje të foljeve më -OJ me prejardhje të mirëfilltë, si p.sh. **punues** nga punoj e kjo nga emri punë, **afrues** nga afroje e kjo nga ndajfolja afër. Po ashtu edhe nga foljet e huazuara, janë formuar emra të vepruesit më -UE/S, p.sh. emri **akuzues** del nga folja akuzoj e kjo nga fjala akuzë, **faturues** nga folja faturoj e kjo nga emri i huazuar faturë, **çimentues** nga folja çimentoje e kjo nga emri çimento, **regjistrues** nga folja regjistroje e kjo nga emri regjistër etj. Te shembujt e huazuar, ç`është e vërteta, mund të ketë pasur ndikim edhe trajta foljore e gjuhës së huaj.

Për konstatimin e fundit sa është i saktë ky supozim vërtetohet nga shembujt të tjerë, kur nga gjuha e caktuar është huajtur drejtpërdrejt folja e caktuar dhe këtë rast

menjëherë është bërë "përkthimi" a konvertimi i formantit prapashtesor foljor i gjuhës së caktuar me barasvlerësin përkatës të shqipes -O/j. Të rikujtojmë a krahasojmë këtë rast shembujt: këndoj (/lat. cantare), kërkuj (/lat. cercare) etj. dhe së këtejmi, edhe emrat e vepruesit: këndues, kërkues e kështu me radhë, pastaj sinjalizoj (/fr. signaliser) e së këtejmi sinjalizues, Po ashtu nga folja stigmatizoj del stigmatizues, nga ofroj ofrues etj.

Pothuajse të gjitha foljet më -O- të gjuhës sonë kanë zhvillim të ngjashëm siç ka b.f. folja mësoj:

mësoj mësova mësuar (mësue) mësim mësues

Përrjashtim nga kjo rregullësi bëjnë dy folje: mbroj dhe rroj, të cilat kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|---------|---------|--------------------|----------|-----------|
| mbroj | mbrojta | mbrojtur (mbrojte) | mbrojtje | mbrojtës; |
| rroj | rrojta | rrojtur (rrojtë) | rrojtje | rrojtës. |
| (rrnoj) | | (rrnue) | (rrnesë) | ? |

Si raste të veçanta po sjellim edhe zhvillimin e foljeve: çoj, çmoj, shkoj dhe shtroj (sipas rubrikave të njëjta që u zbatuan në pasqyrën paraprake në fillim të këtij nëntitulli):

| | | | | |
|--------|---------|------------------|------------------|----------|
| çoj | çova | çuar (çue) | çuarje | çues |
| çmoj | çmova | çmuar (çmue) | çmuarje/çmim | çmues |
| shkoj | shkova | shkuar (shkue) | shkuarje | shkues |
| shtroj | shtrova | shtruar (shtrue) | shtruarje/shtrim | shtrues. |

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm vetëm emri i veprimit bën përrjashtim nga modeli, siç u paraqit te shembulli *mësoj*, ngase emri i veprimit është përrftuar në mbështetje të trajtës së pjesores së shqipes së sotme letrare: **çuar**, **shkuar** plus prapashtesa -JE: çuarje, shkuarje. Te foljet çmoj e shtroj emri i veprimit del dy mënyrash: më -JE dhe më -IM: çmuarje/çmim, shtruarje/shtrim, mirëpo tek të gjitha rastet emri i vepruesit bëhet më -UE/S.

Është thënë më sipër e po e ritheksoj edhe tashti se në periudhën para njësimimit të shqipes letrare janë formuar emra të vepruesit edhe nga foljet më -OJ mbi bazë të dy mënyrave të fjalëformimit: mbi bazë të njëjësimit të së tashmes së dëftores dhe mbi bazë të pjesores së foljes së caktuar. Kështu, pothuajse, rregullisht në dialektin toskë janë formuar emra të vepruesit, në mbështetje të trajtës së kohës së tashme të dëftores. Po rikujtoj faktin se një dukuri e tillë vërehet që në dokumentet e hershme të gjuhës sonë të atij varianti. Kështu në Fjalorin e Likut ndeshëm në trajtën e emrit **përgjonjës** (përgjonj+Ë/S - përgjonjës). Edhe në Anonimin e Elbananit ndeshim në trajtën mësoj (mësoj + S - mësojs). Këtë mënyrë emërformimi e ndeshim në një shembull edhe në Fjalorin e "Bashkimit", por edhe në të folmet gege të Kosovës etj. (Shih: Dialektologjia shqiptare VI, Tiranë 1990, punimi i L. Mulakut "E folmja shqipe e Shalës së Bajgorës, ku përrmenden trajtat mësuesa, mësojsa, knojsa... aty f.

219).

Siç është cekur në kreun e mëparshëm të këtij punimi në Fjalorin e K. Kristoforidhit i hasim të dy variantet më -ONJ/ËS dhe më -UE/S d.m.th. edhe mbi bazë të dialektit jugor edhe mbi bazë të dialektit verior. Kështu në veprën e këtij autori ndeshim trajtat edhe mësues edhe mësonjës, shërues e shëronjës etj. Ndërsa në shkrimet e Naim dhe Sami Frashërit hasim vetëm trajtat më -ONJ/ËS.

Siç u përmend kalimthi më përpara, kufiri i tillë ndarës: -UES /-ONJËS duhet pranuar me kushtëzim, ngase edhe në shkrimet a të folmet toske mund të ndeshim trajta më -UAS, por edhe në shkrime a të folme geqe mund të ndeshim formime më -OJ/S.

Trajtat më -UE/S i hasim pothuajse rregullisht që nga shkrimtarët tanë të vjetër gegë e këndeje. Me fjalë të tjera, që të dyja mënyrat e formimit të emrave të vepruesit vazhduan të jenë aktive në etapën para, gjatë dhe pas Rilindjes sonë Kombëtare, deri në fazën e parë të etapës së normëzimit, kur më tepër për hir të njësimi të gjuhës sonë letrare në mënyrë të ndërgjegjshme u arrit parapëlqimi që të favorizohet mënyra më -UE/S ndaj asaj më -ONJËS a -OJ/S. Kështu që në FGJSSH (1980), pothuajse kryekëput mbizotëroi mënyra e formimit të emrave të vepruesit në mbështetje të pjesores më -UE/S, sidomos te foljet më -OJ⁸⁸.

Ç`është e vërteta, sipas FGJSSH-së ka mbetur si trajtë e normëzuar më -ONJ/ËS vetëm emri punonjës, me kuptimin "ai që punon në një ndërmarrje, në një kooperative, në një institucion" (FGJSSH f. 1573) si relik i traditës së mënyrës së fjalëformimit mbi bazë të vetës së parë njëjës të së tashmes së dëftores si temë fjalëformuese e prejfoljorit veprues. Është e vërtetë se forma tjetër më -UE/S **punues** ndeshet gjithnjë e mëshumë në përdorim, madje kjo trajtë del e angazhuar edhe në cilësinë e mbiemrit, por edhe në cilësinë e një emri a mbiemri që lidhet me kuptimësinë e një makine, mjeti etj. Në këtë kontekst del edhe përdorimi i trajtës **punonjës**, qoftë si emër a si mbiemër që lidhet gjithsesi me semantikën e njeriut. Krahaso: fshatarësia punonjëse, por makina punuese etj.

Në gjuhën letrare të njësuar, sipas FGJSSH-së në vazhdë të traditës së emrave më -ONJ/ËS ka mbetur edhe emri **shëronjës** (Shih: FGJSSH f. 1837), përkrah trajtës **shërues**, mirëpo për të dyja këto trajta referohet barsvlerësi **mjek**.

Po e cek më në fund se trajtat më -OJ/S, si mësojs, në dialektin e veriut të përfutuara pavarësisht apo nën ndikimin e mënyrës më -ONJ/ËS të toskërishtes, nuk u përhapën, edhe pse siç e pamë më sipër ndonjë trajtë më -OJ/S ndeshet qoftë në dialekte, qoftë në shkrime të autorëve të caktuar, ashtu siç mund të ndeshet në toskërishte edhe ndonjë emër më -UA/S, të përfutuara mbase nën ndikimin e mënyrës së tillë nga dialekti verior.

Që të dyja këto dukuri nuk paraqesin ndonjë gjë me vlerë a me ndikim që do të

88

Për që kjo mënyrë fjalëformimi favorizohet ndërgjegjësisht nga gjuhëtarët tanë mjafton të cekim qëndrimin e studiuesit M. Çeliku në artikullin "Mbi ngritjen në normë të emrave e të mbiemrave të tipit **sulmues**" të botuar te "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës" I, Tiranë 1973 f. 149.

rezikonin trajtën e përzgjedhur në letrarishten e sotme kombëtare.

2) Foljet më -UAJ dhe emrat e vepruesit

Në shqipen e sotme letrare, sipas lëndës së regjistruar në FGJSSH, janë një numër i kufizuar foljesh më -UAJ, gjithsej janë 20 e me derivate 26. Pasi këto folje nuk kanë formim të njëjtë të pjesores, përkatësisht të emrave përkatës të veprimit si dhe të vepruesit, në vazhdim po japim pasqyrën e plotë të këtyre foljeve si dhe zhvillimin përkatës të tyre. Këtë e bëjmë me qëllim që të konstatohen gjërat që janë zgjidhur e si janë zgjidhur si dhe të vërehet prirja për zgjidhjen edhe të rasteve të caktuara, të cilat paraqiten ende të pakonsoliduara.

Varësisht nga formimi i pjesores dhe të emrit të veprimit foljet e këtij tipi i ndajmë tri grupe, sipas pasqyrës së mëposhtme.

P a s q y r a e zhvillimit të foljeve më -UAJ

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|
| a) gatuaj shkruaj /parashkruaj, përshkruaj, shtypshkruaj/ paguaj /shpaguaj/ | | gatova shkrova | gatuar (gatie) shkruar (shkrue) | gatim shkrim | gatuese shkrues |
| b) bluaj /përbluaj/ shquaj /përshquaj/ shuaj truaj rruaj kruaj pruaj I pruaj II | | blova shqova shova trova rrova krova prova prova | bluar (blue) shquar (shque) shuar (shue) truar rruar/rrue kruar (krue) pruar pruar | - - shuarje - rruarje (rojë?) kruajtje (!) - - | bluarje shquarje/shqim shuarës(!) rrues (!) (krues) ? - - |
| c) druaj gjuaj huaj luaj ruaj vuaj quaj | druajta gjuajta huajta luajta ruajta vuajta quajta | druajtur gjuajtur/gjuejtë huajtur luajtur/luejtë ruajtur/ruejtë vuajtu(vuejtë) quajtur(quejtë) | druajtje (drojë?) - - - - - - | gjuajtje huajtje luajtje(lojë?) ruajtje (rojë) vuajtje - | ? gjuajtës (huajtës) (lojë)s ruajtës (rojë/s?) - - |

| | | | | |
|-----------------|---------------------|-----------------------|-----------------------|--------------------------|
| tëhuaj pruaj | tëhuajta pruajta | tëhuajtur pruajtur | tëhuajtje (projë?) | (tëhuajtës) (projës?) |
|-----------------|---------------------|-----------------------|-----------------------|--------------------------|

Siç po shihet nga pasqyra e mësipërme, shumica e foljeve të këtij tipi janë njërrrokëshe, nëse diftongu -UA- konsiderohet në funksion të një zanoreje. Foljet e prejardhura: parashkruaj, përshkruaj si dhe kompozita shtypshkruaj e bëjnë zhvillim e emrave prejpjesorë sikurse folja shkruaj, ashtu si edhe folja shpaguaj që e ndjek zhvillimin e foljes paguaj. Në anën tjetër foljet shquaj dhe përshquaj kanë zhvillim tjetër nga folja quaj (quajtur, quajtje quajtës), aty hyjnë në grupin tjetër: shquarje përshquarje a shqim përshqim me mundësi që emri i vepruesit të dalë: shquarës a shques, përkatësisht përshquarës a përshques.

Përrjashtim bën edhe folja kruaj (krova kruar), sepse emrin e veprimit nuk e ka të regjistruar kruarje, sikurse është në fjalorin drejtshkrimor⁸⁹, por e ka kruajtje, trajtë kjo nuk mbështetet në pjesoren e foljes në fjalë, por është si të themi krijim me analogji. Zgjon interes fakti se pikërisht nga kjo folje ka dalë emri i veglës në trajtën përkatëse: kruajtëse dhe kruës kruese, ndërsa emri i njeriut sipas veprimit (emri i vepruesit) nuk është shënuar fare në FGJSSH. Gjithsesi edhe ky rast mund dhe duhet të konsolidohet në kuadër të vetë modelit fjalëformues që po ceket këtu. Kështu që në burimet e tjera ,duhet të jetë e regjistruar edhe forma përkatëse e emërimit në shqyrtim.

Lidhur me paraqitjen e mësipërme sa i përket mënyrës fjalëformuese të emrave prejpjesorë nga foljet më -UAJ (emrave të veprimit dhe emrave të vepruesit) mund të nxirren konstatimet si vijon:

1. Tri foljet e para: gatuaj, shkruaj dhe paguaj⁹⁰ (me derivatet parashkruaj, përshkruaj, shtypshkruaj, shpaguaj) që formojnë grup më vete, emrat përkatës të veprimit si dhe ata të vepruesit i bëjnë sipas mënyrës që e bën grupi më i madh foljeve, atyre më -OJ, pra me prapashtesën -IM: gatim, shkrim, pagim, përkatësisht me prapashtesën -UE/S: gatus, shkruës, pagues. Edhe nga folja shquaj është zhvilluar emri shqim përkrah variantit shquarje si dhe mbiemrit shques, mirëpo sa i përket kriterit të ndikimit të pjesores së letrarishtes në fjalëformim kjo foljë më tepër përkon me foljet e tjera të grupit b).

Është e vërtetë se ekziston dukuria a prirja në shqipen letrare që mbi bazë të pjesores të krijohen emra të veprimit me prapashtesën -JE, jo vetëm siç është rasti shquarje, por edhe gatarje, shkruarje, paguarje, dukuri kjo që meriton vëmendje të posaçme, sepse këta emra po përdoren si trajta sinonime krahas emrave më -IM: gatim, shkrim, pagim. Mbase nga përdorimi paralele do të dalë i lejueshëm edhe zbërthimi sipas ndonjë nënfushe të caktuar semantike.

2. Nëntë foljet e grupi b), të cilat e bëjnë emrin e veprimit mbi bazë të pjesores së

⁸⁹ Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë 1976 f. 320.

⁹⁰ Foljet paguaj (it. pagare - me pague), shkruaj (lat. scrivere - me shkruë) si dhe gatuaj (me gatus) i ndeshim të shënuara me prapashtesën -O-j përkatësisht në Fjalorin e K. Kristoforidhit dhe në atë të "Bashkimit". Me sa duket kjo është edhe arsyeja e zhvillimit të emrit të veprimit më -IM dhe të vepruesit më -UE/S te ky nëngrup sikurse te foljet më -O-.

letrarishtes së sotme me prapashtesën -JE e jo nga pjesorja e ish-gegërishtes letrare, nuk e kanë të zhvilluar emrin përkatës të vepruesit, pos rasteve rrues e blues, trajta këto të trashëguara a të përfutuara me analogji, por që nuk janë aq aktive në letrarishten e sotme. Madje për trajtën rrues në FGJSSH preferohet emri i huazuar berber (Shih: FGJSSH f. 1716), prandaj mund të thuhet se mënyra e formimit të emrave të vepruesit nga ky grup i foljeve mbetet çështje e hapur. Mundësi rrugëzgjdhjeje janë dy:

e para, ka të bëjë me ndjekjen e rrugës së mbështetjes mbi bazë të pjesores së ish -variantit letrar të gegërishtes me -UE- fundor siç u përmendën shembujt: rrues e blues, por nisur nga kjo dukuri nuk do të jetë befasi, nëse ndeshen në burime të caktuara edhe rastet si p.sh. shques (shque), shues (shue) etj., edhe pse siç u cek më sipër, trajtat e tilla nuk dilnin të përgjithësuara para njësimit të gjuhës së sotme letrare;

e dyta, ka të bëjë me respektimin e pjesores së letrarishtes së sotme dhe sipas kësaj mënyre zgjidhja do të ishte kështu: bluarës (bluar), shquarës (shquar), shuarës (shuar) etj.

Meqenëse, siç u tha mënyra e parë, mbeti e papërgjithësuar dhe e dyta, ende nuk ka marrë formën e përgjithësimit dhe të përvetësimit, mund të thuhet se çështja e përfutimit të emërtimeve të caktuara ka mbetur çështje e hapur.

Sipas mendimit tim, pasi që pjesorja e ish gegërishtes letrare është pasivizuar për këtë nëntip foljesh, në njërën anë e në anën tjetër, pjesorja e letrarishtes së sotme mbizotëron pamëdyshje në formimin e emrave përkatës të veprimit si bluarje, shquarje, rruarje etj., atëherë formimi i emrave të vepruesit mbi këtë bazë do të jetë si mënyrë më e përligjur. Nëse favorizohet kjo mënyrë, e cila nuk është e pambështetje në logjikën e rrjedhës së sotme gjuhësore, atëherë nuk do të ketë nevojë të përftohen emërtimet e caktuara të njerëzve sipas veprimtarisë me analogji, siç del b.f. rasti kruajtje e kruajtës, pasi pjesorja e foljes është kruar e jo kruajt/ur.

3. Te foljet e grupit të tretë, të cilat aoristin e pjesoren e zgjerojnë me infiksin -JT- para mbaresës a prapashtesës temëformuese -UR, nuk paraqitet problemi i formimit të emrave të veprimit dhe së këtejmi edhe të emrave të vepruesit. Siç shihet nga pasqyra e mësipërme, pothuajse rregullisht emri i veprimit formohet në mbështetje të pjesores së ish-gegërishtes letrare me prapashtesën -JE si p.sh.: druajtje, gjuajtje, huajtje, luajtje, ruajtje etj. Ç`është e vërteta, sipas shembujve të kësaj pasqyreje vihet re se emrat e vepruesit nuk kanë dalë në të gjitha rastet e foljeve të këtij grupi, pos dy shembujve: gjuajtës dhe ruajtës. Mirëpo po të shikohet kjo çështje në kuadër të strukturës së përgjithsme fjalëformuese, atëherë edhe rastet e tjera në rast nevojë mund të formohen si emra vepruesi po mbi këtë bazë, si p.sh: huajtës, druajtës, vuajtës, quajtës etj.

Krijimet e tipit ruajtës, gjuajtës, krahaso sinonimet: rojë, rojës, rojtar për rastin e parë dhe gjuës, gjojës (!) për rastin e dytë, janë krijime relativisht të reja. Një pohim i tillë, nxirret nga analiza e temës fjalëformuese të emrit në fjalë. Siç dihet pjesorja (paskajorja e mirëfilltë) e ish-gegërishtes letrare dilte (me) ruejtë (ruej ruejta), (me) gjuejtë (gjuiej gjuejta), ndërsa në letrarishten e sotme pjesorja del përkatësisht: ruajtur, gjuajtur. Pra i ri është fenomeni i shndërrimit të diftongur -UE- në -UA- nga ndikimi i gjuhës së njësuar letrare. Pra, këtu është fjala, për pjesoren e ish-shqipës letrare mbi bazë të gegërishtes, e shfrytëzuar për emërtimin e emrave të njerëzve sipas

veprimtarisë. Diku jepet edhe shpjegimi se kemi të bëjme me pjesoren e letrarshes së sotme pa fundorin -UR, që është fakt më pak bindës sesa që është interpretimi i parë, kur dihet e vërteta se para njësimi të gjuhës letrare ekzistonin format: (me) gjuejtë, (me) ruejtë, por edhe emrat gjuejtës e ruejtës.

Te jem edhe më i qartë sigurisht në këtë dukuri ka ndikuar trajta e pjesores së gegërishtes⁹¹, ngase kishte përdorim më të gjerë në etapat e mëparshme sesa pjesorja e letrarshes së sotme, siç po thuhet, pa prapashtesën temëformuese -UR (të paqëndrueshme në fjalëformim) dhe se një rregull e tillë që është e pranuar edhe sot e kësaj dite do të dalë më e qartë tek tipat e tjerë të foljeve pikërisht nga shembujt që do të trajtohen në vazhdim të këtij punimi.

3. Foljet më -EJ dhe emrat e vepruesit

Tipi i foljeve më -EJ përfshin, "një numër të kufizuar foljesh dhe nuk paraqitet prodhimtar në gjuhën e dokumentuar" - thotë prof. Sh. Demiraj⁹². Në FGJSSH gjetëm 66 folje në -EJ fundor, por vetëm të disa sosh del i regjistruar emri i veprimit e akoma më në pak raste del i regjistruar emri i vepruesit, përkundër faktit se në jetën e përditshme sigurisht nga nevoja dalin përfitime të emrave të veprimit, por edhe të vepruesit mbi këtë bazë. P.sh. në rrethana të caktuara patëm rast të ndeshim emërtimin **urrejtës** që del nga folja urrej (me urrejtë) (Shih: gazeta "Rilindja" e datës: 3.II.1990, f. 12). Sigurisht, zhvillimi dhe përpunimi i gjuhës sfidon përfitim gjithnjë e më të madh edhe të emrave të tjerë mbi bazë të foljeve më -Ej.

Në mbështetje të formimit të pjesores dhe mundësisë që del mbi këtë bazë për formimin e emrave prejpjesorë, foljet më -EJ u ndanë në katër grupe, të cilat po i paraqitim në vazhdim:

a) Numri më i madh i foljeve më -EJ, 51 sosh, në letrarshen e sotme e bëjnë pjesoren me fundorin -YE/R. Te nja dhjetë prej tyre të këtij nëntipi del i zhvilluar d.m.th. i shënuar emri përkatës i veprimit më -IM si p.sh. arsej arsim, kërcej kërcim, përdëllej përdëllim, pastaj: shpërblej shpërblim, ngadhënjej ngadhënjim, përkthej përkthim, rrëmbej rrëmbim, shërbej, shërbim dhe rrëfej rrëfim.

Te shembujt e fundit janë pasqyruar edhe emrat përkatës të vepruesit si: përkthyes, shpërblyes, ngadhënjyes, rrëmbyes, shërbyes, rrefyes.

Si po shihet nga shembujt e mësipërm, nga foljet e këtij grupi janë formuar emrat përkatës të vepruesit në mbështetje të pjesores përkatëse të variantit të ish-gegërishtes letrare më -YE fundore, përkatësisht sipas interpretimit tjetër (për mendimin tonë jo aq bindës) nga trajta e letrarshes së sotme pa prapashtesën temë fjalëformuese -R, kurse

⁹¹ E pranojmë me rezervë shpjegimin e dhënë të "Gjuha letrare shqipe për të gjithë", Tiranë 1976, f. 211, ku thuhet se b.f. emri **shitës** del nga shit-UR, kurse emri **djegës** nga djeg-ËS. Mendoj se edhe te këta shembuj nuk duhet mohuar trajtën e pjesorës së ish-gegërishtes letrare: shitë-, djegë- dhe së këtejmi: shitë+S shitës; djegë+S djegës.

⁹² Shaban Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Prishtinë 1988, f. 675.

emrat e veprimit dalin me prapashtesën -IM, ashtu siç dalin edhe te tipi i foljeve më -OJ.

Sikurse emrat e vepruesit shërbyes, përkthyes etj. të zhvilluar mbi bazë të foljeve përkatëse shërbej (me shërbye), përkthej (me përkthye), s'ka pengesa të mos dalin edhe emrat përkatës edhe mbi folje të tjera të këtij grupi si b.f. nga foljet: ushqej, pëlqej, shkëmbej etj. Ç'është e vërteta, në jetën praktike nuk janë raste të rralla kur ndeshim emërtimet përkatëse si p.sh.: ushqyes, pëlqyes, shkëmbyes etj.

b) Një grup i vogël foljesh më -EJ, gjithsej pesë sosh, e bëjnë pjesoren më -T/UR, të cilët kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|-------|---------|--------------------|----------|-----------|
| brej | brejta | brejtur (brejtë) | brejtje | brejtës! |
| vërej | vërejta | vërejtur (vërejtë) | vërejtje | vërejtës! |
| rrej | rrejta | rrejtur (rrejtë) | rrenë | rrenës? |
| vlej | vlejta | vlejtur (vlejtë) | vlerë ? | ? |
| gjej | gjeta | gjetur (gjetë) | gjetje | gjetës. |
| lërej | lërejta | lërejtur (lërejtë) | ? | ? |

Siç po shihet nga shembujt e sjellë më sipër, vetëm te folja *gjej* (me *gjetë*) e ndeshim të regjistruar emrin e vepruesit **gjetës**⁹³, mirëpo edhe vetëm ky shembull mjafton me nxjerrë përfundimin se po kështu mund të gjejnë zgjidhje edhe emrat nga foljet brej brejtës e vërej vërejtës, kurse dy foljet e tjera rrej e vlej: rrënë rrënës, vlerë vlerës(?) që më parë kanë gjetur zhvillimin jashtë modelit, siç po paraqitet këtu.

Sikurse folja gjej në FGJSSH ka gjetur zgjidhje edhe folja **urrej**, pra urrejtje e urrejtës, edhe pse ajo ka tjetër zhvillim të aoristit si dhe të pjesores. Zhvillimi i saj është si vijon:

| | | | | |
|-------|--------|-----------------|----------|-----------|
| urrej | urreja | urryer (urryer) | urrejtje | urrejtës. |
|-------|--------|-----------------|----------|-----------|

Gjithsesi ky nëntip i foljeve më -EJ mund të inkorporohet në foljet më -T/UR, emri i vepruesit i të cilave formohet mbi pjesoren e ish-variantit letrar të gegërishtes, tipi *urrej me urrejtë urrejtës*.

c) Një grup tjetër i foljeve më -EJ, gjithsej gjashtë sosh, e formojnë pjesoren temëformuese më -RE dhe kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|---------|----------|----------|---------------|---|
| lej | leva | lerë | - | - |
| përbej | përbeva | përberë | - | - |
| përdhej | përdheva | përdherë | - | - |
| përgej | përgeva | përgerë | përgerje | - |
| ndej | ndeva | nderë | nderje/ndemje | - |

⁹³ Në këtë mënyrë gjeti zgjidhje edhe emri **urrejtës**, edhe pse folja urrej ka pjesoren urryer e jo urrejtur.

blej bleva blerë blerje blerës

Nga këto folje, siç po shihet e kanë të zhvilluar emrin përkatës të veprimit vetëm foljet pëgej pëgërje, ndej nderje si dhe folja blej blerje, nga kjo e fundit është zhvilluar edhe edhe emri i vepruesit blerës. Mbase edhe vetëm ky shembull do të mjaftonte sa për të treguar modelin më të përshtatshëm për zgjidhjen edhe të rasteve të tjera nga ky grup i foljeve. Prandaj, s'ka kurrfarë pengese që në rast nevojë të përftohen edhe emrat si p. sh. përgërës, nderës, lerës etj. Po ashtu, edhe pse nuk është në qendër të trajtimit tonë, po e përmendim faktin, se edhe emrat përkatës të veprimit mund të dalin sipas shembullit blerje e pëgërje. Me fjalë të tjera, s'duhet të ketë pengesa që të dalin emrat e veprimit: lerje, përdherje, përberje.

Rasti nderje që del edhe ndemje jep mundësinë e diferencimit të kuptimeve sipas pjesores së variantit të caktuar.

ç) Si grup më vete veçuan nja katër folje, të cilat e bëjnë pjesoren më -UR, mirëpo para kësaj parapashtesë temëformuese marrin një -H- epentetike. Këto folje kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|---------------------|--------|---------------|------------|------------|
| ngej | ngeva | ngehur | ngehje (!) | ngehës(!) |
| mbrej ⁹⁴ | mbreva | mbrehur | mbrehje(!) | mbrehës(!) |
| zbrej | | | | |
| mej | meva | mehur | mehje (!) | mehës(!) |
| zbej | zbeva | zbehur (behë) | zbehje (!) | zbehës(!) |

Nga ky grup foljesh në FGJSSH, siç po shihet më sipër, nuk del i shënuar asnjë emër përkatës as i veprimit as i vepruesit, por sipas mënyrës a gjedhes që praktikohet për shembuj të tjerë, kur pjesorja mbaron me një bashkëtingëllore, mendoj se fare natyrshëm mund të ndërtohen emrat përkatës, siç u shënuan më sipër, të shoqëruara me një pikë çuditëse. Pra më duket se fare nuk do të jetë befasi, nëse në të ardhmen jo të largët kur në burimet përkatëse normative si zhvillime të foljeve përkatëse të mësipërme të dalin të shënuar përpjesorët: ngehje ngehës, mbrehje mbrehës, mehje mehës, zbehje zbehës. Pra, është fjala për formimin e prejppjesorëve mbi bazë të trajtës së pjesores qoftë të variantit të gegërishtes: ngehë, mbrehë, mehë, zbehë, përkatësisht të letrarishtes së sotme si më sipër pa prapashtesën temëformuese -UR. Pra -H-ja epentetike e cila paraqitet në particip e jo edhe në aorist normalisht do të dalë e motivuar te tema fjalëformuese tek emrat prejppjesorë, mbase kjo -h mund të reflektohet edhe në të tashmën

Sidoqoftë, rreth formimit të emrave të vepruesit nga foljet më -EJ, siç u trajtuan më sipër, mund të nxjerrim përfundimin se varësisht nga pjesorja e grupit të caktuar dalin edhe nëntipat përkatës të emrave të vepruesit, p. sh:

⁹⁴ Trajta **mbrej** ndeshet në Fjalorin drejtshkrimor (f. 378), e cila në FGJSSH del e shënuar **mbreh** (f. 1092 dhe zhbreh (f.2259).

- më -YE/S, tipi: përkthyes, shërbyes;
- më -T/Ë/S, tipi: gjetës, brejtës, vërejtës;
- më -RË/S, tipi: blerës, lerës, përberës;
- më -HË/S: tipi mbrehës, zbehës.

Sigurisht nën ndikimin e modelit mënyrat fjalëformuese do të përthithin edhe shembuj të tjerë nga grupi i njëjtë i foljeve, edhe pse momentalisht nuk ndeshen të regjistruar në fjalorët tanë normativë të ditës.

E lyp puna që kjo çështje pasi të zërthehet mbase edhe më mirë e gjithanshëm nga kuadrot tanë kompetentë të zërë vend në tekstet përkatëse të gjuhës sonë standarde, pasi që hëpërhë një lëndë e tillë, me sa di, nuk del e trajtuar askund.

4) Foljet më -IJ dhe emrat e vepruesit

Në gjuhën e sotme, sipas materialit të vjelë nga FGJSSH-ja ndeshet një numër i kufizuar i foljeve më -IJ. Varësisht nga formimi i pjesores edhe ky tip folësh ndahet në dy grupe:

- ato folje të cilat e formojnë pjesoren me prapashtesën temëformuese -T/UR, siç janë foljet e nëntipi arrij arrita arritur që janë në numër mjaft të vogël dhe
- ato folje që e formojnë pjesoren me prapashtesën temëformuese -RË, siç janë foljet e nëntipit: *shkrij shkriva shkrire*.

a) Foljet e grupit të parë me prapashtesën temëformuese -T/UR kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|------------|-------------|----------------------|--------------|--------------|
| arrij | arrita | arritur/arritë | arritje | arritës |
| mbërrij | mbërrita | mbërritur (mbërritë) | mbërritje | mbërritës |
| mërij | mërita | mëritur (mëritë) | mëritje | mëritës |
| karakëllin | karakëlliti | karakëllitur | karakëllitje | karakëllitës |
| bredhërij | bredhërita | bredhëritur | bredhëritje | ? |
| ulerij | ulërita | ulëritur (zlëritë) | ulëritjr | ulëritës |

b) foljet e grupit të dytë që janë në numër më të madh kundrejt grupit të parë kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|--------|---------|-----------------|-------------------|-------------------|
| fshij | fshiva | fshirë (fshi) | fshirje (fshimje) | fshirës |
| grij | griva | grirë (gri) | grirje | grirës |
| lëpij | lëpiva | lëpirë (lëpi) | lëpirje | lëpirës (lëpis?) |
| shkrij | shkriva | shkrire (shkri) | shkriroje | shkrires(shkris?) |

Zhvillim të tillë si më sipër kanë edhe disa folje të tjera, siç janë:

| | | |
|----------|----------|-----------|
| thëthij, | thëthiva | thëthirë; |
| tështij | tështiva | tështirë; |
| dërsij | dërsiva | dërsirë |

Mirëpo te këto folje emri përkatës i veprimit nuk del i përfutur nga pjesorja përkatëse, por del i përfutur nën ndikimin e analogjisë me foljet e tjera që e kanë temën e pjesores me prapashtesën temëformuese -T/UR. Ja si dalin të regjistruar emrat e veprimit:

thëthitje, tështitje, djersitje dhe duke u mbështetur në formën e emrit të veprimit edhe emri i vepruesit të foljeve të tilla mund të dalë mbi këtë bazë, pra: thëthitës, tështitës, djersitës. Kjo çështje vetvetiu del e diskutueshme, ngase bën përjashtim nga praktika e sendërtuar për tipa e grupe foljesh të tjera, siç u panë më sipër.

Një zgjidhje kësodore do ta bënte të pranueshëm dhe të arsyeshëm veprimin e tillë, vetëm atëherë nëse ekzistojnë edhe trajta sinonimike paralele, siç është folja djersit kundrejt djersij (që u cek më sipër), kështu që për formimin e emrit përkatës, kur është fjala për konceptin e njëjtë, mund të shfrytëzohet trajta e foljes sinonime tjetër, përndryshe kur kemi të bëjmë me koncepte të ndryshme dhe në rastet kur mungojnë trajtat sinonimike paralele, çështja e zgjidhjes së tillë paraqitet si çështje e diskutueshme. Prandaj themi se duke u mbështetur në modelin e zgjidhjes së rasteve të tjera të këtij grupi të foljeve sipas rregullit edhe emri i veprimit edhe ai i vepruesit mundet me dalë mbi bazë të pjesores së foljes, pra: thëthirje thëthirës; tështirje tështirës, dërsirje dërsirës(!). Pra, s'ka arsye të mëdha, që të bëhet përjashtim vetëm për këto tri raste. Sidoqoftë, kjo dukuri lypset sqaruar, dhe lidhur me këtë kompetentët duhet me marrë qëndrim.

Në burime të caktuara, ndeshen trajta të përfutuara të emrave të vepruesit në mbështetje të pjesores së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes si p.sh. fshis (fshi+ S fshis), gris (gri+S gris) etj. - trajta këto nga pjesorja e gegërishtes: me fshi, me gri, të cilat janë lënë jashtë normës së sotme letrare, mbase pa shkak(!) për shkak të paskajores si mirëfilltë të pa përfillshme nga normëtzimi actual (!?).

5) Foljet më -UJ dhe emrat e vepruesit

Në FGJSSH gjetëm vetëm tri folje më -UJ fundore: buj, përbuj dhe mbruj, të cilat kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|--------|----------|-----------------------|-----------|-------------|
| buj | bujta | bujtur (bujtë) | bujtje | bujtës |
| përbuj | përbujta | përmbujtur (përbujtë) | përbujtje | përbujtës |
| mbruj | mbrojta | mbrujtur (mbrujtë) | mbrujtje | mbrujtës(!) |

Edhe foljet më -UJ e bëjnë pjesoren më -T/UR dhe në mbështetje të pjesores (të trajtës së ish-gegërishtes letrare) janë formuar emrat përkatës të veprimit, përkatësisht të vepruesit si: bujtë bujtje bujtës.

6) Foljet më -ËJ dhe emrat e vepruesit

Në FGJSSH volëm këto folje më -ËJ fundore: bëj, përbëj dhe zhbëj.

Dy foljet e fundit janë të prejardhura nga folja bazë: bëj (me bë, bërë), e cila ka këtë zhvillim:

| | | | | |
|-----|------|-----------------|---------------|-------|
| bëj | bëra | bërë (ba, bamë) | bërje (bamje) | bërës |
|-----|------|-----------------|---------------|-------|

Gjithsesi trajta e emrit prejpjesor mbi trajtën e letrarishtes së sotme me prapashtesën

temëformuese -RË: **bërë** del më e mbështetur në krahasim me trajtat mbi bazë të variantit të pjesores së gegërishtes; ba a bamë bas a bamës a banës (!), siç mund të ndeshet në burime të caktuara nga e kaluara.

Pra, edhe emrat prejpjesorë nga foljet më -ËJ dalin mbi bazë të pjesores së shqipes së sotme letrare.

7) Foljet më -YJ dhe emrat e vepruesit

Të gjitha foljet më -YJ, të cilat u volën nga FGJSSH e bëjnë pjesoren më -RË dhe kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|-----------|----------|-------------------|----------------------------|-----------|
| hyj | hyra | hyrë (hy) | hyrje | hyrës |
| ndërhyj | ndërhyra | ndërhyrë (ndërhy) | ndërhyrje | ndërhyrës |
| ndërhyrës | | | | |
| fryj | fryva | fryrë (fry) | fryrje | fryrës |
| shtyj | shtyva | shtyrë (shty) | shtyrje | shtyrës |
| pështyj | pështyva | pështyrë (pështy) | pështyrje | pështyrës |
| shfryj | shfryva | shfryrë (shfry) | shfryrje (shfrymje) | shfryrës |
| mësyj | mësyva | mësyre (mësy) | mësyrje mësyre(!)(mësymës) | |

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm vetëm foljet **hyj** e **ndërhyj** e bëjnë të kryerën e thjeshtë më -R-, kurse të tjerat e bëjnë më -V/a, mirëpo emrat përpjesorë tek të gjitha rastet dalin njësoj. Të vihet re, se emri i vepruesit në gjuhën e sotme letrare formohet mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme më -RË fundore: hyrës, ndërhyrës, fryrës, shtyrës, pështyrës, shfryrës.

Është e vërtetë se nga ky tip foljesh në burime të caktuara mund të hasen edhe trajta të emrave prejpjesorë të formuar në mbështetje të pjesores së varianteve të ish-gegërishtes letrare d.m.th. pa -RË fundore, si p.sh. hys e hymës, frys e frymës etj., të cilat në letrarishten e sotme u lanë jashtë modelit të favorizuar, por në rast nevojë për koncepte të veçanta mbase mund të shfrytëzohen edhe trajtat si b.f. mësyj mësymje mësymës, shtyj shtymjë shtys a shtymës etj., trajta këto që nuk rrezikojnë standardizimin e trajtave tashmë të normëzuara.

8) Foljet më -AJ dhe emrat e vepruesit

Edhe foljet më -AJ fundore në gjuhën e sotme letrare e bëjnë pjesoren me prapashtesën -RË. Foljet e këtij tipi e kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|-----------|------|-----------|-------|-------|
| laj | lava | larë (la) | larje | larës |
| /përlaj | | | | |
| shpërlaj/ | | | | |

| | | | | |
|------------|--------|---------------|------------|------------|
| thaj | thava | tharë (tha) | tharje | tharës |
| /përthaj/ | | | | |
| qaj | qava | qarë (qa) | qarje | qarës |
| çaj | çava | çarë (ça) | çarje | çarës |
| ndaj | ndava | ndarë (nda) | ndarje | ndarës |
| /përndaj/ | | | | |
| shpërndaj/ | | | | |
| ngjaj | ngjava | ngjarë (ngja) | ngjarje(!) | ngjarës(!) |
| shaj | shava | sharë (sha) | sharje | sharës |

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm emrat përkatës të vepruesit formohen mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme, duke e marrë prapashtesën -S: larës, tharës, ndarës etj., mirëpo në burime të ndryshme të traditës, por edhe në ditët tona ndodh që të hasen edhe trajta në mbështetje të pjesores së gegërishtes (madje në të dy variantet) si p.sh. qas e qamës (qarës), las e lamës (larës), ashtu si edhe emrat e veprimit lamje, thamje, shamje etj., trajta këto të cilat tashmë kanë mbetur trajta të pafavorizuara, duke u konsideruar si të diskutueshme.

Kur është fjala për të njëjtin koncept vërtet mund të konsiderohen si të vjetëruara, por nëse është fjala për ndonjë nuancë kuptimore a stilistike të veçantë, mbase trajtat e tilla mund të diskutohen me qëllim (ri)aktivizimi. S'do mend, mënyra e formimit mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme gjithsesi del si zgjidhje mbizotëruese.

Në tipin e foljeve më -AJ fundor bën pjesë edhe folja **mbaj** dhe derivati i saj **përmbaj**, e cila ka tjetër zhvillim nga sa u përmend më sipër, sepse pjesorja e foljes së tillë del me -T/UR

si p. sh.:

| | | | | |
|---------|-----------|------------------------|------------|------------|
| mbaj | mbajta | mbajtur (mbajtë) | mbajtje | mbajtës |
| përmbaj | përmbajta | përmbajtur (përmbajtë) | përmbajtje | përmbajtës |

Pra, emrat e veprimit dhe ai i vepruesit dalin mbi bazë të pjesores së shkurtër te gegërishtes.

9. Foljet më -IEJ dhe emrat e vepruesit

Foljet më -IEJ e bëjnë pjesoren më -R dhe kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|---------|----------|------------|-----------------|-----------|
| ziej | zjeva | zier (zie) | zierje (ziemje) | zierës |
| përziej | përzjeva | përzier | përzierje | përzierës |
| ndiej | ndjeva | ndier | ndierje | |

Nga shembujt e mësipërm del qartë se në mbështetje të pjesores së letrarishtes së sotme janë formuar edhe emrat përkatës të veprimit, ashtu edhe emrat përkatës të vepruesit, si: zierje zierës, përzierje përzierës dhe se pikërisht mënyra e formimit të tillë vlen të vihet në pah, sepse në burime të caktuara jo vetëm të traditës, por tek-tuk

edhe tashti, mund të ndeshen trajta në mbështetje të pjesores së zgjeruar të gegërishtes, si: ziemje e përziemje, por edhe ziemës (zies) përziës a përziemës. Megjithatë në letrarishten e sotme, sa kam vërejtur edhe te ne, trajtat zierës, përzierës dalin më të qëndrueshme se ato të gegërishtes, kurse emrat ziemje, pëziemje ndaj zierje përzierje dalin të përdorura më shpesh, të cilat në raste të caktuara prirën të shprehin nuancim tjetër semantik (më konkret) nga trajta e letrarishtes së sotme. Gjithsesi rastet e tilla pragmatikisht ia vlen të vlerësohen.

10. Foljet më -YEJ dhe emrat e vepruesit

Edhe foljet më -YEJ në letrarishten e sotme e bëjnë pjesoren me prapashtesën temëformuese -R dhe kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|----------|----------|------------------|------------|-----------------------|
| kryej | kreva | kryer (krye) | kryerje | kryerës (kryes) |
| ngjyey | ngjeva | ngjyer (ngjye) | ngjyerje | ngjyerës (ngjyes) |
| lyej | leva | lyer (lye) | lyerje | lyerës (lyes) |
| gërryey | gërreva | gërryer (gërrye) | gërryerje | gërryerës (gërryes) |
| shqyey | shqeva | shqyer (shqye) | shqyerje | shqyerës (shqyes) |
| përkryey | përkreva | përkryer | përkryerje | përkryerës (përkryes) |
| etj. | | | | |

Lidhur me formimin e emrave prejpjesorë nga ky tip i foljeve dalin çështje ende të pakonsoliduara, madje edhe të diskutueshme. Krahas trajtave të formuara mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme, dalin në konkurrencë edhe trajta mbi bazë të pjesores së gegërishtes. Kështu krahas kryerje, ngjyerje, lyerje, gërryerje etj., dalin trajtat kryemje, ngjyemje, gërryemje etj, si emra të veprimit, por gjithashtu edhe krahas emrave të vepruesit: kryerës, ngjyerës, lyerës, gërryerës dalin trajta: kryes, ngjyes lyes, shqyes, përkryes - pra në mbështetje të pjesores përkatëse të variantit të gegërishtes.

Ndërsa për emrat e veprimit mund të thuhet a të konstatohet se në gjuhën e njësuar letrare janë mbizotëruese trajtat mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme si kryerje, përkryerje etj, për trajtat e emrit të vepruesit mbizotërimi në burime të caktuara te ne nuk del i plotë, edhe pse trajtat mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme gjithnjë e më shumë po stabilizohen

Ç'është e vërteta, nga ky grup i foljeve në FGJSSH vetëm te folja lyej është regjistruar emri i vepruesit dy trajtash: **lyerës** edhe **lyes**. Trajta e parë si sinonim i barasvlerësve bojaxhi e ngjyruës, ndërsa trajta e dytë lyes me kuptim figurativ, sinonim i emrave: krushqar, shkues. Te folja gërryey është shënuar emri gërryes si emër vegle e jo si emërtimi i njeriut sipas veprimtarisë.

Me fjalë të tjera, ma merr mendja, se në raste të tilla duhet të ruhet edhe trajta mbi bazë të pjesores së gegërishtes, pra kur është fjala për të dalluar emrin e njeriut sipas profesionit, nga emri i veglës, e cila kryen funksion të ngjashëm sikurse njeriu si veprues. Kur është fjala të kuptimet figurative, çështja as që duhet të diskutohet. Gjithsesi kjo që sapo u cek rreth dallimit të nuancimeve kuptimore: emër njeriu /

emër vegle (makine, pajisje etj.) del si çështje e diskutueshme, mirëpo kur është fjala te emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë trajtat mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme duhet të favorizohen kundrejt atyre mbi bazë të pjesores së gegërishtes.

Në kontekst të përgjithshëm, sipas mendimit tim, del e nevojshme të theksohet analogjia a ndërndikimi që ekziston në mes të foljeve më -YEJ dhe të atyre të një grupi të caktuar më -EJ. Për të qenë paraqitja më e qartë po i jap në pëqasje njëri me tjetrin dy shembuj, nga një për secilin tip të foljeve. Konkretisht po jap zhvillimin e foljeve: **kryej** e **përkthej**:

- | | | | | |
|-------------|-----------|----------------------|----------|-----------------|
| 1. kryej | kreva | kryer (krye) | kryerje | kryerës (kryes) |
| 2. përkthej | përktheva | përkthyer (përkthye) | përkthim | përkthyes |

Siç po shihet nga këta dy shembuj, vërtet, pjesorja është identike më -YE/R për të dy tipat e foljeve, mirëpo formimi i emrit prejpjesor përkatës ndryshon plotësisht. Te foljet më -EJ emri i veprimit bëhet me prapashtesën -IM (si te foljet më -OJ), ndërsa te foljet më -YEJ bëhet me prapashtesën -JE. Emri i vepruesit te foljet më -EJ (te nëntipi përkthej) formohet me prapashtesën -S, mbi pjesoren e ish-gegërishtes letrare më -YE fundore: përkthye përkthyes, ndërsa te foljet e tipit më -YEJ emri i vepruesit, siç ndeshet në burime të ndryshme, mund të dalë dy mënyrash: mbi pjesores e gegërishtes më -YE: *krye kryes* ose mbi pjesoren e letrarishtes së sotme (toskërishtes): *kryer kryerës*⁹⁵. Kjo çështje ende nuk është konsoliduar plotësisht te ne, por gjykuar sipas prirjes, prestigjit dhe autoritetit të gjuhës së njësuar letrare ka gjasa që ashtu sikurse emri i veprimit, të konsolidohet edhe emri i vepruesit, d.m.th. mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme: *kryer kryerje kryerës* e kështu me radhë.

Favorizimi i një mënyre të tillë del i qëndrueshëm edhe për një arsye tjetër se trajta e tillë e zgjeruar nuk lë shteg për dyfishimin e prapashtesës -S, siç ka ngjarë b.f. të rastet: vrasës, dorasës, gërgasës, madje edhe kryesës, siç doli në gazetën "Bujku" më 22.VIII.1992 f. 5.

II. Foljet vokalike me mbaresë zero dhe emrat e vepruesit

Nga foljet me temë në zanore, të cilat në njëjësin e dëftores, veta e parë, dalin me mbaresë zero, përftohen emrat e vepruesit kryesisht mbi bazë të pjesores përkatëse, por jo të gjitha mbi trajtën e caktuar, qoftë mbi atë të letrarishtes së sotme, qoftë të ish-gegërishtes letrare. Më poshtë do të shohim zhvillimin e foljeve të tilla:

| | | | | |
|----|------|------|-------|-------|
| vë | vura | vënë | vënie | vënës |
|----|------|------|-------|-------|

⁹⁵ Sa për ilustrim po shënojmë se në gazetën "Rilindja", 24. IV. 1990, f. 8 doli emërtimi "kryes i veprës", ndërsa te gazeta "Fjala" nr. 8/87 "kryerës i punëve dhe detyrave", ndërsa në Fjalorin terminologjik serbokroatisht - shqip, Prishtinë 1979, f. 163 si barasvlerës i fjalës kryerës në serbokroatishte del "u_inilac".

| | | | | |
|------|--------|------------------|-------------------|--------------------|
| zë | zura | zënë | zënie | zënës |
| nxë | nxura | nxënë | nxënie | nxënës; |
| ngre | ngrita | ngritur (ngritë) | ngritje | ngritës |
| di | dita | ditur (ditë) | dije ditje(?) (!) | dijës (!)ditës (?) |
| pi | piva | pirë (pi) | pije/pirje | pirës |

Tri foljet e para kanë zhvillim të ngjashëm pasi që edhe formimi i pjesores u del njësoj me prapashtesën temëformuese -NË. Folja **ngre** (me ngritë) e bën pjesoren ngritur (geg. ngritë) me -T(ë)-në shtuese, prej andej del edhe emri i veprimit si dhe ai i vepruesit: ngritje ngritës, mënyrë kjo që nuk është praktikuar te folja di (me dijtë), edhe pse edhe te ajo pjesorja ndërtohet ngjashëm si te shembulli ngre ngritur // di ditur.

Nga folja di (me dijtë), jo nga pjesorja po nga njëjësi është formuar emri i veprimit dije si dhe emri i vepruesit dijës, me një -J- epentetike. Pra vetëm te kjo folje kemi përjashtim. Mbase, përjashtimi i tillë është përgjithësuar nën ndikimin e homonimisë që shkaktohet me fjalën **ditë dita**⁹⁶. Siç dihet, edhe trajtat ditje ditës nuk janë jashtë modelit dhe nëse zënë të praktikohen një ditë do të kenë mbështetje pikërisht në sistem, përkatësisht në modelin fort të kapshëm e të njohur fjalëformues.

Edhe te folja pi (me pi) kemi zhvillimin pije, mirëpo kjo në gjuhën letrare nuk e ka kuptimin e emrit të veprimit, prandaj edhe doli emri përkatës pirje (pimje) si dhe emri i vepruesit pirës, që të F. Bardhi dilte në trajtën pis (pi+S pis), trajtë kjo që nuk pati përgjithësim, mbase edhe kjo për shkak të fjalës homonime të huazuar **pis** (pissllëk). Kujto shprehjen popullore: "Nuk ka fis pa pis, por nuk duhet të ketë as fis pa pris".

Edhe lidhur me këtë që sa po u cek vërehet mundësia e diferencimit të emrave prejpjesorë për nga kuptimi, kështu që prejpjesorët mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme tregojnë emra të mirëfilltë të veprimit e të vepruesit, siç është rasti pirje, pirës dhe emrat prejpjesorë mbi bazë të pjesores ose paskajores së mirëfilltë të gegërishtes tregojnë emrin e një sendi konkret dhe atë të njeriut që lidhet me të, siç është rasti pije pijës.

III. Foljet e parregullta (supletive e josupletive dhe emrat e vepruesit

Në vazhdim do të shohim se si janë zhvilluar emrat përkatës të vepruesit nga foljet e parregullta: a) supletive dhe b) ato josupletive.

a) Procesi i zhvillimit të foljeve të parregullta supletive është si vijon:

⁹⁶ Prof. E. Murtezai në punimin "Disa çështje. propozime dhe dilema lidhur me terminologjinë filozofike në shqipe" të botuar te "Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, Prishtinë 1988, f. 157, shpreh mendimin se më e mbështetur logjikisht e ndërtimisht forma nën/**ndërditje** sesa ajo nën/**ndërdije**.

| | | | | |
|------|--------|-----------------|-----------------|----------------|
| jam | qeshë | qenë | qenie | ? |
| kam | pata | pasur | pasje/kamje | kamës |
| bie | prura | prurë(pru) | prurje | prurës |
| ha | hëngra | ngrënë | ngrënie/hamje | ngrënës/hamës |
| bie | rashë | rënë (ra) | rënie/ramje | rënës (!) |
| jap | dhashë | dhënë | dhënie | dhënës |
| rri | ndenja | ndenjur(ndejë) | ndenjje (ndejë) | ndenjës(?) |
| shoh | pashë | parë (pa, pamë) | pamje | pamës/parës(!) |
| vij | erdha | ardhur(ardhë) | ardhje | ardhës |

Në këtë grup foljesh dalin mjaft çështje që tërheqin vëmendjen, sepse ndodhin mjaft përjashtime nga "rregullia" e zhvillimit që është përmendur për tipat e grupet e tjera që janë trajtuar më sipër.

Nga foljet jam (me qenë) dhe shoh (me pa), sipas FGJSSH-së nuk është zhvilluar emri i vepruesit, ndërsa nga folja bie (me ra, rënë) është përfutur vetëm mbiemri rënës, po kjo nuk do të thotë se mbi këto folje nuk mund të dalë edhe emri i vepruesit, nëse paraqitet e nevojshme si p.sh.: qenës, parës a pamës. Ç`është e vërteta, në kompozita trajta -pamës si largpamës shkurtpamës etj. del normalisht, madje largpas ndeshet në burime të caktuara nga shqipja e dokumentuar si p. sh. në shkrimet e Nikollë Ivanajt (të vitit 1916).

Veçori paraqiten edhe lidhur me foljen kam (me pasë, pasur), sepse te kjo është përfutur emri i vepruesit në mbështetje të së tashmës së dëftores kam kamës e jo nga pjesorja pasës (paskanik), edhe pse mbi këtë bazë e ndeshim edhe në shkrimet e P. Bogdanit **pas** e herë herë edhe tash në formën me përsëritje të parapashtesës **pasës**. Edhe më karakteristik del rasti te folja ha (ngrënë) ngase te kjo është zhvilluar emri i vepruesit në dy variante: edhe në mbështetje të së tashmës së njëjësit të dëftores **ha hamës** edhe mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme: **ngrënë ngrënës**. Te P. Vasë Shkodrani ndeshim foljet: *me hangër* edhe *me ngranë*.

Te shembujt e tjerë, siç po shihet, respektohet pjesorja përkatëse sipas rregullave tashmë të praktikueshme.

b) Te foljet e parregullta josupletive del zhvillimi si më poshtë:

| | | | | |
|------|--------|------------------|----------|-----------|
| them | thashë | thënë | thënie | thënës(!) |
| lë | lashë | lënë | lënie | lënës(!) |
| dua | desha | dashur (dashtë) | dashje / | |
| vdes | vdiqa | vdekur ((v)dekë) | vdekje / | |
| vete | vajta | vajtur (vajtë) | vajtje | vajtës(!) |

Edhe pse nga tek asnjëra nga foljet, siç del nga lënda e regjistruar në FGJSSH, nuk është përfutur, përkatësisht nuk del i shënuar emri përkatës i vepruesit, në bazë të gjedhes që praktikohet për tipa e grupe të tjera të foljeve mund të nxirret konstatimi se, në rast nevojë edhe te këto folje mund të dalë siç edhe po del faktikisht fare

natyrshëm mbi bazë të pjesores përkatëse emri i vepruesit si p.sh.: thënës, lënës, dashës, vdekës, vajtës, pa i kontestuar shembujt si b.f.: vdektar, dashnor, lëneshë etj. Për këtë mjafton të rikujtojmë kompozitat: arsimdashës, mirëvajtës, mbarëvajtës etj.

IV. Foljet me temë në bashkëtingëllore dhe emrat e vepruesit

Të gjitha foljet në temë me bashkëtingëllore, d.m.th. atyre që e tashmja e dëftores veta e parë njëjës u mbaron me bashkëtingëllore u ndanë në dy grupe:

- 1) grupi i parë, ku përfshihen foljet me temë në bashkëtingëllore pa cilësinë e prapashtesës dhe
- 2) grupi i dytë, ku përfshihen ato folje me temë në bashkëtingëllore a formant me cilësinë e parapashtesës së mëvetësishme.

1) Foljet me temë në bashkëtingëllore pa cilësinë prapashtesës dhe emrat e vepruesit

Duke u mbështetur në veçoritë që i karakterizojnë lidhur me formimin e pjesores dhe së këtejmi dhe të emrit të vepruesit, foljet e këtij grupi i ndajmë në katër nëngrupe:

1. Më poshtë po shënojmë zhvillimin karakteristik të disa foljeve të nëngrupit të parë si shembuj përfaqësues:

| | | | | |
|---------|----------|----------------------|-----------|-----------|
| mat | mata | matur (matë) | matje | matës |
| këput | këputa | këputur (këputë) | këputje | këputës |
| korr | korrës | korrur (korrë) | korrje | korrës |
| gdhend | gdhenda | gdhendur (gdhendë) | gdhendje | gdhendës |
| mih | miha | mihur (mihë) | mihje | mihës |
| prashit | prashita | prashitur (prashitë) | prashitje | prashitës |
| dëllir | dëllira | dëllirur (dëllirë) | dëllirje | dëllirës |
| pres | prita | pritur (pritë) | pritje | pritës |

Zhvillim të ngjashëm kanë pothuajse të gjitha foljet me temë në çfarëdo bashkëtingëllore. Përfundim bën folja **pres** (me pre), e cila ka këtë zhvillim:

| | | | | |
|------|-------|-------------|----------------|--------|
| pres | preva | prerë (pre) | prerje (presë) | prerës |
|------|-------|-------------|----------------|--------|

Kjo folje shkon më tepër me nëngrupin e foljeve më -EJ: **prej** preva sikurse **blej** bleva etj., prandaj, nëse ripozicionohet kjo folje në grupin më -EJ nuk do të ishte kurrfarë befasi. Sidoqoftë, edhe ky përfundim nga modeli i zhvillimit të tashëm mund të diskutohet.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm përfaqësues të gjitha foljet e këtij nëngrupi kanë zhvillim të rregullt lidhur me formimin e emrave të veprimit ashtu si edhe të

vepruesit, mirëpo lidhur me këtë me të drejtë shtrohet pyetja, cila është tema fjalëformuese e emrave të prejardhur prejfoljorë: njëjësi i dëftores veta e parë ose pjesorja? Madje, cila nga variantet e pjesores ajo e ish-gegërishtes letrare, apo trajta e pjesores së letrarishtes së sotme pa prapashtesën temëformuese -UR?

Përgjigja në pyetjet e shtruara mund të jepet në këto tri variante a mënyra të mundshme:

Së pari, nëse konsiderohet se si temë fjalëformuese shërben veta e parë njëjës e dëftores, atëherë forma e prapashtesës del -ËS mat + ËS: matës.

Së dyti, interpretimi mund të bëhet edhe duke e trajtuar a shpjeguar se prapashtesa del gjithashtu në trajtën -ËS, nëse konsiderohet se si temë fjalëformuese shërben trajta e pjesores së letrarishtes së sotme pa prapashtesën temëformuese -UR, p.sh. mat mat-UR matËS.

Së treti, interpretimi mund të bëhet duke e konsideruar se si temë fjalëformuese shërben pjesorja e ish-variantit letrare të gegërishtës më -Ë fundore, atëherë si trajtë e prapashtesës pranohet vetëm formanti -S, ngase -Ë -ja del si pjesë përbërëse e pjesores, kështu nga mat matë (me matë) del matës.

Sqarimi i mësipërm del i nevojshëm për të shpjeguar formën e vërtetë të prapashtesës në rastet e tilla. Dhe lidhur me këtë se cili interpretim del më i mbështetur kam mendimin se interpretimi që del mbi trajtën e pjesores së ish -gegërishtes letrare është më bindës. Bindjen e tillë e mbështes në këto dy arsye:

e para, pjesorja është trajtë bazë më e fortë dhe logjikisht më stabile që shërben si temë fjalëformuese për formimin e emrave të vepruesit tek të gjitha tipat e foljeve dhe

e dyta, veta e parë e së tashmes së dëftores nuk paraqitet e qëndrueshme edhe te disa shembuj të këtij nëngrupi të foljeve, sidomos te foljet me -T-në fundore, si p.sh. mat mas, kështu që bashkëtingëlloret T e S paraqiten si variante paralele, por nëse shikohet pjesorja (më drejtë paskajorja me + pjesore) si trajtë përfaqësuese, atëherë T-ja del më e mbështetur morfologjikisht.

2. Në nëngrupin e dytë u përfshinë foljet apofonike si dhe ato, të cilave pjesorja në letrarishten e sotme nuk u ndryshon në krahasim me variantin letrar të gegërishtes letrare. Ja disa shembuj:

| | | | | |
|-------|--------|--------|---------|------------|
| vjel | vola | vjelë | vjelje | vjelës |
| sjell | solla | sjellë | sjellje | sjellës |
| tjerr | tora | tjerrë | tjerrje | tjerrës |
| marr | mora | marrë | marrje | marrës |
| tumir | tumira | tumirë | tumirje | tumirës(!) |

Sipas shembujve të mësipërm pamëdyshje mund të thuhet se emri i vepruesit është formuar mbi bazë të temës së pjesores së letrarishtes së sotme të foljes përkatëse.

3. Nëngrup më vete formojnë foljet metafonike që në njëjësin e dëftores (veta e parë) të kohës së tashme marrin fundorin -AS. Foljet e tilla kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|--------|---------|--------------------|----------|-------------|
| bërtas | bërtita | bërtitur (bërtitë) | bërtitje | bërtitës(!) |
|--------|---------|--------------------|----------|-------------|

| | | | | |
|-------------------------|-------------------|----------------------------------------|---------------------|------------------------|
| buças gërhas etj. | buçita gërhita | buçitur (buçitë) gërhitur (gërhitë) | buçitje gërhitje | buçitës gërhitës(!) |
|-------------------------|-------------------|----------------------------------------|---------------------|------------------------|

Te ndonjëra nga foljet më -AS dallohet tema onomatopeike fjalëformuese si p.sh. gërgas nga gër-gër, sikurse gërhas gër +h-AS, madje edhe trokas nga trok-trok trok + AS, vërras nga vërr-vërr vërr + AS etj, të cilat do të ceken në grupin e foljeve me prapashtesim.

Në këtë kuadër bëjnë përjashtim disa folje më -AS, të cilat kanë zhvillim tjetër, si p.sh.:

| | | | | |
|----------------------|---------------------|--------------------------------------|----------------------------------|------------------|
| ngas I vras | ngava vrava | ngarë(nga) vrarë (vra) | ngasje vrasje | ngasës vrasës |
| ngas II ngasës(!) | ngava | | ngarë (nga) | ngasje |
| gërgas gërgas(ës) | gërgita | | gërgitur (gërgitë) (gërgasje) | gërgasë |
| ngjas përngjas | ngjava përngjava | ngjarë (ngja) përngjarë (përngja) | ngjarje (?) përngjarje | ? ? |

Gjithashtu bëjnë përjashtim edhe foljet flas e plas, të cilat kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|--------------|---------------|------------------------|-----------------------------------|-----------------|
| flas plas | fola plasa | folur (folë) plasur | folë (folje (!)) plasë, plasje | folës plasës |
|--------------|---------------|------------------------|-----------------------------------|-----------------|

Ndërsa foljet e nëntipit bërtas bërtitur (bërtitë) i formojnë emrat përpjesorë përkatës të vepruesit me prapashtesën -S tek foljet e nëntipit **ngas vras ngas gërgas** kemi të bëjmë me një proces pak më të ndryshëm.

Ç`është e vërteta, procesi i formimit të emrave të vepruesit: ngasës, vrasës, gërgasës mund të shpjegohet tri mënyrash:

E para, siç thuhet në burime të caktuara emrat e tillë janë formuar mbi bazë të temës së njëjësit së të tashmës së dëftores: ngas, vras, gërgas + prapashtesa -ËS: ngasës, vrasës, gërgasës.

E dyta, e cila mund të shfaqet si hipotezë, jo e pabazë, se kjo trajtë së pari është formuar mbi bazë të pjesores së trajtës së shkurtër të gegërishtes (me + pjesore): nga+S. vra+S, gërگا+S, trajtë kjo e cila për t`u dalluar nga veta e parë e njëjësit të së tashmës së dëftores me të cilën u përpoq si homonim, mori një sisforcim pikërisht po atë prapashtesë, d.m.th. formantin -Ë/S dhe kështu doli trajta ngasës (nga+s+ËS, vrasës (vra+s+ËS), gërgasës (gërگا+s+ËS). Këtë hipotezë që mund të quhet edhe tezë, ta them kështu kushtëzimisht, e vërtetojnë trajtat e emërtimeve të tilla që ndeshet që në shkrimet e shkrimtarëve tanë të vjetër siç u argumentua në kreun e mëparshëm të këtij punimi, te shembujt: vras (me vra), ndas (me nda), pis (me pi),

les (me le), prus (prusës) (me pru), ras (doras) (me ra do(rë)ras), por edhe në burime të mëvonshme etj. Në Fjalorin shqip-serbokroatisht (1981 f. 327), b.f., po edhe në burimer të tjera, e ndeshim emërtimin e njeriut sipas veprimtarisë a cilësisë **gërgas** si barasvlerës të shëmbullit **gërgasës** që e ndeshim në FGJSSH.

E treta, trajtat në fjalë mund të shpjegohen edhe sipas mënyrës tjetër d.m.th. mund të kenë dalë nga trajtat emërore me prapashtesë-mbaresën -Ë përkatëse si p.sh. ngasë-a, vrasë-a, gërgasë-a + prapashtesa -S ngasës, vrasës gërgasës. Po kjo mënyrë nuk motivon sa mënyra e dytë (pjesorja e shkurtër).

Sidoqoftë sipas mendimit tim me rastin e gjykimit a të rivlerësimit duhen pasur parasysh të tria këto mënyra. Është e vërtetë se në realitetin tonë gjuhësor dy-tri trajtat e tilla po goditen nga trajtat "e reja" të formuara në mbështetje të pjesores së letrarishtes së sotme: ngarës, vrarës e gërgarës. Në këto trajta kemi rastin t'i ndeshim mjaft shpesh aktualisht, si p.sh.: në gazetën "Bujku" më 27. II. 1992 f. 12 ndeshëm trajtën vrarës. Po ashtu në gazetën Rilindja të datës 20. XI. 1990 f. 14, po edhe te burime të tjera pothuajse normalisht e ndeshim emërtimin "ngarësi i veturës", "ngarësi i automjetit" etj.(Shih edhe të "Zëri dt. 28. XI. 1991 f. 8, te gazeta "Bujku" më 12. XII. 1991 , më 15. VII. 1992 f. 4 etj.). Edhe në punimin e V. Milkanit të cituar këtu disa herë, ndeshet emërtimi "**autongarës**".

4. Në nëngrupin e katërt përfshihen foljet me -ES fundore, të cilat kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|-------|--------|------------------|---------|---------|
| shes | shita | shitur (shitë) | shitje | shitës |
| pyes | pyeta | pyetur (pyetë) | pyetje | pyetës |
| pres | prita | pritur (pritë) | pritje | pritës |
| zbres | zbrita | zbritur (zbritë) | zbritje | zbritës |
| bares | barita | baritur (baritë) | baritje | baritës |

Nga rregulla e mësipërme bëjnë përjashtim foljet: thërres dhe dënes, të cilat kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|------------|----------|------------------|------------------|-----------|
| thërres | thërrita | thërritur | thërritje | thërritës |
| (thirr(i)) | (thirra) | (thirrë) | thirrje | (thirrës) |
| dënes | dënesa | dënesur (dënesë) | dënesë (dënesje) | ? |

Gjithsesi vihet re se emri i vepruesit edhe te ky nëngrup i foljeve formohet mbi bazë të pjesores së ish-gegërishtes letrare.

2) Foljet me bashkëtingëllore a formant me cilësinë e prapashtesës së mëvetësishme dhe emrat e vepruesit

Siç dihet përveç zanore-prapashtesës -O- (pa zgjerim e me zgjerim) me të cilën janë

formuar folje të prejardhura në gjuhën tonë janë edhe këto prapashtesa foljore me bashkëtingëllore fundore: -S, -AS, -ATIS, pastaj -OS, -ATOS si dhe prapashtesa-AS, -AT⁹⁷dhe -IT.

Në vazhdim do të japim shembuj karakteristikë të foljeve me prapashtesat në fjalë si dhe zhvillimin e tyre, sipas rubrikave që u praktikuan në këtë punim.

1. Me prapashtesën -S kemi një numër të vogël të foljeve si p.sh. mpiks, zbraps, të cilat kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|--------|---------|--------------------|----------|-----------|
| mpiks | mpiksa | mpiksur (mpiksë) | mpiksje | mpiksës |
| zbraps | zbrapsa | zbrapsur (zbrapsë) | zbrapsje | zbrapsës! |

Edhe foljet e tjera më -S fundore me e pa cilësi prapashtese kanë po këtë zhvillim, siç u pa më sipër.

Në kuadër të foljeve me prapashtesën -S hyjnë edhe foljet që kanë për temë një emër që mbaron me zanoren -I, por që ka gjasa të jenë formuar nga prapashtesa -IS (-I+ IS - IS), siç është nëntipi: ujdís, stolis, të cilat kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|---------|----------|----------------------|-----------|----------------------------|
| ujdis | ujdisa | ujdisur (ujdisë) | ujdisje | ujdisës |
| stolis | stolisa | stolisur (stolisë) | stolisje | stolisës |
| qeveris | qeverisa | qeverisur(qeverisë) | qeverisje | qeverisës (vetëqeveris) |
| arratis | arratisa | arratisur (arratisë) | arratisje | arratisës |
| ujtis | ujtisa | ujtisur (ujtisë) | ujtisje | ujtisës |

Mënyra e formimit të emrit përkatës të vepruesit nuk ndryshon nga modeli, që u cek më sipër për foljet me prapashtesën temëformuese më -Ë (në gegërishte).

2. Prapashtesa -AS mund të vërehet vetëm në disa raste siç janë shembujt nga tema fjalëformuese onomatopeike, si b.f.: trokas, vërras, çokas, çukas e ndonjë tjetër që kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|--------|---------|--------------------|--------------------|-------------|
| trokas | trokita | trokitur (trokitë) | trokitje | trokitës(!) |
| vërras | vërrita | vërritur (vërritë) | vërritje (vërrimë) | vërritës(!) |
| çokas | çokita | çokitur (çokitë) | çokitje | çokitës(!) |
| gërhas | gërhita | gërhitur (gërhitë) | gërhitje | gërhitës(!) |

Ka raste që kjo prapashtesë del si një shtesë përforcuese e foljeve ekzistuese me

⁹⁷ Prapashtesat në fjalë janë të cekura në librin e gramatikës "Fonetika dhe gramatika ... II f. 302, të cilave u shtova vetëm simotrën -AS dhe -AT që janë formante të vërejtura prej meje.

prapashtesë zero, p.sh. çuk (çukur).

3. Te grupi i foljeve më -AT ndeshim shembuj që formanti -at del i identifikuar si prapashtesë me temë të qartë fjalëformuese e te disa jo. Edhe te këto folje, si me thënë, zhvillimi i emrit të vepruesit del i rregullt mbi bazën e pjesores së ish-gegërishtes letrare. Ja disa shembuj:

| | | | | |
|-------|--------|------------------|---------|---------|
| cokat | cokata | cokatur (cokatë) | cokatje | cokatës |
| degat | degata | degatur (degatë) | degatje | degatës |
| zukat | zukata | zukur (zukatë) | zukatje | zukatës |

por më tepër dalin folje me -AT fundor si p.sh.:

| | | | | |
|----------|-----------|------------------------|------------------------|------------|
| piskat | piskata | piskatur (piskatë) | piskatje (piskamë) | piskatës |
| hukat | hukata | hukur (hukatë) | hukatje | hukatës |
| hallakat | hallakata | hallakatur (hallakatë) | hallakatje (hallakamë) | hallakatës |
| nuhat | nuhata | nuhatur (nuhatë) | nuhatje | nuhatës |

Edhe këto, pra, siç po shihet, kanë zhvillim të ngjashëm me nëngrupin e mësipërm.

4. Me prapashtesën -IS janë formuar një grup foljesh nga tema e qartë fjalëformuese (zakonisht nga emrat) si p.sh. përrallë përrallis, pajë pajis etj., të cilat kanë këtë zhvillim:

| | | | | |
|-----------|------------|------------------|-------------|--------------|
| përrallis | përrallisa | përrallisur | përrallisje | ? |
| pajis | pajisa | pajisur (pajisë) | pajisje | pajisës |
| cigaris | cigarisa | cigarisur | cigarisje | ? |
| artis | artisa | artitur (artisë) | artisje | artisës |
| zvarris | zvarrisa | zvarrisur | zvarrisje | zvarrisës(!) |
| çekanis | çekanisa | çekanisur | çekanisje | ? |

Në kuadër të kësaj prapashtese përfshijmë edhe foljet si:

ujtis (ujë), bojatis (bojë), këmbatis (këmbë), zjarrtis (zjarr), teletis (tel) etj.

Këtë rast siç po shihet te shembujt: bojatis, këmbatis dhe teletis, prapashtesa -IS del e zgjeruar me elementin -T- të parashoqëruar nganjëherë nga një -A-a -E- mbështetëse: zjarr+TIS zjarrtis, bojë+ATIS bojatis, këmbë+ATIS këmbatis; tel+ETIS teletis.

Konstatojmë ,se edhe këto folje kanë zhvillim të njëjtë si shembujt që u dhanë më sipër.

5. Foljet me prapashtesën -OS zënë vend të konsiderueshëm jo vetëm në grupin e foljeve me temë në bashkëtingëllorë, por edhe të foljeve me prapashtesim të shqipes në përgjithësi. Te një numër i konsiderueshëm i foljeve më -OS, formanti prapashtesor -OS dallohet qartë nga tema fjalëformuese që zakonisht është emër. Ja disa shembuj dhe zhvillimi përkatës i tyre:

| | | | | |
|---------|----------|----------------------|-----------|-----------|
| ajros | ajrosa | ajrosur (ajrosë) | ajrosje | ajrosës |
| faqos | faqosa | faqosur (faqosë) | faqosje | faqosës |
| hekuros | hekurosa | hekurosur (hekurosë) | hekurosje | hekurosës |
| dyllos | dyllosa | dyllosur (dyllosë) | dyllosje | dyllosës |
| finjos | finjosa | finjosur (finjosë) | finjosje | finjosës |
| palos | palosa | palosur (palosë) | palosje | palosës |

Po këtë zhvillim e kanë edhe foljet e tjera më -OS si p. sh.: firmos, gëlqeros, pudros, vidhos, vulos, katranos, ngjyros etj.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm emri vepruesit del mbi bazë të pjesores së ish-gegërishtes letrare, por që ka ngjashmëri edhe me trajtën përfaqësuese: njëjës in e vetes së parë të së tashmes së dëftores.

Në jetën tonë të përditshme, madje dalin edhe emërtime të mirëfillta të njerëzve sipas profesionit mbi këtë bazë të krijuara nga procesi i punës, siç janë shembujt: hekurosës (serb. peglaç), finjosës (serb. cedjivaç), palosës, vidhosës, katranosës etj.

Në kuadër të foljeve më -OS hyn edhe folja m fundoren -ATOS si armatos, e cila ka zhvillim të njëjtë sikurse shembujt që u dhanë më sipër.

6. Te një grup foljesh del qartë prapashtesa -IT, e cila u shtohet zakonisht temave emërore si p.sh.: kosë kosit, radhë radhit etj., të cilat kanë zhvillim të ngjashëm me grupet e tjera të foljeve me temë në bashkëtingëllore a formant me cilësinë e prapashtesës së mëvetësishme. Ja disa shembuj dhe zhvillimi i tyre:

| | | | | |
|----------------|----------|----------------------|-----------|-----------|
| kosit | kosita | kositur (kositë) | kositje | kositës |
| radhit | radhita | radhitur (radhitë) | radhitje | radhitës |
| rendit | renedita | renditur (renditë) | renditje | renditës |
| (bashkërendit) | | | | |
| shoshit | shoshita | shoshitur (shoshitë) | shoshitje | shoshitës |
| voztit | voztita | voztitur (voztitë) | voztitje | voztitës |

Gjithsesi edhe nga ky nëntip foljesh dalin mjaft emra prejpjesorë në cilësinë e ertimit të njerëzve sipas profesionit a të veprimtarisë.

* * *

Si konstatim i përgjithshëm rreth formimit të emrave përkatës të vepruesit me prapashtesat përkatëse mund të vlejnjë sirregullat e caktuara

a) Te foljet paralele qëndrueshmëria e emrit varet nga vetë qëndrueshmëria e foljes me prapashtesën përkatëse, përkatësisht nga vetë trajta e caktuar foljore dhe favorizimi i saj, në kuadër të situatës që shprehet, stilit, modelit etj. Kështu, p.sh. mbi bazë të foljeve përkatëse: përralloj përrallis përrall përrallos; lyej lyrësoj; ngjyros ngjyroj; dreqnoj dreqnos; zhubros zhubravit etj. del edhe emri i vepruesit. Me një fjalë në mbështetje të kuptimit sforcues të trajtës së caktuar foljore për

nënfushën e caktuar semantike do të favorizohet edhe emërtimi i njeriut sipas veprimtarisë a cilësisë që del i përfutur pikërisht mbi trajtën e pjesores së foljes përkatëse paralele, p.sh. përrall përrall/ë/s, përrallis përrallis/ë/s, përrallos përrallos/ë/s; lyej lyes, lyrësoj lyrësues, e kështu me radhë.

b) Edhe lidhur me temën foljore të emrave të vepruesit rreth raportit temë e trajtës foljore të aoristit, të së tashmës së dëftores si dhe të pjesores, qoftë e variantit të ish shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, qoftë të pjesores së letrarishtes së sotme si tema fjalëformuese del e nevojshme të njihen a të ritheksohen konstatimet si vijon:

1. Është e vërtetë se në të kaluarën, sidomos në dialektin e toskërishtes, por nuk është pa gjurmë edhe në atë të gegërishtes, janë formuar emra prejfoljorë mbi bazë të temës së njëjësit të së tashmës së dëftores të vetës së parë, pos krijimeve të tipit a klasës së foljeve më -OJ si punoj punonjës, kjo mënyrë fjalëformimi shihet edhe te tipat e foljeve të tjera si rrëfenj rrëfenjës, pastaj ruanj ruanjës, kam kamës e ndonjë tjetër, mirëpo kjo mënyrë emërformimi në gjuhën e sotme letrare del pothuajse plotësisht e pasivizuar nga mënyra tjetër e favorizuar, e mbështetur mbi bazë të pjesores së foljes së caktuar, e cila shërben si temë fjalëformuese.

2. Sa i përket supozimit se edhe aoristi (e kryera e thjeshtë) do të ketë shërbyer si temë emërformuese për formimin e ndonjë emri të vepruesit, shikuar sipas gjendjes së sotme, mund të thuhet se një ndikim i tillë duket fare i papeshë. Te foljet që e formojnë aoristin më -VA (me një -V- epentetike), madje edhe te disa folje vokalike me mbaresë zero, ky ndikim ose forma e tillë nuk del as si ndikim plotësues sugjerues, sepse tema e aoristit nuk përkon me temën e pjesores së foljes së caktuar. Në këtë grup a klasë bëjnë pjesë ato folje që e formojnë aoristin me elementin infiksor -JT- a -T-, siç janë shembujt ruaj ruajta ruajtur (ruejtë me ruejtë), mbaj mbajta mbajtur (mbajtë me mbajtë), arrij arrita arritur (arritë me arritë) etj., pastaj te disa folje të tjera si bëj bërë (ba me ba ose me bë), bie prura prurë (pru me pru) etj. dhe sidomos te shumica e foljeve me temë në bashkëtingëllore si p.sh. mat mata matur (matë), kosit kosita kositur (kositë), shes shita shitur (shitë) etj., mirëpo për formimin e emrit të vepruesit gjithsesi tema e aoristit mbetet larg nën hijen e temës së pjesores, sidomos të pjesores së shkurtër të gegërishtes. Mjafton të përmend rastin e emrit të vepruesit nga folja bie (me pru), prura, prurë (geg. pru), emri i vepruesit në gegërishte del prus, tek Asdreni e ndeshim prusës d.m.th. me dyfishim prapashtese, ndërsa në letrarishten e sotme del: prurës.

3. Pjesorja si temë për formimin e emrave të vepruesit në dialektin e gegërishtes dokumentohet që nga burimet më të hershme të shkrimit shqip, madje epërsia e saj ndaj mënyrave të tjera është e padiskutueshme që atëherë.

Sa ka ndikuar për mirë a për keq anashkalimi të moscekurit qartë të pjesores së shkurtër (të pjesores ose të paskajores geqe!) në letrarishten e sotme mbetet të vlerësohet? Sigurisht kjo mënyrë fjalëformimi paraqitet si model i formuar që nga tradita dhe shi për këtë edhe pati fuqi e autoritet të normëzohet në gjuhën e sotme letrare, edhe pse kjo për bazë kishte dialektin toskë e jo atë gegë. Mirëpo si të thuash, pjesorja e gegërishtes dhe pjesorja e letrarishtes së sotme varësisht nga grupi a nëngrupi i foljeve në gjuhën e sotme letrare e kanë ndarë fushën e veprimit. Numri

më i madh i emrave prejpjesorë formohet me prapashtesën -S mbi bazë të pjesores së gegërishtes, si p.sh. mësoj mësuë mësuës, përkthej përkthye përkthyes, gatuaj gatue gatues etj. Po kjo trajtë e pjesores shërben edhe për formimin e emrave të vepruesit nga foljet me temë në bashkëtingëllore etj. Mirëpo, në anën tjetër, edhe trajta e pjesores së letrarishtes së sotme shërben si trajtë më e favorizuar për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë të disa grupe foljesh si p.sh.: bie prurë prurës, shpërndaj shpërndarë shpërndarës, fryj fryrë fryrës, laj larë larës, blej blerë blerës, prej prerë prerës etj. duke i lënë jashtë norme a nën hije trajtat e gegërishtes si p.sh. *prus, shpërndas, frys, las, bles, pres* - edhe pse nuk ishin pa traditë përdorimi, por jo edhe aq të përgjithësuara. Nga ky grup foljesh ende ruan pozitën që kishte emri pamës, kundrejt parës, i cili në kompozita është i paprekshëm si largpamës, shkurtpamës etj. Vendi i emrave të vepruesit me prapashtesën -S, qoftë me temë emërore, qoftë me temë foljore do të dalë më qartë pasi të analizohet edhe formimi i emrave të njerëzve sipas veprimtarisë me prapashtesa të tjera konkurrencte si dhe emrat e përbërë, siç do të shohim në vazhdim.

P ë r m b y l l j e

Krejt kjo që u shtrua dhe u trajtua këtu lidhur me formimin e emrave prejfoljorë të vepruesit me prapashtesën -S mund të përmbliidhet në këto dy konstatime:

E para, formimet mbi bazë të së tashmes së dëftores, që ndeshen në burime të caktuara në letrarishten e sotme nuk janë as aktive as produktive.

E dyta, formimet, mbi bazë të trajtës së pjesores së foljes së caktuar janë aktive dhe prodhimtare në letrarishten e sotme të njësuar.

E treta, dy konstatimeve të mësipërme mund të shtohet edhe konstatimi i tretë se në rrethana të caktuara po mbi temë foljore dalin krijime të emrave prejfoljorë edhe me prapashtesën -TAR siç janë shembujt: ngrohtar, mihtar, mbathtar etj. krahas prejpjesorëve: ngrohës, mihës, mbathës etj. dhe se këto dy modele dalin të formëzuara dhe në rrethana të caktuara, secili model mbulon nënfushë të caktuar semantike, të cilat kanë nevojë të konsolidohen a të përcaktohen më mirë në bazë të nevojës që paraqitet.

Kur është fjala rreth konstatimit të dytë, d.m.th.. rreth formimeve të emrave mbi bazë të pjesores aktualisht dalin çështje që patjetër lypset sqaruar. Ç`është e vërteta, këtu qëndron edhe nyja e zgjidhjes së çështjes, e cila ende nuk del e qartësuar sa duhet në burimet përkatëse të gjuhësinë tonë. Me thënë të drejtën, me sa di, veç një paraqitjeje prej nesh, në asnjë burim tjetër normativ nuk është qartësuar çështja se cila trajtë e pjesores, qoftë ajo e ish gegërishtes letrare, qoftë e letrarishtes së sotme mbi bazë të të cilëve tipa, nëntipa, grupe e nëngrupe të foljeve shfrytëzohet për formimin e emrave përkatës.⁹⁸

⁹⁸ Shih për këtë trajtesën *Rreth përcaktimit të rregullës për formimin e emrave*

Mirëpo, siç u tha, edhe pse në pika të caktuara ende kanë mbetur çështje të diskutueshme a të pakonsoliduara në vazhdim po japim në pika të shkurtëra rregullën, nëse mund të quhet kështu, se si del e zgjidhur konkretisht çështja e sipërcekur:

1. Emrat e vepruesit me prapashtesën -S mbi bazë të pjesores së ish variantit letrar të gegërishtes i formojnë këto grupe foljesh:

a) foljet me temë në zanore dhe togzanor siç janë ato:

- më -OJ (tërësisht, si p.sh.: mësoj mësue mësim; mbroj mbrojtë mbrojtës;

- më -EJ (pjesërisht) si p.sh.: shpërblej shpërblye shpërblyes, vërej vërejtë vërejtës, mbrej mbrehë mbrehës;

- më -UAJ (pjesërisht), si p.sh.: shkruaj shkruie shkruies, ruaj ruajtë ruajtës;

- më -UJ (tërësisht), si p. sh.: buj bujtë bujtës;

- më -IJ (pjesërisht), si p. sh.: arrij arritë arritës.

b) Të gjitha foljet me temë në bashkëtingëllore, të cilat e formojnë pjesoren me prapshtesën temëformuese më -Ë në ish shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes si p.sh: qeveris qeverisë (me qeverisë), qeverisë. pyes pyetë pyetës, hekuros hekurosë(me hekurosë) hekurosës, radhit radhitë (me radhitë) radhitës, gërgas gërgasë(me gërgasë) gërgasës, degat degatë (me degatë) degatës etj.

2. Emrat e vepruesit me prapashtesën -S nga pjesorja e letrarishtes së sotme:

a) Foljet me zanore që e formojnë pjesoren me prapashtesën temëformuese -RË (tërësisht):

- më -ËJ, si p. sh.: bëj bërë bërës;

- më -IJ, si p. sh.: fshi fshirë fshirës;

- më -YJ, si p. sh.: fryj fryrë fryrës;

- më -AJ, si p. sh.: laj larë larës;

- më -EJ, si p. sh.: blej blerë blerës.

b) Foljet me togzanor që e bejnë pjesoren me prapashtesën temëformuese -R:

- më -IEJ, si p. sh.: ziej zier zierës;

- më -YEJ, si p. sh.: kryej kryer kryerës;

- më -UAJ, si p. sh.: shuaj shuar shuarës(?)

c) Foljet vokalike me mbaresë zero, si p.sh: pi pirë pirës,
vë vënë vënës, zë zënë zënës, nxë nxënë nxënës.

ç) Foljet e parregullta si p.sh.: bie rënë rënës, bie prurë prurës, jap dhënë dhënës, them thënë thënës, lë lënë lënës.

prejppjesorë të vepruesit më -(Ë)S në shqipen letrare kombëtare, ne veprën e N. Veselajt Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit I, Prishtinë 1997, f. 27-38.

d) Foljet apofonike, si p.sh.: sjell sjellë sjellës, tjerr tjerrë tjerrës.

Ç`është e vërteta, disa raste ende kanë mbetur plotësisht jo të konsoliduara, ndër to po përmend grupin e foljeve më -UAJ të tipit *shuaj* që e bëjnë pjesoren me prapashtesën temëformuese -R: *shuar* (geg. *shue*) dhe emrin e veprimit më -JE mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme: *shuarje*. Në praktikë emri i vepruesit të këtyre foljeve del dy mënyrash, mbi pjesoren e gjuhës së sotme letrare: *shuar shuarës* dhe mbi pjesoren e ish-gegërishtes letrare *shue shues*. Në gjuhën e sotme letrare kur kemi parasysh vetë prestigjin e standardit si dhe përdorimin e temës së emrit të veprimit mbi këtë bazë, atëherë respektimi i kësaj teme fjalëformuese edhe për emrin e vepruesit s'ka arsye të mos zbatohet.

Gjithashtu pa u stabilizuar a konsoliduar plotësisht ka mbetur edhe rasti i formimit të emrave të vepruesit nga foljet më -IEJ të tipit kryej, të cilat e bëjnë pjesoren me prapashtesën temëformuese më -R: kryer dhe emrin e veprimit më -JE po mbi këtë bazë: kryerje. Edhe pse në praktikë emrat e tillë dalin edhe mbi bazë të pjesores së ish-gegërishtes letrare të tipit kryes kur kemi parasysh arsyet e mësipërme edhe në këto raste, më shumë përparësi ka trajta mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme, kështu që më shumë përparësi ka trajta kryerës ndaj kryes.

Vlen të përmendet gjithashtu edhe rasti i nja katër foljeve metafonike më -AS si: *ngas I*, *vras*, *ngas II* dhe *gërgas*, të cilat e formojnë trajtën e pjesores më -RË: *ngarë*, *vrarë*, *gërgarë*, ndërsa në ish shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes: *nga* (me *nga*), *vra* (me *vra*), *gërگا* (me *gërگا*). Sigurisht nga këto trajta janë përfutur emrat e vepruesit: *ngasës*, *vrasës*, *gërgasës*. Shtrohet çështja si duhet të interpretohet (shpjegohet) tema e tillë:

e para, mbi bazë të së tashmes së dëftores,

e dyta, mbi bazë të pjesoren së ish gegërishtes letrare me dyfishim prapashtese apo

e treta, mbi bazë të emrit prejfoljorë e ventualë me prapashtesë-mbaresën -Ë:
ngasë-a, *vrasë-a*, *gërgasë-a*?

Interpretimi i dytë më duket se është më i përkapshëm.

b. EMRAT E NJERËZVE SIPAS VEPRIMTARISË ME PRAPASHTESA TË TJERA

Përveç prapashtesës -S e cila, siç e pamë, del e angazhuar për formimin e emrave të njerëzve sipas veprimtarisë më tepër mbi temë foljore e më pak mbi temë emërore, për emërtimin e njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë dalin të angazhuara edhe prapashtesa të tjera siç janë prapashtesat a fundoret: -TAR, -AR, -OR, -TOR, -XHI, -IST, -ER, -IER, -AN, -ANT, -ENT, -IK si dhe formante të tjera, por më e dalluar del prapashtesa -TAR. Shembujt me këto formanti do t'i trajtohen radhazi. Të gjitha këto formante mbështeten në tema emërore, përveç prapashtesën -TAR, e cila, siç është cekur edhe më përpara, dilte edhe mbi temë foljore.

1) Emrat me prapashtesën -TAR

Prapashtesa -TAR është formant i njohur me përdorim të gjerë për formimin e emrave të vepruesit të gjuhës sonë dhe në këtë kuadër del e angazhuar edhe për formimin e emrave të njerëzve sipas profesionit a "për të emërtuar ushtruesin e mjeshhtërisë", siç e theksojnë Xhuvani - Çabej.

Siç e pamë në nënkreun e mëparshëm të këtij kreu në të gjitha tipat kuptimorë sipas motivimit të jashtëm ndeshim emërtime me këtë prapashtesë, pra edhe mbi bazë të temës foljore, edhe pse në numër relativisht të vogël me këtë prapashtesë janë formuar edhe emra siç janë prejfoljorët: *mbathtar, tjerftar, gjuetar, prestar, qëndistar*, e ndonjë tjetër, por numri më i madh i emrave më -TAR del mbi temë emërore.

Që në dokumentet e hershme të gjuhës sonë të shkruar bien në sy formime të emrave me prapashtesën -TAR mbi temë emërore. P. sh.: burgëtar, gojëtare, peshkëtar (Buzuku), fëdigëtar, shortëtar, veshtëtar (P. Budi), derëtar, furrëtar, këshilltar, rrogëtar, vjershëtar (F. Bardhi), luftëtar, gjuhëtar (P. Bogdani) etj.

Ja edhe disa shembuj të tjerë nga jeta jonë e përditshme:

- mbi temë të një emri të gjinisë femërore: anëtar, barkëtar, vaskëtar, cylëtar, farkëtar, fshesëtar, naftëtar, pemëtar, gojëtar, etj.;
- mbi temë të emrave të gjinisë mashkullore: dhëmbëtar, zdrukthëtar, qymyrtar, pylltar, vargëtar, xhamtar, tregtar etj.;
- mbi temë të emrave femërorë me elidimin e -E -së fundore: daulltar (daulle), zejtar (zeje), valltar (valle) etj.;
- mbi një emër prejfoljor të veprimit si p.sh.: mblesëtar, arsimtar, vajtimtar, tregimtar etj.;
- mbi emrat me zanore fundore (-i, -e) pa e eliduar atë: famullitar, llogaritar, qeveritar, anijetar, xehetar etj.

Nga pikëpamja e drejtshkrimit të temës prodhuese lidhur me emërtimet në fjalë me këtë prapashtesë studiuesit kanë paraqitur mendime të ndara.

Ndërsa në drejtshkrimin e miratuar lejohen përjashtime rregullash rreth shënimit të Ë-së mbështetëse para prapashtesës -TAR, ndonjë studiues mendon ndryshe d.m.th.

shpreh mendimin se duhet shënuar gjithsesi zanorja -Ë me rastin e formimit të emrave të vepruesit. Kështu për emrat më -TAR, F. Sulejmani shprehet "te fjalët në shqyrtim nuk duhet të bëjmë kurrfarë përjashtimi e të shkruajmë pa -Ë-në tematike para formanteve që fillojnë me bashkëtingëllore"⁹⁹, kështu ai rekomandon "pishëtar, e jo pishtar, kur kemi parasysh temat (emrat motivues): pishë, furrë, anë, amë, lojë e kështu me radhë. Edhe Musa Nushi ka mendim të njëjtë. Ky mendon se duhet përmbajtur "parimin morfologjik", sepse "drejtshkrimi i ndryshëm i këtyre emrave nuk ka mbështetje argumentuese as nga aspekti i shqiptimit letrar as në traditën e ngulitur të shkrimit"¹⁰⁰. Autori thotë se përveç "shembujve si pishëtar, furrëtar, ashtu duhet të shënohen njësoj sa i përket temës edhe trajtat xehetar, daulletar, kur kemi parasysh temën: xehe, daulle".

Gjithsesi prapashtesa -TAR është aktive në letrarishten e sotme. Disa huazime (mbi bazë persiane) si bajraktar, hisedar, madje taksidar (a taksildar) në shqipe tingëllojnë si të ishin të krijuara me prapashtesën shqipe -TAR.

Edhe pse Xhuvani-Çabej formantin -ATAR e trajtojnë si prapashtesë më vete, lidhur me pavarësinë e saj konstatojnë se kjo prapashtesë nuk është veçse variacion i -TAR-it, i njëjtë me këtë edhe në funksionet që ka, kryesisht me atë nomina agentis", për këtë arsye ky formant këtu trajtohet në kuadër të emrave me prapashtesën -TAR. Lidhur me qëndrueshmërinë e trajtës -ATAR në shqipen e sotme letrare mund të konstatohet njëfarë pasiviteti i saj. Është e hetueshme prirja që A-ja mbështetëse të zëvendësohet me një -Ë- mbështetëse te ato raste, ku del e nevojshme një mbështetje e tillë. Si p.sh. në vend vegshatar (veqshaxhi) - vegshëtar vegshëxhi, peshkatar peshkëtar etj., kurse te emrat si temë të gjinisë femërore groshatar ledhatar ka prirje të ruhet -Ë-ja e temës: groshë ledhë: groshëtar, ledhëtar. Sigurisht një prirje e tillë e zëvendësimit të A-së me -Ë- shihet më tepër te krijimet e reja.

Lidhur me këtë prapashtesë ja si e ka shprehur mendimin e vet, studiuesi Musa Nushi: "Nga sa mund të vërej prapashtesa -ATAR është karakteristikë për emrat e mbiemrat e formuar nga temat foljore si prekatar (prek+atar), prijatar (prij + atar) dhe sipas analogjisë kjo morfemë është shkrirë dhe u është ngjitur edhe temave emërore si cergatar, bjeshkatar, gjakatar, krahatar, peshkatar". Për disa nga këta emra, të cilët, siç thotë autori, "dalin në formë të ndryshme shkrimi" propozon që të marrin prapashtesën -TAR e jo -ATAR dhe lidhur me këtë jep arsyetimin: "besoj se nuk do të kishim bërë shkarje sikur temës fjalëformuese t'ia shtonim prapashtesën -TAR në vend të asaj -ATAR", sepse "kanë një mënyrë fjalëformimi" dhe për këtë jep shembujt: "arkëtar, barkëtar"¹⁰¹.

⁹⁹ Fadil Sulejmani, Çështje të normës letrare, kumtesë e botuar te "Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe", Prishtinë 1983, f. 91

¹⁰⁰ Musa Nushi, Për disa shkarje drejtshkrimore në literaturën gjuhësore", kumtesë e botuar te Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe, Prishtinë 1983, f. 259.

¹⁰¹ Musa Nushi, po aty f. 259.

Edhe pse mbase në këtë dukuri ka pasur ndikim trajta "popullore" -AXHI / ATAR si barkaxhi / barkatar etj., mendoj se kjo prirje, d.m.th. pa -A- në mbështetëse vlen të vlerësohet më me kompetencë.

2) Emrat e formuar me prapashtesën -AR

Nga gjuha popullore e traditës, si të themi, në gjuhën e sotme letrare është trashëguar një numër mjaft i madh i emërtimeve me prapashtesën -AR, emërtime këto që përdorshin sidomos si emërtime të njerëzve sipas mjeshtërisë, disa prej të cilave ende nuk e kanë humbur aktualitetin.

Tek emrat e vepruesit më -AR dallohet qartë tema prodhuese motivuese emërore, si p.sh.: grazhdar, gjizar, lopar, bucelar, djathar, dhjar, shtambar, shtëpar, viçar, vegshar, vorbar, opingar, patar, pelar, gomarjar etj, që, si na është e ditur, shumica absolute janë emërtime, siç u tha, të "profesioneve" nga jeta fshatare blegtorale e qytetare "zejtare" që lidhen me jetën ekonomike të kohës paksa të kaluar ose në kalim e sipër, "profesione" këto që ushtroheshin nga personat e caktuar, të cilat në ato kohë e rrethana shoqërore e ekonomike të caktuara kishin domethënie më të madhe sesa kanë sot, në kohën e industrializimit dhe modernizimit teknik, megjithatë sa herë e do puna, emërtimet e tilla mund të aktivizohen, sidomos në të ashtuquajturin "bisnes të vogël".

Në letrarishten e sotme të njësuar janë edhe një numër i caktuar i fjalëve ndërkombëtare më -AR fundor, por që shumica mund të zërthehen edhe në shqipe si emra të prejardhur me prapashtesën -AR si p.sh.: funksionar, sekretar, sanitar, stanar, legjionar, aksionar, bibliotekar, biçikletar etj. Po të kësaj nënfushe semantike janë edhe disa emra të shqipes si: vendar, shtetar, kështjellar,(krye)familjar, por edhe katundar, pleqnar, qytetar (me semantikë të theksuar stilistike nga kuptimi i përgjithshëm, të cilat nuk konkurrohen nga prapashtesa simotër -TAR.

Xhuvani - Çabej lidhur me emrat me këtë prapashtesë vërejnë se "nga gjuhët ballkanike këtë prapashtesë e kanë serbokroatishtja, bullgarishtja, rumanishtja e greqishtja e re" dhe lidhur me këtë sa për ilustrim nga gjuha serbokroate shënojnë këta shembuj: kuhar (gjellëtar), zidar (murator), mlinar (mullis), knjizhar (librar) dhe kozar (dhjar).

Ndonëse për këtë prapashtesë studiuesi Ardian Vehbiu thotë se "vetëm prapashtesa -AR e ruan aktivitetin kryesisht në fushën e emrave të njerëzve sipas mjeshtërisë" mund të konstatohet se ndër ne, por edhe përgjithësisht në gjuhën e sotme letrare më e parapëlqyeshme del prapashtesa -TAR, e cila gjithnjë e më shpesh po del si formë paralele kundrejt emërtimeve të caktuara më -AR. Krahaso, p.sh.: gjizëtar, gjobëtar, djathëtar, kundrejt trajtave: gjizar, gjobar, djathar. Për një dukuri të tillë a njëfarë "alergjie" ndaj formave më -AR dhe favorizimin e atyre më -TAR, që është paksa e pranishme te ne, por edhe përgjithësisht mund të ketë ndikuar pikërisht ngjashmëria me trajtat e gjuhëve të tjera të Ballkanit, konkretisht me të serbishtes. Lidhur me këtë po e sjell mendimin e Musa Nushit, i cili thekson se "fjala bibliotekar nuk është ndërtuar drejt, pa marrë parasysh se kjo fjalë me këtë përbërje, përsëritet prej një

fjalori në fjalor... Kjo fjalë përdoret kryesisht në trajtën bibliotekist. Ma merr mendja se derivatin bibliotekar e kemi të huazuar nëpërmjet serbokroatishtes".¹⁰²

Sidoqoftë autori më tepër parapëlqen prapashtesën -IST kundrejt asaj -AR, sepse siç thotë ai "për formimin e emrave të personave sipas profesionit a punës që kryejnë përdoret më tepër prapashtesa e burimit të huaj -IST, që në gjuhën shqipe sot është bërë mjaft prodhuese".

Me këtë desha të vë në spikamë se me vetëdije të shqipfolësve të ne më e parapëlqyeshme del prapashtesa -TAR, por edhe ajo -IST sesa ajo -AR, kur kemi raste përputhesh të formave shkrimore me trajtat e caktuara të serbishtes. Rreth dukurisë së pakësimit të emërtimeve më -AR, kundrejt atyre më -TAR mjafton të sjell faktin se në Fjalorin e gjuhës shqipe (1954) emrat më -AR zënë 18% nga numri i përgjithshëm në atë burim, ndërsa në Fjalorin shqip-serbokroatisht (1981) përqindja e tillë zbritet vetëm 6%. Në Fjalorin e shqipes së sotme, Tiranë (2002) gjismëpërgjysmë më shumë kemi emërtime më -TAR se me -AR. Besoj se mjaftojnë faktet e mësipërme sa për të argumentuar pasivitetin e emrave me këtë prapashtesë në përgjithësi dhe sidomos të ne në veçanti.

3) Emrat me prapashtesën -OR

Me prapashtesën -OR e ndeshim ndonjë emërtim të njerëzve sipas profesionit, por gjithsesi në numër të vogël në krahasim me emrat e vepruesit mbi temë emërore që dalin me prapashtesat e sipërtrajtuara: (Ë)S, -TAR e -AR.

Me këtë prapashtesë janë formuar emrat *shenjtor*, *përçor*, *dasmor*, *vreshtor*, të cilët nuk se janë emra aq të mirëfilltë të profesioneve, madje edhe trajta drejtor që është refleksi i fjalës drejtore të italishtes, edhe pse tema mbiemërore drejt- (i drejtë) është e shqipes, s' di sa mund të ketë mirëfillësi fjalëformuese në gjuhën tonë. Nuk duhet të na habitë fakti se kemi mjaft emra të huazuar më -OR fundor në gjuhën tonë, disa prej të cilëve si dhe trajta *drejtor* dalin të zbërthyeshëm. Krahaso: aktor, edukator, vizitor, administrator, kontrollor, prokuror etj. Ç'është e vërteta, këto janë fjalë ndërkombëtare, të cilat edhe ngjasojnë me trajtat e shkrimore të gjuhëve të tjera, sidomos të atyre neolatine, nën ndikimin e të cilave këto emërtime edhe janë formëzuar me cilësinë e profesionit në gjuhën tonë.

Me këtë prapashtesë e ndeshim edhe emrin *kalor* (kaluar) si dhe ai *detor* (detuer) që në gjuhën e sotme kanë marrë prapashtesën sforcuese -(Ë)S: kalorës, detorës.

Po e përmend edhe rastin e emrit *stanore* nga tema stan- me prapashtesën femërore -ORE. Siç e kemi cekur më përpara në gjininë mashkullore mbi bazën stan- del emërtimi i njeriut me prapashtesën -AR: stanar.

Gjithsesi formimet më -OR si emra të njerëzve sipas profesionit nuk praktikohen në gjuhën tonë mbi bazë të fjalë-temave të brumit autokton.

¹⁰² M. Nushi, vepra e cituar në shënimin e mësipërm.

4) Emrat me prapashtesën -TOR

Me prapashtesën -TOR në gjuhën tonë kemi një numër jo të madh të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit a mjeshtërisë. Në letrarishten e sotme ndeshim këta emra: *qebaptor, fjalëtor, farëtor, punëtor; blegtor, gjator, maltor, ëmbëltor, vjeshëtor, vraptor* etj. Ç'është e vërteta, siç theksohet edhe nga Xhuvani - Çabej "në shumë fjalë prapashtesa -TUER a -TUAR ndrohet me prapashtesën -TAR", dukuri kjo që vazhdon të jetë e pranishme edhe në letrarishten e sotme. Madje kemi raste që edhe trajtat e "qëndrueshme" si *blegtor, ëmbëltor, vreshtar, qumështar, priren të dalin me prapashtesën tjetër simotër -TAR, kështu që edhe në burime normative i ndeshim a duhet t'i ndeshim të parapëlqyera trajtat: **blegtar, ëmbëltar, qumështar, qebaptar, vreshtar** etj. etj. - prirje kjo që është aktuale dhe mjaft me perspektivë dhe mendoj se s'ka kurrnjë të keqe nëse favorizohet në të ardhshmen, kur kemi parasysh angazhimin a specializimin e prapashtesës -OR e -TOR për nënfusha të tjera semantike, siç është angazhimi në fushën e mbiemrave si dhe te nënfusha e emërtimeve të veglave a të aparateve teknike.*

Është e vërtetë se kemi një sërë emrash, mbi 50, si emërtime të njerëzve sipas profesionit të karakterit ndërkombëtar që kanë formantin -TOR fundor, si p.sh. *lektor, mentor, inspektor, instruktor, redaktor, kreditor, fonditor, tornitor* etj., po ky fakt nuk ka mundur të mbizotërojë në formime të brumit verndës në krahasim me formimet me -TAR.

Në këtë kuadër vlen të cekem edhe emërtimet si fjalë ndërkombëtare me formantin fundor -ATOR, si p.sh.: *saldator, axhustator, disenjator, aviator, agjikator, organizator, racionalizator, novator* etj. Po të kësaj natyre janë edhe: *murator, minator, orator, pagator, ideator* që edhe në shqipe kanë temë të qartë prodhuese e motivuese, por që përkojnë me trajtat e gjuhëve të tjera, prej kah edhe janë huazuar ose janë krijuar a formëzuar në saje të analogjisë.

Xhuvani-Çabej cekin dy raste: *shërbëtor (shërbëtuor/ shërbetuer)* dhe *detor (detuor/ detuer)* si reflekse të latinishtes ngase "rrjedhin e para nga latinishtja *servitorem* dhe e dyta nga *debitore*. Dhe prej një konstatimi të tillë mund të nxjerrim përfundimin se emrat e huazuar më -TOR dhe -ATOR më tepër janë huazime, qoftë nga latinishtja qoftë nga gjuhët neolatine ose edhe nga gjuhë të tjera po mbi këtë bazë. Madje kjo është arsyeja që nuk këshillohen emërtimet e reja nga brumi vendës me prapashtesën -TOR.

5) Emrat me prapashtesën -XHI

Prapashtesa -XHI, e cila në gjuhën turke (osmane) paraqitet si prapashtesë speciale për emërtimin e njerëzve sipas profesionit a mjeshtërisë në gjuhën shqipe pati ndikim jo të vogël. Madje formanti i tillë zotëronte dukshëm ndaj prapashtesave të tjera për këtë funksion, jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në disa gjuhë ballkanike ku qe përhapur, si p.sh. në rumanishte, serbokroatishte e maqedonishte, ku, siç thuhet, ende vazhdon të jetë aktiv.

Studiuesit Xhuvani - Çabej cekin se "me këtë prapashtesë janë formuar një varg

emrash vepruesish prej emrash turqisht, p.sh.: *arabaxhi, bakërxi, bejtexhi, bojaxhi, duhanxhi, dyqanxhi, fajdexhi, hallvaxhi, hanxhi, hasraxhi, kafexhi, kallajxhi, teneqexhi*" - emërtime këto që edhe në letrarishten e sotme përdoren për nevoja të caktuara, sidomos për nevoja stilistike, edhe pse, do të shtonim, se disa prej tyre kanë përdorim gjithnjë e më të rrallë, sepse siç shprehet Mariana Ymeri prapashtesa turke -XHI tashmë "e ka humbur prodhimtarinë në gjuhën e sotme shqipe" dhe se vetë "praktika e gjuhës po mënjanon çdo ditë e më shumë huazimet e hershme dhe disa formime të mëvonshme, qoftë nëpërmjet vjetërimit të tyre, qoftë nëpërmjet zëvendësimit me mjetet e shqipes".

Sa ka qenë popullore kjo prapashtesë në gjuhën tonë dëshmojnë edhe faktet se përveç huazimeve të përvetësuara sipas mënyrës së huazimit transfer ajo "u bë produktive edhe në fjalë të shqipes si: *baltaxhi, barkaxhi, laknaxhi, lekurëxhi, vozaxhi*". Është e vërtetë se që në Fjalorin e F. Bardhit ndeshim në emërtimet më -XHI: *qirixhi* dhe *qyrxhi*. Emërtime me këtë prapashtesë ndeshim edhe në Gramatikën e Da Leçes¹⁰³. Sigurisht gjuha e popullit, sidomos ajo e të folmeve të qyteteve ishte e stërmëshur me turqizma e në kuadër të tyre edhe të emërtimeve me prapashtesën -XHI. Ndonëse K. Kristoforidhi nuk i shënon ato në Fjalorin e tij, pos dy - tri rasteve, në Fjalorin e "Bashkimit" prezentimi i emrave me -XHI është mjaft i madh, por aty edhe bëhet përpjekje e vetëdijshme për zëvendësimin e tyre me sinonime të farkëtuara me mjetet fjalëformuese të gjuhës shqipe. Por megjithë përpjekjen, pothuajse të vazhdueshme për mënjanimin e emërtimeve më -XHI, prapëseprapë kjo çështje ka mbetur aktuale deri edhe në ditët e sotme. Vediha Topçiu duke analizuar çështjen e turqizmave në shqipe thekson: "Gjuha letrare do të mund të lirohej nga ato turqizma që kanë sinonimi (të plotë)... me gjithë këtë përdorimi i tyre do të jetë i nevojshëm edhe i pazëvendësueshëm sa herë që në literaturë do të trajtohen motive e personazhe që lidhen me rrethana të caktuara historike".¹⁰⁴

Se si po zëvendësohen apo janë zëvendësuar trajtat më -XHI në gjuhën tonë, sa për ilustrim po i cek vetëm këta shembuj: *barkaxhi* barkëtar, *baltaxhi* baltëpunues, *furraxhi* furrëtar, *fallxhi* falltar, *teneqexhi* teneqepunues, *vozaxhi* vozabërës, *fshesaxhi* fshesar a fshesëtar etj.

Nga shembujt e sipërshënuar vërtetohet konstatimi i Ludmila Buxhelit, e cila thekson se "është zëvendësuar p.sh. prapashtesa -XHI me prapashtesat -AR e -TAR ose me emrin: -punues (-bërës), i cili në këtë rast ka marrë vlerë fjalëformuese prapashtesore" dhe se pikërisht trajta *sharrtar*, *furrtar*, *jorganpunues* të përdorura në vend të trajtave më -XHI: *sharraxhi*, *furrxhi*, *jorganxhi* - sot janë trajta të qëndrueshme "në përputhje me normën e sotme letrare".

Lidhur me turqizmat në përgjithësi, ku bëjnë pjesë edhe emërtimet më -XHI, siç u

¹⁰³ Shih te "Gramatika e parë e gjuhës shqipe (R. Ismajli), Prishtinë 1982, ku ndeshen trajtat: *arixhi, qerraxhi, ekmexhi, xhemixhi* (it. *barcarolo*).

¹⁰⁴ Vediha Topçiu, Disa çështje të turqizmave në gjuhën e sotme, Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe, Prishtinë 1983 f. 277.

cek më sipër, Anton Kranji, pasi shprehet se atij nuk i "duket e urtë metoda e zëvendësimit të turqizimeve me fjalë të tjera të huaja, me përjashtim të rasës, kur këto të fundit janë në përdorim ndërkombëtar" nxjerr përfundimin se "të pakta do të jenë turqizmat që mbesin në gjuhën shqipe, por edhe këto do të zbresin në minimum".¹⁰⁵

Si nga aspekti teorik, ashtu edhe nga ai praktik është me interes të ceket punimi i Mehmet Topallit me titull "Emrat e ndërtuar me prapashtesën -AXHI në të folmen e shqipes së Prizrenit"¹⁰⁶, ku autori "duke i përimituar vështimthi", emrat e ndërtuar me këtë prapashtesë i klasifikon në 9 farë. Numër më të madh të shembujve sipas konstatimit të tij, zënë emrat e nënfushës semantike "që tregojnë njeriun që merret me zejen e përpunimit, të përshtimit (prodhimit -sqarim imi) ose shitjes së asaj që shpreh tema e emrit", pastaj shënon nënfushat e tjera kuptimore ku përdoren emrat e caktuar, qoftë të huazuar nga turqishtja, qoftë edhe të "emrave të vetë shqipes dhe të atyre që shqipja i ka marrë hua prej gjuhëve të tjera".

Autori vëren me të drejtë se në gjuhën shqipe të Prizrenit ashtu si në shqipen mbarë në shumicën e rasteve kjo prapashtesë që në turqishte paraqitet në katër variante: CI (XHI), C1 (XHË), CU (XHU) dhe CÛ (XHY) është rrafshuar në prapashtesën -XHI -AXHI).

Duke u mbështetur në shumicën e shembujve të vjelë nga e folmja, të cilën e ka në shqyrtim, autori arrin në përfundimin se emrat më -AXHI duhet të zëvendësohen me formantin përkatës "-ATAR" të shqipes.

Kështu më duket se autori, si të themi, e tejzmadhon trajtën -ATAR, kundrejt trajtës -TAR ose -ë/TAR. Këtë po e them, sepse në gjuhën e sotme letrare zanorja mbështetëse epentetike -A- nuk del aq e domosdoshme, pasi që për një funksion të tillë epentetik më praktike del zanorja -Ë-. Ç'është e vërteta, zanorja -Ë- në disa raste mund të cilësohet si një element fundor i temë-emrit të caktuar, si p.sh. lëkuraxhi lëkurëtar, barkaxhi barkëtar etj., por në raste të tjera kjo në letrarishten e sotme del a mund të dalë në funksion epentetik.

Prapashtesa turke -XHI- në gjuhën tonë pati përhapje mjaft të konsiderueshme. Në shqipe kjo prapashtesë del vetëm në dy variante: -XHI dhe -ÇI, ndërsa, siç u tha më sipër, në gjuhën turke kjo prapashtesë del në katër variante si p.sh.:

- me XHI: gaseteci (gazetaxhi), kahveci (kafexhi), gemici (gjemixhi);
- më XHË: arabac1 (arabaxhi), bostanc1 (bontanxhi), biçakci (thikëtar);
- me XHU: kontrollurcu (kontrollor), koruyucu (mbrojtës),
- me XHY: ölçücü (matës), ütücü (hekurosës), üzümçü (hekurta) etj.

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm në gjuhën tonë janë përfutur vetëm me emërtimet turke me variantin prapashtesor -XHI dhe "XHË", të tipit gjemixhi dhe bostanxhi. Siç dihet në shqipe trajta -ÇI "u ngjitet emrave që mbarojnë me bashkëtingëllore të pazëshme" si p.sh. bixhosçi, dyfekçi, zanatçi etj. Krahaso turqisht

¹⁰⁵ A. Kranji, Hyrje e turqizimeve në shqipe dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre, te "Studime mbi leksikun..." II, Tiranë 1972 f. 343.

¹⁰⁶ Mehmet Topalli, "Emrat e ndërtuar me prapashtesën -AXHI në të folmen e shqipes së Prizrenit", botim i Shkollës së lartë pedagogjike "Xhevdet Doda" të Prizrenit, Prizren 1986.

saatçi, zanaatçi, akçi, bekçi, biletçi etj. Ndërsa trajta -XHI përdoret në raste të tjera që mbarojnë me bashkëtingëllore të zëshme.

Në përgjithësi mund të konstatohet se emërtimet me prapashtesën me origjinë turke në letrarishten e sotme nuk janë më as prodhimtare as aktive, në krahasim me periudhat e mëhershme.

6) Emrat me prapashtesën -IST

Me prapashtesën -IST janë reflektuar në gjuhën shqipe një numër mjaft i madh i emërtimeve me cilësinë e fjalës ndërkombëtare. Në "Fjalorin e fjalëve dhe të shprehjeve të huaja" të M. Ndreca¹⁰⁷ janë afro 200 shembuj me këtë prapashtesë. Shumica e shembujve tregojnë njeriun sipas veprimtarisë a profesionit që ushtron, por ka ndër ta edhe emra që tregojnë njeriun më tepër sipas cilësisë a përkatësisë së tij shoqërore a ideologjike, si p.sh.: autonomist, ateist, cionist, dogmatist, evolucionist, federalist, fraksionist, laburist, materialist, unitarist, evangjelist etj.

Disa nga emërtimet e mësipërme ndeshen të përdorura në dokumentet e shkruara të gjuhës sonë qysh herët, p.sh. fjalën evangjelist e përdor Gj. Buzuku. Fjalët psalmist e anatomist i përdor P. Bogdani etj. Dihet se fjalët e tilla i takojnë fondit aktiv jo vetëm të gjuhës sonë, por edhe të shumicës së gjuhëve të tjera.

Sa i përket analizës fjalëformuese mund të themi se te një pjesë e madhe e emrave më -IST dallohet qartë tema motivuese si p.sh. hotelist, karikaturist, fabulist, folklorist, korist, kranist, fizkulturist, futbollist, makinist, modelist, motorist, pompist, pamfletist, protokollist, skenarist, vagonist violinist etj. Në shqipe vetë emri temëprodhues është fjalë aktive e fondit të fjalësit të gjuhës sonë. Nga shembujt e mësipërm po rikujtoj vetëm tre shembujt e parë: hotel-, karikaturë- e fabul-. Mirëpo në realitetin tonë gjuhësor ndeshim edhe emra më -IST me temë jo të qartë sa i përkët zberthimit në gjuhën sonë, si p.sh. okulist, deist, altruist, fideist etj. - shembuj këta që janë në numër më të vogël kundrejt atyre fjalëve ndërkombëtare a ndërkombëtarizmave që edhe në shqipe, siç e pamë në disa shembuj, kanë temë të qartë fjalëformuese.

Me të drejtë prof. Shaban Demiraj konstaton se "sipas gjedhes të fjalëve të këtij tipi si komunist, socialist, imperialist etj. janë formuar në shqipe fjalët: majtist, djathtist, shkollarist etj."

Vlen të theksohet fakti se në gjuhën tonë ndeshim një grup emërtimeve si: *filatelist, daktilografist, harmonist, gjeodezist, kimist, akademist, ekonomist* etj. tema fjalëformuese e të cilave mbaron më një -I fundore si p.sh. filateli-, daktilografi- etj., të cilës i shtohet prapashtesa -IST për të formuar emërtimin e njeriut sipas profesionit. Te rastet e tilla kemi të bëjmë me elidimin e i-së së temës. Kjo vërtetohet dhe me faktin kur kemi parasysh edhe shembujt të tjerë, si p.sh. organo organist e të ngjashme, ku shihet qartë se elidohet zanorja fundore e temës fjalëformuese, ndërsa prapashtesa -IST qëndron e plotë.

¹⁰⁷ Mikel Ndreca, Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të huaja, Prishtinë 1986.

Ndër ne hetohet një prirje që të krijohen emërtime të këtij nëntipi më -IST, edhe pse konceptet e tilla janë të mbuluara me barasvlerës të tjerë, madje edhe të normëzuar si p.sh.: *teorist* krahas *teoricien* e *teorik*; *gjuhësisht* krahas *gjuhëtar* e *linguist* etj.

Duke qenë kjo prapashtesë produktive dhe aktive në shqipen e sotme, pikërisht për emërtimin e njerëzve sipas mjeshtërisë ose të punës që kryejnë në jetën e përditshme, dalin edhe aso trajtash që nuk është e domosdoshme të jenë në gjuhë të tjera. Kështu te ne i ndeshim edhe këto trajta emërtimesh: *patinazhist* (*patinazh*), *peisazhist* (*peisazh*), *masazhist* (*masazh*), *manikurist* (*manikur*), *pedikurist* (*pedikur*), *drenazhist* (*drenazhë*), *montazhist* (*montazh* -në film) ashtu si *shantazhist* etj. edhe pse në gjuhë të tjera mund të ketë edhe zgjidhje të tjera si *patinator*, *pediker*, *maniker*, *drenazher*, *montazher* e që reflektohet në këto trajta edhe në gjuhën tonë aty - këtu nga ndonjë përdorues.

Lidhur me trajtat: *manikurist*, *pedikurist* mendoj se në shqipe më mirë do të dilnin trajtat *manikurues*, *pedikurues*, kur kemi parasysh faktin se folja **kuroj** është fjalë e njohur aktive e fjalësit të gjuhës sonë.

7) Emrat me prapashtesën -ER

Xhuvani - Çabej kanë konstatuar se prapashtesa -ER si prapashtesë "e rrallë në gjuhën popullore është bërë produktive në gjuhë të shkrimit duke formuar me të emra që tregojnë një gradë ushtrie ose një profesion" dhe për këtë japin shembujt: *kapter*, *reshter*, *toger*, *pastaj delmer*, *bulqer* (*bujk*). Gjithjashtu cekin edhe fjalën *laper* si një krijim të hershëm nga *lapë* (*leckë*).

Autorët në fjalë shënojnë edhe faktin se "disa emra me këtë prapashtesë janë marrë ashtu të plotë prej gjuhëve romane (italisht e frëngjisht)" dhe sa për ilustrim japin shembujt: *milioner*, *noter*, *veteriner*, *shofer* si dhe *kandiler* e *oficer*.

Ç'është e vërteta, Xhuvani-Çabej në kuadër të kësaj prapashtese pëfshijnë edhe shembujt më -IER të tipit *portier*, *tip ky* i cili në këtë punim trajtohet veçan. Një dallim të tillë e pamë të arsyeshme ta bëjmë më tepër për shkaqe praktike, por edhe për arsye të tjera, ngase me gjithë funksionin e njëjtë që kryejnë ka raste kur këta dy elemente të huazuara: -ER dhe -IER nuk mund të ndërkëmbehen njëra për tjetrën, ngase mbulojnë nënfusha të ndryshme semantike. Me fjalë të tjera nuk janë të lejueshme trajtat paralele mbi temë të njëjtë fjalëformuese duke e shtruar kështu jo *sadokudo* po në raste domosdo, nevojën për diferencimin e trajtave në shqyrtim.

Në FSHSK janë shënuar edhe këta emra si emërtime njerëzish sipas profesionit: *fermer*, *spiker*, *kapter*, *veteriner*, *dispeçer*, *trajner*, *noter*, *kombanjer* e në burime të tjera ndeshim edhe emërtimet: *adulter*, *akusher*, *autosajder*, *dubler*, *cerber*, *menaxher*, *teknomenaxher*, *moler*, *partner*, *reporter*, *sufler*, *shinter*, *vulkanizer*, *zhongler*.

8) Emrat me prapashtesën -IER

Në "Gramatikën e gjuhës së sotme shqipe (Morfologjia)" konstatohet se ndër prapashtesat me origjinë të huaj: -IK, -ANT, -ENT, -IER (-ER) "më prodhimtare paraqitet prapashtesa -IER, e cila mund të bashkohet edhe me tema emrash që sot

ndihen si fjalë shqipe" dhe për këtë jepen shembujt: karrocë - karrocier, portë - portier, bankë - bankier, boks - boksier, magazinë - magazinier".

U cek më sipër arsyeja pse në punimin tonë trajtohen ndaras formantet -ER ndaj -IER, edhe pse te vepra e Xhuvani -Çabejt, në gramatikën e sipërcekur si dhe në burime të tjera këto dy formante nuk trajtohen veç e veç.

Me prapashtesën -IER, e cila në gjuhën tonë letrare u përhap me të madhe, sidomos në etapën e Pavarësisë, përdoren kryesisht emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë a profesionit të huazuara nga italishtja, si p.sh.: *betonier, brigadier, doganier, infermier, inxhinier, kamerier, korrier, vinçier, autovinçier, financier, mobilier, portier, romancier, stallier, tapicier, timonier, xhenier, banakier, hotelier, parukier, pastiçier, grenadier, shansonier, pionier, barsolier, konferencier, granatier, rentier, stazhier* etj.

Përdorimi i trajtave të tillë me këtë formant ka një shtrirje mjaft të gjerë në gjuhën tonë, por që në kohë të fundit ritmi i shumimit të shembujve të tillë ka filluar të ngadalësohet në dobi të trajtave më -ER dhe formanteve të tjera, kështu që raporti emërtimeve më -ER dhe -IER në FSHS (2002) është i barabartë për nga numri.

Sa ishte e përhapur dhe e përvetësuar formanti -IER në gjuhën tonë në etapën e viteve `30 e `40 dëshmon rasti i fjalës boksier, trajtë kjo që vetëm në shqipe e ka formantin -IER se në të tjera del formanti -ER. Krahaso: *angl. boxer, fr. bocseur, sp. boxedor, gjerm. Boxer, rus boksior, serb bokser, turq boksör, it. pagilista, pagilatore.*

9) Emrat me prapashtesën -AN

Në gjuhën tonë kemi disa emra të huazuar me cilësi të fjalës ndërkombëtare që kanë elementin fundor -AN, si p.sh.: nallban, dekan, veteran, jaran, pehlivan, xhanan, por edhe partizan, dragoman, narkoman, borizan, artizan etj. Gjithashtu në letrarishten e sotme ndeshim edhe emra të tjerë me këtë element prapashtesor që është i zbërthyeshem më qartë se te shembujt e mësipërm, ngase fjalë-tema fjalëformuese del e motivueshme dhe është fjalë aktive e fjalësit të gjuhës sonë, si p.sh.: fizikan, matematikan, politikan, gramatikan, republikan, madje edhe historian, komedian, etj. Xhuvani - Çabej në studimin e tyre të mirënjohur "Prapashtesat e gjuhës shqipe" shënojnë se prapashtesa -AN "u ngjitet emrave e mbiemrave duke treguar një cilësi të fjalës rrënjë" duke mos e cekur qartë, por as duke mos mohuar faktin se elementi i tillë përdoret jo vetëm për të treguar njeriun sipas cilësisë ("të fjalës rrënjë"), por edhe sipas profesionit, siç dëshmojnë shembujt e mësipërm që u sollën në punimin tonë.

Mbase nga ndonjë studiues shembujt e tipit fizikan, matematikan mund të konsiderohen si fjalë të huazuara transfer, d.m.th. bashkë me elementin -AN fundor dhe se për këtë merret për bazë qëndrimin e studiuesve Xhuvani - Çabej, të cilët nuk e shënojnë qartë faktin në fjalë. Sidoqoftë, mbase qëndrimi i tillë do të ketë ndikuar që emrat e këtij tipit mbi bazë të fjalë-temave ndërkombëtarizma me -IK(ë) fundore të mos jenë konsoliduar ende plotësisht në gjuhën tonë letrare. Ç`është e vërteta, në

gjuhën e sotme letrare nuk ndeshim raste të rralla që numri i shembujve më -AN mbi bazë të nëntipit të mësipër (mbi ndërkombëtarizmat më -I dhe me -IK(Ë) fundore) të rritet në mënyrë suksesive, si p.sh.: komedian, tragjedian; fonetikan, aritmetikën, statistikan etj.

Gjithsesi prirja lidhur me aktivizimin e prapashtesës -AN mbi bazë të ndërkombëtarizmave më -I dhe -IK(Ë) fundore tipi: histori, matematikë: *historian matematikan* që ishte e vërejtshme në etapën e Pavarësisë, në kohën tonë pothuajse ka kaluar a duhet të kalojë në dukuri, duke e mbështetur me ndërgjegje të plotë një dukuri të tillë, sepse një veprim i tillë do të ndihmonte konsolidimin e drejtshkrimit të emrave të këtij tipi, përkatësisht të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit.

10) Emrat me formantin -ANT

Me formantin -ANT në shqipen e sotme letrare nga tradita kanë gjetur përdorim disa emra të huazuar nga gjuhët e tjera. Te një numër shembujsh të tillë tema e qartë motivuese nuk mund të zbërthehet në shqipe si p.sh.: *militant, ofrant, garant, adjutant, diversant, aspirant, laborant*, ndërsa te një numër tjetër fjalë-tema fjalëformuese mund të zbërthehet pa vështirësi si p.sh.: *demonstrant, diskutant, konsultant, liferant, spekulant, sekundant, manipulant, dublant* - kur kemi parasysh faktin se në shqipe mbi këtë bazë e kemi të përfutur trajtën foljore, por edhe emrin prejfoljor si p.sh.: *demonstroj demonstrues, diskutoj diskutues* etj. Madje në letrarishten e sotme varësisht nga stili që shprehet trajtat mbi bazë të foljes janë më të parapëlqyera. Edhe më të qartë dhe motivues dalin shembujt vijues më -ANT si: *adresant (adresë), shifrant (shifër) ministrant (ministër) praktikant (praktikë), kursant (kurs) diplomant (diplomë), maturant (maturë), muzikant (muzikë), komandant (komandë)*.

Raporti ndërmjet trajtës -ANT dhe -AN është mirë të sqarohet më mirë. Është e vërtetë se në shkrime të traditës këto dy formante nuk dalin të dalluara qartë, për këtë arsye ndodh që edhe në shkrimet të ditës të ndeshim të mgatërruara trajtat edhe fizikan edhe fizikant, edhe matematikan edhe matematikant, edhe praktikan edhe praktikant, edhe fabrikan edhe fabrikant, muzikan e muzikant etj.

Mendimi im është që vetëm në rastet kur trajta më -ANT disi del e rrënjosur në atë trajtë mund të përdoret, përndryshe për raste të reja më e favorshme duhet të dalë trajta më -AN, sidomos në rastet kur temë formuese del një ndërkombëtarizëm me -IK(ë) fundore dhe kur ende nuk është krijuar mundësia që emërtimi i caktuar të dalë me prapashtesën -UE/S, d.m.th. mbi bazë foljore të shqipes.

Në fund lidhur me këtë formant po cek faktin se kur është fjala tek emërtimet të cilat tregojnë njeriun paksa pësues ai që merr a duhet me marrë diçka që ka lidhje me fjalë-temën prodhuese, siç janë fjalët e huazuara: *diplomant, doktorant, kursant, ministrant, edukant* etj. që në latinishte (a gjuhë të tjera marrin prapashtesën -AND, me të cilat tregohet që personi i caktuar duhet të marrë diplomë, doktoratë, edukatë etj. për deri sa t'i gjindet barasvlerësi përkatës me elemente më të pranueshme në gjuhën tonë mbase më mirë do të ishte të shënohet ky formant më -AND e jo më -

ANT, si p.sh. doktorand - doktoratëmarrës; edukand - edukatëmarrës etj..
Gjithsesi kjo çështje mbetet si çështje e hapur që kërkon zgjidhje.

11) Emrat me fundoren -ENT

Me fundoren -ENT në gjuhën tonë përdoren disa emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë a përkatësisë, si p.sh.: *asistent, agjent, intendent, enteresent, komitent, konsulent, referent, student, regjent, delikuent, disident, klient, korrespondent, docent, obducent, pacient, president, recensent, konkurrent, regjent, oponent.*

Duke qenë nën ndikimin e ndërkombëtarizmave me elementin e tillë fundor ndodh që fundori i tillë për analogji të përdoret edhe te ndonjë emër tjetër që si fjalë ndërkombëtare i takon tipit tjetër të emrave që formohen a janë formëzuar me prapashtesë tjetër si p.sh. muzicient, matematicient, fizicient, teoricient etj. që siç dihet emërtimet e tilla janë të normëzuar me prapashtesa të tjera si: muzikan(t) a muziktar, matematikan, fizikan, e kështu me radhë.

Gjithsesi duhet pasur kujdes që mënyra e shkrimit të emrave me fundoren -ENT mos të shtrihet edhe për ata nëntipa emrash që kanë gjetur zgjidhje në mënyrë tjetër më të pranueshme dhe më praktike, siç janë ata me prapashtesën -AN, -TAR etj., sepse formanti -ENT është huazuar bashkë me tërë emërtimin dhe nuk duhet ngatërruar me formantin c/ien të frëngjishtes.

12) Emrat me fundoren -IK

Me fundorin -IK në gjuhën tonë përdoren disa emra të huazuar me cilësinë e fjalës ndërkombëtare si p.sh. *akademik, mekanik, hidraulik, teknik, mekanik, kritik, skolastik, patrik, kanonik, heretik, etnik, kozmetik, lirik, romantik, teorik, elektronik, grafik* etj. Po ashtu me këtë fundore ndeshim edhe këta emra me origjinë orientale: *ashik, sheik, mynafik.*

Siç shihet nga shembujt: *mekanik, teknik, kritik* ... emrat e tillë pothuajse i praprijnë ndërkombëtarizmës me -IK(ë) fundore: *mekanikë, teknikë, kritikë*, me të cilat janë të lidhura a të varura kuptimisht si emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë.

Meqenëse mjaft emra që u cekën më sipër ende nuk kanë gjetur konsolidim në gjuhën tonë letrare mendoj se si zgjidhje më i mirë do të ishte që edhe në këto raste të emërtimit të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë të hyjë në aktivizim prapashtesa -AN, siç ka ndodhur me shembujt matematikan, fizikan. Rastet më -IK fundore mbesin gjithnjë të përdoren si mbiemra. Po rikujtoj se përpara se të konsolidohet trajta matematikan në shkrimet e hershme të shqipes është përdorur trajta matematik, pastaj matematikant, matematicient e ndonjë trajtë tjetër. Tashti, po përsëris, trajta **matematikan** është përligjur normativisht.

Gjithsesi duhet pasur parasysh faktin se rastet mekanik, teknik me derivatet e mundshme në gjuhën tonë letrare janë normëzuar vetëm më -IK fundore, prandaj ato për konceptin e njëjtë s'ka nevojë të shënohen ndryshe.

13) Emrat me formante të tjera fundore-prapashtesore

Në gjuhën tonë, edhe pse në numër të vogël shembujsh, përdoren edhe formante të tjera për emërtimin e njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë. Më poshtë po i shënoj edhe nja 12 formante të tilla, të cilat po i ilustrojmë me shembuj konkretë përkatës:

1. -CI/EN: Me këtë formant fundor në Fjalorin e gjuhës së sotme është shënuar vetëm emërtimi teoricien. Kjo trajtë është fjalë e huazuar nga gjuha frënge. Formanti i tillë në atë gjuhë shqiptohet -SJË. Sipas kësaj rruge ndodh që ndonjë autor i papërvojë të përdorë trajta të ngjashme si: muzicien, fizicien, praktikien he aq më keq më -c/ient: muzicient, fizicient, praktikient etj., të cilat, siç u tërhoq vërejtje edhe më përpara, vërtet dalin të panevojshme, kur dihet se tashmë për konceptet në fjalë i kemi trajtë-termat e normëzuar dhe se edhe trajta e vetme teoricien është në goditje e sipër nga trajtat: teorik teorist teorizues e ndonjë tjetër.

2. -C/IST: Nën ndikimin e fundorit të italishtes -CISTO (C-ja lexohet Ç), në gjuhën tonë janë reflektuar dy emra që janë të regjistruar në FGJSSH: elektrikist dhe fizarmonicist. Sipas kësaj mënyre në realitetin tonë gjuhësor ndodh të shfaqet ndonjë trajtë si p.sh. mekanicist, logjicist. Ma merr mendja se zgjidhjet që ndeshen në burime të caktuara si p.sh. mekanik mekanikan, logjikan, elektrikan, harmonikan - duhet pasur parasysh, mbase ato si zgjidhje janë më të arsyeshme dhe si të tilla nuk është keq të përkrahen, siç janë b.f. formimet më -AN fundore. Andaj në këtë kuadër tërheq vëmendjen e studiuesve rreth një çështjeje që e shtroj si pyetje: sa është me vend në gjuhën tonë përdorimi i fundorit -C/IST, tek emërtimet si logjicist, grecist, turcist, kur dihet fakti se elementi -C- në gjuhën tonë nuk përshtatet me temën fjalëformuese. Krahaso: specialist i logjikës logjicist, ai i turqishtes *turCist* në vend turQist ose specialist i gjuhës turke *turKist*, përkatësisht specialist i greqishtes (greQist) ose i gjuhës greke (greKist). Sigurisht rregullave të fjalëformimit të shqipes më tepër i përgjën trajtat me /qist ose k/ist se sa me c/ist, ngase tema fjalëformuese nuk mbaron me C po me Q- (shumësi) ose K- (njëjësi). Në të vërtetë nëse kemi të bëjmë me leximin e C-së latine, ajo lexohet në raste K, jo C, siç del në e alfabetit të shqipes. Sidoqoftë, një traditë e tillë përdorimi nga shkencëtarët tanë bie ndesh me rregullat e fjalëformimit të shqipes, prandaj mbase duhet rishikuar kjo çështje. Për mendimin tim më drejt do të dilnin në shqipe trajtat logjikan a logjikist, grekist (specialist i gjuhës greke), turkist (specialist i gjuhës turke) ose grekolog, turkolog se sa trajtat me -CIST: logjicist, grecist, turcist(!!!)..

3. -OZ: Mbase në ndikimin e disa emrave e mbiemrave më -OZ fundor si karagjoz, mafioz, marangoz, bajloz, muskuloz etj. në disa vise të shqipes dëgjohet emërtimi **makinoz** për makinist. Trajta makinoz nuk është trajtë e normëzuar.

4. -ASH: me fundorin -ASH -(AÇ) në gjuhën tonë të përditshme përdoret fjala pirash (pijanec) edhe ajo grupash (fraksionist), e cila ka karakter të fjalës ndërkombëtare, por për qëllime stilistike ndodh të përdoret edhe ndonjë trajtë si partiaç a partiash, udbaş a udbash e ndonjë tjetër. Sigurisht emrat e tillë në numër janë të pakët dhe pos për qëllime stilistike nuk kanë përdorim të përgjithshëm apo

nuk japin shenja shumimi.

5. -C: Me këtë formant kemi disa fjalë të huazuara në shqipe si: polic, milic, marinc, princ, por edhe sigurimc. Te shembujt e tillë nuk kemi të bëjmë me trajtat dialektore si: korrc, vjedhc, gjykcac etj. por kemi të bëjmë me huazime a përdorime të fjalëve për qëllime stilistike.

6. -IR: Ndër ne nën ndikimin e gjuhës serbokroate shpeshherë ndodh të ndeshim jo vetëm në ligjërim të thjeshtë, por edhe në shkrime të caktuara trajtat kurir (korier), oficer (oficer) etj, ngase kështu shqiptohen e shkruhen këto fjalë ndërkombëtare në serbishte. Më karakteristik është emri komandir¹⁰⁸ që i takon fushës së ushtrisë. Fjala komandir, përdoret më gjerësisht në gjuhën ruse, por edhe në gjuhën serbokroate krahas fjalës komandant, për në shkallë kievarkie më të ulët se fjala komandant. Po ky emërtim në situata të caktuara ndeshet ose më mirë ndeshet e përdorur edhe në gjuhën tonë.

Ma merr mendja se për rrafshin neutral kuptimor në shqipe në vend të kësaj trajte më mirë është të përdoren fjalë-termat përkatës: komandant, komandar a komandues. Fjala nikoqir, me origjinë greke, si huazim transfer, në Shqipëri, pothuajse është në përdorim normal.

7. -AS: Me këtë prapashtesë, e cila në gjuhën e sotme letrare u specializua për emërtimin e njëzve sipas vendbanimit a prejardhjes, në ndonjë rast në burime të caktuara po ndeshet pa kurrfarë nevojë edhe për emërtimin e njëzve sipas profesionit a veprimtarisë si p.sh.: përbalcas (edhe P. Bogdani), yshtas, kullotas, optikas, kryeqytetas (te Bariqi), mësimdhënas (te Naimi), teorikas (te L. Poradeci), rilindas, bashkëkohas, burrështetas etj.

Shembujt në fjalë në gjuhën e sotme letrare dalin me prapashtesën speciale -Ë/S.

8. -NIK: Me prapashtesën -NIK në burime të caktuara ndeshim në këto emërtime: çetnik, shpianik, kreshnik. Në Fjalorin e F. Bardhit ndeshim tre emra me këtë prapashtesë: kamatnik, haraçnik e strazhnik.

Kjo prapashtesë sllave nuk është as prodhimtare as aktive në shqipen e sotme letrare.

9. -AK: Me prapashtesën -AK janë formuar emrat: ushtarak dhe shtëpiak. Te ne emri shtëpiak po përdoret si barasvlerës për nikoqir, madje edhe pse jo aq i qëlluar edhe për termin domar të serbokroatishtes. Sipas mendimit tim konceptit **domar** më tepër i përgjigjet barasvlerësi "**mirëmbajtës objekti**" sesa: shtëpiak a nikoqir, kujdestar shtëpie etj. Me prapashtesën -AK në ndonjë burim nga e kaluara është shënuar historiak, koncept ky që tash është normëzuar në trajtën **historian**. Shih për këtë edhe në punimet e E. Koliqit te "Shejzat" (Romë) nr. 5-8 /68.

10. -OS: Nën ndikimin e gjuhëve të huaja në gjuhën tonë kanë hyrë edhe disa fjalë më -OS fundore, si p. sh. *kustos*, *komandos* etj. Edhe pse emri komandos mund të zbërthehet me elemente fjalëformuese të gjuhës shqipe, elementi -OS, këtë rast, nuk është prapashtesë e emrit të gjuhës shqipe, prandaj edhe tërë kjo fjalë konsiderohet si

¹⁰⁸ Termi **komandir** përdoret në Armatën Ruse (Sovjetike) si barasvlerës i termit **komandant** që përdoret në gjuhë të tjera (Shih: B. Klai_, Veliki rječnik stranih rječi, izraza i kratica, Zagreb 1968 f. 671). Në gjuhën serbe përdoret për gradë më të ulët në ushtri dhe së këtejmi është reflektuar paksa edhe në shqipe.

emër i parmë i huazuar.

11. -OK: Me prapashtesën -OK në gjuhën tonë është formuar emërtimi *sharrok*, që është sinonim i emrit *sharrues* a *sharrtar*.

12. -AQ: Në kohën tonë në shqipen e sotme letrare është përfutur emri **shënaq** me kuptimin "ai që shënon vaksinën" dhe rekomandohet që kjo fjalë në këtë trajtë të përdoret për të zëvendësuar trajtën **vaksinues**¹⁰⁹.

Përmbyllje

Pa pretenduar se jemi shterues në parashtrimin e kësaj teme po përfundojmë me konstatimin se prapashtesa -S është prodhimtare tek emrat me temë mbi bazë të pjesores, kurse prapashtesat e tjera, sidomos ajo -TAR dhe -AR dhe mbi bazë të temave emërore mbi bazë të brumit të shqipes, kurse prapashtesat -AN, -IST, -IER dhe -ER e ndonjë tjetër zakonisht janë të vërejtshme te fjalët e huazuara ose mbi bazë të temave si fjalë-ndërkombëtare.

Rreth raportit konkurrues të formanteve prapashtesorë më në hollësi do të bëhet fjalë në kreun V të këtij punimi, pasi të analizohen emërtimet e njerëzve sipas profesionit në gjininë përfaqësuese femërore.

(2) EMRAT E PARMË SI EMËRTIME TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT

Në cilësinë e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën tonë me origjinë autoktone a të përvetësuar si të tillë del, një numër jo i madh i emrave.

Mbi bazë të tipit kuptimor sipas veprimtarisë shënuam këta emra të parmë që po i quajmë të brumit të shqipes: plak, mbret, prift, bari, pasi si të tillë I ndeshim të trashëguar nga lashtënia Ndërkaq ndërkohë me burim të huaj numri i tyre, si fjalë-emra svantë, është i konsiderueshëm, si p.sh: arkitekt, profesor, dekan, teknik, inxhinier, filozof, doktor etj. Siç dihet nga studiuesit është përqafuar qendrimi se të gjithë emrat e huaj të huazuar me cilësinë e fjalës ndërkombëtare ose me cilësinë e ndërkombëtarizmes, kur nuk janë të zbërthyeshëm me elemente të gjuhës sonë, konsiderohen emra të parmë, pa marrë parasysh faktin se në gjuhë të tjera a në gjuhën dhënëse emri përkatës mund të ketë zbërthim të qartë, qoftë si emër i prejardhur, qoftë si emër i përbërë, andaj edhe mjaft raste me formantet fundore të cekua më sipër konsiderohen në shqipe si emra të parmë.

Zakonisht në emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë sipas profilizimeve të profesioneve emrat e parmë dalin brenda emërtimit togfjalësh përkatës.

¹⁰⁹ Shih te doracaku normativ "Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj" botim i Prishtinës, si dhe te revista "Gjuha jonë" nr. 1/87, Tiranë 1987.

(3) EMRAT ME PËRNGJITJE DHE PRAPASHTESIM NJËHERAZI

Në kuadër të emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë a cilësisë hasim disa emra të formuar sipas mënyrës së përzier me përngjitje dhe prapashtesë njëherazi. Këta emra janë formuar historikisht dhe nuk paraqesin model, por nuk janë edhe aq të pavërejtshëm edhe në letrarishten e sotme të njësuar.

Ja disa shembuj: përdërës, merendues, nëpunës, mëditës, nëdorës (posedues)¹¹⁰, nëndorës (ryshfetçi), mengues (ndëgjues në kuvendet e pleqve¹¹¹), medorës (luftëtar), mëdorës (kafshar), mëkëmbës (te Naimi: nëkëmbës), mendorës; dashamirës, bëmirës, bëkeqës etj.

Për të pasur një ide më të qartë se si janë formëzuar emrat e tillë për nga ndërtim-fjalëformimi po i zbërthejmë dy shembuj: *nëpunës* e *mëditës*:

nëpunës - në + punë + S: nëpunës;

mëditës - me + ditë + S: mëditës.

Kjo mënyrë fjalëformimi nuk është prodhimtare, por siç u tha nuk është aq e pavërejtshme në shqipen e sotme letrare, siç dëshmojnë edhe shembujt: dashamirë/s, bamirë/s, nëndorës e të ngjashëm.

Disa nga shembujt siç janë: nëdorës, medorës, mengues, mendorës ... janë vjelë kryesisht nga ligjërimi popullor, çka dëshmon se edhe shembujt të tjerë të tillë të paregjistruar mund të ndeshen akoma në ligjërimet tona popullore.

(4) EMRAT E PËRBËRË (KOMPOZITAT)

Në lëmin e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit janë aktive dhe prodhimtare dy tipa të emrave të përbërë:

a) Në tipin e parë përfshihen emrat e përbërë ku gjymtyra e dytë përcaktohet nga gjymtyra e parë, e cila mund të jetë emër, ndajfolje, përemër, numëror dhe për nga funksioni dhe komponenti i tillë fjalësor merr tipare të një parashtese a të një siparashese (prefiksoidi), kurse gjymtyra e dytë mund të jetë një emër vepruesi me

¹¹⁰ Haxhi Birinxhiku, Disa shmangie në përdorimin e terminologjisë në "gazetën zyrtare të KSAK, kumtesë e botuar te "Gjendja e terminologjise shqipe në Jugosllavi", Prishtinë 1988, f. 148

¹¹¹ Fjalë-term i njohur së paku në të folmet e Dukagjinit. Kështu quhej shoqëruesi "pleqnarit" në "mbarime" për me i mbajtë mend fjalët. Ekziston edhe shprehja: "Mos iu tut livduesit, po tutju menguesit". E ndëgjuar dhe e shënuar dhe e shpjeguar nga Shaban Pagarusha në fshatin Korishë të Prizrenit, më 8. II. 1973.

prapashtesën -TAR, -TOR, -AR dhe -S, p.sh.: kryegjahtar, bashkëpunëtor, kryefamiljar, kryegjykatës, vetëshkrues, shumëfishues etj.

b) Në tipin e dytë përfshihen të gjithë ata emra të përbërë ku gjymtyra e parë përcakton të dytën dhe tregon objektin a veprimin e saj, kështu që gjymtyra e dytë, për nga funksioni dhe kuptimi, merr tipare të një prapashtese a siprapashtese (prefiksoidi)¹¹² si p.sh.: bukepjekës, hekurpunues, gjellëbërës, orëndreqës etj.

Pra këtu ndarja në dy tipa u bë sipas funksionit prefiksoid a sufiksoid që kryen gjymtyra e caktuar. Të shohim në vazhdim edhe ndonjë karakteristikë të emrave në shqyrtim njëherë me siparashtesim e së dyti me siprapashtesim:

Së pari, tek emrat e tipit me siparashtesim dallojmë dy lloj siparashtesash: a) ato me burim autokton dhe b) ato të burimit të huaj.

a) Siparashtesat e burimit vendës janë: bashkë-, vetë-, krye, shumë- etj. Do të mjaftohemi vetëm me shënimin e ndonjë shembulli pa komentim, si: bashkautor, bashkëkooperues, bashkëpjesëtar, bashkëpronar; kryemjek, kryeinxhinier, kryevinçier, kryekomandant; vëtpunëdrejtues, vetëqeverisës; shumëgarist, shumëfishues etj.

b) Me burim të huaj do të përmendim këtu sa për ilustrim vetëm këto siparashtesa: auto-, elektro- dhe hidro-. Edhe lidhur me to po japim disa shembuj karakteristikë:

- autovinçier, automekanik, autollamarinist;
- elektroatlator, elektromontator, elektrosaldator;
- hidroinstalues, hidroinxhinier, hidroteknik, hidroterapeut etj.

Rreth prefiksoideve me prejardhje të huaj: auto-, elektro- e hidro- mendoj se vlen të theksohet fakti se këto fjalë me cilësi siparashtese nuk është e lejueshme të "përkthehen bukual" a të zëvendësohen përherë me barasvlerësit ekuivalent të gjuhës sonë si p.sh. auto/ vetë, elektro/ rrymë, hidro/ ujë, sepse fjala e huaj del e desemantizuar në emërtimet e caktuara lidhur me kuptimin fillestar. P.sh **automekanik** s' bën të "shqipërohet" vetëmekanik(!), ngase është fjala për **mekanik automjetesh**. Po ashtu s'bën të zëvendësohet **hidroinstalator** a **hidroatlues** me ujëintlues, ngase dihet se uji në shqipe s'ka se si të instalohet, por instalohen pajisjet e ujësjellësit, prandaj trajta **instalues ujësjellësi** del e parapëlqyer e jo ujintlues. Edhe **elektroatlator** a **elektroinstalues** s'bën të zëvendësohet me rrymëintlues, sepse është fjala për instalimin e pajisjeve elektrike. Edhe në serbishte thuhet elektroatlater e jo strujointalater. Kështu, me sa e di, veprohet edhe në gjuhë të tjera.

Të përfundojmë lidhur me këtë se së paku në letrarishten e sotme tek emërtimet e cekura më sipër nuk duhet të zëvendësohen siparashtesat me burim të huaj përkatësisht: auto-, elektro-, hidro- me barasvlerësit e shqipes: vetë-, rrymë-, ujë-,

¹¹² Trajtat me prapashtesën SI- si p.sh. siparashtesë për prefiksoid, siprapashtesë për sufiksoid, sindajshesë për afiksoid etj. më duken përdorime me vend. Këto pos tjerash i kam ndeshur të përdorura edhe nga Hajri Shehu te "Gjuha jonë nr. 4/87 f. 49 dhe E. Hysa te "Studime filologjike" nr. 2/86 f. 92 etj.

sepse trajtat në shqipe, hëpërhë, nuk dalin të desemantizuara.

Po shtojmë edhe këtë se të përafërta me tipin e sipërcekur sa i përket ndërtimit janë edhe emërtimet e tipit, si: skuadërkomandant, togëkomandant, postëkomandant; zëvendës drejtor, zëvendëskomandant, nëndrejtor, nënpresident, nënministër etj.

2) Tek emrat e përbërë të tipit të dytë me siprapashtesim, ku si element i dytë del patjetër një emër prejfoljor i vepruesit me prapashtesën -S, duhet të vështrohen me kujdes të dyja gjymtyrët e kompozitës, sidomos gjymtyra e dytë.

Për këtë qëllim sa për ilustrim po i sjell këta shembuj:

argjendpunues, bakërpunues, mermerpunues, leshpunues, litarpunues, gëzofpunues, lëkurëpunues; gjellëbërës, çelësabërës, vegshabërës, gëlqerebërës; pemëshitës, perimeshitës, pijeshitës, mishshitës, dardhashitës; këpucarnues, akulloreqitës, piteqitës etj.

Nga shembujt e mësipërm shihet se sufiksoidi në mënyrë shumë të përpikët shpreh profilin e mjeshtërisë së caktuar: punues i argjendit = argjendpunues; berës i vegshave = vegshabërës; shitës pemësh = pemëshitës etj., mirëpo kjo rregull fjalëformuese nuk ndalet vetëm në një numër të caktuar siprapashtesash. Ky model vlen pothuajse për të gjitha foljet, përkatësisht për të gjithë emrat prejpjesorë, kur këtë e kërkon dhe e lejon logjika e të shprehurit. Të rikujtojmë lidhur me këtë edhe ndonjë shembull: mësimdhënës, letërshtëpërndarës, edukatëmarrës edukatëdhënës, perimeritës, pjatallarës etj. etj.

Edhe diçka duhet sqaruar lidhur me raportin ndërmjet këtyre dy tipave të emrave të përbërë me siprapashtesim dhe me siprapashtesim. Ndërsa në tipin e parë mund të qëndronin pranë e pranë në model shembujt si p.sh. bashkëpunues dhe bashkëpunëtor, d.m.th. emrat me prapashtesa të ndryshme, në tipin e dytë me siprapashtesim nuk janë të lejueshëm emra tipash të tjerë pos emrave prejfoljorë të vepruesit. P.sh. nuk mund të thuhet **mermerpunëtor(!)** por vetëm **mermerpunues**.

Në këtë punim do të zihen në gojë edhe raste të tjera lidhur me emrat e përbërë si dhe vendi i tyre i domosdoshëm në emërtimin e njerëzve sipas profesionit, prandaj lidhur me këtë këtu nuk po e zgjas më tepër.

E shoh të arsyeshme që të mbyll këtë nëntitull me fjalët e V. Milkanit, i cili shprehet kështu:

"Emërtimet formuar me anë të kompozimit kanë interes gjuhësor, prirje të qartë zhvillimi dhe zëvendësojnë fjalët e parme dhe formimet ekzistuese prapashtesore. Te këto emërtime vihet re prirja e sotme e shqipes për të zbërthyer në mënyrë të tejdukshme nocionin". Po këtë veçori e vëren dhe e shpreh shumë mirë A. Kostallari me fjalët "Në thelb këtu pasqyrohet jo vetëm ndikimi i produktivitetit të kompozimit, por edhe stimuli i vetë kompozimit"¹¹³.

¹¹³ A. Kostallari, Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare, Shkenca shoqërore në shkollë, nr. 2/67, Tiranë 1967 f. 70.

Ç. EMËRTIMET JONJËFJALËSHA TË PROFESIONEVE TË FORMËZUARA NGA SHTYTËS TË JASHTËM

Në nomenklaturën e profesioneve ndeshim emërtime jo njëfjalëshe, me të cilat tregohen emërtimet e njerëzve sipas profesionit të formëzuar nga shtytës të jashtëm dhe nuk kanë të bëjnë me formante të brendshme fjalëformuese të fjalës së parë. Emërtimet e tilla paraqiten dylojëshe:

1. emërtime me dyfishim a gërshetim profesionesh dhe
2. emërtime togfjalësha.

1. Emërtime me dyfishim a gërshetim profesionesh

Në praktikën gjuhësore vërehen emërtime të caktuara, kur për plotësimin e vendit të lirë të punës kërkohen konkurrues, të cilët, përveç profesionit kryesor a përkatës duhet të posedojnë edhe profesion tjetër, si të themi, plotësues, përkatësisht kryerësi duhet të njohë dy a më shumë profesione (punë e detyra). Sa për ilustrim nga "Lista alfabetike e profesioneve" Beograd 1986 i volla disa shembuj të kësaj natyre:

lektor-përkthyes, lektor-redaktor, lektor-akcentolog; kimist- teknolog, kimist - laborant; fizikan- atomist, fotograf-ilustrator, kalibrnist-vegëltar, teknik-dispeçer, latues-montazhist, saraç-modelist, librar-magaziner, përkthyes-korrespondent, laborant-pedolog, laborant-teknolog, mjek-statistikan, agroteknik-pejsazhist, agronom-arkitekt, arkitekt- teknolog etj.

Nga përditshmëria jonë po jap këta shembuj:

gazetar-korrespondent, korrespondent-bashkëpunëtor, arkeolog-kustos, daktilografist-administrator, referent-përkthyes, sekretar-arkëtar, përkthyes-procesmbajtës, portier-zjarrfikës, arkivist-arkëtar, pastrues-korrier, diplomat-atashe, përkthyes-albanolog, arkëtar- likuidator, rojtar-zjarrfikës, dentist-terapeut, oficer-adjutant etj.

Të gjitha emërtimet e sipërcekura përbëhen prej dy emrash dhe secili prej tyre në situata të caktuara mund të qëndrojë si emërtim i mirëfilltë i profesionit të caktuar, pa pasur nevojë për shoqërimin e fjalës tjetër. Nga ana formale duket se këta dy emra kanë ndërlidhje bashkërenditëse si fjalët e përbëra (kompozitat), mirëpo nga pikëpamja semantike këto nuk janë të barabarta, ngase emri i parë në radhë për nga funksioni paraqet profesionin kryesor strumbullar, kurse emri i dytë vetëm e plotëson konceptin e të parit. Pikërisht ky fakt i dallon këto emërtime nga fjalët e përbëra me "lidhje bashkërenditëse" (Shih: Gramatika ...II, f. 163). Merret vesh se po të ndërrohet vendi i emrit në renditje ndryshon edhe funksioni i emërtimit të tillë. P.sh. tek emërtimi: lektor-përkthyes kuptohet se lektori do të kryejë a duhet të dijë edhe zanatin e përkthyesit, ngase kryen edhe ndonjë punë të përkthyesit. Ndërsa te versioni përkthyes-lektor theksi bie te "përkthyesi", i cili kryen edhe ndonjë punë të lektorit. Po kështu duhet të kuptohen e të zbërthehen edhe shembujt e tjerë që u

shënuan më sipër sa për ilustrim. P.sh. tek emërtimi pastrues-korrier, pastruesi kryen edhe punën e korrierit, tek emërtimi mjek-statistikan, mjeku kryen edhe punët e statistikanit etj.

Te disa shembuj kemi të bëjmë me gërshetim profesionesh p.sh. rojtar-zjarrfikës d.m.th. rojtari duhet të ketë kualifikimin e zjarrfikësit, tek emërtimi përkthyes-albanolog nënkuptohet se përkthyesi duhet ta ketë kualifikimin e albanologut, d.m.th. ta njohë patjetër gjuhën shqipe e që te ne kuptohet se duhet ta njohë edhe serbokroatishten. Të ngjashme janë edhe emërtimet mjek - stomatolog, mami - infermiere, infermier - laborant etj.

Gjithsesi emërtimet e sipërcekura qëndrojnë në mes të emrave të përbërë në njërën anë dhe të togfjalëshave në anën tjetër, por që nga pikëpamja kuptimore më tepër afrohen me nocionin e emërtimeve togfjalësha.

2. Emërtimet togfjalësha

Emërtimet togfjalësha (perifrastike) në nomenklaturën e përgjithshme të profesioneve janë në numër më të madh sesa janë emërtimet njëfjalësha dhe ato me dyfishim a gërshetim profesionesh. Sa i përket çështjes rreth përcaktimit a formulimit të emërtimeve të caktuara dalin mjaft gjëra që kërkojnë sqarim, sidomos fakti kur kemi të bëjmë me ndikimin e jashtëm. Ç'është e vërteta, koncepti i plotë i emërtimit perifrastik të profesionit të caktuar del në ndërlidhjen e të gjitha fjalëve që e përbëjnë atë, edhe pse dihet se kuptimi strumbullar mbetet gjithnjë te emri a fjala e parë si gjymtyrë kjo kryesore drejtuese.

Pothuajse të gjitha emërtimet e profesioneve të profilizuara janë togfjalësha. Sa për ilustrim po jap pasqyrën e të dhënave nga "Lista alfabetike e profesioneve të AMO-s" në kuadër të Jugosllavisë, dokument ky që ka rëndësi orientuese të karakterit universal. Sipas përqindjes në atë dokument emërtimet togfjalësha marrin pjesë **71.40%** në numrin e tërësishëm prej **2500** profesionesh, emërtimet kompozita marrin pjesë **21.80%**, emrat me prejardhje (me prapashtesim) **6.40%** dhe emërtimet fjalë të parme me vetëm **0.16%**.

Shumica e emërtimeve të profesioneve njëfjalëshe janë emra me funksione hiperonime që do të thotë se në gjirin e vet mund të përfshijnë një numër të konsiderueshëm të emërtimeve të tjera të profilizuara. Kjo mund të shihet në çdo nomenklaturë të profesioneve. Kështu që pas çdo emri njëfjalësh ose nënkuptohen ose shënohen fjalët përcaktuese të emërtimit të profilizuar, emërtimi i tillë togfjalësh pretendon a nënkupton faktin që në asnjë rast mundësisht të mos lërë asnjë shteg homonimie ose variant semantizimi që do të rrezikonin qartësinë kuptimore të emërtimit të caktuar.

Në vazhdim do të tërheq vëmëndjen rreth kuptimit të përcaktorëve, përkatësisht rreth (pa)qëndrueshmërisë së tyre semantike e logjike. Shembujt konkretë të emërtimeve togfjalësha, janë shënuar nga burimet e caktuara "zyrtare" te ne, por që sipas mendimit tim, janë formulime logjikisht e objektivisht të gabuara. Për të qenë sa më tejdukshme "lajthitjet" e tilla ballaballas tyre po i shënoj trajtat barasvlerëse në gjuhën serbokroate si dhe në kllapa po e shënoj të bolduar fjalën e drejtë, ashtu siç

mendoj se do të duhej të ishte përkthyer:

Shembuj lajthitjesh kuptimore përmbajtësore
të disa emërtimeve togefjalështa te ne

1. Montues i stabilimenteve (duhet: **i pajisjeve**) të ngrohjes - monter uredjaja za grejanje;
2. Mekanik i stabilimenteve (**i pajisjeve**) termike - mehaniçar termiçkih uredjaja;
3. mekanik reparti (duhet: **i motorëve repulsorë me ngasje elektrike**) - pogonski mehaniçar;
4. elektromekanik i makinave të repartit (**i makinave me ngasje elektrike**) - elektromehaniçar pogonskih mašina;
5. instalues uji a ujinstalues (duhet: **instalues i ujësjellësit**) - vodo instalater a intalater vodovoda;
6. mekanik i veglave (më drejt: **makinë-veglave ose makinë-pajisjeve**) - mehaniçar alatljika;
7. axhustator (**mekanik axhustimi**) për punimin e sythave (e hallkave a unazave) - bravar za izradu okova;
8. axhustator (**mekanik makinash**) për punimin e pjesëve të rezervës - mašinbravar za izradu rezervnih delova;
9. marinarët (**marincat a marinësit**) amerikanë - ameriçki marinci;
10. drejtues ndërrimi (**përgjegjës ndërrese**) - smenski upravnik;
11. parapunëtor ndërrimi (**kryepunëtor ndërrese**) - smenski predradnik a predradnik smene;
12. referent i inokredive (**kredive të jashtme**) - referent inokredita;
13. lajmëruese (**paraqitëse**) e programit të televizionit - najavlivačica televizijskog programa.

Shembujt e mësipërm si dhe disa raste të tjera janë trajtuar më në hollësi në artikuj të veçantë. Këtu u paraqitën sa për të tërhequr vërejtjen në mënyrë që të shtohet kujdesi rreth dukurisë së tillë të pamirë. Me fjalë të tjera qëllimi ynë është që të ashpërsohet kriteri i përgjegjësisë së përkthyesve a i "krijuesve" të tillë joautoritativë, të cilët bëjnë lajthitje të tilla, sigurisht padashje, por që i sjellin shumë dëme gjuhës sonë dhe sidomos njësimi të terminologjisë shqipe, pra edhe në fushën e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit. Kjo kërkon mbikëqyrje a ndihmë institucionale në plan kombëtar.

P ë r m b y l l j e

Tërë kreun mbi formëzimin e emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë po e përmbyll në këto tri pika:

E para, tërë fondi i emrave të njerëzve sipas profesionit (në kuadër të emrave të

vepruesit) sipas rrugëve të formëzimit ndahet:

- a) në krijime mbi bazë të burimit aktokton, në njëren anën dhe
- b) të emrave të huazuar nga gjuhët e huaja, në anën tjetër.

Edhe pse ekziston dëshira që sa më shumë emra të krijohen me elemente të burimit vendës, megjithatë numri i emërtimeve me burim të huaj mbetet në numër të konsiderueshëm. Ky fakt nuk duhet të na brengosë fort, ngase kjo arsyetohet për shkak të teknologjisë së përbashkët universale dhe të ngjashmërive të profesioneve në suaza ndërkombëtare. Si në gjuhë të tjera edhe në gjuhën tonë emërtimet ndërkombëtare me rastin e hyrjes së tyre në fondin aktiv të gjuhës së caktuar formëzohen semantikisht, por këtë rast, herë më shumë e herë më pak, pësojnë ndryshime a përshtatje varësisht nga sistemi fjalëformues i gjuhëve përkatëse standarde. E dyta, nga pikëpamja e tipave kuptimorë prodhimtari më të madhe kanë emrat që motivuese një folje (zakonisht pjesoren), kurse formimet sipas mjetit të punës, sipas lokalit të punës dhe sipas degës a veprimtarisë ekonomike - shoqërore mbi temën emërore marrin prapashtesa të ndryshme, ndër to më të përdorura janë ato të burimit vendës, siç janë: -TAR, -AR e -AN si dhe ato të burimit të huaj -IST -ER e -IER. Formimet me prapashtesën -XHI aktualisht krijohen me prapashtesën -S sipas procesit të punës që kanë për temë nuk kanë rritje të ndjeshme për nga numri.

E treta, në strukturën formëzuese fjalëformuese emërtimet në shqyrtim ndahen në: (1) emra të prejardhur me prapashtesim, (2) emra të parmë, (3) emra me përngjitje me prapashtesim njëherazi, (4) emra të përbërë si dhe (5) emërtime me dyfishim a gërshetim profesionesh si dhe emërtime togfjalësha.

Në punim vend i konsiderueshëm iu kushtua emrave të prejardhur me temë emërore dhe të atyre me temë foljore. Nëntipi me temë foljore është nëntipi, jo mjaft i studiuar në gjuhësinë tonë sidomos në rrafshin praktik aktual. Nga analiza që iu bë këtij nëntipi doli se emrat foljorë të vepruesit formohen pothuajse tërësisht me prapashtesën -S (-ue/s, -ye/s, ë/s) mbi temë të foljes përkatëse. Formimet me prapashtesën -TAR mbi temë foljore nuk janë të pahetueshëm, ndonëse nuk kanë përhapje aq të gjerë. Emrat foljorë me prapashtesën -S aktualisht formohen mbi temën e pjesores së foljes përkatëse. Formimi mbi temën e së tashmes së dëftores pothuajse është pasivizuar. Ka mbetur në përdorim vetëm ndonjë shembull nga tradita. Nga analiza që iu bë emrave prejpjesorë doli se aktualisht për formimin e emrave të tillë shfrytëzohet trajta e pjesores së ish -gegërishtes letrare më shumë si dhe pjesorja e gjuhës së sotme shqipe më pak, varësisht nga tipi, nëntipi, grupi a nëngrupi i foljeve.

Lidhur me emrat e vepruesit mbi temën emërore u dhanë shembuj me gjithsej 25 prapashtesa a formantë, siç janë: -Ë/S, -TAR, -AR, -OR, -TOR, -XHI (-ÇI), -ER, IER, -AN, -ANT, -ENT, -IK, -CIEN, -CIST, -OZ, -ASH, -C, -IR, -AS, -NIK, AK, -OS, -AQ. Më aktive dhe prodhimtare janë prapashtesat: -S, -TAR, -AR, -IST, -ER dhe -AN. Emrat me përngjitje plus prapashtesim janë në numër të vogël si dhe emrat e parmë, kurse emrat e përbërë e shënojnë rritje, si ata me siparashtesim, ashtu edhe ata me siprapashtesim.

Tek emrat me dyfishim a gërshetim profesionesh emërtimi a emri i parë që prin

zakonisht është parësori, ndërsa tek emërtimet togfjalësha, sidomos te ne, nuk del e diskutueshme çështje e fjalëformimit sa del çështja e vërtetësisë logjike-semantike, për shkak se po ngjajnë lajthitje a shkarje të caktuara si rrjedhojë e mosnjohjes së lëndës gjatë përkthimit a përshtatjes dhe për shkak të mungesës së koncepteve të caktuara për profilizimet e profesioneve të caktuara, prandaj lypset bërë verifikime e rishikime të shumë emërtimeve në përdorim e sipër, ngase vërtetësia semantike e një sërë emërtimeve në përdorim e sipër te ne del e diskutueshme ose e paqëndrueshme.

Kreu IV

RRETH EMËRTIMIT TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT ME GJINI PËRFAQËSUESE FEMËRORE

Në bazë të lëndës së trashëguar nga tradita e shkrimit të gjuhës sonë deri më tash mund të konstatohet se emrat e njerëzve sipas profesionit në fjalorët përkatës si edhe në nomenklatura të profesioneve janë shënuar zakonisht në gjininë përfaqësuese mashkullore, ndërsa emri i profesionit në gjininë femërore është nënkuptuar. Një traditë e tillë vazhdon edhe sot e kësaj dite, mirëpo gjithnjë e më të shpeshta janë rastet që edhe në fjalorë e më pak në nomenklatura krahpërkrah emrit në gjininë mashkullore të shënohet edhe emri në gjininë femërore ose vetëm në gjininë femërore. Është e vërteta, pra, edhe pse në numër jo aq të madh, ndeshim raste që emri si emërtim i njeriut sipas profesionit shënohet vetëm në gjininë femërore. Kjo dukuri shihet edhe në gjuhë të tjera. Sa për ilustrim po sjell faktin se ndër 21 mijë emërtime të profesioneve profilesh të ngushta, sa janë regjistruar në doracakun "Lista alfabetike e profesioneve" (botim i Entit Federativ të Statistikës, Beograd 1986),¹¹⁴ vetëm diçka mbi 100 sosh janë shënuar në gjininë femërore, fakt ky që na jep për të kuptuar se me emërtimet e tilla përfaqësohen ato profesione, të cilat i ushtrojnë vetëm a kryesisht femrat dhe kjo është edhe arsyeja që emërtimet e tilla janë shënuar vetëm në gjininë përfaqësuese femërore.

E përdor togfjalëshin "gjini përfaqësuese" si shprehje konvencionale, sepse në jetën bashkëkohore, sidomos në industri, kibernetikë etj. fort të pakta janë profesionet që nuk mund a nuk duhet të ushtrohen nga personi i mësuar, pavarësisht nga gjinia, edhe pse emërtimi i caktuar në organikat përkatëse mund të jetë i shënuar në këtë ose atë gjini përfaqësuese. Megjithatë, d.m.th. pa marrë parasysh integrimin e punëve dhe të detyrave pa dallim gjinie edhe sot e kësaj dite ende ka raste, ndonëse të rralla, të ndarjes së punëve dhe të detyrave sipas gjinisë së caktuar, varësisht edhe nga natyra e punës që kryhet dhe varësisht nga subjektiviteti shoqëror.

Sa për ilustrim po e cek një konkurs karakteristik që u botua në gazetën "Rilindja", më 22.II.1987, f. 19, me të cilin kërkohet një "imam i xhamisë" dhe një "hoxhanicë", kështu që sipas punëve që kryejnë, domosdo imami "hoxha" si kryerës i punëve dhe i detyrave duhet të jetë mashkull, ndërsa "hoxhesha" patjetër duhet të jetë femër, ngase "profesionet" a punët e detyrat që do të kryejnë ata, për të cilat edhe do të paguhen,

¹¹⁴ Abecedni spisak naziva zanimanja, Savezni zavod za statistiku, Beograd 1986.

imponojnë edhe gjininë. Shembuj të tillë ndeshim edhe në raste të caktuara, siç mund të jetë kërkesa për "prift famullitar" kundrejt "moter nderi" etj., kështu që personat e tillë përveç njohurive e aftësive për punë i karakterizon edhe gjinia natyrore.

Nën kushtet e ndryshme ekonomike e shoqërore në të kaluarën ndarja e punëve në mes të gjinive ka qenë edhe më e shprehur se sot në disa fusha të veprimtarisë a të ekonomisë, kështu që edhe sot emërtimet e caktuara janë bërë dhe bëhen më tepër sipas gjinisë përfaqësuese të emrit. Në vazhdë të kësaj dukurie, por edhe për shkaqe e dukuri të reja edhe sot e kësaj dite del krejt normale që disa profesione, ndonëse në numër të kufizuar, të emërtohen vetëm në gjininë femërore, siç janë, b.f., emërtimet: mami, motër medicinale, mandeshë, defatore, prostitutë etj. e disa të tjera të figurojnë në fjalorë e burime të tjera vetëm në gjininë mashkullore, si p.sh.: futbollist, boksier, marinar, pleqnar, minator, ushtar etj.

Mirëpo si rezultat i zhvillimeve të reja shoqërore-politike e ekonomike, kulturore e sportive, nën kushte të caktuara "profesionet" e tilla nuk dalin më të rezervuara vetëm për meshkuj, por në to inkuadrohen edhe femrat, prandaj krahpër krahem emërtimeve të gjinisë mashkullore dalin edhe emërtimet në gjininë femërore. Pra nuk e kam këtu fjalën vetëm për rastet si: ushtar ushtare, minator minatore, por edhe për raste të tjera si më specifike si p.sh. futbollist futbolliste, boksier boksierë, karatist karatiste etj.

Është i njohur fakti se loja e futbollit konsiderohej si lojë e meshkujve (djelmohave), megjithatë kemi raste, madje të shohim edhe në televizor (film) se më këtë "zeje" të *meshkujve* tashti kanë filluar të merren edhe femrat (vajzat) "profesioniste". E kemi në dijeni se edhe në Prishtinë ishte formuar ekipi i futbollisteve dhe se nuk ishte fjala për ndonjë rast sa për kërshtëri, por kishim të bënim me një ekip "serioz", siç shkruanin masmediat, dhe se kjo dukuri është gjithnjë në rritje, aktivitet ky, i cili është gjithnjë më i vërejtshëm edhe në vende të tjera.

Gjithashtu patëm rast të lexonim në gazetën "Rilindja" të datës 1.III.1987, f. 16, që në botën e Perëndimit "lindin kolbojët - prostituta meshkuj" si pandan meshkujsh "kolgerlave", profesion ky "i ri" i shpallur publikisht, që po merr "përmasa të mëdha në Evropë". Po në atë artikull përmendet emërtimi i profesionit në femërore: "prostituta (meshkuj e femra)", "ndërmjetësues (meshkuj e femra)" dhe "klientë (meshkuj e femra)".

Siç del nga shprehja e mësipërme mes thonjzash dy emërtimet: "ndërmjetës" e "klient" janë shënuar në gjininë përfaqësuese mashkullore, ndërsa "prostitutë" përdoret në gjininë përfaqësuese femërore, edhe pse në tekstin e mësipërm nënkuptohen kryerësit e të dy gjinive: meshkuj e femra, siç shënohen edhe aty.

Në vazhdim po e cek edhe një dukuri a prirje që ka të bëjë me regjistrimin e titujve a të emërtimeve "zyrtare" vetëm në gjininë përfaqësuese mashkullore, edhe pse sipas normës letrare që të dyja trajtat normativisht janë të lejueshme të përdoren, varësisht nga gjinia e kryerësit të punëve dhe të detyrave, përkatësit të titullit a thirrjes që e gëzon individi i caktuar.

Këtë dukuri po e ilustruj me dy shembuj që i nxora nga shtypi ynë:

- 1."doktor Shpresa H., *specialist-internist*" (te gazeta "Kosovarja" nr. 7 1987);
2. "Xhemile M., *sekretar* i OTH" (te gazeta "Rilindja" 2.XII.1988).

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm, edhe pse kryerësja e punëve a bartësja e

"titullit", "funksionit" a të "profesionit" është femër, emërtimi i caktuar i profesionit: "doktor, specialist, sekretar" është shënuar në gjininë përfaqësuese mashkullore.

Dukuria e mësipërme nuk ka shpëtuar pa u vërejtur edhe nga studiuesi Ibrahim Goçi, i cili edhe rekomandon a e arsyeton një zgjidhje të tillë. Ai shprehet se për t'i ikur homonimisë së caktuar "janë mjaft të përshtatshme fjalët gjegjëse shqipe p.sh. "**barnatore** të përdoret në vend të termit **farmaci**" ndërsa **barnator/i** (më drejt: barnatar) në mashkullore për punëtorin, shitësin e barërave", d.m.th. për të dyja gjinitë. Kështu - përfundon ai - "shitorja të jetë veç në femërore, punëtori veç në mashkullore, si doktor Mira etj."

Një dukuri e tillë është e njohur edhe në gjuhë të tjera jo vetëm në serbokroatishte. Sa për ilustrim po e përmend praktikën që e ndjek prof. Murat Bejta në Fjalorin e tij frëngjisht - shqip¹¹⁵, ku emrat sipas gjinisë i dallon kështu: m. = emër i gjinisë mashkullore, f. = emër i gjinisë femërore dhe n.(për gjininë asnjansë të frëngjishtes) = në shqipe nënkuptohet si emër i gjinisë mashkullore dhe asaj femërore që do të thotë se emrat që kanë shenjën dallues n. përpara, pa marrë parasysh trajtën shkrimore në atë gjuhë në shqipe përfaqësohen me emrin në gjininë mashkullore, por që nënkuptohet edhe ajo femërore nga konteksti, siç ishin rastet në shembujt e sipërshënuar.

Me fjalë të tjera, përkundër traditës vendëse, por edhe ndikimit të gjuhëve të tjera si dhe praktikës së trashëguar "zyrtare" që emërtimi i njeriut sipas profesionit të shënohet në gjininë përfaqësuese mashkullore, në jetën praktike të gjuhës sonë letrare sipas fjalorëve përkatës shihet një dukuri e disa emërtimeve të profesioneve edhe në gjininë femërore. Lidhur me këtë mjafton të konsultohet dhe të krahasohet lënda e tillë e regjistruar në Fjalorin e gjuhës shqipe (1954) kundrejt Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe (1980). Në fjalorin e fundit vihet re një shumim i numrit të emërtimeve të gjinisë femërore si p.sh. veteriner, sekretar që nuk ishin në Fjalorin e vitit 1954 edhe në këtë gjini, por vetëm në mashkullore: veteriner, sekretar. Në Fjalorin e fundit madje ndeshim shembujt: *shumëfishuese, tezgjahiste*¹¹⁶ e ndonjë tjetër vetëm në gjininë përfaqësuese femërore, dukuri kjo që do të trajtohet më në hollësi më poshtë si nëntitull më vete në këtë krye të punimit.

Për të shqyrtuar këtë temë pata mbështetje punimin cilësor të Kornelja Simës me titull "Vëzhgime mbi emërtimet e reja të grave sipas profesionit në fushën e prodhimit industrial" (Studime mbi leksikon ... I, Tiranë 1972), punim ky, edhe pse fillestar, me të drejtë, mund të konsiderohet si punim model, ndonëse aty nuk shqyrtohen çështjet siç po bëhet në punimin tonë. Veç tjerash nga ai punim si gjë pozitive do të theksoja vetë faktin e të shtruarit e çështjes për diskutim e trajtim si temë të veçantë.

Duke pasur për bazë të dhënat nga gramatikat e burimet e tjera lidhur me lëndën në shqyrtim mendojmë se tërë çështja rreth strukturës fjalëformuese, ndërtimit, reflektimit si dhe prirjes së rritjes së emërtimeve të grave sipas profesionit mund të përfshihen në këto nëntë pika a nënkrerë

¹¹⁵ Murat Bejta, Fjalor frëngjisht - shqip, Prishtinë 1985.

¹¹⁶ Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980 f. 1953 dhe 1991.

1. Ndërtimi i emërtimeve të grave mbi bazën e emrit të gjinisë mashkullore duke marrë prapashtesën femërorëzuese -E;
 2. Ndërtimi i emërtimeve femërore mbi bazën e emrit të gjinisë mashkullore duke marrë prapashtesën femërorëzuese -ESHË;
 3. Emërtime të pavarura të grave me prapashtesën -ATORE;
 4. Emërtime me prapashtesa të tjera jo prodhimtare;
 5. Emërtime të grave të ngulitura si fjalë a emra të parmë;
 6. Emërtime të pavarura të përfutuara me analogji;
 7. Rreth kërkesave të shtuara lidhur me profesionet në femërore;
 8. Formanti fjalëformues i emërtimeve të grave në shërbim të diferencimit stilistik;
 9. Rreth dukurisë së homonimisë së emërtimeve të grave kundrejt emërtimeve homonime të fushave të tjera semantike.
- Të gjitha këto çështje do të trajtohen më hollësisht në vazhdim.

1. Ndërtimi i emërtimeve të grave mbi bazën e emrit të caktuar të mashkullores duke marrë prapashtesën femërorëzuese -E

Pa mëdyshje mënyra më prodhimtare e formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit të gjinisë femërore në shqipe është ajo që ndërtohet me prapashtesën -E, prapashtesë kjo që i shtohet emrit të trajtës përkatëse të gjinisë mashkullore të njëjësit të pashquar.

Një shumim a prodhimtari e tillë mund të vërehet nga lënda e regjistruar në FGJSSH (1980), kundrejt asaj në FGJSH (1954), kështu që në FGJSSH ndër të tjera, ndeshim këto emërtime të femërorëzuara nga emri përfaqësues në gjininë mashkullore: *atlete, dentiste, soliste, sekretare; vullnetare, tregimtare, rrëfyese, prestare* etj. që nuk ishin në FGJSH (1954).

Si po shihet nga shembujt e mësipërm, ashtu siç është vepruar me shembujt autokton si te rasti *rrëfimtare* nga *rrëfimtar*, *rrëfyese* nga *rrëfyes*, *prestare* nga *prestar*, po kështu është vepruar edhe te rastet kur emri është i huazuar nga gjuhë të ndryshme, qoftë me cilësi ndërkombëtare të fjalës, qoftë pa atë cilësi, si p.sh. *dentiste* nga *dentist*, *sekretare* nga *sekretar* etj. Kështu pra në rastet e tilla procesi i formëzimit të emërtimeve të profesionit në gjuhën shqipe është bërë brendapërbrenda gjuhës shqipe.

Ky proces vlen të theksohet a të vihet në pah më mirë, sepse është në sistem dhe paraqet model fort të kapshëm me mundësi të pakufizuar fjalëformimi në gjuhën tonë dhe se kjo mënyrë fjalëformimi, përkatësisht e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit me gjini përfaqësuese femërore, sidomos në gjuhën e shkrimit, është mënyra më praktike që po sendërtohet duke u mbështetur në elementin -E, si prapashtesë speciale femërorëzuese, edhe pse dihet se në gjuhën tonë kemi edhe formante të tjera femërorëzuese.

Në punimin e Xhuvani - Çabejt "Prapashtesat e gjuhës shqipe" nuk ceket asnjë shembull i femërorëzimit të emrit të caktuar të profesionit nga mashkullorja me prapashtesën -E, mirëpo një mundësi e tillë jo vetëm se nuk mohohet, por favorizohet në bazë të shembujve të dhënë aty si ilustrim për të dokumentuar se "me këtë prapashtesë janë formuar emra mocioni prej emrash derivatë që shënojnë një frymor: korrëse, mbjellëse;

mëzatore, punëtoare, stanore".

Përveç rasteve kur kjo prapashtesë si prapashtesa "më e përhapur" femërorëzuese, e cila "zakonisht i shtohet temës së emrit të gjinisë mashkullore" dhe kështu formon emra si emërtime të grave sipas profesionit, do të cek edhe rastet kur nga analogjia formohen emra të mirëfilltë me prapashtesën -E pa qenë e pranishme trajta e gjinisë mashkullore, e cila edhe mund të nënkuptohet, por këto janë raste kur trajta e regjistruar vetëm në femërore quhet trajtë përfaqësuese e emrit në gjininë femërore.

2. Ndërtimi i emërtimeve të grave mbi bazë të emrit të gjinisë mashkullore duke marrë prapashtesën -ESHË

Me prapashtesën -ESHË, siç thuhet me të drejtë në veprën e Xhuvani -Çabejt, janë formuar emra mocioni (nomina motionis), d.m.th. emra femërore, që tregojnë (...) "një femër me profesion të mashkullit përkatës" dhe për këtë jepen shembujt: argateshë (argat), bareshë (bari), bujkeshë (bujk), çobaneshë (çoban), famulleshë (famull/tar), jatreshë (jatro), kllogjineshë (kllogjën), mjekeshë (mjek), murgeshë (murg), rogteshë a rrogateshë (rrogat) terzeshë (terzi), ustalleshë (usta).

U tha më sipër, siç del edhe nga shembujt e mësipërm se prapashtesa -ESHË i është shtuar zakonisht "temës së emrit të gjinisë mashkullore", mirëpo kjo dalje nuk paraqitet aq e thjeshtë. Të vihet re se te shembujt: jatro jatreshë, bari bareshë, terzi terzeshë etj. me rastin e femërorëzimit elidohet zynorja fundore e emrit përkatës të gjinisë mashkullore. Madje te rasti arixhi arixheshkë, prapashtesa -ESH del e sforcuar edhe me elementin -K(Ë) -ESHKË, te usta ustalleshë prapashtesa del në trajtën -LLESHË, d.m.th. me elementin mbështetës -LL-, ndërsa te rasti famull/tar famull/eshë e ai rrogat rogteshë a rrogateshë, në dukje kemi formim të pavarur ndaj emrit në mashkullore me prapashtesën e sforcuar me elementin parashitës -T- -TESHË rrogateshë, përkatësisht -AT- -ATËSHË rrogateshë, por aty shihet se ajo -T ishte pjesë e emrit në gjininë mashkullore. Lidhur me këtë zgjon interes edhe zhvillimi **probatin probateshë**.

Këto "parregullësi" a ndryshime të caktuara të formantit fundor që u cekën më sipër nuk janë të parëndësishme që të njihen a të dihen më në thellësi, ngase formëzimet e tilla tregojnë vjetërsinë e përdorimit të një formanti të tillë në gjuhën tonë, ashtu edhe për ligjshmëritë e caktuara rreth fjalëformimit me këtë formant në raport me temën e qartë prodhuese, apo jo?

Supozohet se prapashtesa -ESHË është "refleks i prapashtesës latine -ISSA, përkatësisht -ESSA të italishtes", mirëpo duke pasur parasysh përhapjen e gjerë e në thellësi kohore të këtij formanti, pra, si në kohë ashtu edhe në hapësirën shqipfolëse, mund të thuhet se kjo prapashtesë që del edhe në përdorim mashkullor si Arbesh (Arbëresh), Barbesh, Golesh. Martanesh etj.(emërvende), tingëllon plotësisht si formant vendës i gjuhës sonë. Me të drejtë prof. Çabej konstaton se shembujt: baroneshë, dukeshë, konteshë "janë gjysmëhuazime me zëvendësim sufiksi". Sidoqoftë mendoj se lidhur me këtë formant në stadin e latinishtes vulgare parashqipja ka çka të kërkojë ose shqipja e sotme nën krahët e saj.

Sa për ilustrim të kontatimit që u tha më sipër më poshtë po i shënojmë në disa gjuhë femëroret e emrave të gjinisë mashkullore: *baron, princ, kont, drejtor* që janë fjalë të karakterit ndërkombëtar, me qëllim që të shihet refleksi prapashtesor në ato gjuhë në krahasim me barasvlerësin përkatës në shqip:

1. baroneshë: angl. baroness, fr. baronne, it. barobessa, sp. baronesa, serb. barunica, gjerm. Baronin;
2. princeshë: angl. princess, fr. princesse, it. principessa, sp. princesa, serb. princeza, rus. princessa, gjerm. Princezzin;
4. konteshë: angl. countess, fr. comtesse, it. contessa, sp. condesa, serb. kontesa (grofica), gjerm. Gräfin;
5. drejtoreshë: angl. head - mistress, fr. directrice, it. direttrice, gjerm. Direktorin, serb. direktor/ica.¹¹⁷

Edhe nga shembujt e mësipërm shihet qartë se prapashtesa -ESHË është veçori e dalluar vetëm e gjuhës shqipe, prandaj me të drejtë prof. Çabej trajtat e tilla i quan "gjysmëhuazime". Është e vërtetë se prapashtesa -ESH(Ë) në shqipe dokumentohet relativisht herët. Lashtësia saj dokumentohet, siç u cek, edhe nga variantet e ndryshme si zgjerim i kësaj prapashtese që është rezultat i jetëgjatësisë me elemente të tjera, si p.sh.:

-ESHKË (arixheshkë), -LLESHË (ustalleshë), -TESHË a -ATESHË (rrogateshë), pastaj -(Ë)RESHË a -NESHË (trimëreshë, magjereshë, burrëreshë a burrneshë) etj.¹¹⁸

Sigurisht të pavarura nga trajtat e gjuhëve të tjera dalin edhe emërtimet më -ESHË te trajtat si: mbret - mbretëreshë, bujk - bujkeshë, virgjëreshë, perëndeshë, mëndeshë si dhe edukatoreshë, ministreshë, poeteshë etj.

Emërtimet e këtij nëntipi si emra femërore pa pretendim profesioni, por më tepër me kuptim të njeriut sipas cilësisë, janë të përhapura edhe në stilin e poezisë, si p.sh.: pikuleshë, hyjneshë, sygjireshë, pëllumbeshë etj.

Sidoqoftë, krijimet me prapashtesën -ESHË edhe pse të goditura nga konkurrenca e trajtave me prapashtesën sinonimike -E, ato me sukses po i qëndrojnë konkurrencës dhe mjaft prej tyre janë formëzuar si emërtime të njerëzve sipas profesionit. madje këto pjesërisht dalin më të pavarura ndaj trajtave të emrave të gjinisë mashkullore, siç u pa edhe nga shembujt e mësipërm.

¹¹⁷ Për këtë janë konsultuar fjalorët përkatës, por edhe "Copitol's concise dictionary, Bologna - Italy, Spektar Zagreb f. B/43, P/45.

¹¹⁸ Xhuvani - Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, A Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980, f.471, 472.

3. Emërtime të pavarura të grave me prapashtesën -ATORE

Xhuvani - Çabej te prapashtesa "-ATUAR - ATUER" shënojnë edhe trajtën femërorëzuese "-ATORE", mirëpo në analizë ata nuk i dallojnë trajtat sipas gjinisë. Sipas tyre kjo prapashtesë, d.m.th. -ATOR/-ATORE, për nga funksioni është pothuajse identike me prapashtesën -TOR, TUER, ngase, siç konstatojnë ata "morfologjikisht është një variacion i prapashtesës -TOR, -TUER f. TORE. Kjo shihet nga identiteti i funksionit sepse javatore, vajatore p.sh. janë nomina agentis si punëtor, blegtor, prandaj në ndonjë fjalë kemi të dyja format ajktuer ajkatuer, vajtore vajatore" (Shih: A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980 f. 453).

Në parim kontaktimi i tillë qëndron, por kur përimitohet paksa çështja del se edhe funksionalisht siç do të provohet edhe këtu më poshtë, trajta prapashtesore -ATORE dallon jo vetëm nga trajta mashkullore -ATOR, ATUER, por edhe nga trajta femërore -TORE. Për këtë në një vend tjetër më përhollësisht është bërë fjalë.¹¹⁹ Dhe nga kundërvënia e formantëve sinonimikë -ORE, -TORE dhe -ATORE duke u dëshmuar me fakte, se prapashtesa -ORE del më tepër e specifikuar për emërtimin e mjeteve dhe të sendeve konkrete, prapashtesa -TORE për emërtimin e vendshërbesave (lokaleve të punës etj), ndërsa prapashtesa -ATORE mbetet si trajtë e vetme me prirje specializimi pikërisht për emërtimin e grave sipas profesionit a cilësisë së tyre.

Këtë dallim praktikisht e ka vënë re implicitivisht edhe studiuesi Mehmet Halimi në disa punime të tij¹²⁰, por që pothuajse tërë lënda lidhur me këtë përmbledhet në një kumtesë të botuar në librin "Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi" (Prishtinë 1988, f. 32 - 44). Në këtë punim që ka titullin "Mundësia e zgjerimit dhe e pasurimit të terminologjisë me prapashtesën -TORE" autori përmend afro 40 raste (shembuj konkretë) të emërtimeve të grave nga "fusha e ekonomisë shtëpiake" me këtë prapashtesë. Edhe në burime të tjera vërtetohet fakti i ekzistimit dhe i përdorimit të emërtimeve të tillë me këtë prapashtesë.

Ja disa nga shembujt që ndeshen në realitetin tone gjuhësor si dhe në burime të caktuara leksikografike e të tjera, shumica të shënuara në punimin e M. Halimit që u citua më sipër:

bukatore, magjatore, n(d)ihmatore, fshisatore, rangatore, lojsatore, frymatore, enatore, cingëlatore, javatore, vekatore, veshatore, telatore, lënuratore, tjerratore, drithatore, fushatore, plehatore, gjamatore, vajatore, njehatore, m(bu)lojatore, ujatore, faratore, defatore, furkatore, barkatore; llafatore, dijatore, heratore, gjakatore, dhelatore, petatore, burgatore; burratorre, rrogatore; pitatore, vijëzatore, mbathatore, gjellatore, fliatore etj. herratore (Zymeri), dhekatore (A. Hajdaraj).

Kur kemi parasysh faktin se nga kjo shumësi emërtimeve që arrijnë në mbi 40 shembujt,

¹¹⁹Shih për këtë "Raporti kundërvënës brenda prapashtesave simotra: -atore, ore e tore" në veprën e N. Veselajt *Çështje të shqipes standarde në fishë të leksikut dhe të fjalëformimit I*, Prishtinë 1997, f. 146 - 159

¹²⁰ M. Halimi, shih edhe te gazeta "Rilindja" më 20. II. 1988, f. 14 etj.

dhe shumica prej tyre, ndeshen në përdorim të përditshëm aktiv (së paku te ne) mund të nxirret gjykimi se kjo mënyrë fjalëformuese mund a duhet të cilësohet edhe si një model i pranueshëm fjalëformues me të drejt konkurrimi, madje këtë model e bën më të pranueshëm pikërisht nënfusha semantike që mbulon, nënfushë kjo, e cila mund të përkufizohet përafërisht kështu: "nënfusha semantike ku pasqyrohen emërtimet e grave sipas veprimtarisë që kryejnë punë qoftë në jetën familjare, qoftë në të ashtuquajturën "ekonomi të vogël" a "biznes të vogël", qoftë në institucione të caktuara ku ushtrohet "zeja e caktuar", veprimtari kjo që ushtrohet kryesisht nga femrat, objekti i së cilës ceket në temën fjalëformuese".

Gjithsesi kur kemi parasysh shumësinë e emrave siç u cek më sipër e aq më tepër nevojën në rritje për "zanate" të tilla nga *ekonomia e vogël*, atëherë mund të konstatohet se kjo mënyrë fjalëformimi me prapashtesëm -ATORE mund të cilësohet pa kushtëzim edhe si model që mund të përthithë në vete edhe veprimtarinë e grave, sidomos në fushën artizanale dhe të punëve shtëpiake e të tjera, siç u përmend më sipër.

* * *

Nga kjo që u shtrua deri këtu del se si prapashtesa aktive dhe prodhimtare për formimin e grave sipas veprimtarisë a profesionit janë prapashtesa -E, -ESHË dhe -ATORE, kurse të tjerat që do të cekën më poshtë kanë përhapje më të kufizuar apo paraqesin raste të vetmuara.

Nga analiza e shembujve të caktuar del se prapashtesa -ATORE del më e pavarur se dy prapashtesat e para -E dhe -ESHË, të cilat paksa janë të varura a të ndërlidhura nga prapashtesa e emrit mashkullor ose të vetë emrit përkatës mashkullor, kurse emrat me prapashtesën -ATORE janë krijime të pavarura të mbështetura drejtpërdrejt në nënfushën semantike, siç u cek më sipër. Këtë e vërtetojnë të gjithë shembujt e mësipërm me prapashtesën -ATORE.

4. Emërtime me prapashtesa të tjera jo prodhimtare

Përveç emërtimeve me prapashtesat speciale femërorizuese -E, -ESHË dhe -ATORE që i pamë më sipër, në gjuhën tonë kemi edhe emërtime me prapashtesa të tjera, të cilat ose janë të huazuara nga gjuhë të tjera ose janë krijime a modifikime nga zhvillimi i brendshëm i strukturës fjalëformuese të gjuhës sonë, por që nuk janë aq podhimtare dhe aktive në letrarishten e sotme.

Mirëpo, edhe pse në numër të kufizuar emërtimet e tilla në kuadër të emërtimeve të përgjithshme nuk janë të parëndësishme, jo vetëm sa i përket anës historike, por edhe sa i përket aspektit aktual.

Ja disa shembuj sipas prapashtesave përkatëse:

- më -NICË: hoxhancë (hoxhë), bakallnicë (!)(bakall);
- më -ICË: magjistricë (magjistar), hamallicë (hamall);

- më -A/TARE:qëndistare, vajatare, rangatare, odatare, boshtare (nga qëndis, vaj, rang, odë, bosht);
- më -KË: çobankë (çoban), tejnaxherkë (tenajxher);
- më -CË: vajtojcë, gatojcë, fërkojcë, hollojcë;
- më -ORE: çelnikore (stopaneshë), stanore (stan, stanar);
- më -TORE: magjetore, gërhantore;
- më -INJË(-INË): robinjë; hamallinë;
- më -SHORE: nanshore;
- më -SË e -SE: fërkojsë e fërkojse, lasë e lase.
- më -Ë: amvisë
- më -IKE: bojaxhike, zanatzlike, plisaxhike, qerraxhike, kacaxhike, (!)

Prapashtesat -KË, -ICË, -ANICË e -INJË për këtë nënfushë semantike duket se janë me origjinë sllave dhe veç rasteve të rralla emërtimet me këto prapashtesa nuk janë të parapëlqyera në gjuhën tonë. Me një fjalë krijimet me këto prapashtesa nuk paraqesin model për emërtimet e grave sipas profesionit në gjuhën tonë.

Prapashtesa -CË është e përbërë nga prapashtesa -C me -Ë-në femërore dhe i përgjigjet prapashtesës -SË, përkatësisht -(Ë)S të mashkullores si p.sh. las (larës): lasë a lase, fërkojs (fërkues): fërkojsë a fërkonjëse (fërkuese).

Prapashtesa -ATARE është variacion i prapashtesës -TAR, përkatësisht -ATAR të emrave të gjinisë mashkullore, formant ky që nuk është prodhimtar për krijimin e emrave të gjinisë femërore pavarësisht nga versioni në gjininë mashkullore. P.sh. për të qenë më e qëndrueshme trajta **odatare**, mbase më mirë do të ishte që të mirrte prapashtesën -ATORE: **odatore**, pasi që prapashtesa -ATORE del më në shumë shembuj të kësaj kategorie kuptimore. Siç u paraqit më sipër të gjitha gjasat janë që prapashtesa -ATORE të dalë më e parapëlqyer për emërtimim e grave sipas profesionit a artizanatit në krahasime me prapashtesat -ORE dhe -TORE, por edhe ndaj prapashtesave të tjera.

Prapashtesa -IKE zgjon interes, sepse vjen si përkthyes e emrave të huazuara të turqishtes me -I fundore si sojni sojnikë, haxhi haxhike, zorraxhi zorraxhike si dhe shembujt që i shënova më sipër nga burimi Klasifikimi i profesioneve të Kosovës, Prishtinë 2006).

Pasi shembujt të tillë nuk ndeshim në fjalorët tanë normativë, mendoj se formimet e tilla dalin shumë të diskutueshme. A do të shtohet edhe ky formant shembujve me formantet aktive: -e, -eshë dhe -atore, apo jo, le të vlerësohet.

Gjithsesi është me interes të ndiqet konkurrenca në mes të prapashtesave femërorëzues aktive: -E, -ESHË dhe -ATORE, por edhe të tjerave jo vetëm në kuadër të emrave të gjinisë femërore, por edhe në krahasim me prapashtesat speciale të emrave të gjinisë mashkullore, sidomos kur kemi të bëjmë me ndikim të ndërsjellë. Lidhur me këtë ndikim këtu po i përmend vetëm disa raste; defatore - defator defëtar; gjamatore - gjamator gjamatar, ngjeshatore - ngjeshatar. Siç po shihet trajta e parë më -ATOR del nën ndikimin e trajtës -ATORE, ndërsa trajta më - (A)TAR del si trajtë e pavarur e gjinisë mashkullore, nga e cila mund të dalë femërorja më -E: defëtare, gjamëtare, ngjeshëtare, por sigurisht me kuptim tjetër nga

ai më -ATORE: defatore, gjëmatore, ngjeshatore.

Ma merr mendja se një prirje të tillë dalluese është mirë ta kenë parasysh studiuesit dhe ta vlerësojnë edhe standologët tanë si një pasuri që realisht e ka gjuha jonë si zgjidhje atavike trashëguese dhe se vlerësimi i tillë duhet të zërë vend në tekstet normative të gjuhës sonë standarde.

5. Disa emërtime të grave të ngulitura si emra të parmë në shqipe

Si emërtime të grave të ngulitura si emra të parmë konsiderohen emrat: babo, baxhi, dado, mami, hanko, xhadi.

Emërtimet në fjalë mund të jenë të huazuara a të femërorëzuar mbi bazë të ndonjë gjuhë të huaj, për që në shqipe kanë marrë trajtë të ngulitur dhe mbasea fundore e tyre nuk ndjehet si prapashtesë e mirëfilltë e shqipes.

Sa për ilustrim për të treguar se si emri përkatës del i femërorëzuar si emërtim i njeriut (gruas) sipas profesionit, po me kuptim autonom, po trajtojmë paksa kuptimin leksikor që ka fjala **mami mamia** në shqipe. Me këtë fjalë-term në letrarishten e sotme kuptohet një "punonjëse e shërbimit mjekësor, me përgatitje të posaçme, që kujdesohet për gratë gjatë barrës dhe pret foshnjat kur lindin". Nga pikëpamja etimologjike thuhet se kjo fjalë "**mami**" është refleks i fjalës "*mamma*" të latinishtes. Për këtë nocion në serbokroatishte del barasvlerësi *babica*, *it. levatrice* dhe *mamma*, *fr. accouchence*, *angl. midwifery*, *gjerm. Geburetilte*, *sp. camadrana*, *turq. ebe, ninecik*), kështu që trajta **mami mamia** e kriticalizuar kështu në shqipe nga forma shkrimore dhe shqiptimore i takon vetëm gjuhës shqipe, edhe pse rrënja MAM- mbase mund të jetë karakteristike edhe për ndonjë gjuhë tjetër.

Shembujt e sipërcekur nuk kanë versione të gjinisë mashkullore, për këtë shkak edhe u quajtën trajta të ngulitura. Por nuk janë vetëm këto fjalë që i ndeshim të regjistruara në gjininë përfaqësuese femërore, edhe pse kanë strukturë të ngjashme fjalëformuese me emrat e gjinisë mashkullore, të cilët edhe mund të dalin po mbi këtë temë fjalëformuese në rrethana të caktuara.

6. Emërtime të pavarura të grave sipas veprimtarisë

I quajtem krijime të pavarura emërtimet e caktuara të grave, të cilat sipas burimeve të caktuara kanë dalë vetëm në gjininë femërore e jo edhe në atë mashkullore, ngase kështu kanë kushtëzuar rrethanat e formëzimit nga vetë procesi i veprimtarisë, sepse punët dhe detyrat e caktuara i kryejnë kryesisht a vetëm gratë.

Ja disa shembuj të nxjerrë nga burimet përkatëse nga:

FGJSSH (1980):

1) çorapëbërëse e çorapëpunuese, shumëfishuese, rrobalarëse, petkalarëse, pjatatarëse, qilimpunuese, tezgjahiste, gatuese, lasë, lënurëse, lagëse;

2) Fjalori i K. Kristoforidhit: lanjëtores;

3) FSHS (1984): gjamatore, mjelëse, modiste, vajtuëse, qilimendëse;

S'do mend se qëndrueshmëria e emërtimeve të sipërshënuara të formëzuara në rrethana të caktuara as që sillet në dyshim, mirëpo është e vërtetë se po në rrethana të caktuara nocionet e emërtimeve të tilla mund të dalin edhe në gjininë mashkullore. Kështu që në rrethe të caktuara edhe mund të jenë në përdorim normal edhe trajtat si: *qilimpunues, çorapëpunues, tezgjahist* etj.

Por në këtë kontekst do veçuar fakti se kur kemi të bëjmë me prapashtesa të tjera, jo këto më -S dhe më -IST që janë prapashtesa speciale për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë, atëherë dalin çështje të cilat kërkojnë sqarim. Në këtë vazhdë po e përmend trajtën *lanjëtare* të shënuar nga K. Kristoforidhi. Po në Fjalorin e K. Kristoforidhit emri paralel i gjinisë del me prapashtesën -TAR jo -TOR: **lanjëtar**, ashtu ndodh edhe me trajtën *renatore* dhe **renatar**, por te shembulli i dytë me trajtën *renatore* si term "popullor" kuptohet gruaja që kryen punën e shtëpisë sipas radhës (rendit) në familje shumanëtarëshe, ku ka shumë gra, kurse *renatar* - quhej "argati", i cili ndante rendin gjatë prashitjes etj. Pra në këto raste natyra e punëve ndryshon dhe semantika e fjalë-termave të caktuar nuk bashkëtakohet konkretisht, ngase u takon dy nënfushave të ndryshme semantike. Edhe studiuesi A. Zymberi në të folmen popullore ka ndeshur **herr(a)tar** për gjininë mashkullore dhe **herratore** për gjininë femërore.

Prandaj në "stilin popullor" në rrethe të caktuara diferencimi është shumë më i qartë se në disa burime shkrimore. Mirëpo nëse shfaqen raste kur profesioni i caktuar është emërtuar vetëm në gjininë përfaqësuese femërore fillojnë ta kryejnë rastësisht (jo në mënyrë të zakonshme) edhe meshkujt ose ndonjë mashkull, atëherë mund të ngjajë i njëjti proces, d.m.th. emri i gjinisë femërore mashkullorëzohet me të hequrit e prapashtesës femërorëzuese -e, duke marrë prapashtesën zero a fundoren e gjinisë mashkullore. Pra, në raste të tilla ndodh proces i ngjashëm, kur ndonjë femër fillon të ushtrojë mjeshhtërinë të emërtuar në gjininë mashkullore, kur, siç e cek më sipër, emërtimi femërorëzohet, duke marrë, pra, prapashtesën përkatëse femërorëzuese. Të rikujtojmë rastet: defatore dhe vajtojcë. Mashkulli i tillë mund të quhet po ashtu defatore-ja a vajtojcë-a, por normalisht mund të mashkullorëzohet trajta duke u hequr prapashtesën -E karakteristike femërore dhe vepruesi të quhet: defator-i ,vajtojc-i e kështu me radhë. Natyrisht nuk duhet përçmuar prirja e vërtetë që emrat në gjininë mashkullore edhe për "profesionet e tilla" të dalin me prapashtesën -TAR si p.sh. defëtar, vajtar (vajtues) etj., por zakonisht trajtat e tilla shprehin koncept tjetër semantik nga trajtat me prapashtesën përkatëse ku mbizotëron emri në gjininë femërore nga "zanati" sipas traditës "popullore" me prapashtesën përkatëse -E, -ESHË ose -ATORE.

Nga jeta jonë e përditshme (moderne) po cek emërtimin: *paraqitëse e programit televiziv* (serb. najavljiivačica TV- programa) që ndër ne nga serbishtja është përkthyer "*lajmëruese e programit televiziv*"(!). Këtu nuk e kemi për qëllim të trajtojmë më në hollësi se cila trajtë është më e mbështetur në gjuhën tonë, ngase së paku për hir të njësimin të terminologjisë, sigurisht duhet favorizuar atë trajtë e cila është më e përgjithësuar, por këtu kemi për qëllim të vëmë në pah faktin se punët e tilla janë të përcaktuara në organikën përkatëse. Aty është paraparë që këto punë dhe detyra patjetër duhet t'i kryejë personi i gjinisë femërore, person ky që duhet t'i

plotësojë edhe disa kushte të veçanta. Pra pa marrë parasysh se ekzistojnë emrat në gjininë mashkullore paraqitës edhe lajmërues, për emërtimin e "profesionit" të caktuar vlen vetëm emërtimi në gjininë femërore: "*paraqitëse e programit televiziv*". Pra, në rastin konkret emërtimi **paraqitëse e programit televiziv** është emërtim i pavarur. Pavarësinë e tillë ia siguron vetë natyra e punëve dhe e detyrave të parapara që kryhen.

Sigurisht kjo çështje si dhe çështjet e tjera si kjo meritojnë trajtim më të hollësishme, sidomos tashti kur kërkesat për emërtime të pavarura në gjininë femërore janë në rritje e sipër.

7. Rreth kërkesave në rritje lidhur me emërtimin e grave sipas profesionit

Duke u nisur jo vetëm nga fakti se "qëllimi i shoqërisë", siç theksonte një autor, "është që femra të jetë prezente më shumë me punën e saj dhe ta japë kontributin barabar me mashkullin" si në çdo punë "ashtu edhe në veprimtarinë ekonomike e shoqërore"¹²¹ etj., por edhe për arsye të vetë ekzistencës në realitetin tonë shoqëror, vihet re kërkesa gjithnjë në rritje për punësimin e femrës, madje edhe në ato punë e detyra që dikur konsideroheshin si punë ekskluzivisht për meshkuj. Këtu nuk do ta kem fjalën vetëm për rastet si ushtarë, oficerë, infermiere, aktore, artiste (përkrah emrave përgjegjës në gjininë mashkullore), por kalojmë përtej këtyre caqeve. Do të përmend faktin se në jetën praktike kemi raste kur me konkurse për punësim kërkohen vetëm femra si p.sh.

konduktore autobusi, sekretare teknike, konfesioniste, higjieniste, kozmetikane, paraqitëse e programit televiziv, spikere e radios, daktilografiste - administratore, sekretarësh e drejtorit të përgjithshëm, pastruese e lokaleve të administratës, punëtore grimi, patinazhiste, modiste, frizere, stjuardesë, enëlarëse, kafebërëse, banakiere, gardiane (burgu) për femra, servuese-pjatalarëse, odatore (përgatitëse e dhomave në hotel), infermiere - kujdestare në çerdhën e fëmijëve, kujdestare - pedagoge etj. etj.

Çka do të thotë se për vendet e tilla të punës duhet a mund të konkurrojnë patjetër vetëm femrat, pasi që ashtu kërkon natyra e punëve të caktuara ose ashtu ka vendosur institucioni i caktuar i shtyrë edhe qëndrimi politik-komercial i ditës.

Sa për ilustrim po cek se në "Nomenklaturën e profesioneve" Beograd (1969), emërtimi **pastruese** (e lokaleve të administratës), me gjini përfaqësuese femërore, ka shifrën 139.22, vend pune ky që praktikohet të plotësohet nga punëtori i gjinisë femërore, ndërsa punët dhe detyrat nën shifrën 139.25 janë emërtuar **pastrues** (rrugësh), pra në gjininë përfaqësuese mashkullore. Kështu veprohet zakonisht edhe në ndërmarrje prodhimi. Zakonisht për pastrimin e lokaleve të administratës

¹²¹ H. Susuri, Punësimi dhe papunësimi i femrës në KSA të Kosovës, te revista "Përparimi" nr. 6/83, Prishtinë 1983 f. 911.

kërkohej "pastruese", ndërsa për pastrimin e hallave të prodhimit kërkohej "pastrues".

E ndjej të nevojshme të cek edhe një dukuri që gjithnjë del e pranishme edhe në shoqërinë tonë, e cila më përpara, së paku, me sa dihet, nuk ishte e afirmuar botërisht. Është fjala për prostitucion, një ndër "zanatet" më te vjetra të femrës në shoqërinë njerëzore.

Kështu siç lexuam në gazetën "Politika ekspres" të datës 1.X.1987, f.3, në shtojcën për gra thuhet se "prostitucioni konsiderohet (në Beograd) si "ekonomi e vogël" - legale, e cila sjell fitime të mëdha" dhe se për këtë kërkohej "punësimi i prostitutave profesioniste". Me këtë dukuri të këtij "zanati të vjetër" tashmë është e ballafaquar edhe shoqëria shqiptare, gjë që po shkruajnë mjaft shpesh edhe gazetatat tona. Nëpër hotele e lokale përkatëse po hapen "kazinot" a "lojëtoret", ku po punësohen (gjysmë)legalisht profesionistet që shërbëjnë në lokale nate etj.

Çështjet që u përmendën më sipër u bënë me qëllim, ngase me ato probleme që ballafaqohet shoqëria ballafaqohet edhe gjuha, prandaj në këtë drejtim dalin edhe çështje gjuhësore që lypset trajtuar me autoritetin e kompetencën e duhur.

8. Formanti fjalëformues prapashtesor i emërtimeve të grave në shërbim të diferencimit stilistik

Dihet se trajtat e ndryshme sinonimike prapashtesore mbi tema të njëjta fjalëformuese janë formuar në situata e rrethana të caktuara, rrethana këto që mund të arsyetohen e të interpretohen edhe me fakte historike.

Sido që të jetë, nga aspekti stilistik shumësia e formave të tilla fjalëformuese mund të paraqesë një pasuri e laryshi shprehjesh, mirëpo nga aspekti i stilit zyrtar, ku bën pjesë edhe nomenklatura e profesioneve, emërtimet e tilla paraqesin problem që duhet thjeshtësuar dhe sqaruar. Ndërsa për nevoja stilistike, secila trajtë "popullore" e "zyrtare" mund të zërë vend për mrekulli në situata të caktuara, në stilin zyrtar, siç u tha, mjafton vetëm njëra trajtë, madje trajta e cila paraqet model dhe se ai model del i "zyrtarëzuar" në harmoni me normën e shqipes letrare.

Nga realiteti ynë gjuhësor i kam vjelë disa trajta sinonimike me prapashtesa të ndryshme mbi temën e njëjtë fjalëformuese, p.sh.:

- hamalle, hamalleshë, hamallicë, hamallinë;
- tjerratore, tjerrëse, tjerrëtare;
- vajtuëse, vajtojcë, vajtojsë, vajatore, vajtoje;
- falltore, fallxheshë, falltare, fallçore, fallxhore, fallatore;
- sekretare, sekretareshë, sekretaricë(!);
- drejtore, drejtoreshë, drejtoricë(!);
- edukatore, edukatoreshë, edukuese, edukatëdhënëse;
- kujdestare, kujdestareshë, kujdesuese;
- doktore, doktoreshë, doktoricë, doktorkë (!)

- profesore, profesoreshë, profesorkë, profesoricë (!)
- robe robeshë, robëreshë, robëruese, robinjë, robinë;
- etj.

Nga shembujt e mësipërm nga pikëpamja e rrafshit stilistik mund të nxjerrim konstatimet si më poshtë:

1. Trajtat me prapashtesat: -ICË: hamallicë, doktoricë, sekretaricë, drejtoricë (direktorice); -INJË (-INË): robinjë (robinë); -KË, si doktorkë, profesorkë etj. për arsye të vetë formave përkatëse të jashtme, edhe pse mund të ndeshen mjaft shpesh në thjeshtligjërim, kuptohet se ato nuk janë trajta të normëzuara. Trajtat e tilla mund të përdoren vetëm për qëllime stilistike satirike etj.

2. Trajtat më -E si hamalle, tjerrese, vajtuese, edukuese, doktore, robe, falltare, kujdesuese, edukuese, edukatëdhënëse kuptohet se janë krijime "të reja" apo femërorëzime të trajtave përkatëse "zyrtare" të gjinisë mashkullore.

3. Trajtat më -ATORE si: vajatore e vajtore, tjeratore nënkuptohet se janë krijime të pavarura dhe të krijuara në gjuhën popullore, i takojnë stilit popullor dhe vetëm a kryesisht në nënfushën kuptimore të jetës artizanale popullore të ashtuquajtura "ekonomi e vogël" përgjithësisht kanë qëndrueshmëri përdorimi ose për dukuri të ngjashme të infiltuara edhe në jetën bashkëkohore.

4. Trajtat më -ESHË, si drejtoreshë, doktoreshë, fallxheshë hamalleshë, kujdestarëshë, edukatoreshë - i takojnë edhe këto më tepër stilit të përditshëm jo zyrtar me nuanca respekti e përkëthelie, dashamirësie, por që i afrohet në ndonjë rast stilit zyrtar. Kështu që kjo prapashtesë i bën konkurrencë simotrës -E. Me një fjalë pikërisht dukuria e konkurrencës që i bëjnë njëra -tjetrës prapashtesat simotra -E dhe -ESHË zgjojnë interes dhe do të jenë paksa objekt trajtimi në vazhdim.

Në praktikë nuk janë raste të rralla kur për emërtimin e caktuar, madje në të njëjtin tekst përdoren të dyja këto trajta edhe edukatore edhe edukatoreshë, sekretare edhe sekretarëshë, poete edhe poeteshë, profesore edhe profesoreshë etj. dhe mund të thuhet se që të dyja janë trajta të mbështetura edhe nga pikëpamja e normës letrare. Nga lënda që konsultuam fituam bindjen se mbizotëron prirja që emërtimet në -E të jenë më të parapëlqyera në stilin zyrtar administrativ, ngase ashtu dalin të regjistruara edhe në emërtesat zyrtare, në organika e institucioneve të caktuara etj., kurse trajtat më -ESHË janë më tepër karakteristikë e stilit bisedor, por dalin edhe në rrafshet e tjera stilistike më të "buta", siç janë shprehjet poetike, humoristike. Me një fjalë, trajtat e tilla i japin stilit konotacion ledhatues, përlules, gjithësesi më skofiar. Konstatimin e mësipërm po e ilustruj me dy-tre shembuj konkret:

- "Është studente e vitit të pestë, por ndër të gjitha studenteshat ajo ka arritur mesataren më të lartë" (Zëri i rinisë, datë 28.II.1987 f. 11);
- "Ajo është mjeke, por te kjo mjekeshë kanë dëshirë të vizitohen të gjithë ..." (Rilindja, 15 qershor 1988)
- "Po më dhi(m)men qeta spikera e spikerresha, po habitna qysh po u shterret zani..." (...) "pse nuk keni spikere të reja?" (revista "Kosovarja" nr 1/85

f. 17).

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm trajtat më -E studente, mjeke, spikere janë emërtime "zyrtare", ndërsa ato më -ESHË: studenteshë, mjekeshë, spikereshë - janë emërtime që i takojnë më tepër stilit bisedor me konotacion të theksuar stilistik përkëdhelës skofjaresk.

Varësisht nga konteksti edhe njëra edhe trajta tjetër janë përdorime me vend. Po çfarë qëndrimi duhet mbajtur kur të dyja format përdoren sipas konceptit zyrtar neutral, pa konotacion stilistik, kur dihet fakti se nuk janë të rralla rastet kur në një konkurs lexojmë se kërkohet një profesore, një edukatore, kurse në tjetrin lexojmë se kërkohet një profesoreshë, një edukatoreshë? Ky fakt flet se çështja në fjalë ka mbetur, si me thënë, e hapur, gjuhësisht e diskutueshme.

Prof. Ali Dhrimo lidhur me këtë konstaton se "prapashtesa -ESHË (ashtu si edhe -ONJË, -ICË. -USHË) me kohë e ka humbur prodhimtarinë e saj", prandaj sipas tij shumë shembuj tashmë janë ngritur në normë me prapashtesën -E si p.sh. agronome, brigadiere, drejtore, ministre etj. Megjithatë ai cek edhe mundësinë e bashkëjetesës së trajtave më -ESHË dhe më -E, ngase "variancionet me prapashtesat -ESHË dhe më -E, kur dallohen midis tyre në rrafshin kuptimor ose stilistik, do të vijojnë të përdoren si barabar normative".

Rreth dallimeve në "rrafshin stilistik" siç e thotë prof. A. Dhrimo, dhamë mbase shembuj të mjaftueshëm më sipër, ndërsa si ilustrim edhe për "rrafshin kuptimor" do të japim tashti një shembull që e morëm nga përditshmëria jonë. Nuk janë raste të rralla te ne, kur me konkurs, qoftë intern, qoftë publik, për një vend pune kërkohet b. f.: sekretare teknike, sekretare e konviktit të femrave dhe në anën tjetër kërkohet sekretareshë e drejtorit të përgjithshëm, sekretareshë-administratore, sekretareshë dhe buletashitëse, sekretareshë - daktilografiste, daktilosekretareshë etj. Siç mund të kuptohet edhe nga emërtimet e mësipërme me emërtimin mbi bazë **sekretare** nënkuptohet kandidati a kandidatja me përgatitje të lartë (superiore) profesionale, d.m.th. juriste a ekonomiste me fakultet të kryer, ndërsa për emërtimet mbi bazë **sekretareshë**, nënkuptohet që kandidatja duhet ta ketë të kryer kryesisht shkollën e mesme ose mbase mund të ketë edhe përgatitje të ulët profesionale, ta ketë të kryer ndoshta vetëm kursin e daktilografisë e të ngjashme, varet nga kushtet e veçanta që kërkohet t'i përmbushë.

Pra edhe nga vetë emërtimi dallohet qartë "rrafshi kuptimor" a shkalla e ndërlikueshmërisë së punëve që lypsen të kryhen. Por sa do të përfilllet ky dallim në të ardhshmen dhe sa do të përgjithësohet trajta e caktuar për kuptimin e caktuar ia vlen të ndiqet, realiteti i sotëm është ky, siç u cek më sipër. Nuk përjashtohet mundësia që e ardhmja të sjellë ndryshime, të cilat mund të jenë edhe më të vërejtshme.

Njëfarë sireaksioni ndaj formave më -E edhe në vend të atyre trajtave që ishin përgjithësuar sadokudo me prapashtesën -ESHË edhe në stilin "zyrtar", po e përmend mendimin e studiuesit Musa Nushi, i cili duke e pasur të ravijëzuar në sistemin e vet ligjërimor trajtën më -ESHË, siç është e dhe fjala **ministreshë** kundrejt asaj **ministre**, e cila edhe pse si trajtë e vetme del e normëzuar në letrarishten e sotme, reagon me vërejtjen: "formimi i trajtës femërore ministre me

prapashtesën -E, në vend se më -ESHË, të ngritur tashmë në normë drejtshkrimore më duket se është në kundërshtim me rregullat e fjalëformimit (...), sepse (pos tjerash) "ka edhe vështirësi edhe në shqiptimin e trajtave të tilla, si p.sh. ministre ministrja, mjeshtrë mjeshtrja, ngase pa nevojë grumbullohen katër bashkëtingëllore, kurse trajta me -ESHË ministreshë, mjeshtrëshë shqiptohet më lehtë". Autori gjykon se "formimi i emrave të këtij tipi më -ESHË ka shtrirje më te gjerë dhe si "rrjedhim edhe përdorim më të madh"¹²².

Ne nuk patëm për qëllim as të mbështesim as të hedhim poshtë mendimin e M. Nushit, por vetëm të vëmë në spikamë edhe reagimet e tilla, ngase është e vërtetë se disa fjalë më -ESHË nga tradita janë të ngulitura mjaft thellë në vetëdijen e shqipfolësve, prandaj edhe reagimi për ruajtjen e tyre në përdorim është i arsyeshëm. Dihet se që nga vepra e Buzukut e këndej janë përdorur trajtat si mikeshë, perëndeshë, mbreteshë (mbretëshë) etj.

Lidhur me këtë do të shtonin edhe të dhënë se vërtet trajtat më -E i afrohen emrit të gjinisë mashkullore më tepër për nga shkalla profesionale se trajta më -ESHË. Tek trajtat me -ESHË, ç'është e drejta, vërehet sadokudo njëfarë pavarësie më e madhe në fjalëformim në krahasim me të parën, d.m.th. me prapashtesën -E, pavarësi kjo që është edhe më e madhe te emrat femërorë më -ATORE, siç është cekur më përpara.

Po e përmend edhe një fakt tjetër që nuk është i pavlerë. Trajtat më -ESHË nuk i shtrohen aspak homonimisë me fjalë të fushave të tjera semantike, siç i shtrohen b.f. format me prapashtesën -E, siç do të shohim në nëntitullin në vazhdim, prandaj edhe kjo veçori leksikore duhet pasur në konsideratë në raste të caktuara, kur shqipfolësi përcaktohet për njërin a për tjetrën trajtë, aq më tepër duhet të rritë kujdesin standardologu, kur rekomandon trajtën përkatëse..

9. Dukuria e homonimisë leksikore dhe emërtimet e grave sipas profesionit

Homonimia si dukuri d.m.th. trajtat e njëjta emërore me kuptim të ndryshëm është e pranishme edhe lidhur me emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë me gjini përfaqësuese femërore.

Ç'është vërteta, si në gjuhë të tjera edhe në shqipe ndodh që emri si emërtim i njeriut sipas profesionit të përkojë edhe me emrin si emërtim i mjetit të caktuar, mjet ky i caktuar që zakonisht kryen funksion të ngjashëm sikurse edhe vepruesi njeri. Mjafton të rikujtojmë faktin se me fjalën **kontrollor** në shqipe kuptohet "punëtori që kontrollon punën e kryer nga punëtorët e tjerë" dhe njëherazi me fjalën **kontrollor** kuptohet "pajisja me të cilën kontrollohet puna e një makine tjetër etj.". Ka raste që për t'i ikur kësaj homonimie në shqipe emërtimi i njeriut shënohet në trajtën "kontrollues" ndërsa emërtimi i pajisjes mbetet i pandryshuar "kontrollor" ose edhe në trajtën femërore **kontrolluese** (vegël kontrolluese - kontrolluese), mirëpo kur është fjala te kryerësi i punëve i gjinisë përfaqësuese femërore çështja del edhe më e ndërlikuar, pasi që dallimi del edhe më i theksuar.

¹²² Musa Nushi, artikulli i cituar në kreun e mëparshëm të këtij punimi.

Duke e ndjekur këtë dukuri më në hollësi, sipas lëndës së regjistruar në FGJSSH del mjaft i hetueshëm fakti se për t'i ikur homonimisë ndërmjet nënfushës semantike të emërimit të njeriut ndaj emërimit të veglës, siç u cek në shembullin tonë të mësipërm, më tepër pëson pikërisht emri i gjinisë femërore. Për të kuptuar më mirë këtë dukuri më poshtë po i jap disa shembuj që i vola nga burimi i sipërcekur. Këta po i paraqit në dy rubrika, në të parën shënohet emërtimi i njeriut sipas veprimtarisë dhe në të dytën përballë emërtimi veglës a pajisjes përkatëse me të cilën kryhet veprimi i caktuar:

Shembuj të "ikjes" së homonimisë me dallim gjinie

| Gjinia mashkullore (emri i njeriut) | Gjinia femërore (emri i veglës) |
|----------------------------------------|-------------------------------------------|
| hapës (punëtori që...) | - hapëse (vegël a pajisje me të cilën...) |
| kapës " | - kapëse " |
| përdorës " | - përdorëse " |
| mbledhës " | - mbledhëse " |
| mbyllës " | - mbyllëse " |
| shtytës " | - shtytëse " |
| ujitës " | - ujitëse " |
| zjarrfikës " | - zjarrfikëse " |
| lakëdhënës " | - flakëdhënëse " |
| xhamprerës " | - xhamprerëse " |
| etj. | |

Besoj se shembujt e mësipërm mjaftojnë sa për të ilustruar dukurinë e cekur pak më përpara. Lidhur me këtë shtrohet çështja pse pikërisht ndodh kështu, pse emërtimet e mjeteve (pajisjeve) dalin në gjininë femërore ndërsa emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë në gjininë përfaqësuese mashkullore?

Një pjesë e përgjigjes tashmë del e qartë nga lënda e shtjelluar më sipër, ngase sipas traditës emërtimet e njerëzve sipas profesionit shënohen në gjininë përfaqësuese mashkullore, kurse dukuria e shënimit të tyre edhe në gjininë femërore për shumicën e rasteve është dukuri paksa e re, prandaj emërtimi i veglës (pajisjes) në gjininë femërore e gjen trajtën femërore paksa si kuti të zbrazët, gjithsesi më të brishtë ndaj asaj të gjinisë mashkullore. Pjesa tjetër e përgjigjes mund të ndërlidhet me emërzimin e mbiemrit përkatës. Disa nga emrat e pajisjeve në gjininë femërore kanë mundur të përftoheshin pikërisht nga emërzimi i mbiemrit. Ja si mund të ketë kaluar a të jetë zhvilluar ky proces nga shembujt konkretë: makinë qepëse - qepëse, vegël përdorëse - përdorëse, pajisje ujitëse - ujitëse etj. Kështu që mbiemri në femërore i është përshtatur gjinisorisht emrit strumbullar të sendit konkret (veglës, pajisjes, makinës). Po në rastet e tjera kur emri strumbullar del në gjininë mashkullore si p.sh. aparat thithës a ka mundësi që të emërzohet mbiemri në gjininë mashkullore thithës? Përgjigja është e thjeshtë dhe e sigurtë: po, por trajta e gjinisë femërore lë më shumë hapësirë të lirë manovrimi

Kemi edhe mjaft raste të tilla, por kur kemi parasysh faktin që e thamë më sipër rreth

gjinisë përfaqësuese e përfaqësimit të profesionit në përgjithësi, atëherë del më i arsyeshëm shpjegimi pse favorizohet a duhet favorizuar edhe në të ardhmen trajta në femërore si emërtim vegle, kur dihet fakti se te veglat, sendet, pajisjet kemi të bëjmë vetëm me gjini gramatikore e jo edhe me atë natyrore, siç ngjan tek emërtimet e njerëzve sipas profesionit.

Gjinia e emrit në ndonjë rast mund të jetë përfutur edhe nga ndikimi i trajtës së caktuar të gjuhës së huaj, prej kah përkthehet a kalkëzohet emërtimi përkatës duke e ruajtur gjininë e fjalës marrëse. P.sh. termi teknik "plovak" i serbishtes në shqipe doli "pluskues" d.m.th. në gjininë mashkullore, ndërsa "kopaçica" doli në shqipe "mihëse" a "gërmuese", d.m.th. në gjininë femërore, ku barasvlerësit përkojnë në gjini në të dyja gjuhët, mirëpo ky fakt nuk mund të përgjithësohet. Më mirë është të vetëdijësohet prirja që u tha më sipër që kur të jetë i domosdoshëm një emërtim i tillë i veglës, atëherë emri i njeriut të regjistrohet zakonisht në gjininë përfaqësuese mashkullore, kurse emri i veglës përdorëses po mbi të njëjtën temë fjalëformuese të regjistrohet në gjininë përfaqësuese femërore. Dihet se edhe homonimia e plotë nëse ndodh ajo sqarohet nga konteksti, por edhe kjo prirje nuk është keq të shfrytëzohet si lehtësim i rastësishëm për t'i ikur homonimisë.

Nga kjo që u shtrua më lartë imponon nevojën për trajtime më të thelluara. Këtu u përmend vetëm homonimia e emrave të mjeteve, kundrejt emrave të grave sipas profesionit me temë foljore. Ndër raste të tjera duhet përmendur, ndonëse kalimthi, edhe rastin e homonimive tek emrat e gjinisë femërore me prapashtesën -TORE. Do të mjaftohem me sjelljen e një shembulli, ngase edhe të tjerët paraqiten po kështu. Dihet se me emrin **ëmbëltor** është pagëzuar "personi që bën ëmbëlsira", kurse me emrin "**ëmbëltore**" quhet "dyqani ku shiten ëmbëlsirat". Shtrohet çështja si të quhet femra që shet ëmbëlsira? Sipas rregullës emri mashkullor merr prapashtesën femërorizuese -E dhe normalisht del emërtimi i femrës: **ëmbëltore** që vetvetiu krijon homonimi me emrin e lokalit. Për t'i ikur kësaj homonimie mund të ndiqen dy rrugë, e para, që emërtimi i gruas të quhet **ëmbëltoreshë** dhe e dyta është që emri i vepruesit të marrë prapashtesë tjetër b.f. prapashtesën -TAR: **ëmbëltar** e së këtjemi edhe emri i femrës **ëmbëltare** (ëmbëlsirashitëse). Si duket në letrarishten e sotme, e cila dita e ditës po merr tiparet e një **gjuhe standarde kombëtare**, rruga e dytë doli më e parapëlqyeshme dhe më e leverdishme, ngase siguron zgjidhje të përhershme afatgjatë, ngase respektohet ravijëzimi i modeleve fjaëformuese me formante të specifikura.

Procesi i konkurrimit që sapo u zu në gojë këtu përfshin të gjitha elementet e formëzimit dhe të fjalëformimit dhe pikërisht këto lëvizje evoluimi dalin prirjet e zhvillimit dhe zgjidhjet në formë rregullash, modelesh e parimesh, studimi dhe hetimi i të cilave do të na japë rezultate të dëshirueshme.

Përmbyllje

Në nomenklaturën e profesioneve mbizotërojnë trajtat e emërtimeve të njerëzvesipas profesionit në gjininë mashkullore, e cila konsiderohet si gjini përfaqësuese, sepse në të shumtën e rasteve punët dhe detyrat e caktuara mund t'i kryejë njeriu pa marrë parasysh gjininë. Mirëpo në raste të caktuara kur këtë e imponon natyra e punëve si në nomenklatura ashtu edhe në burime të tjera shënohen emërtimet vetëm në gjininë femërore, përkatësisht në gjininë përfaqësuese femërore.

Përveç ndonjë emri të pammë të ngulitur si të tillë si emërtime të grave sipas profesionit a cilësisë si: *mami, baxhi, tajë* etj. emrat e grave formohen me femërorëzimin e emrave mashkullorë me prapashtesat speciale përkatëse, ndër të cilat më të njohura janë: **-E**, dhe **-ESHË**. Mjafton të ilustrujmë këtë fakt me këta shembuj: rrëfytes rrëfyese, dentist dentiste, solist soliste, shkrues shkruese; bujk bujkeshë, princ princeshë, mbret mbretëreshë (mbreteshë) etj.

Të shembujt e mësipërm prapashtesat simotra **-E** dhe **-ESHË** nuk i bëjnë konkurrencë njëra tjetrës, mirëpo në disa raste të tjera konkurrenca e tyre është e dukshme si: sekretare e sekretarëshë, mike e mikeshë, edukatore e edukatorëshë. Ka gjasa që këto të bashkëtojnë, qoftë në rrafshet stilistike, qoftë edhe në rrafshet kuptimore pragmatike, të cilat dallohet nga ndërlikueshmëria e punëve që kryhen si *sekretarëshë e kabinetit të drejtorit*, përkatësisht *sekretare e konviktit të femrave*.

Përveç këtyre dy prapashtesave në shkrimet e hershme, por edhe në jetën e përditshme e ndeshim aktive, por jo sa dy të parat prapashtesën femërorëzuese – **ATORE**. Prapashtesa e tillë **-ATORE** karakterizohet me pavarësi më të madhe se dy të parat ndaj prapashtesave përkatëse të gjinisë mashkullore, pasi që kjo prapashtesë nuk vihet mbi bazë të emrit të gjinisë mashkullore, por drejtpërdrejtë mbi emër-temën përkatëse fjalëformuese, mbi të cilën mund të formohet edhe emri i gjinisë mashkullore, madje edhe me prapashtesë tjetër. Si p.sh.: gjamatore gjamëtar (gjamë-), ngjeshatore ngjeshtar (me ngjeshë ngjeshë-), kangatore këngëtar (këngë-), njehatore njehtar (me njehë njehë-) etj.

Një numër emrash më **-ATORE** nuk e kanë emrin paralel në gjininë mashkullore për të njëjtin nocion si p.sh. fshisatore (gruaja që fshin, që e ka "zanat" ose që e ka rendin për të fshirë pastruar); fshësëtar (ai që shet a që punon fshesa), furkatore (gruaja që e ka "zanat" me tjerrë me furkë), furkëtar (ai që punon e shet furka) etj. Edhe pse në burime të caktuara të kohës sonë një numër emërtimeve del i shënuar vetëm në gjininë përfaqësuese femërore si p.sh.: çorapëbërëse, shumëfishuese, tezgjahiste, mjelëse, vajtuëse etj. formëzimi i tyre mbi bazë të emrit të gjinisë mashkullore si model duket i qartë. Gjithashtu tek rastet si defatore defator, ndodh procesi i kundërt d.m.th. trajta e gjinisë mashkullore të formëzohet nën ndikimin e modelit të formimit të emrit të gjinisë femërore me mashkullorëzimin e prapashtesës **-ATORE** në **-ATOR** (defatore / defator).

Rastet mëndeshë, pikuleshë, lëneshë, motër(spitali) etj. nuk kanë paralele në gjininë mashkullore mbi temën e njëjtë fjalëformuese, prandaj rastet e tilla tregojnë në njëfarë dore vitalitetin a pavarësinë e përftimeve të emërtimeve vetëm në gjininë femërore.

* * *

Gjithsesi veçoritë që u cekën lidhur me emërtimin a formëzimin e emrave të grave sipas profesionit a veprimtarisë duhet të kihen parasysh në kuadër të sistemit të përgjithshëm të strukturës fjalëformuese të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe.

EMËRTIMET E NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT VËSHTRUAR NGA ASPEKTI I LIDHJES SË TYRE NGA KUPTIMI DHE FORMA

Si çdo pjesë e njësisë leksikore edhe emrat e njerëzve sipas profesionit, me të dalë në jetë, d.m.th. me përfshirjen e tyre në fondin aktiv të fjalësit të shqipes, i shtrohen procesit të konkurrimit, qoftë sipas konceptit të gjerë që lidhet me strukturën e përgjithsme ligjërimore, qoftë sipas kuptimit të ngushtë që lidhet edhe me elementet e fjalëndërtimit. Ky proces i përcjellë me ndërlikueshmëri të ligjshme, është i pranishëm, qoftë në paraqitjen a përcaktimin e nocionit, qoftë në qëndrueshmërinë brendapërbrenda strukturës a modelit të caktuar formëzues e fjalëformues edhe të emër-emërtimet e njerëzve sipas profesionit. Gjithsesi fjalët në kontekst pos gramatikisht lidhen edhe leksikisht për nga kuptimi dhe forma. Me nocionin "lidhje e fjalëve për nga kuptimi e forma" në leksikologji kuptohen kategoritë leksikore të sinonimisë, antonimisë dhe të homonimisë¹²³, ku procesi i konkurrimit dhe i kundërvënies domosdo është i pranishëm. Të vështruarit e temës nga ky aspekt, d.m.th. nga pikëpamja e lidhjes për nga kuptimi dhe forma në fushën e kërkimit shkencor paraqet interes praktik, por ka edhe rëndësi teorike. Është e vërtetë se vëzhgime të kësaj natyre lidhur me procesin e konkurrimit të mjeteve dhe të mënyrave të formëzimit e të fjalëformimit në rrafshin gramatikor (morfologjik) dhe leksikor (semantik) janë bërë edhe deri tashti, ku është prekur ngapak edhe tema në shqyrtim, madje ashtu u bë edhe në këtë punim, mirëpo, me sa di, deri tashti, ndonjë përfundim i sistemuar ende nuk është dhënë rreth kësaj dukurie. Në vazhdim do të përpiqemi të vëmë në dukje, së pari, gjendjen ekzistuese të emërtimeve në fjalë nga pikëpamja që u tha më sipër dhe, së dyti, do të sugjerojmë ndonjë zgjidhje a përfundim me interes.

Dukuria e sinonimisë është dukuria më e dallueshme, mirëpo edhe antonimia dhe hominimia si procese leksikore nuk janë dukuri të pavërejtshme në këto konkurrenca, përkundrazi në raste të veçanta, kur është fjala për përcaktimin e drejtë të emërtimit të caktuar në kuadër të fondit leksikor përgjithësisht, ndikimi i tyre është i konsiderueshëm, madje në mjaft raste edhe vendimtar.

1. Sinonimia dhe emërtimi i njerëzve sipas profesionit

Sinonimia si "ngjashmëri e fjalëve dhe e shprehjeve nga kuptimi"¹²⁴ është dukuri mjaft e vërejtshme tek emërtimet e njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe. Sipas rregullit emërtimi i caktuar si term nuk duron sinonimi, atëherë prej nga del e pranishme kjo

¹²³ Shih: Jani Thomaj, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Prishtinë 1977, f. 41.

¹²⁴ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, f. 1754.

dukuri? Nuk është vështirë të përgjigjemi në pyetjen e mësipërme, kur kemi parasysh faktin se prania e sinonimisë, tek emërtimet në shqyrtim kuahtëzohet nga mjaft shkaqe:

a) nga arsyeja e ndarjes së profesioneve në grupe, nëngrupe, bashkësi e profile të caktuara;

b) për shkak të ndryshimit të teknologjisë së punës për veprimtarinë e caktuar, por edhe

c) nga arsyeja e krijimit të emrit të caktuar me elemente të caktuara fjalëformuese nga autorë në qendra të ndryshme veprimtarie. Kështu ka ndodhur që për të njëjtin nocion mbi bazë të tipave kuptimorë paronimikë të shfaqen trajta të ndryshme, si p.sh.:

këpucëtar, këpucar (kapucar) këpucëbërës, kundraxhi; luletar, lulishtar, luleshitës; vreshtar, rrushshitës, vreshtaruajtës, shitës i fidaneve të rrushit etj.

Tek emërtimet njerëzve sipas profesionit dallojmë dy segmente të sinonimisë të ndërlidhura fort ndërsjelltazi e që janë: *sinonimet gramatikore dhe sinonimet leksikore.*

Si kriter për dallimin e sinonimisë gramatikore nga ajo leksikore merret fakti se ndërsa te sinonimet gramatikore ndryshon kryesisht vetëm formanti i caktuar prapashtesor (sipas varianteve morfologjike me elemente alomorfimi), kurse tema fjalëformuese motivuese mbetet e njëjtë ose rrënja e fjalës së caktuar mbetet si morfemë e qartë dhe stabile, te sinonimia leksikore "ndryshojnë fjalët, shprehjet ose ndërtimet që kanë kuptim të njëjtë ose shumë të afërt me kuptimin e një fjalë, të një shprehjeje a të një ndërtimi tjetër"¹²⁵.

a) Disa shembuj të sinonimisë gramatikore

Duke u mbështetur në kriterin a përcaktimin që u dha më sipër lidhur me formantet paralele prapashtesore mbi morfemën a rrënjën e njëjtë të fjalës, sinonimi gramatikore ndeshim te shëmbujt si vijon:

1) Së pari, po përmendim kundërvënien e prapashtesës -TAR ndaj -AR, te shembujt: djathar djathëtar, këpucar këpucëtar, bravar bravëtar etj. Konkurrenca ndërmjet prapashtesave në fjalë vazhdon edhe në letrarishten e sotme. Disa autorë favorizojnë njëjërën e disa të tjerë tjetrën trajtë. Sipas lëndës që trajtuam, për arsye pragmatike fitohet përshtypja se prapashtesa -TAR del më e favorizuar nga ajo -AR, për ndonjë nënfushës semantike, ndërsa ajo -AR për ndonjë nënfushëz tjetër. Gjithsesi prapashtesa -TAR konkurren në më shumë nënfusha semantike të emërtimëve në shqyrtim nga ajo -AR.

2) Konkurrenca vazhdon edhe ndërmjet prapashtesave -TAR dhe -TOR, si p.sh.:

gjahtar e gjahtor, ëmbëltar e ëmbëltor, barnatar e barnator, qumështar e qumështor, mishtar e mishtor, blegtar e blegtor.

Te shumica e emrave të mësipërm prapashtesa -TAR del më e konsoliduar, edhe pse nga tradita, prej fjalori në fjalor ndeshen të regjistruara trajtat më -TOR. Ekziston prirja që të

¹²⁵ Shih: Shefkije Islamaj, Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1985 f.

përkrahet shtrirja e trajtave më -TAR për të gjithë shembujt e tillë paralelë.

3) Sinonimi gramatikore mund të quhen edhe rastet kur prapashtesa me origjinë turke -XHI konkurrohet nga prapashtesa me origjinë vendi -TAR si të shembujt:

hekurxhi hekurtar, daullexhi daull(e)tar. trapaxhi traptar, hasraxhi hasratar, jorganxhi jargantar, sharraxhi sharrëtar etj.

Gjithsesi në gjuhën e shkrimit në letrarishten e sotme trajtat më -TAR janë jo vetëm më të parapëlqyera por të vetmet si të favorizuara, të qëndrueshme.

4) Sinonimi trajtash do të cilësohen edhe shembujt si p.sh.: skiator skitar, fizikant fizikan e të ngjashme, kur prapashtesa shqipe -TAR, -AN zëvendëson formantin fundor të gjuhës së huaj -ATOR, -ANT.

5) Kemi raste kur një formant prapashtesor me origjinë të huaj zëvendësohet po me formant tjetër të huaj, siç mund të konsiderohen shembujt: bibliotekar bibliotekist, hotelier hotelist, postaxhi postier, teoricien teorik (teori+ik) a teorist etj.

6) Sinonimi gramatikore quajmë kushtëzimisht edhe emrat e formuar me prapashtesën -S, përkatësisht variantet -ONJ/ËS ndaj -UE/S, ndonëse të shembujt e tillë kemi të bëjmë me qasje të ndryshme fjalëformimi, meqenëse të rastet e tilla, ç'është e vërteta, nuk ndryshon prapashtesa e mirëfilltë, por tema fjalëformuese. E quajtmë këtë sinonimi të kushtëzimtë, sepse më tepër kanë tipare të sinonimisë leksikore. Të rikujtojmë shembujt: mësues mësonjës, hetues hetonjës, punues punonjës etj. Çështë e vërteta, sinonimi gramatikore të mirëfilltë (alomorfim) do të kishim të rastet eventuale: **mësues** mësuar, përkatësisht mësonjës mësojs.

Siç dihet në letrarishten e sotme me -ONJ/ËS është stardardëzuar vetëm trajta *punonjës* e në njëfarë dore edhe: *shëronjës*, por janë të lejuara njëherazi edhe trajtat kundërvënëse: **punues** e **shërues** si emra paralelë, por për nocione paksa të diferencuara. P.sh. në Fjalorin e H. Goranit për **punonjës** në serbokroatishte del barasvlerësi **radni čovek**, kurse për **punues** - **obradjivač**, **izradjivač**¹²⁶.

7) Në vazhdim po përmend rastet kur të emrat paralelë njëri është emër i huazuar e tjetri emër prejfoljor i gjuhës shqipe, por që tema e foljes i takon fjalës së huazuar. Ja disa shembuj: normist normues, poenter poentues, diskutant diskutues, referent referues, konkurrent konkurrues, prognozer prognozues, vullkanizer vullkanizues, komentator komentues, recitator recitues etj.

Gjithsesi trajtat më -UE/S janë krijime më të reja të dala nga procesi i punës (kuptohet si rrjedhje nga foljet më -Oj) si raste dhe në konkurrencë e sipër janë para fitores përfundimtare drejt normëzimit të plotë si trajtë e vetme¹²⁷, por ndodh që me trajtën e dytë të shprehet koncept tjetër nga ai që shprehet me emrin e huazuar si b.f. redaktor e

¹²⁶ H. Gorani, Fjalor i termave dhe i shprehjeve ekonomike shqip -serbokroatisht, Prishtinë 1985 f. 267.

¹²⁷ Ludmilla Buxheli në artikullin "Pastrimi i gjuhës letrare nga disa emra të huaj të veprimt e të vepruesit" të botuar në revistën "Gjuha jonë" nr. 1/84, f. 40, favorizon trajtat më -UES kundrejt huazimeve tranfer, ku pos tjerash thuhet: "... edhe emrat diskutant, konkurrent, petendent, referent, simpatizant janë zëvendësuar me emrat diskutues, konkurrues, pretendues, referues, simpatizues etj. që kanë një prapashtesë të shqipes".

redaktues, edukator edukues, edukatëdhënës etj., atëherë të dy a të tri trajtat e tilla mund të bashkëjetojnë.

8) Në shqipen e sotme letrare është e vërejtshme bashkekzistenca e emrave paralelë nga rrënja a fjalë - tema e përbashkët e fjalës së caktuar autoktone si p.sh. këshilltar këshillues, vallëtar vallëzues, Zakonisht emrat prejpjesorë më -UE/S shprehin nuancime të tjera semantike në krahasim me emrat që janë formuar mbi bazë emërore, sepse trajta e parë e lidh kuptimin drejtpërdrejt me emrin b.f .përkatësisht këshill valle, ndërsa e dyta me prejpjesorin përkatës: këshillim, vallëzim.

9) Sinonime gramatikore do të quhen edhe ata emra që në burime të caktuara dalin me prapashtesë sforcuese, shtuese a të dyfishuar. Ja disa shembuj: estet esteticien estetikan, ekonom ekonomist, gjeodet gjeodezist, gjeograf gjeografist, biolog biologjist, fotograf fotografist, hidraulik hidraulikist hidraulikan, metalurg metalurgjist; milic milicionar milicioner, psalt psaltës, psaltist; murg murgar; mjek mjekës, mjektar; burizan burizanist; embëltor embëltorist embëltar; kritik kritikan kritizer, papë papëtar etj.

Shtytësit për dukurinë e prapashtesës sforcuese janë të ndryshëm duke filluar nga ngacmime brendagjuhësore e duke kaluar edhe si ndikime të jashtme nga gjuhët e huaja. Mjaft raste të prapashtesës sforcuese dalin nga zbehja e prapashtesës së parë (fillestare) për shkaqe homonimie e të tjera. Sa për ilustrim po i paraqes këta shembuj: lypës lypc lypcar; lopës lopc lopçar, kaluer kalor kalorës etj. Ngjashëm me rastet e mësipërme ka ndodhur edhe procesi të fjala: fallxhi me trajtat: *fallxhor*, fem. *fallxhore fallxheshë*. Nëse emri i caktuar me prapashtesë sforcuese shpreh nocion paksa tjetër dhe ka fituar përgjithësim, emrat në trajtat e ndryshme mund të bashkëjetojnë, përndryshe nëse kemi të bëjmë për konceptin e njëjtë, atëherë do të mjaftonte vetëm njëra trajtë.

Edhe rastet e prejfoljorëve: vras vrasës (vrasës), ngas ngasës (ngarës), gërgas gërgasës (gërgarës) sipas një interpretimit të caktuar, jo aq hipotetik, i takojnë nëntipit me dyfishim prapashtese.

10) Sinonime gramatikore quajmë edhe emrat paralelë të gjinisë femërore si p.sh. edukatore edukatoreshë, ministre ministreshë, sekretare sekretareshë, edhe pse në raste të veçanta mund të shprehin nocione të ndryshme leksikore a stlistike. Po kështu do të trajtohen edhe rastet e tjera si: çobane çobankë çobaneshë, vajtoare vajtojcë vajtoare; vallëtare valltorkë; bukatore bukatore; renatore renatate, defatore defatate etj., ndonëse trajtat më -A/TARE mund të jenë raste të femërorëzimit të emrit të gjinisë mashkullore me prapashtesën -TAR, ato me -ATORE kanë ose bartin njëfarë cilësie pavarësie.

Sidoqoftë, nga lënda që u shtrua më sipër mund të vërehet se sinonimia gramatikore në shqipe ka të bëjë më tepër me emra të prejardhur me prapashtesa sinonimike duke përfshirë edhe emrat me prapashtesë zero dhe se në raste të caktuara trajtat e tilla në njëfarë mënyrë formojnë sinonimi leksikore të një tipi të veçantë.

b) Disa shembuj të sinonimisë leksikore

Në emërtimet e njerëzve sipas profesionit në gjuhën tonë vërehen këta tipa të sinonimeve leksikore: fjalë e huaj - fjalë shqipe, fjalë e huaj - fjalë e huaj, fjalë shqipe (letrare) - fjalë shqipe (dialektore). Ndërsa nga struktura fjalëformuese (e ndërtuese)

vërehen tipat: emër i parmë - emër i prejardhur, emër i prejardhur - emër i përbërë, emër i përngjitur - togfjalësh, por edhe me kombinime të mundshme: emër i parmë - emër i parmë, emër i prejardhur - emër i prejardhur.

Meqenëse si temat fjalëformuese ashtu edhe elementet ndajshitesore fjalëformuese nuk paraqesin paqartësi të dukshme lidhur me përcaktimin e sinonimisë leksikore të tipit përkatës, këtu nuk do të thellohemi në probleme të veçanta, por do të mjaftohem vetëm me të sjellët e ndonjë shembulli konkret sa për ilustrim duke vënë në pah, së pari, tiparin ndërkrasues dhe së dyti, aspektin strukturor fjalëformuese.

a.1) *Fjalë e huaj - fjalë shqipe*: dhaskall - mësues, soldat - ushtar (ushtëtar), kasap - mishtar, mishshitës, kundraxhi - këpucëtar, strazhnik - rojtar etj.

Siç dihet disa nga emërtimet nga gjuha e huaj kanë kaluar në shtresën pasive të leksikut tonë, ndërsa ndonjëra prej tyre mund të qëndrojnë si emërtim historik, por që tashti ka arritur në kuptim antonimik, mirëpo ne po i përmendim si sinonime, pasi që në momente të caktuara ashtu ishin, madje në stile përkatëse ashtu edhe mund të paraqiten edhe sot.

2) *Fjalë e huaj - fjalë e huaj*: praktikant - stazhier stazhist, livrant - liferant, afarist - aferist, kambist - diler etj.

Zakonisht në rastet e më sipërme parapëlqehet trajta që ka përgjithësim më të madh si dhe prestigji aktual i gjuhës prej kah është marrë ai huazim, nëse trajtat e caktuara nuk përdoren për koncepte të ndryshme semantike, si p.sh: afarist (lidhet me biznes) e aferist (lidhet me aferë). Gjithashtu lypset sqaruar edhe trajta e tjera si p.sh.: maser masazhist, prakticien praktikant, veteriner - veterinar, teoricien teoretik teorist etj., të cilat mund të cilësohen edhe si sinonime gramatikore, por e vërteta është se ndryshimimi i prapashtesës së caktuar vjen si rezultat i huazimit nga gjuhë të ndryshme që mund të mbulojë mbase edhe nocione të ndryshme.

Natyrë e gjuhës sonë e do që emërtimet e huazuara të shqipërohen sa më shumë aty ku ka mundësi, qoftë me zëvendësimin e tërë fjalës, qoftë me zëvendësimin e pjesëshëm të elementeve të caktuara fjalëformuese. Kështu që b.f. **liferant** zëvendësohet me dërgues, furnizues ose me zëvendësim hibrid të pjesëshëm: **liferues**. Kështu vepohet edhe në raste të tjera dhe se një mënyrë e tillë gjithsesi duhet pasur kujdes që të mos ndikojë keq në qartësinë e paraqitjes së konceptit të caktuar.

3) *Fjalë e gjuhës letrare - fjalë dialektore*: mihës mihtar, herrës herrtar, tjerrës tjeritar etj.

Duke i pasur për bazë situatat reale të zhvillimit të gjuhës sonë letrare dhe njësimin të saj e sidomos duke i përfillur modelet gjalluese prodhimtare e aktive të letrarishtes së sotme mund të thuhet se nuk është vështirë të dallohen emërtimet me karakter dialektor si p.sh. mihtar, herrtar, tjeritar ndaj mihës, harrës, tjerrës etj. edhe pse formimet e tilla që këtu i cilësuam dialektore, nuk janë jashtë sistemit të fjalëformimit të gjuhës sonë përgjithësisht, mirëpo sot për sot del mbizotëruese mënyra e formimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë me prapashtesën -S kur tregohet një proces pune, përkatësisht kur për temë fjalëformuese është një pjesore e foljes përkatëse, ndërsa kur si fjalë-temë fjalëformuese është një emër, atëherë pothuajse normalisht mund të

dalë në përdorim prapashtesa -TAR, por tani mbase me një kuptim të diferencuar nga trajta tjetër. Së paku, të krahasohet kundërvënia e tipit mbathës e mbathtar (mbathëtore), ku siç dihet, ekziston arsye fortë që në shqipen standarde, secila nga këto mënyra të specifikohet për nënfushë të caktuar semantike.

Sinonime leksikore të kësaj natyre mund të jenë shembujt: amvisë/shtëpiake, nëpunës/zyrtar, djathëtar (djathar)/ stopan baxho, përderës/lypës, delmer/dhenar deleruajtës, qumështshitës /tambëlshitës etj.

Sinonime leksikore mund të quhen edhe disa krijime që janë formuar te ne në krahasim me sinonime të tjera të letrarishtes ose që kanë gjasa të letrarëzohen si p.sh. shtëpiak - mirëmbajtës objekti, mjeshtër shtëpie; lajmëruese e programit televiziv - paraqitëse e programit televiziv; përcjellës i ekipit - shoqërues i ekipit etj.

b. Pasi rreth fjalëformimit është bërë fjalë më përpara më në hollësi, këtu do të mjaftohemi vetëm me paraqitjen e shembujve të caktuar, pa komentim rreth tipave përkatës të fjalëformimit në përfaqje ndërmjet tyre.

1) *Fjalë e parme - fjalë e prejardhur*: bujk - lavërtar, plak - pleqnar, mjek - mjekës - mjekatar (doktor) etj;

2) *Fjalë e prejardhur - fjalë e përbërë*: bukatar furrtar - bukëpjekës; mishtar kasap - mishshitës; kuzhinier - gjellëbërës etj.;

3) *Fjalë e përbërë - emërtim togfjalësh*: kryefamiljar a zotshtëpie - i zoti i shtëpisë); kryeinxhinier - inxhinier kryesor; elektromekanik - mekanik i elektropajisjeve etj.

Te rastet e mësipërme sinonimia leksikore mund të quhet sinonimi relative, sidomos atëherë kur në nomenklatura të profesioneve mund të qëndrojnë sipas rastit të dyja a të tria trajtat.

2. Antonimia dhe emërtimet e njerëzve sipas profesionit

Dukuria e antonomisë tek emërtimet e njerëzve sipas profesionit është e pranishme në vëllim të vogël dhe pak a shumë ka karakter specifik. Është i njohur fakti se "antonimet janë fjalë me kuptim të kundërt", përkatësisht, siç e thotë studiuesi Ibrahim Goçi, janë "çifte fjalësh me kuptime të kundërta midis tyre, të cilat duke plotësuar kuptimin e njëra tjetrës përmes kundërvënies ato së pari e pohojnë veten, pastaj e mohojnë njëra tjetrën"¹²⁸ dhe pikërisht po "nëpërmjet kundërvënies" del edhe procesi i konkurrimit dhe nevoja e përcaktimit të emërtimit të caktuar si emërtim të njeriut sipas veprimtarisë.

Ç'është e vërteta, dalja e antonimeve si emërtime të mirëfillta të profesioneve është e kufizuar, por ndikimi, si të themi, i tërthortë nuk është dukuri e kufizuar, por një dukuri e gjallë që merr pjesë në makrostrukturën e formëzimit të emërtimit të njerëzve sipas profesionit.

¹²⁸ Ibrahim Goçi, Antonimet e gjuhës shqipe, IAP, Prishtinë 1985 f. 37. Me vlerë janë edhe punimet e Jani Thomajt (te Leksikologjia) dhe të Miço Samarës (te Studime mbi leksikun ... 1972).

Specifika e daljes së antonimeve në emërtimet e njerëzve sipas profesionit do ta shihet më së miri pasi të vëmë në pah disa shembuj konkretë.

Po e analizojmë paksa b.f. antonimin **mësues** ndaj atij **dhaskall**.

Shikuar nga aspekti historik, këto dy fjalë ishin sinonime, e në rrethe të caktuara ashtu mund të jenë edhe sot, por me kohë këto dy fjalë kaluan a u shndërruan në antonime. Në gjuhën e sotme letrare me fjalën **dhaskall** kuptohet "një mësues i keq, i vrazhdë", një "pseudomësues" a një "mësues" që "ishte në shërbim të huaj apo të klerit"(!), kurse me fjalën **mësues** në gjuhën e sotme kuptohet një njeri që "jep mësim në shkollë", përkatësisht "ai që shquhet në një fushë të caktuar të dijes e të veprimtarisë shoqërore" (FGJSSH f.1132. Kështu që pikërisht nga kuptimet polisemantike me ngjyrimet stilistike, siç u cekën më sipër, kuptohet më lehtë antonimia e këtyre fjalëve. Mirëpo vetëm emri **mësues** është emërtim i mirëfilltë i njeriut sipas profesionit, sepse mësuesi për punën e vet merr pagën dhe për të fituar një emërtim të tillë ai kryen shkollën e caktuar dhe merr "thirrjen zyrtare" sipas kualifikimit shkollor përkatës.

Po ky kriter vlen edhe për sinonimet e poshtëshënuara që tashmë kanë kaluar në antonimi të mirëfillta. Krahaso: zabit - oficer, kaplar - tetar, çatip - shkruar etj. raste këto që vetëm njëra trajtë ka kuptim neutral, d.m.th. emërtim të mirëfilltë profesioni, kurse trajta tjetër del e pasivizuar si emërtim profesioni, por për arsye stilistike mund të përdoren normalisht në rrethana e situata të caktuara si njëra ashtu edhe trajta tjetër.

Tip të veçantë paraqesin antonimet nga fusha e së drejtës si: i padituri - paditësi, i mbrojturi (klienti) - mbrojtësi (avokati), kundërpropozuesi - propozuesi etj. Në rastet e tilla vetëm njëri nga çiftet është emërtim që tregon njeriun sipas profesionit, kurse tjetri është pësuesi a i pësuarit. Krahaso b.f. shembullin: "paditësi" (prokurori), i cili paguhet për "zanatin" detyrën që kryen, kurse "i padituri", jo vetëm se nuk ka kurrfarë fitimi, por ai mund të pësojë keq në kontestin përkatës gjyqësor. Kur është fjala te antonimi paditës - i paditur, emërtimi i i dytë paraqet edhe një homonimi të vrazhdë, dukuri kjo për të cilën do të bëjmë fjalë paksa te tema e homonimisë.

Përveç rasteve që u cekën më sipër vetë natyra e punës a e veprimtarisë së njeriut imponon nevojën e krijimit (formëzimit) të antonimeve, kur vetëm njëri nga çiftet kryen funksionin e njeriut sipas profesionit e tjetri jo.

Rreth kësaj specifike del e nevojshme të jepet edhe ndonjë sqarim.

Në realitetin e përditshëm gjuhësor ndodh të kërkohej punëtori nën emërtimin b.f. "**ngarkues-shkarkues**" në stacionin e caktuar për ngarkim – shkarkimin e mallit (mallrave), por ndodh të emërtohet vendi i punës edhe vetëm **ngarkues i mallit** ose **shkarkues i mallit**. Është e vërtetë se fjalët: ngarkim - shkarkim janë antonime, por në procese të caktuara të punës këto dy koncepte mund të paraqesin një tërësi. Kështu që punëtori i emërtuar si "**ngarkues - shkarkues i vagonave**" zë punë dhe paguhet për të dyja proceset ngase edhe ngarkon edhe shkarkon vagonetat etj. mirëpo në rastet kur punët ndahen, p.sh. kur dikush ngarkon e dikush në një vend tjetër shkarkon, atëherë qëndrojnë veçan të dyja emërtimet: **ngarkues i vagonetave** dhe **shkarkues i vagonetave**.

Është e vërtetë se emërtime të tilla të ndara i ndeshim edhe në emërtesat e caktuara të profesioneve, varësisht nga veprimtaria që ushtrohet në ndërmarrjet e caktuara.

Po kësaj natyre i takojnë edhe emërtimet si b.f.: afrues e largues, kështu që në një

nomenklaturë ndeshet emërtimi: *afrues* i pjesëve të rezervës dhe në një vend tjetër *largues* i hedhurinave; *marrës* i veglave ose *dhënës* i veglave; *shitës* i mallrave të përziera/ *blerës* i mallrave për furnizim; huadhënës /huamarrës, qiradhënës / qiramarrës, mësimdhënës mësimarrës etj. Edhe lidhur me shembujt e nëntipit të mësipërm del e nevojshme të jepet ndonjë sqarim. Ndërsa rreth mirëfillësisë së fjalës *shitës* si emërtim i njeriut sipas profesionit nuk shprehet kurrfarë dyshimi, pasi që siç dihet çdo *shitës* njihet si "mjeshtër" i profesionit të vet, për **blerës** mund të shprehet dilemë, pasi që çdo *blerës* s'mund të cilësohet si njeri i profesionit, mirëpo në rrethana të caktuara edhe emri blerës merr tiparin e njeriut sipas profesionit, sidomos kur blerësi si furnizues blen mallrat dhe ua dorëzon të tjerëve për manipulime të mëtejshme dhe njëherazi për një punë të tillë ai paguhet, merr pagë.

Në fund po e cek edhe një veçori që i takon kësaj natyre që po trajtohet këtu. Dihet b.f. se nga foljet antonimike montoj çmontoj mund të dalin normalisht emrat e vepruesit edhe montues edhe çmontues, mirëpo në cilësinë e emrit të njeriut sipas profesionit qëndron si emërtim i vetëmjaftueshëm vetëm trajta montues (montator), i cili kuptohet se është i aftësuar edhe për montimin edhe për çmontimin e pajisjeve të caktuara. Mirëpo ka raste që dalin aq gjëra të ndërlikuara në teknologjinë e prodhimit, sa që mund të ndodhë që edhe antonimet e tilla të jenë të zërthyeshme në dy emërtime të ndryshme profesionale. P. sh. nga foljet radhit çradhit dalin emërtimet: **radhitës** e **çradhitës**. Kështu që të dy emrat në nomenklaturën e organikave në shtypshkronjë dallohen qartë, d.m.th. paraqesin dy profesione (vende pune) të ndryshme të mirëfillta.

Gjithsesi përveç sinonimisë edhe dukuria e antonimisë ndikon në raste gjatë procesit të formëzimit dhe të konsolidimit të emërtimeve të caktuara të njerëzve sipas profesionit.

3. Homonimia dhe emërtimet e njerëzve sipas profesionit

Homonimia si kategori leksikore a si dukuri në emërtimet e njerëzve sipas profesionit nuk është aq e pranishme, mirëpo ndikimi i saj në raste të caktuara është vendimtar për pranimin a për mospranimin e trajtës së caktuar shkrimore a shqiptimore për konceptin e caktuar. Dihet se homonimi është "një fjalë që tingëllon njësoj me një tjetër, por nga kuptimi ndryshon prej saj", përkatësisht me këtë fjalë-term kuptohet "përputhja tingullore e dy e më shumë njësisive të ndryshme gjuhësore" (FGJSSH 691)¹²⁹ që është rezultat i rrugëve të ndryshme të krijimit të fjalëve të caktuara, por edhe si pasojë e zërthimit të polisemisë.

Në vazhdim do të cekim ndonjë shembull të homonimit të krijuar si rezultat i rrugëve të ndryshme.

Në burime të ndryshme hasim në emërtimin **kos(ë)tar** herë me kuptimin "ai që shet

¹²⁹ Rreth homonimisë shih: Jani Thomaj, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Prishtinë 1977, f. 51; Xhevat Lloshi, "Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe" dhe "Rreth shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe" te "Studime mbi leksikon ..." I, Tiranë 1972.

kos", herë me kuptimin "ai që kosit me kosë".

Rasti i parë ka për temë motivuese një emër të rezultatit të prodhimit nga qumështi: **kos** kosi, emërtim ky që në burime të caktuara është shënuar me trajtën kosaxhi, kurse në gjuhën e sotme mund të ndeshen sinonimet si b.f.: **kosshitës** a **kostar**(!), kosbërës, kosnxënës, kosshpërndarës etj.

Rasti i dytë ka për temë motivuese emrin e një mjeti të punës të quajtur **kosë** kosa. Në rrethe të caktuara për këtë nociom përdoren trajtat sinonimike: kosaç e kosaxhi, kurse në letrarishten e sotme, sigurisht krahas trajtës **kosëtar** mund të parapëlqehet edhe trajta **kositës**, trajtë kjo që mbështetet në pjesoren e foljes përkatëse kosit (me kositë), me të cilën edhe emërtohet procesi i punës së caktuar.

Në burime të caktuara haset homonimi prestar edhe për nocionin "ai që pret rroba - rrobaqepës" por edhe si term nga e teknologjisë "ai që punon me presë" (serb. presaç_ preser). Homonimi paraqet edhe fjala dhjetar, me këtë fjalë-term kuptohej "ai që mblidhte të thjetat" edhe për nocionin si kalk të përkthyer nga serbishtja për termin "desetar"(dhjetar) me kuptimin "komandues i njësisë më të vogël ushtarake" që në shqipe mbase më mirë i përgjigjet fjalë-termi *tetar* ose *skudër-komandant*.

Po e përmend edhe rastin antonim nga terminologjia juridike *paditës / i paditur*, të cilët ndërlidhen me fjalëtermin **padi-a**: "*kërkesë që i bën dikush gjykatës kundër një tjetri për të mbrojtur një të drejtë ose për të zgjidhur një çështje; akti me këtë kërkesë*" (FGJSSH f.1320) dhe mbi bazë të kësaj fjalë del folja **padit** (me paditë) dhe së këtejmi emërtimi i njeriut sipas veprimi: **paditës-i** (d.m.th. pala padibërëse), ndërsa emri dhe mbiemri i pësuesit (d.m.th. i palës padingarkuese) është emërtuar: **i paditur-i**. Pikërisht emri i padingarkuesit si *i padiur* krijon homonimi të vrazhdë me përgjegjësin **i paditur-i**, që etimologjikisht e kuptimisht lidhet me fjalën **dije** (*njohuri, dituri, shkencë*), më drejt, ka të bëjë me **pa dije**, me **pa dijeni** dhe si mbiemër dhe si emër del me këtë kuptime themelor: *Njeri i paditur, që nuk ka arsimim dhe kulturën e përgjithshme, që s'ka dituri, i pa dije, i pa shkollë*. (Po aty f. 1320) E quajtëm **homonimi tejet të vrazhdë**, ngase ndodh që *paditësi* (juridikisht) të jetë një injorant (vërtet njeri i paditur), ndërsa *i padituri* (juridikisht) të jetë një njeri akademik, njeri me dije shumë e me arsimim të lartë, i cili duhet të vetnëshkruajë *si i paditur*(!!!). Prandaj për t'i ikur një absurditeti të tillë, propozojmë të futet në përdorim termi **padingarkues** në vend **i paditur**. Dhe kështu, gjithsesi kuptimisht e juridikisht termat: **padingarkuesi** në vend **i padituri**, përkatësisht **padiparaqitësi** si sinonim i paditësit, padishkruesi (avokati) etj gjithsesi do të jenë më të përkapshëm, më të logjikshëm e stilistikisht më të pranueshëm, madje një intervenim i tillë nuk lë kurrfarë pasojash, përkundrazi qartësia do të jetë më në nivel. Sidoqoftë, është koha që të rishqyrtohen termat e të gjitha fushave shkencore, ashtu edhe të jurisprudencës (rtë drejtës), për të shmangur keqkuptimet nga homonimet e vrazhda.. Shembuj të tillë homonimie në burime të ndryshme, ngase siç dihet në nomenklaturat e profesioneve trajtat e njëjta nuk janë të lejueshme për arsye se sjellin huti lidhur me paraqitjen e saktë të profesionit a të vendit të punës, në fjalorë zakonisht shënohen në zëra të veçantë.

Po e përmend edhe homoniminë që paraqet fjalë-termi i huazuar "axhustator" në shqipe, sidomos te ne. Mbase si term fillestar ai mund të qëndronte, por me zberthimin e polisemisë, konkretisht në krahasim me barasvlerësit përkatës të serbokroatishtes e të

gjuhëve të tjera homonimia e tillë del e patolerueshme. Kështu në burime të caktuara fjala **axhustator** e shqipes te ne ndeshet në barasvlerësi me fjalë-termat e serbishtes: "**adjuster**", "**bravar**" dhe "**mašinbravar**"¹³⁰. Domosdo te ne del e nevojshme që të përcaktohen barasvlerësit përkatës për konceptet e caktuara të sipërcekura dhe të harmonizohen me emërtimet përkatëse që janë në përdorim në Shqipëri e vende të tjera.

Homonimia mund të paraqitet (zhvillohet) edhe për shkak të zbrërthimit të emrit të caktuar në nënfusha të ndryshme semantike. Kështu p. sh. fjalë-termi **instrumentist** përdoret në muzikë, në mjekësi, në mekanikë, në industri, në elektronikë e në degë të tjera të ekonomisë, prandaj del e nevojshme që për secilën degë ose të formëzohen fjalë-termat të rinj ose të jepen shpjegimet, edhe pse, në mjaft raste, mund të jenë të kuptueshme nga vetë konteksti.

Një problem i tillë del i shpjeguar a i regjistruar edhe në fjalorët e caktuar normativë, kështu që p.sh. në FGJSSH për emrin **ligjërues** jepen këto kuptime polisemantike i sqarojmë pjesërisht me fjalë tona:

1. ligjvënës;
2. ligjëratëmbajtës dhe
3. recitues, gojëtar.

Ndërsa në shembullin e mësipër zhvillimi i homonimisë del në fushën e emrit të njeriut sipas profesionit a veprimtarisë së tij, por varësisht sipas nënfushave të caktuara semantike të ndryshme, tek shembuj të tjerë nënfushat semantike mund të kalojnë edhe jashtë emërtimeve të njerëzve ato kalojnë edhe në emërtimin e mjeteve të caktuara etj. Më poshtë po i jap zhvillimin homonimik të tre emrave prejpsorë: zbulues, drejtues dhe shënues, ashtu siç paraqiten në FGJSSH:

1. Me emrin **zbulues** kuptohet:

- personi që bën zbulim;
- ushtari që merret me zbulim (d.m.th. për nevoja ushtarake);
- një mjet teknik (që kryen veprime zbulimi).

2. Me fjalën **drejtues** kuptojmë:

- personin që drejton e organizon punën në një ndërmarrje etj;
- personin që vë në lëvizje një makinë;
- një pajisje a aparat në elektroteknikë (që shërben për të drejtuar veprime të caktuara teknologjike).

3. Me fjalën **shënues** emërtohet:

- njeriu që shënon diçka me veglën e caktuar;
- vegla e posaçme "me të cilën vihet në shenjë mbi diçka".

¹³⁰ Rreth shumëkuptimësisë së fjalë-termi **axhustator** te ne shih edhe te punimi: Çështje të emërtimeve të profesioneve në shkollat tona të mesme" (N. Veselaj) te revista "Gjuha në shkollë", SHGJA të Kosovës, Prishtinë 1989, f. 106.

Siç u pa nga shembujt e sipërshënuar emri i veglës emërtohet plotësisht njësoj si edhe emri i njeriut, ngase edhe vegla a pajisja kryen funksionin ashtu si edhe njeriu. Në shumicën e rasteve format e tilla nuk paraqesin vështirësi lidhur me paraqitjen e konceptit të caktuar, ngase emri i njeriut dhe ai i veglës kuptohen a dallohen nga konteksti. Mirëpo ka raste kur emri i njeriut apo mjeti (vegla) dallohen edhe me anë të prapashtesës përkatëse, kështu që nuk është e pavërejtshme prirja që emri i veglës të marrë prapashtesë tjetër, si b.f. *zbulues zbulor, zbuluesor; drejtues drejtuesor, shënues shënuesor* ose emri i njeriut të marrë prapashtesë a shenjues tjetër si p.sh. *zbulimtar, drejtimtar (drejtimdhënës), shënimtar a shënaq* etj. Gjithsesi mbesin çështje të hapura.

Sigurisht në rritje e sipër janë emërtimet homonime, por njëherazi edhe dallimet e caktuara sipas prapashtesave përkatëse speciale, çka tregon dukurinë e rritjes së numrit të emërtimeve të tilla.

P ë r m b y l l j e

Për të qenë tema e trajtuar në mënyrë sa më complete emërtimet e njerëzve sipas profesionit u trajtuan edhe nga aspekti i lidhjes së fjalëve për nga kuptimi dhe forma, përkatësisht u trajtua raporti i këtyre emërtimeve në konkurrencë të brendshme dhe të jashtme edhe sipas kategorive leksikore të sinonimisë, antonimisë dhe të homonimisë. Gjithsesi trajtimi i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit nga këndvështrimi i aspektit të lidhjes së fjalëve për nga kuptimi dhe forma, pra sipas dukurive të sinonimisë, antonimisë dhe homonimisë del i arsyeshëm dhe me interes, ngase vihen në pak probleme që nuk dilnin aq të vërejtshme nga qasje e këndvështrime të tjera, andaj në përmbyllje po përsërisim disa nga gjerat që u trajtuan më sipër fare shkurtimisht:

1. Sinonimia si dukuria më e ndjeshme në këtë kompleks, siç u pa, është e pranishme tek emërtimet në shqyrtim, sidomos zgjon interesim sinonimia gramatikore pa u lënë anash as sinonimia leksikore. Në sinoniminë gramatikore del në pah raporti i konkurrencës së prapashtesave sinonimike si dhe prirja rreth cilësimit të prapashtesave speciale për këtë qëllim. Në kuadër të sinonimisë leksikore shihet konkurrenca ndërmjet emërtimeve në raportin: fjalë e huaj - fjalë e huaj, fjalë shqipe - fjalë e huaj si dhe fjalë e gjuhës letrare - fjalë dialektore a fjalë me përdorim të kufizuar. Gjithashtu preket edhe çështja e formëzimit të emërtimeve në fjalë nga aspekti i fjalëformimit: emër i parmë - emër i prejardhur, emër i prejardhur - emër i përbërë, emër i prejardhur - togfjalësh me mundësi kombinimesh të të gjithë tipave e nëntipave.

2. Antonimia si kategori leksikore lidhur me emërtimet e njerëzve sipas profesionit ka paraqitje specifike. Në shumicën e rasteve, në organika a në emërtesat e sistematizimeve të punës, vetëm njëri çift antonimik paraqitet si emërtim i mirëfilltë i profesionit ose i veprimtarisë (veprimi), kurse çifti tjetër jo. Ka raste kur të dy çiftet bashkohen në një proces, atëherë edhe emërtimi i profesionit a i vendit të punës konsiderohet si një emërtim i vetëm, siç është rasti: ngarkues - shkarkues (i vagonave) etj. gjithashtu ka

raste që të dy çiftet antonimike të shprehin emërtime të veçanta si p.sh. radhitës /çradhitës etj.

3. Sipas rregullit homonimia si kategori leksikore logjiksht e praktikisht nuk mund të qëndrojë në organikën e caktuar të të njëjtës organizatë punonjëse, ngase njëra trajtë do të godiste trajtën tjetër dhe kështu do të shkaktonte ngatërresë kuptimore, megjithatë edhe kjo dukuri ndikon në emërtimet e caktuara të njerëzve sipas profesionit. Homonimet mund të kenë origjinë të ndryshme, por janë të njohura trajtat homonime që dalin në fusha të ndryshme semantike si raste nga zbërthimi i polisemisë e në mënyrë të veçantë kur e njëjta formë shkrimore e shqiptimore e emrit të caktuar emërton edhe njeriun sipas veprimtarisë edhe mjetin a pajisjen me të cilën kryhen operacione tekniko-teknologjike, siç dalin b.f. trajtat shënues (njeriu i cili shënon ...) shënues (mjeti automatik që shënon ose me të cilin njeriu shënon ...).

Meqenëse trajta homonimike pengon qartësinë e shprehjes së nocionit përkatës, në nomenklatura të së njëjtë degë dukuria e tillë mënjanohet duke gjetur zgjidhje, zakonisht duke e zgjedhur një trajtë tjetër sinonimike natyrisht duke i ndryshuar emrit gjininë ose duke i ndryshuar prapashtesën përkatëse tek emrat e prejardhur. Gjithsesi lypset bërë përpjekje që aty ku ka mundësi për homonimet e vrazhda të gjenden zgjidhje më të arsyeshme.

Kreu VI

RRETH DALLIMIT NDËRTIMOR E KUPTIMOR TË EMËRTIMEVE TË NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT PA E ME PROFILIZIM TË NGUSHTË

Çështja që do të trajtohet në këtë krye është prekur si me thënë kalimthi në paraqitjet deritashme në këtë punim. Është fjala për një pikë mjaft me interes që ka të bëjë me dallimin ndërtimor e kuptimor të emërtimeve në shqyrtim pa e me profilizim të ngushtë që lidhet si me thënë me rrafshin e parë edhe më të ngushtë të piramidës sipas paraqitjes skematike. Pra kemi të bëjmë me nocionin e emërimit përkatës pa profilizim të ngushtë ndaj emërimit me profilizim të ngushtë. Për të qenë më e qartë çështjea në shqyrtim po jap skemën me shembuj konkretë të merenduar në katër rubrika. Në fillim veç numrit rendor të skemës prin emri i vendshërbesës a i lokalit të punës e pas tij vijnë dy rubrikat e tjera: emërtimet e njerëzve sipas profesionit pa profilizim të ngushtë, që paraqesin njëfarë kiearkie semantike a nyjëtimit në vargun e fjalëformimit emëror dhe në rubrikën e fundit janë shënuar emërtimet e njerëzve sipas profesionit me profilizim të ngushtë.

Skema e vargut fjalëformues të shkallëzuar pa e me profilizim të ngushtë profesioni

| Emërtimi i Vendshërbesës | Emërtimi i njeriut pa profilizim të ngushtë profesioni | Emërtimet e njeriut me profilizim të ngushtë profesioni |
|-----------------------------|--------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. vegëltore | vegëltar | vegëlgrihës, vegëlmprehës, vegëlsaldues, vegëlpunues, vegëlpaketues, vegëlshitës etj. |
| 2. ëmbëltore | ëmbëltar | ëmbëlsiragatues, ëbëlsirashitës, ëmbëlsirabërës, ëmbëlsiraservues etj. |
| 3. çajto | çajtar | çajbërës, çajshitës, çajqitës, çajshpërndarës, çajblerës etj. |
| 4. punishte | metalist (mekanik) | metalpunues, metalshkrirës, metalgdhëndës metalshpues, ; axhustator-mekanik etj. |

| | | |
|-------------------------------|-----------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 5. mishtore | mishtar | mishshitës, mishcoptues etj. |
| 6. gëzofitore | gëzofitar | gëzofpunues, gëzofshitës, gëzofarnues, gëzofqepës etj. |
| 7. lëkurëtore /lëkurëtari/ | lëkurëtar /lëkurës/ | lëkurëmbledhës, lëkurëpunues, lëkurëregjës, lëkurëshitës, lëkurëterës etj. |
| 8. blegtori/a | bari (blegtor, (blegtar) | çoban) lopësh, bari dhensh (dhenruajtës), bari dhish etj. |
| 9. ngrohtore | ngrohtar | ngrohës i kazanave me avull, ngrohës i zyreve të punës, mirëmbajtës i ngrohjes qendrore etj. |
| 10.këmbimtare(!) | këmbimtar | nëpunës-këmbyes i të hollave me çeqe, këmbyes i valutave devizore, përcjellës i kursit(bursës) etj. |
| 11. mëso(n)jtore | mësues | mësues në çerdhën e fëmijëve; (shkollë); mësues i gjuhës shqipe ë tetëvjeçare; mësues i kimisë në shkollë të mesme, mësues i kibernetikës etj. |

Kështu pra emrat vegëltar, ëmbëltar, çajtar, metalist, mishtar, gëzofitar, lëkurëtar, blegtar, ngrohtar, këmbimtar, mësues - në realitetin tonë, ku është duke lulëzuar prona private, më tepër tregojnë pronarin (zyrtarin) a mbikëqyrësin e lokalit a të veprimtarisë së caktuar, i cili gjithsesi nënkuptohet se e njeh profesionin përkatës të cekur në temën prodhuese fjalëformuese. Ndërsa emërtimet që këtu u shënuan si emra të përbërë, siç janë b.f. veglapunues, ëmbëlsirabërës, çajqitës, metalshkrirës, mishshitës, gëzofpunues, lëkurëpunues, dhenruajtës etj. ose si emërtime togfjalësha si: ngrohës i kazanave me avull, këmbyes i mallrave të përziara etj., në të vërtetë janë emërtime të mirëfillta të njerëzve sipas profesionit me profilizim të ngushtë, por që nuk lidhen vetëm me kualifikimin e shkallës më të ulët, ngase siç po shihet nga shembujt kemi të bëjmë me një veçori që mund të ketë sendërtim në çdo nivel të shkallëzimeve sipas ndërlikueshmërisë së punëve.

Nuk janë, pra, raste të rralla te ne kur b.f. *mishtari* (emërtim i profilit të gjerë) si pronar paguan mishshitësin ose kur i zoti i burektores (burektari - emërtim i profesionit jo me profilizim të ngushtë) paguan personin (burekgatuesin) që përgatit burekat, i cili i del zot profesionit me profilizim të ngushtë, ashtu siç e kërkon “zanati”, i cili veç përvojës

do të mund të ketë të kryer specializimet më të larta.

Po theksoj edhe këtë fakt se emërtimet si emra hiperonimë (pa profilizim të ngushtë) mund të jenë të përkapshëm për nga numri, ndërsa emërtimet si emra me profilizim të ngushtë paraqiten me mundësi të pakufizuar shumimi dhe këta zakonisht dalin, siç tregojnë shembujt ilustrues, qoftë si emra të përbërë, qoftë si emërtime togfjalësha. Me fjalë të tjera, kur kemi parasysh tipat kuptimorë, emërtime të profilit të gjerë, siç janë emrat e prejardhur në funksion të profesionit të profilit të gjerë hiperonimikë, ndeshim në të gjitha nënfushat semantike: sipas mjetit të punës, lëndës a objektit të punës, lëndës a objektit të punës, lokalit a vendit të punës, degës a veprimtarisë së caktuar, por në raste edhe sipas procesit të punës, mirëpo, pikërisht te nënfusha e fundit, sipas procesit të punës, bëhet ndërshkallëzimi më i hollësishëm i profilizimit, profilizim ky për të cilin po tërhiqet vëmendja këtu.

Gjithsesi kjo dukuri e emërtimeve me të cilët po ballafaqohet shoqëria për ditë e më shumë ia vlen të ndiqet edhe nga gjuhëtarët, ngase të gjitha rastet është e pamundur të shënohen në doracakët e emërtesave përkatëse e jo më në fjalorët e përgjithshëm normativë, prandaj njohja e rregullave dhe e modeleve fjalëformuese ka rëndësi të madhe. Siç dihet në përdorim të brendshëm në thjeshtligjërime mjafton vetëm të cekurite emërtimit bazë strumbullar, ndërsa në organika (sistematizimet e vendeve të punës) emërtimi tekstualisht duhet të ketë përkufizim të plotë

Si përfundim, siç po shihet edhe nga shembujt konkretë ndërtimisht kemi të bëjmë me emra të përbërë, pothuajse të barabartë si barasvlerës me emërtimet togfjalësha, të cilët kuptimisht janë të plotë shprehimisht, andaj njohja me skemën e sipërshënuar së paku në parim si dhe me tërë lëndën e shtruar në këtë punim besoj se do të ndihmojë të interesuarit për të zgjidhur problemet e caktuara ose të orientohen më lehtë në rrugën drejt zgjidhjeve përkatëse.

Të vihet re se 7 pikat e para, nga skema 1-7, kemi të bëjmë me emërtimin e një mjeti konkret të punës: vegël, ëmbëlsirë, çaj, metal, mish, lëkurë – prandaj emërtimi i njeriut sipas profilimit të ngushtë del zakonisht si emër kompozitë, ndërsa te shembujt e katër pikave të fundit, 8-11, që kemi të bëjmë me veprimtari të njeriut sipas procesit të punës, të bariut, të ngrohësit, këmbyesit, mësuesit – emërtimi i njeriut sipas profilit të ngushtë të profesionit del zakonisht si emërtim togfjalësh.

Kreu VII

VËZHGIMET QENËSORE MBI EMËRTIMET E NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT NË GJUHËN SHQIPE DHE REZULTATET PËRMBYLLËSE

Nga shtjellimi që iu bë temës "Struktura fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe", sipas krerëve përkatës, mund të nxjerrim konstatimet a konkluzionet përmbyllëse me interes. Duke ritheksuar përfundimet e përgjithshme sipas krerëve përkatës në këtë pëmbyllje, domosdo do të ripërmendim edhe ndonjë arritje të veçantë (ndonjë sirisim) që del nga analiza e punës sonë dhe që na duket me interes.

I

Nga zbërthimi që iu bë termit *profesion*, përkatësisht togfjalëshit "*njeriu sipas profesionit*", doli si përfundim se fjalë-termi **profesion** si fjalë ndërkombëtare me cilësinë e ndërkombëtarizmit, pothuajse në të gjitha gjuhët, ka kuptimin "veprimtari kryesore (pune e mjeshtëri) me të cilën merret njeriu për të siguruar jetesën dhe për t'i dhënë shoqërisë", qoftë në fushën e prodhimit material, qoftë në fushë të kulturës, shkencës etj. Kjo fjalë në gjuhë të ndryshme mund të ketë pësuar zgjerim a ngushtim kuptimi, mirëpo koncepti i sipërcekur mbetet gjithsesi si kuptim themelor.

Në gjuhën tonë letrare krahas termit **profesion** përdoren edhe barasvlerës të tjerë sinonimikë, si p.sh.: mjeshtëri, zanat, zeje; degë profesionale; përgatitje shkollore (profesionale), titull a gradë (shkencore, akademike) e kuadrit përkatës; punë e detyra etj., mirëpo nga këto sinonime asnjëri nuk mundi ta zëvendësojë plotësisht fjalëtermin *profesion*, i cili del mjaft i përgjithësuar si në gjuhë të tjera, ashtu edhe në gjuhën tonë.

Edhe rreth emërtimeve togfjalësh "*emërtimi i njeriu sipas profesionit*": dalin sinonimet si: njeriu sipas mjeshtërisë, njeriu sipas degës profesionale, emërtimi njeriu sipas titullit, gradës a rangimit kielarkik, njeriu sipas përgatitjes shkollore (kualifikuese) etj., cilësime këto që i ka fituar a i fiton njeriu në shoqëri, ushtri, ndërmarrje (institutacion) etj., përkatësisht emërtime që i mbart personi sipas vendit të punës (organikës), punëve dhe detyrave që i kryen a do t'i kryejë etj., por edhe këto, pos në rrethana të caktuara nuk mund ta zëvendësojnë togfjalëshin "emërtimi i njeriut sipas profesionit". Shpesh në vend të *emrit të njeriut sipas profesionit a veprimtarisë* përdoren disa emra hiperonimë si p.sh.: punëtor, punonjës, kuadro, nëpunës, personel, ushtarak, shtetar etj.- që në të vërtetë ngërthejnë në vete emërtime të specializuara të profilizimit të gjerë, por edhe këta s'mund të zëvendësojnë plotësisht termin *profesion sipas*

profilimit të ngushtë, përkatësisht emërtimi i njeriu sipas profesionit. Fundja, për temën në shqyrtim në traditën shkrimore të shqipes është parapëlqyer termi togfjalësh "*emërtimi i njeriu sipas profesionit*", andaj kështu u veprua edhe në këtë punim, qoftë me kuptim të ngushtë, qoftë me kuptim të gjerë (sipas grupit, llojit, nënlojit, bashkënjësisë a profilimit të caktuar).

Sipas kuptimit të ngushtë me "emërtim të njeriut sipas profesionit" kuptojmë kryesisht nomenklaturën që përdoret në prodhim të drejtpërdrejtë, por edhe në shërbime jo prodhuese, por që personat e caktuar janë aftësuar a kanë kualifikimin përkatës profesional, kurse sipas kuptimit të gjerë me termin "njeriu sipas profesionit" kuptojmë çdo njeri që kryen ose mund të kryejë punë a veprimtari, qoftë në prodhim të drejtpërdrejtë ose jo, por që një punë a veprimtari e tillë i sjell ose do t'i sjellë të emërtuarit të mira materiale ose shpërblim moral.

Çështja e emërtimit të njerëzve sipas profesionit është një çështje mjaft e ndërlikuar. Nuk i përket vetëm jetës private as nuk është edhe vetëm si çështje e shkollës. Me të ballafaqohen organizatat prodhuese dhe të gjitha institucionet, madje ajo është çështje e shoqërisë në kuptim të gjerë, por edhe e bashkësisë kombëtare e shtetërore në veçanti. Emërtimet e njerëzve sipas profesionit i kalojnë, pra, caqet kombëtare e shtetërore, duke u paraqitur domosdo edhe si çështje me përmasa globale ndërkombëtare.

Sidoqoftë, ne në këtë punim e shohim edhe si çështje gjuhësore, ngase në gjuhën tonë problem në vetvete nuk paraqet vetëm çështja e vjeljes, njohjes dhe e përvetësimit të emërtimeve të caktuara, qoftë nga tradita, qoftë nga përditshmëria jonë sipas degëve ekonomike (industriale) dhe sipas degëve të administratës e të kulturës etj., por shtrohet detyrë e ngutshme para organeve dhe organizmave kompetente që të bëhet edhe konsolidimi dhe harmonizimi i emërtimeve të kësaj nënfushe semantike, jo vetëm brenda qendrave tashmë të njohura universitare, por edhe në kuadër të terminologjisë unike të mbarë truallit shqipfolës. Del e nevojshme që zgjidhjet e caktuara të propozuara nga organizmat përkatës duhet të botohen si doracakë dhe pas diskutimeve dhe harmonizimit të nevojshëm duhet të dekretohen, përkatësisht të sanksionohen edhe me akte ligjore si emërtime unike të profesioneve që do të respektoheshin domosdo nga të gjitha organet e organizmat përkatëse në të gjitha viset shqipfolëse. Gjithsesi edhe në gjuhën tonë, sikurse bëhet në gjuhët e shteteve të zhvilluara, duhet të aplikohet sistemi i shifrimit të profesioneve në harmoni me emërtimet e profesioneve në plan ndërkombëtar. Pra krahas përkufizimit me fjalë duhet të aplikohet sa më parë, shifra përkatëse shoqëruese e tekstit, e cila duhet të jetë e harmonizuar me gjuhë të tjera të zhvilluara sipas kërkesave bashkëkohore universale.

II

Rreth vështrimit kronologjik të formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe mund të jepen këto konstatime:

E para, emërtimet e njerëzve të natyrës në shqyrtim jo vetëm si huazime, por edhe si formime nga burimi i shqipes dokumentohen që nga periudha para shkrimore të gjuhës sonë, siç janë emërvendet: Lopës (Lopar), Kudhës, Lëkurës, Pëllumbar, Dard(h)an,

Shpatar etj., pastaj po ky fakt dëshmohej edhe nga modelet fjalëformuese që ndeshim në numër mjaft bindës që në veprën e parë të Gj. Buzukut, te Fjalori i Frang Bardhit etj. si dhe në burime të caktuara folklorike të periudhës së vjetër, siç janë shembujt: gojëtar, luftëtar, furrëtar; krijues, shpëtues, shkruer; shitës, lutës, përrallës etj. - modele këto të gjalla edhe sot e kësaj dite.

E dyta, ndonëse në fazën vijuese të etapës para Rilindjes Kombëtare në shkrimet e dokumentuara shihet një shumim i fjalëve të huaja me cilësinë e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë, megjithatë përdorimi i emrave të vepruesit me prapashtesat e mirëfillta të gjuhës sonë nuk ndërpritet. Gjithandej vazhdojnë të përdoren, prapashtesat speciale -S (sipas varianteve: -UE/S, -ONJ/ËS, Ë/S)), -TAR, -AR etj., si p.sh: mëkëmbës, gjahtar, kujdestar, përgjonjës, mësues, kullotës, folës, detar etj.

Edhe pse administrata shtetërore zhvillohej në gjuhë të huaj (zakonisht turqisht), megjithatë disa funksione shoqërore e komunikime bëheshin në gjuhën e popullit. Të kujtojmë kuvendet e pleqve, ritet e zakonet e caktuara të traditës, por edhe ligjërimet në shërbesat fetare etj., elemente këto që ndeshen paksa edhe në shkrimet e vjetra të gjuhës sonë, por që nëpërmjet tyre ruheshin e ripërtërisheshin edhe mjaft emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë së tyre në gjuhën e popullit. Me fjalë të tjera gjuha shqipe vazhdonte traditën e saj edhe në fushën e emërtimeve të profesioneve a të veprimtarisë.

E treta, në etapën e Rilindjes Kombëtare kemi rilindje e përlindje të vërtetë edhe sa u përket formave të fjalëformimit dhe të formëzimit. Në këtë etapë kemi njëfarë rikthimi me vetëdije në formimin e fjalëve mbi bazë të brumit të shqipes ose të formave të përvetësuara më përpara ose që me kalkëzim nga gjuhët e huaja, por shihet njëfarë animi drejt gjuhëve perëndimore. Fjalët e huaja tashti nuk janë të favorizuara, sidomos turqizmat, ndonëse ndikimi i administratës shtetërore si administratë e huaj ende ishte i paevitueshëm, siç ishin edhe emrat e profesioneve me prapashtesën -XHI. Tani në këtë etapë tek emrat e vepruesit (njeriut sipas profesionit) në përgjithësi mbi temë foljore mbizotëron prapashtesa -s (-ues,-yes,-ës, -onjës), ndërsa mbi temë emërore prapashtesa -tar, -ar, -tor etj., rikujto emrat: matës, adhurues, shkronjës; gjuhëtar, mishtar, kërkimtar, punëtor etj. Dolën në pah edhe disa trajta dialektore e të tjera, nga të cilat jo të gjitha u pranuan në shqipen letrare të etapave të pastajme.

E katërta, në etapën ndërmjet dy luftërave botërore vazhdohet rruga e rilindësve dhe mbështetja në gjuhën e popullit sa i përket modelit fjalëformues të trashëguar, siç u përmend më sipër, mirëpo tashti rezistenca ndaj emërtimeve të huazuar nga gjuhët evropiane nuk del aq e fortë. Madje kah fundi i kësaj etape shihet njëfarë shtrirjeje e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit me prapashtesën **-ist, -tor**, të cilat ç'është e vërteta, pothuajse ishin huazim tranfer ose ishin "kopjim" i formave nga gjuha italiane e të tjera. Në këtë etapë dallohen emërtimet më -AN të formuara mbi dërkombëtarizmat me -IK(Ë) fundore si dhe të atyre më -I fundore të tipave: matematikan, historian etj

E pesta, në fazën e parë të periudhës pas Luftës II Botërore u krijuan kushte të reja, të cilat në një farë mënyre frenuan përhapjen e pakontrolluar të terminologjisë së huaj

perëndimore, por nuk mund ta ndalnin dot atë. Edhe në fazën e parë të etapës së parë që u quajt etapa e konsolidimit të terminologjisë në të ashtuquajturën "gjuhë e sotme letrare shqipe", d.m.th. letrarishtja e mbështetur në ish-shqipen letrare mbi bazë të toskërishtes, vazhduan të përdoren dhe të konsolidohen mjaft emra me origjinë italiane me fundorin -TOR (-ATOR) të tipit: murator, frezator, axhustator, tornitor; me prapashtesën -IER të tipit: infermier, pastičier, boksier etj. Kjo etapë karakterizohet me marrjen nën vështrim të terminologjisë përkatëse nga komisionet e caktuara gjuhësore që, për nga organizimi dhe cilësia, nuk ishte aq veçori e etapave të mëparshme. Si rezultat i një mbikqyrjeje të tillë çështja e terminologjisë, madje edhe e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit pothuajse u vu në binarë paksa më normale se asnjëherë më parë. Edhe pse vazhdon ende procesi i huazimeve, po tashti ai bëhej më në mënyrë profesionale se përpara. Gjithsesi vazhdonte përfitimi a favorizimi i emërtimeve të caktuara në mbështetje të modeleve fjalëformuese të vetë shqipes. Tashmë çështja e emërtimeve nga çështje individuale e personave të caktuar, në Shqipëri, u bë çështje shoqërore a çështje e grup-ekspertëve kompetentë të organizuar në rrafshin shtetëror e së këtejmi edhe kombëtar.

Nga fundi i viteve `70 dhe fillimi i viteve `80 fillon edhe etapë e re në gjuhësinë shqiptare në përgjithësi, por edhe për emërtimet e njerëzve sipas profesionit në veçanti. Tashti fillon etapa e normëzimit të gjuhës së njësuar letrare që filloi të quhet "gjuha e njësuar letrare kombëtare".

Kjo është etapa e jetësimit të normës të përbashkët letrare, njëherazi mund të quhet

etapë e re edhe sa i përket sendërtimit të trajtave dhe të mënyrave fjalëformimit.

Lidhur me këtë po e përmend vetëm një shembull sa për ilustrim nga emërtimet e njerëzve sipas profesionit. Për fjalën **gëzof**, si emërtim profesioni më përpara në popull

si sinonim i fjalës turke qyrk: qyrkçi a qyrkaxhi në shqipe doli kalku gëzofçi e më pastaj gëzofitar (FGJSH 1954), kurse në FGJSSH nuk i ndeshim të regjistruara trajtat e

vjetra a vjetëruara: qyrkçi qyrkaxhi gëzofçi, por vetëm **gëzofitar** si trajtë e normëzuar

për konceptin "tregtar gëzofash" si dhe **gëzofpunues** për konceptin "punues i gëzofave", term ky që i përgjigjet plotësisht zejes së profilizuar. Së këtejmi në Fjalorin e shqipes së sotme (1984të) del i shënuar vetëm emërtimi **gëzofpunues**. Kështu pra gjedhja tipike "gëzofpunues" si emërtim i profilizuar dhe mbizotërimi i plotë i emërtimeve më -UE/S ndaj -ONJ/ËS, del si zgjidhja më e mirë dhe e përshtatshme bashkëkohore e gjuhës së përbashkët shqipe.

Në rrafshin paradigmatic shembuj si ky ka mjaft sa që kjo prirje ka kaluar si modeli më i kapshëm dhe i favorizuar për emërtimet e profileve të profesioneve të caktuara

Nga gjysma e parë e viteve `80 deri në ditët e sotme emërtimet e njerëzve sipas profesionit i hasim edhe në fjalorë të fushave të ndryshme specialistike të degëve

të ekonomisë dhe të degëve të tjera të dijës, pra edhe të degëve prodhuese si dhe të ashtuquajturave degë joprodhuese. Në kohën tonë emërtimi i profesioneve paraqitet gjithnjë si çështje e hapur, jo vetëm në pikëpamje të përzgjedhjes së trajtave të caktuara formëzuese, por edhe kur është fjala te konkurrenca me ekuivalencat me trajtën e caktuar sinonimike, qoftë të huazuar nga gjuha e huaj, qoftë nga trajtat e caktuara të burimit vendës. Gjithashtu konkurrencë zhvillohet edhe brenda elementeve fjalëformuese prapashtesore, por edhe në kuadër të mënyrave të caktuara emërformuese edhe të burimit vendës. Ç`është e vërteta, disa nga çështjet e hapura nga kjo nënfushë semantike nga aspekti formëzues e fjalëformues janë bërë objekt më i hollësishëm shqyrtimi në krerët e nënkrerët e veçantë në vazhdim të këtij punimi.

III

Me formëzimin e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit kuptojmë si krijimet autoktone ashtu edhe huazimet e përvetësuara, të cilat ishin ose janë emra aktivë në leksikun e sotëm të gjuhës sonë. Ç`është e vërteta, emri i vepruesit vetëm kur merr tipar profesioni mund të cilësohet si emërtim i mirëfilltë i njeriut sipas profesionit. Ky formëzim i emrave të vepruesit në emra të njëriut sipas profesionit, që u pa nga dy rrugët e sapocekura, paraqitet mjaft kompleks, pasi edhe krijimet autoktone ndikohen nga elemente të gjuhëve të tjera, por edhe huazimet nga gjuhët e huaja, marrin elemente të gjuhës vendëse. Si emër vendës u quajt edhe ndonjë emërtim, i cili vetëm nga etimologjia mund të shpjegohet si fjalë e huazuar, ashtu u quajt edhe ndonjë emërtim tjetër i krijuar me elemente të gjuhëve të huaja, por plotësisht të përvetësuara nga gjuha e jonë, krijime këto karakteristike, siç janë rastet: *mbret, prift, mjek* etj. Në këtë punim fjalë a terma ndërkombëtarë u quajtën të gjithë emrat e huazuar të këtij nëntipi, të cilët u ndanë në dy grupe: në emra me cilësi ndërkombëtarizmi dhe në emra të huazuar pa cilësi ndërkombëtarizmi. Në të vërtetë, këtu bëhet dallimi i kuptimeve të termave: fjalë e huaj, fjalë e huazuar, fjalë ndërkombëtare dhe ndërkombëtarizëm.

Vend i posaçëm iu dha trajtimit të emrave në shqyrtim sipas tipave kuptimorë. Veçan u trajtuan tipat mbi bazë: *sipas procesit të punës, sipas lëndës a objektit të punës, sipas produktit të punës, sipas mjetit të punës, sipas lokalit a vendit të punës dhe sipas degëve a veprimtarive shoqërore - ekonomike*. Për secilin tip u dhanë karakteristikat përkatëse dhe u vunë në pah mënyrat e fjalëformimit, përkatësisht u vu në dukje zberthimi perifrastik si dhe temat fjalëformuese dhe prapashtesat speciale. Nga skema e paraqitur dolën konstatime me interes. Si p.sh. vetëm te tipi kuptimor sipas veprimtarisë shoqërore-ekonomike dalin edhe emra të parmë (me prapashtesë zero), sepse, ç`është e drejta, pothuajse të gjithë emrat në shqyrtim janë emra të prejardhur me prapashtesim. Emra të parmë të kësaj kategorie ka pak, ndërsa emra të përbërë e togfjalësha ka shumë si emërtime të njerëzve sipas profesionit. Tek të gjitha nënfushat semantike del e përdorur prapashtesa -TAR, por ajo nuk del më favorizuar gjithkund. Kjo doli më qartë në analizën në vazhdim, ku më në hollësi u analizua formëzimi a fjalëformimi i emrave të

njerëzve sipas profesionit, qoftë si emra të prejardhur me temë foljore, qoftë me temë emërore duke theksuar prapashtesat përkatëse edhe ato speciale, por pa harruar as emërtimet jonjëfjalëshe të formëzuar nga shtytës të jashtëm, d.m.th. mbi emërtimet me gërshetim profesioni si dhe ato perifrastike.

A) Për të dalë punimi më i plotë lidhur me emrat me temë foljore u morën në trajtim të gjithë tipat e nëntipat e foljeve. Po ritheksoj faktin se formimi i emrave të vepruesit mbi temën foljore në asnjë burim të deritashëm, me sa di unë, nuk është trajtuar me kaq hollësi si në këtë punim. Është e vërtetë së pothujase të gjithë emrat e vepruesit me temë foljore marrin prapashtesën -S (me variantet: -UE/S, -ONJ/ËS, Ë/S) pos disa rasteveve që marrin prapashtesën -TAR. Në këtë punim të gjitha foljet u përfshinë në katër grupe:

1. Foljet me temë zanore dhe grupzanor (10 tipa);
2. Folet vokalike me mbaresë zero;
3. Foljet e parregullta (supletive e josupletive);
4. Foljet me temë në bashkëtingëllore (pa cilësinë e prapashtesë dhe me formant fundor me cilësinë e prapashtesës së mëvetësishme).

Nga lënda e shtruar rezulton se formimet mbi të tashmën e dëftores që ndeshen në burime të caktuara në të kaluarën në letrarishten e sotme letrare nuk janë më aktive dhe as prodhimtare. Aktive dhe prodhimtare janë formimet mbi **pjesoren e foljes së caktuar**, mirëpo ky proces paraqitet jo fort i thjeshtë, ngase disa emra, varësisht prej tipave të foljeve, formohen **mbi bazë të pjesores (trajta e shkurtër) të ish-gegërishtes letrare**, kurse disa të tjerë formohen **mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme**. Pikërisht këtë proces nuk e kemi të sqaruar sa duhet në asnjërin nga burimet e deritashme normative. Edhe pse ndonjë rast ende ka mbetur në fazën e konsolidimit, mendoj se konstatimet e mëposhtme janë të qëndrueshme. Së pari mbi pjesoren e shkurtër të gegërishtes formohen emrat e vepruesit të këtyre tipave dhe nëntipave të foljeve:

- a) nga foljet me temë në zanore dhe togzanor si: foljet më-OJ (tërësisht): mësoj mësoes, mbroj mbrojtës; foljet më -EJ (tërësisht përveç nëntipit që e bëjnë pjesoren me prapashtesën -RË) si p.sh.: shpërblej shpërbljes; vërej verëjtës; mbrej mbrehës; foljet më -UAJ (pos një grupi të vogël ende të pakonsoliduar) si p.sh.: shkruaj shkrues; ruaj ruajtës; foljet më -UJ (tërësisht): buj bujtës dhe foljet më -IJ (pjesërisht vetëm grupi që e bën pjesoren më -(T-): arrij arritës.
- b) Nga foljet me temë në bashkëtingëllore (tërësisht), p.sh.: qeveris qeverisës; pyes pyetës; hekuros hekurosës; radhit radhitës.

Së dyti, mbi pjesoren e letrarishtes së sotme formohen emrat e vepruesit të këta tipa e nëntipa foljesh:

- a) Nga foljet më -RË në pjesore: foljet -ËJ (tërësisht): bëj bërës; foljet më -IJ (pjesërisht): fshi fshirës më -YJ (tërësisht): fryj fryrës; foljet më -AJ (tërësisht pa foljen mbaj): laj larës; foljet më -EJ (pjesërisht): blej blerës.
- b) Nga foljet me togzanor që e bëjnë pjesoren më -R: foljet më -IEJ (tërësisht): ziej

zierës; më -YEJ (tërësisht): kryej kryerës;më - UAJ (pjesërisht), p. sh.: shuaj shuarës.

c) Nga foljet vokalike me mbaresë zanore (pa foljen ngre dhe di), p.sh.: pi pirës; vë vënës; zë zënës; nxë nxënës.

ç) Nga foljet e parregullta (supletive dhe josupletive), p.sh.: shoh pamës (parës(!)); bie rënës; jap dhënës; bie prurës;them thënës; lë lënës; jam qenës(!) Bëjnë përjashtim foljet vij (me ardhë), rri (me ndejë (ndenjuri), kam (me pasë) së ketejmi edhe emrat e veprimit dhe ata të vepruesit dalin: ardhje ardhës, ndenjë ndënjës, pasje (kamje) pasës (kamës).

d) Nga foljet apofonike, ku pjesorja e letrarishtes së sotme përkon me pjesoren e ish-shqipës letrare mbi bazë të gegërishtes, p. sh.: sjell sjellës; tjerr tjerës.

Ç`është e vërteta, ende kanë mbetur të pakonsoliduara d isa raste ose që kërkojnë sqarim si p.sh.:

a. Disa raste nga foljet e nëntipit shuaj që emri i vepruesit mund të dalë dy trajtash: shues dhe shuarës, kryej: kryes dhe kryerës etj. Gjithsesi kur kemi parasysh trajtën e konsoliduar të emrit të veprimit si dhe autoritetin e trajtave të pjesores së letrarishtes së sotme, më tepër ka gjasa të përgjithësohet trajtat përkatëse: shuarës, kryerës e kështu me radhë.

b. Edhe emrat e vepruesit vrasës, ngasës, gërgasës që ndiqen nga emrat e veprimit si ngasje, vrasje, gërgasje (gërgasë) që në këtë trajtë janë sanksionuar në normën e sotme letrare që po goditen jo rrallë nga formimet nga pjesorja e letrarishtes së sotme: vrasës vrasje, ngarës ngarje, gërgarës gërgarje, mund të interpretohen edhe nga pjesorja e ish gegërishtes letrare me dyfishim prapashtese, edhe pse ekziston interpretimi tjetër se janë përfutur mbi bazë të vetës së parë njëjës të dëftores.

Gjithsesi qëndrueshmëria e trajtave të tilla si dhe e trajtave të reja nga të cilat po goditen vlen të ndiqet.

B) Tek emërtimet mbi bazë emërore dalin këto prapashtesa më të përdorura: -TAR, -AR, -S, -AN, -TOR dhe -OR me origjinë vendi si dhe -XHI, -IST -IER e -ER, mbi fjalë-tema me origjinë të huaj. Si formante prapashtesore a fundorë dalin në përdorim bashkë me fjalët e huazuara edhe këta formantë si p.sh. -ANT, -ENT, -CI/EN etj.

Tek emrat e tillë nuk del kontestuese çështja e ndërtimit, por del çështja e favorizimit të formantit të caktuar, sidomos kur kemi të bëjmë për konceptin e njëjtë leksikor.

Numri i formimeve më prapashtesat e caktuara si dhe prirja e shumimit apo e stagnimit të emërtimeve me prapashtesat e caktuara shihet më qartë në "Tabelën" e prezentuar në këtë punim sipas fjalorëve përkatës si dhe sqarimet që janë dhënë lidhur me të.

Nga pasqyra e paraqitur në këtë punim shihet se numri i emërtimeve me temë foljore me prapashtesën -S është pesëfishuar, përkatësisht gjashtëfishuar në

krahasim me FGJSSH 1954. Kjo dëshmon se emrat e formuar mbi temën foljore, d.m.th. mbi pjesoren e foljeve përkatëse janë aktivë dhe prodhimtarë në gjuhën e sotme letrare shqipe. Në FSHS (1984) si numri ashtu edhe përqindja shënojnë rritje edhe më të madhe. Mirëpo rritje shënojnë edhe formimet me prapashtesat përkatëse mbi temë emërore. Po e rikujtojmë disa të dhëna nga tabela e numrit të emrave sipas prapashtesave aktive në FGJSH ndaj FGJSSH-së.

Nga emrat e formuar mbi temën emërore shumim kemi te tipi i emrave të formuar me prapashtesën -TAR. Me këtë prapashtesë në FGJSH 1954 ndeshëm të regjistruar 37 shembuj, kurse në FGJSSH 1980 88 sosh, që do të thotë 51 më shumë. Shumim kemi edhe te emrat me prapashtesën a fundorin -IST. Në FGJSSH hasëm 46 shembuj më shumë se sa ishin në FGJSH. Edhe lidhur me formimet me -IER/-ER kemi shumim të konsiderueshëm, në FGJSH ishin 10 shembuj, kurse në FGJSSH 20.

Formimet me prapashtesat e tjera janë pothuajse të nivelizuara për nga numri, ndërsa sa i përket përqindjes numri i tyre madje shënon rënie. Sa për ilustrim po rikujtojmë të dhënat nga tabela e sipërshënuar.

Sa i përket përqindjes emrat me -AR nga 18% zbresin në 8%, ata me -TOR nga 12% në 5%, me -OR nga 4% në 3%, kurse në krahasim me përqindjen në FSHSK 1981 zbresin në 1%. Përqindja e emrave me XHI nga 17% sa ishte në FGJSH në FGJSSH zbrit në 7%. Sipas numrit e përqindjes në FSHS (1984) shënohet rritje e numrit të emërtimeve me prapashtesën -AR, por përqindja mbetet vetëm 9%, emrat më -TOR dhe -OR shënojnë rënie edhe sa i përket numrit edhe sa i përket përqindjes, kështu që numri i tyre përkatësisht 13, 6 ose 2 e 1 përqind, po ashtu edhe emrat më -XHI zbresin në vetëm 4% nga numri i përgjithshëm i emërtimeve në shqyrtim, numri i tyre i regjistruar mbetet i njëjtë 29 shembuj.

Me fjalë të tjera si prapashtesa aktive të specifikuar në formimin e emrave të vepruesit në shqipen letrare kombëtare të butimit vendës janë: -S zakonisht mbi temë foljore dhe -TAR mbi temë emërore kryesisht.

C) Numrin më të madh të profesioneve të profilizuara e përbëjnë emërtimet jo njëfjalëshe të njerëzve sipas profesionit, d.m.th. emërtimet me dyfishim a me gërshetim profesionesh, si p.sh.: lektor-përkthyes, arkeolog-kustos etj si dhe emërtimet togfjalësha, si p.sh: montues i pajisjeve ngrohëse, përkthyes i gjuhës shqipe, lektor i gjuhës serbe, profesor i gjuhës angleze etj. Emërtimet e tilla sa i përketë vërtetësisë me tepër paraqesin çështje logjike, kuptimore se sa çështje të strukturës fjalëformuese e formëzuese.

Është e vërtetë se në nomenklaturën e profesioneve, në fjalorë etj. emërtimet e tilla qoftë njëfjalësh, qoftë me dyfishim, qoftë si togfjalësha dalin zakonisht në gjinë përfaqësuese mashkullore, por ka raste që dalin edhe në gjininë përfaqësuese femërore.

Në emërtimet e grave sipas profesionit si emra të prejardhur më aktive janë prapashtesat femërorizuese -E dhe -ESHË. Karakteristike del edhe prapashtesa -ATORE. Prapashtesa -E dhe ajo -ESHË në raste të caktuara i konkurrojnë njëra tjetrës, siç janë shembujt: doktore doktoreshë, edukatore edukatoreshë, ministre ministreshë etj.

V

Gjatë vështrimit të emërtimeve në shqyrtim nga aspekti i formës dhe kuptimit doli rezultati se veç konkrrencës që kanë emërtimet e caktuara në fushën e sinonimisë, antonimisë dhe homonimisë, doli edhe rezultatet përkatëse.

VI

Dukuria e specifikimit dhe e stabilizimit të kuptimeve të emërtimeve të caktuara sipas ndarjes emërtime pa profilizim të ngushtë (hiperonime) ndaj emërtim i profilizimit të ngushtë (hiponime) tipi: gëzofar ndaj gëzofpunues, gëzofshitës, gëzofarnues etj., ku emrat me temë emërore, si me thënë, bashkëjetojnë me emrat me temë foljore a kompozita me siprapashtesim, të cilët janë më aktivët dhe prodhintarët në kohën e sotme, sidomos kur bëhet përcaktimi më i hollësishëm i emërtimeve të njerëzve sipas profesionit me profilizim të ngushtë.

Gjithsesi pothuaj se krejt punimi përshkohet nga me të veçanta ose me risime që nuk i ndeshim të trajtuara në këtë mënyrë në burime të tjera të kësaj natyre, por njëherazi kanë mbetur edhe mjaft çështje sadopak të prekura, por jot ë zgjidhura, të cilat kërkojnë trajtimin e duhur nga standeologët e studiuesit tanë.

Përfundim

Me rastin e trajtimit të "Strukturës së formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit" patëm parasysh:

Së pari, emërtesat e profesioneve të cilat u vështruan në përfaqje jo vetëm brendakombëtare e meshtetërore, por edhe në raporte ndërkombëtare, sidomos kur është fjala për kualifikimet zyrtare, shkollore e profesionale të karakterit universal, siç janë edhe titujt e gradat shkencore. Lidhur me këtë rreth emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe mund të bëhet ndonjë vërejtje, por në parim sa i përket klasifikimit në grupe, lloje, nënloje, bashkënjësi, duke kaluar edhe në profilizime nuk mund dhe nuk duhet bërë vërejtje. Po ashtu duhet përshtatur edhe kategorizimet në plan kombëtar e ndërkombëtar, siç janë edhe emërtimet sipas profilizimit: emërtimet e profesioneve sipas profilit "të ngushtë" dhe emërtimet e profesioneve sipas profilit "të gjerë" që mund të jenë në numër të pakufizuar. Përveç ndarjes së profesioneve sipas profileve të caktuara bëhet edhe klasifikimi sipas kualifikimit shkollor profesional që varësisht nga ndërlikueshmëria ndahet në tetë, përkatësisht dhjetë shkallë. Secila shkallë përfshin numër të pakufizuar emërtimeve, por gjithsesi numër më të madh kanë shkallët e ulëta ndaj niveleve të larta. Krahas përkufizimit me fjalë të emërtimeve të caktuar lypset praktikuar edhe shifrimin e profesioneve në përputhje me praktikën evropiane e botërore.

Së dyti, formëzimet nga tradita, si ato të huazuara, ashtu edhe krijimet autoktone përveç se duhen njohur sa më mirë ato u vunë në dukje dhe u shfrytëzuan, jo vetëm sa për të fituar njohuri historike - shkencore përgjithësisht, por edhe për nevoja të ditës. Ç'është e drejta, jo i tërë thesari i traditës është i përdorshëm sot, madje edhe në kuadër të fondit aktiv të fjalësit të gjuhës shqipe lypset dalluar trajtat e specializuara nga trajtat e rastësishme. Në punim u dalluan tipat e nëntipat e caktuar aktivë e prodhimtarë të emrave duke pasur parasysh ligjësitë dhe prirjet fjalëformuese të kohës sonë. Ndodhë nganjëherë se më lehtë është të krijohet një emër i ri që përputhet me modelin, sesa të ruhet qëndrueshmëria e një trajtë emërore nga tradita, e formuar me mjete e mënyrë që tashmë duken arkaike. P.sh në diasporë (te arbëreshët e Italisë) ndeshet emri delmer (bari delesh a dhenruajtës), te A. Santori qerras (qerrtar a qerrepuues) te DH. Todri shëres(ës) etj., por meqenëse në letrarishtem e sotme prapashtesat a formantët -ER, -AS, -ES për emërtimet e njerëzve sipas profesionit nuk përdoren më as për raste, ngase dalin të specializuara a të ngarkuara për nënfusha të tjera semantike, trajtat e tilla nuk kanë shans të ripërdoren ose të përkrahen.

Së treti, gjatë analizës së hollësishme formëzimi dhe formimi i emrave të njeriut u vështruan jo vetëm në rrafshin diakronik, por edhe në rrafshin sinkronik. Në këtë kuadër u bë dallimi brenda klasës së emrave të vepruesit, që tregojnë njeriun sipas

cilësisë a përkatësisë partiake a doktrinare, sipas cilësisë a veprimtarisë shoqërore etj. edhe sipas punëve e detyrave që kryen, mund të kryejë apo është i aftësuar a do të aftësohet për t'i kryerë.

Nga analiza fjalëformuese që iu bë emrave të vepruesit (emërtimeve të njerëzve sipas profesionit) rezulton fakti se tek emrat e prejardhur nuk favorizohet çdo prapashtesë nga tradita, madje as ato të rastësishmet të kohës sonë, por vetëm ato që janë aktive dhe prodhimtare, të cilat, si të thuash, dalin të specializuara për tipin a nëntipin e caktuar të emrave përkatës. P.sh. prapashtesa -S del e specializuar për emërtimet e njerëzve sipas tipit kuptimor mbi bazë të procesit të punës, pra mbi bazë të një teme fjalëformuese foljore zakonisht të trajtës së pjesores, prandaj edhe emrat e tillë quhen përkatësisht **emra prejfoljorë** a **emra prejpjesorë**. Prapashtesa -S përdoret, por më pak edhe mbi fjalë-tema emërore, ku dalin të angazhuara edhe mjaft prapashtesa të tjera. Ndër to si më aktive në shqipe janë, prapashtesa -TAR, ajo -AR, -AN, por jo prapashtesat e tjera si -AS, -ES, -OR, -TOR, etj. kurse fjalët e huazuara zakonisht, në mos qofshin të huazuara bashkë me formantin përkatës marrin këto prapashtesa të huazuara: -XHI, -IST, -IER (-ER), etj.

Në mënyrë të veçantë u vlerësua formimi i emrave të përbërë (kompozitat) në cilësinë e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë. Këtu dallohen vetëm dy tipa të kompozitave:

a) tipi i parë, ku gjymtyra e parë shërben si prefiksiod (siparashtesë) ndaj gjymtyrës së dytë, e cila edhe emërton njeriun sipas profesionit, p.sh. kryeinxhinier, shumëfishues, bashkëpunëtor, nëndrejtor, mbikëqyrës, zëvendësdrejtor etj. dhe

b) tipi i dytë, kur gjymtyra e dytë (emri i vepruesit) pothuajse si një sufiksoid (siprapashtesë) kryen funksionin e një prapashtese speciale, madje në mënyrë edhe më të saktë e me përpikmëri shpreh profilizimin e emërtimit të njeriut sipas punës që kryen p.sh. krahaso: gjellëtar-gjellëbërës, gjellëshpërndarës, gjellëserves; hekurtar - hekurpunues a hekurthyes; jorgantar a jorganxhi - jorganpunues a jorganshitës; mishhtar - mishshitës, mishcoptues etj.

Së katërti, është e vërtetë se në gjuhën shqipe ashtu si edhe në disa gjuhë të tjera ku dallohet qartë gjinia (gramatikore e natyrore) e emrit, emërtimet e njerëzve sipas profesionit rëndomë shënohen në gjininë përfaqësuese mashkullore, por varësisht nga natyra e punëve që kryhen kryesisht a kryekëput nga personat e gjinisë femërore, atëherë ngjan që të bëhen përjashtime dhe emërtimet e caktuara dalin të shënuara në gjininë përfaqësuese femërore. Nga analiza që iu bë kësaj dukurie doli se prapashtesat karakteristike të mirëfillta siç janë -E, -ESHË, -ATORE, edhe pse i konkurrojnë njëra tjerës, megjithatë dalin të mëvetësishme dhe secila ruan mëvetësinë e vet për nënfushën e caktuar semantike a stilistike.

Së pesti, meqenëse procesi i konkurrimit të mjeteve dhe të elementeve e mënyrave fjalëformuese nuk del i plotë vetëm me analizë fjalëformuese (gramatikore morfologjike) doli e nevojshme që ky proces të vështrohet edhe nga analiza leksiko-semantike duke vërejtur në një radhë të parë lidhjet e emrave të tillë për nga kuptimi dhe forma siç janë kategoritë leksikore të sinonimisë, antonimisë dhe ajo e homonimisë. Dhe këtë rast dolën në pah mjaft karakteristika me interes për temën që u trajtua, por edhe u ravijëzua më mirë prirja e gjallë e gjedheve formëzuese e

fjalëformuese që është karakteristike për gjuhën standarde kombëtare sot si dhe perspektivën e saj.

Së gjashti, nga analiza e gjithanshme dolën mjaft rezultate që nuk janë vënë re apo nuk kanë qenë të qarta më përpara, sidomos rreth dallimit ndërtimor e kuptimor të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit pa e me profilizim të ngushtë, mirëpo të gjitha këto përfundime rreth zgjidhjeve dhe prirjeve formëzuese e fjalëformuese do të mbesin pa fryt po s'u bë sendërtimi i tyre në jetë në mënyrë të organizuar.

Sidoqoftë, për jetësimin e tyre nuk mjafton vetëm njohja e ligjësisë, por zbatimi i tyre dhe për këtë qëllim lypset angazhimi i ndërgjegjshëm i të gjitha organeve dhe organizmave kompetente duke përfshirë edhe specialistët e gjuhës dhe ata të institucioneve përkatëse, ashtu edhe faktorët në organizatat e digasteret shoqërore e shtetërore siç janë edhe organet e organizmat në fushën e administratës, të jurisprudencës dhe sidomos të fushës ekonomike (industriale) pa i harruar fare organet e shtypit dhe të mjeteve të tjera të informacionit.

Suksesi do të quhet i plotë për bashkësinë shqipfolëse, vetëm atëherë, kur të botohet një doracak unik (libër i veçantë), së paku të karakterit orientues e pastaj edhe sanksionues me vlerë gjithkombëtare me emërtimet dhe përshkrimet (përcaktimet) e profesioneve bazë, sigurisht ku do të përfshihej numër i konsiderueshëm emërtimeve duke i pasur përballë edhe emërtimet përfaqësuese të profesioneve edhe në ndonjë gjuhë të huaj të shoqëruara edhe me shifrën përkatëse, ashtu siç janë sanksionuar dhe shifruar edhe në gjuhët e zhvilluara evropiane e botërore. Një kurorëzim i tillë po të zbatohet, gjë që shtrohet si detyrë e ngutshme, pa mëdyshje do të zgjidhte shumë çështje të hapura nga kjo fushë. Sigurisht një veprim i tillë me interes shoqëror e kombëtar, kërkon mjete e punë të organizuar ekipore, përkrahje nga organet shtetërore e institucionale. Sidoqoftë, pa një angazhim të tillë nuk do të zgjidhen plotësisht çështjet e kësaj natyre, ngase nuk janë punë të vogla. Duhet të jemi të vetëdijshëm se jeta po shtron dhe do të shtrojë edhe më shumë probleme të kësaj natyre dhe të tjera në të ardhshmen, prandaj edhe bashkësia jonë duhet të përgatitë kuadro për zgjidhjen e tyre.

L I T E R A T U R A

a) Studime të veçanta (përmbledhje punimesh):

1. Ajeti, dr. Idriz, Studime gjuhësore në fushë të shqipes (I, II, III, IV), Redaksia e botimeve të Rilindjes, Prishtinë 1982 - 1989.
2. Bokshi, dr. Besim, Rruga e formimit të flrksionit të sotëm nominal të shqipes, Prishtinë, 1980.
3. Çabej, dr. Eqrem, Studime gjuhësore (I, II, III, IV, V, VI,VII), Prishtinë 1976 - 1988.
4. Bugarski, Ranko, Jezik i lingvistika, Nolit Beograd 1972; Teorija standardnog jezika, Gjuha dhe praktika, nr. 1-2/85, Prishtinë 1985; Lingvistika o _oveku, Beograd 1975.
5. Demiraj, prof. Shaban, Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, Prishtinë 1981; Morfologjia historike e gjuhës shqipe I, II, Prishtinë 1980; Historia e gjuhës së shkruar shqipe, Prishtinë 1970; Gjuha shqipe dhe historia e saj, Prishtinë 1989.
6. Došli_, mr. Mirko, Spskohrvatski jezik, Priština 1978.
7. Dubois, Jean, Etude sur la derivation suffixale en Français moderne et contemporain, Paris 1962.
8. Filipovi_, R., Teorija jezika u kontaktu, Zagreb 1986.
9. Qamiloviç_, dr. Slobodan, Poslovi i organizacija kadrovske funkcije, JZPR, Beograd 1986.
10. Cimohovski, Vasllav, Gjuha shqipe, Prishtinë 1988.
11. Grup autorësh, Pravopis srpskohrvatskog jezika (Skolsko izdanje), Beograd 1966.
12. Grup autorësh, Priru_nik za izradu i pra_enje jedinstvene nomenklature zanimanja u SFRJ, PP, Beograd 1988.
13. Grup autorësh, Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës I, Tiranë 1973.
14. Grup autorësh, Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe (morfologjia), Tiranë 1976.
15. Grup autorësh, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, II, Tiranë 1972.
16. Grup autorësh, Priru_na gramatika hrvatskog jezika, školska knjiga, Zagreb 1979.
17. Grup autorësh, Probleme të historisë së gjuhës shqipe, Prishtinë 1971.
18. Grup autorësh, Çështje të normës letrare, IA, Prishtinë 1980.

19. Grup autorësh, Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe, Prishtinë 1977.
20. Grup autorësh, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë 1974.
21. Grup autorësh, Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976.
22. Grup autorësh, Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, Tiranë 1975.
23. Goçi, Ibrahim, Antonimet e gjuhës së sotme shqipe, IA, Prishtinë 1985.
24. Ivi_, Milka, Drejtime në linguistikë, Prishtinë 1977.
25. Ismajli, dr. Rexhep. Gramatika e parë e gjuhës shqipe, Prishtinë 1982;
Mbi statusin e shqipes standarde në RSFJ, Thema, nr. 10/88, Prishtinë 1988;
Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbërit, Prishtinë 1985; Shumësia e tekstit, Prishtinë 1977.
26. Jovi_ Miomir, Latinski jezik za istori_are, Priština 1985.
27. Islamaj, Shefkije, Çështje të sinonimeve në gjuhën shqipe, IA, Prishtinë 1985.
28. Këlmendi, mr. Ahmet - Hasimja, mr. Mazllum, Gramatika e gjuhës shqipe (Sintaksa) për kl. II të AMO, Prishtinë 1989.
29. Leake, Wiliam Martin, Researches in Greece, London 1814.
30. Mulaku, dr. Latif, "Kuptimi i rasave në shqipen letrare" dhe artikuj të tjerë të botuara në revistën "Përparimi në vitet '60-'70; Përdorimi i emrave me prapashtesën -IM, Përparimi" nr. 11/61; Rreth shkrimit të fjalëve me prapashtesën -S, Jehona nr. 3-4/63, Shkup 1963; Mbi gjuhën e vjershave të Fan Nolit, "përparimi" nr. 10 e 11/62; Formimi i emrave me prapashtesë -SHMËRI, Jehona 5/84; Mbi zhvillimin e gjuhës letrare shqipe gjatë Rilindjes Kombëtare dhe mbi neologjizmat e K.Kristoforidhit, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, nr. 10/85, Prishtinë 1986.
31. Martinet, Andre, Elemente të gjuhësisë së përgjithshme, Prishtinë 1974;
Osнови op_e lingvistike, Zagreb 1982.
32. Pirraku, dr. Muhamet, Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit, Prishtinë, 1989
33. Polovina, Vesna, Jezik, zna_enje i kontekst, _ivi jezici, Beograd 1983.
34. Petan_i_, dr. Martin, Industrijska pedagogija, Školska knjiga, Beograd 1975.
35. Sulejmani, mr. Fadil, Praktikumi i gjuhës së sotme letrare shqipe, Prishtinë 1980; E mbësuar e Krështenë e Lekë Matrëngës, IA, Prishtinë 1979.
36. Stjuart, D_ulijan, Teorija kulturne promene, Beograd 1981.
37. Škiljan, Dubravko, Pogled u lingvistici, Zagreb 1980.
38. Thomai Jani, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Prishtinë 1977.
39. Veselaj Nuhi, Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit I, Prishtinë 1997; Foljet më -O në gjuhën shqipe, Prishtinë, 2002.
40. Xhuvani, Aleksandër, Vepra I, Tiranë 1980; Studime gjuhësore, Prishtinë 1978.

b) Fjalorë enciklopedikë e shpjegues:

1. Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë 1954.
2. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980.

3. Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë 1984.
4. Re_nik sprskohrvatskoga knji_evnog jezika, Matica srpska, Novi Sad 1967 - 1976.
5. Knjigovodstveni leksikon, Beograd 1965.
6. Pravna enciklopedija, Beograd 1985.
7. Re_nik stranih re_i i izraza (Aleksi_), Beograd 1978.
8. Veliki rje_nik stranih rje_i, izraza i kratica (B. Klai_), Zagreb 1978.
9. K. Kristoforidhi, Fjalori shqip - greqisht, Rib. Prishtinë 1977.
10. Enciklopedijski rje_nik lingvisti_kih nauka (Rikard Semeon), Zagreb 1969.
11. Turcizmi u srpskohrvatskom - hrvatskosrpskom jeziku (Škalji_Abdullah), Sarajevo 1973.
12. Fjalor i psikologjisë (P. Nushi), Prishtinë 1987.
13. Nouveau petit Larousse, Paris 1969.
14. Fjalorth kuptimesh të gjera gjeografike në shqipe (Q. Lleshi), Prishtinë 1985.
15. Fjalorth i ri (Gazulli), Tiranë 1941, rib. Prishtinë 1968.
16. Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja (M. Ndreca), Prishtinë 1986.
17. Fjalor i fjalëve të huaja, Instituti Albanologjik, Prishtinë 1988.
18. Fjalor enciklopedik shqiptar, Tiranë 1985.
19. M. Vujaklija, Leksikon stranih re_i i izraza, Beograd 1980.
20. Shefik Osmani, Fjalor i Pedagogjisë, Shtëpia botuese "Nëntori", Tiranë
21. Pedagoška enciklopedija I, II, Novi Sad 1989.

c) Fjalorë dygjuhësorë e shumëgjuhësorë të konsultuar
(përveç atyre të analizuar në punim)

1. V. Kokona, Fjalor frëngjisht - shqip, Tiranë 1966; Fjalor shqip - frëngjisht, Tiranë 1977.
2. Lacaj - Fishta, Fjalor latinisht - shqip, (ribotim) Prishtinë 1980.
3. Fjalor terminologjik juridik serbokroatisht - shqip, Prishtinë, 1972.
4. N. H. Gjini, Fjalor shqip - greqisht, Tiranë 1971.
5. Zef Simoni, Fjalor gjermanisht - shqip, Tiranë 1978.
6. Copital's concise dictionary, Bologna (...)
7. Fjalor i termave të gjuhësisë, Tiranë 1975.
8. Deutsek - Albanscher sprachführer, Tiranë 1972.
9. Tursko-srpski srpsko - turski re_nik (Agushi), Istanbul 1980.
10. (Baji_ - Dunderovi_ - Kern) Poslovni privredno-tehni_ki re_nik (srpskohrvatsko-nema_ko- englesko-francuski) Numeri_ki sistem, Beograd 1973.
11. Klasifikimi i profesioneve në Kosovë, Prishtinë 2006.